

ECONOMICUS NR 8/2012

REVISTË SHKENCORE E FAKULTETIT EKONOMIK

Kryeredaktor

Prof. Dr. ADRIAN CIVICI

Redaktore

BESARTA VLADI

Këshilli botues

Prof. Dr. SULO HADËRI

Prof. Dr. LULJETA MINXHOZI

Prof. Asoc. Dr. FATOS IBRAHIMI

Prof. Asoc. Dr. ENGJELL PERE

Dr. KRESHNIK BELLO

Dr. ZEF PREÇI

Dr. ARJAN KADARE

Dr. ELVIN MEKA

Dr. SELAMI XHEPA

Dr. NEVILA XHINDI

Dr. SHKËLZEN MARKU

ILIR HOTI, MSc

Arti grafik

Blerim BYTYÇI

ISSN 2223-6295

Miratuar si revistë shkencore nga komisioni i vlerësimit të titujve akademikë në Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës nr. 153 datë 08.10.2010

UNIVERSITETI EUROPIAN I TIRANËS / TIRANË
Bulevardi "Gjergj Fishta" / www.uet.edu.al / info@uet.edu.al



përmbajtja

ANALIZA DHE DEBATE

<i>Studimi i flukseve tregtare mbi bazën e Modelit të Gravitetit Tregtar. Rasti i Shqipërisë.....</i>	<i>5</i>
Prof. Asoc. Dr. Engjell PERE	
Godiva RËMBECI	
Arianit SHKURTI, PhD	

<i>Reforma e Zhvillimit të Sektorit të Ujit të Pijshëm dhe Ujrave të Zeza: Progresi, Rezultatet, Analiza dhe Vlerësimi</i>	<i>22</i>
Dr. Arben BAKLLAMAJA	

<i>Kultura Kombëtare dhe Gratë në Lidërsip.....</i>	<i>35</i>
Dr. Edlira Gjuraj (Tukaj)	

<i>A funksionon taksa e sheshtë?.....</i>	<i>46</i>
Enea Zafiri, MA	

ANALIZË HISTORIKE

<i>Shembja e një shteti: Shkëlqimi dhe rënia e piramidave financiare shqiptare në 1997.....</i>	<i>60</i>
Prof. Dr. Adrian CIVICI	

<i>Rreth bisedimeve shqiptaro-italiane për zbatimin e Traktatit të Pages me Italinë – 1947 (rregullimi i çështjeve me karakter ekonomik dhe financiar që rridhnin nga Traktati i Pages me Italinë)</i>	<i>68</i>
Prof.Dr. Ksenofon Krisafi	

Dossier: FINANCIMI I UNIVERSITETEVE

<i>Skema e re e financimit të Arsimit të Lartë</i>	<i>88</i>
Henri Çili, PhD	

<i>Roli i Arsimit të lartë në Ekonomi dhe format e Financimit të tij</i>	<i>100</i>
Prof. Asoc. Dr. Engjell Pere	
Prof. Dr. Luljeta Minxhozi	

<i>Financimi i Arsimit të Lartë në Shqipëri- Sfida dhe Mundësi</i>	<i>119</i>
Arbjan Mazniku, MA	
Gjergji Filipi, PhD	

<i>Modeli amerikan i universitetit dhe avantazhet e tij në tregun global të dijes dhe ekonomisë</i>	<i>130</i>
Fatos Tarifa, PhD	

<i>Një vështrim mbi renditjen e universiteteve nga Revista "Time" për periudhën 2011–2012</i>	<i>142</i>
Prof. Dr. Përparim Fuga	
Dr. Tomi Treska	

ZHVILLIME EKONOMIKE NDERKOMBETARE

<i>Vendet BRIK në arkitekturën globale të shekullit të 21-të.....</i>	<i>153</i>
Donald Shena, MA	

<i>Chinamania: Pse Kina nuk mund t'ia kalojë Amerikës si superfuqia shkencore e botës?....</i>	<i>173</i>
Fatos Tarifa PhD	
Prof. Dr. Përparim Fuga	

MATEMATIKA NE EKONOMI

<i>Një përmbledhje ekonometrike mbi analizën e modelimit shumëpërmasor. Transmetimi i çmimeve në produktet bujqësore.....</i>	<i>182</i>
Avis Andoni, MSc	

<i>Sistemi Bankar Shqiptar përballë krizës ekonomike.....</i>	<i>199</i>
Arbi Agalliu, MSc	

<i>Përdorimi optimal i të dhënave të vrojtuara: Mbi shpërndarjen e statistikës.....</i>	<i>211</i>
Prof.Asoc.Dr. Hysen Binjaku,	
Teuta Xhindi MA	

<i>Një vështrim i përgjithshëm mbi përdorimin e teknologjive të GPS dhe të sensorëve në menaxhimin e një biznesi transporti</i>	<i>220</i>
Prof. Asoc. Dr. Tamara Luarasi	
Muhamet Avdyli MSc	

<i>Një teoremë mbi pikat fikse të përbashkëta në hapësirat kuazi-metrike të dislokuara.....</i>	<i>230</i>
Prof. As. Dr. Elida Hoxha,	
Mrc. Arben Isufati	

<i>Zbulimi i autokorrelacionit në modelet ekonometrike dhe metodat e vlerësimit të tyre</i>	<i>239</i>
Raimonda Dervishi MSc,	
Prof. Asoc. Dr. Shkëlqim Kuka	

<i>Hipoteza e Porterit dhe Politika Mjedisore: Rishikimi i literaturës mbi ekonomiksën e mjedisit dhe paradigmën.....</i>	<i>252</i>
Matilda Tola	

<i>ABSTRACTS</i>	<i>259</i>
------------------------	------------

Studimi i flukseve tregtare mbi bazën e modelit të gravitetit tregtar – rasti i Shqipërisë

_____ Prof. Asoc. Dr. Engjell Pere _____

_____ Godiva Rëmbeci _____

_____ Arianit Shkurti, PhD _____

Abstrakt. Qëllimi kryesor i këtij punimi është të analizojë flukset tregtare bilaterale midis Shqipërisë dhe vendeve të tjera duke u mbështetur në modelin e gravitetit tregëtar. Ashtu sikurse në modelin e njohur klasik, bazë për studimin e këtyre lidhjeve janë marrëdhëniet tregtare midis Shqipërisë dhe vendeve të tjera, si dhe faktorët e njohur ndikues në këto flukse, si për shëmbull madhësia e ekonomive, distanca midis vendeve, diferenat në zhvillimin ekonomik të vendeve të veçanta, pjesëmarrja në marrëveshje ekonomike, etj.

Synimi i modelit është të evidentojë në rastin e Shqipërisë masën e ndikimit të faktorëve të mësipërm në flukset tregtare. Në tërësi, sot janë të njohur partnerët kryesorë të vendit përsa i përket marrëdhënieve të eksport – importit; në këtë këndvështrim, qëllimi i punimit është të shkohet më tej në analizë, duke studiuar më në detaje ndikimin e faktorëve të sipër përmendur.

Fjalë kyçe:

Modeli i gravitetit, tregtia ndërkombëtare, avantazhet krahasuese

HYRJE

Punimi i paraqitur synonon të analizojë faktorët të cilët ndikojnë në marrëdhëniet tregtare bilaterale të Shqipërisë me vendet e tjera të ekonomisë botërore. Në tërësi, modelet e përdorura në studimin e këtyre marrëdhënieve përfshijnë një gamë të gjerë. Ndër to më të njohurat janë modelet e bazuara në avantazhet konkurruese relative të cilat ekzistojnë midis vendeve të ndryshme. Megjithëse teorikisht të argumentuar, shpesh të dhënat konkrete të këtyre modeleve, nuk përputhen me rezultatet konkrete në marrëdhëniet tregtare midis vendeve të ndryshme. Në këtë këndvështrim, në literaturën ekonomike vend të veçantë zenë edhe një grup tjetër modelesh, siç janë ato të “gravitetit tregtar”.

Modelet e gravitetit tregtar synojnë të shpjegojnë marrëdhëniet tregtare midis ekonomive të ndryshme bazuar në forcat tërheqëse të “gravitetit” të cilat mund të ndikojnë në vëllimin tregëtar midis vendeve. Ndër këto forca, apo faktorë përcaktues mund të merret në konsideratë madhësia e ekonomive respektive, ndryshimet në intensitetin apo rendimentin e punës në vendet e ndryshme, largësinë midis tyre, marrëveshjet e veçanta tregtare që mund të ekzistojnë, etj.

Modelet e gravitetit tregtar janë në përgjithësi të njohur në literaturën ekonomike. Në këtë këndvështrim, qëllimi i këtij punimi është të konkretizojë në rastin e Shqipërisë ndërtimin e një modeli të tillë dhe të analizojë masën e ndikimit të faktorëve gravitacionalë në marrëdhëniet tregtare të Shqipërisë me ekonominë botërore në tërësi. Në studim janë marrë në analizë dy flukset tregtare: eksporti dhe importi; ndërsa si faktorë përcaktues janë marrë: madhësia e ekonomisë Shqiptare dhe ajo e vendeve të ndryshme, gjë e cila konkretizohet në GDP e vendeve përkatëse; avantazhet relative midis vendeve, shprehur kjo në intensitetin e punës dhe konkretizuar në model në ndryshimet që ekzistojnë midis GDP për frymë në Shqipëri dhe në vendet e tjera; distancat midis vendeve; ndryshimin e kurseve reale të këmbimit si një faktor i rëndësishëm që ndikon në marrëdhëniet tregtare; ndryshimet në konkurrueshmërinë e çmimeve, shprehur kjo në paritetin e fuqisë blerëse midis vendeve; distancën gjeografike midis tyre, si dhe ekzistencën apo jo të marrëveshjeve tregtare të veçanta midis Shqipërisë dhe vendeve të tjera.

Si bazë të dhënash në punim është marrë *CHELEM – CEPII French data base*, kjo pasi kjo data base siguron një kompleksitet më të mirë të të dhënave të nevojshme në model, si dhe paraqet një sistem dhe vlerësim më objektiv ndërkombëtar, meqënëse është fjala për marrëdhënie midis vendeve të ndryshme.

Numri i vendeve të marra në studim nga *data base* e mësipërme është 15, duke përfshirë vendet kryesore me të cilat ka marrëdhënie tregtare Shqipëria. Periudha e studiuar është ajo e viteve 1991–2009, e parë kjo si në tërësi, ashtu edhe e ndarë për vitet 1991–2000 dhe 2001–2009.

Punimi është ndarë në dy pjesë: në pjesën e parë analizohet në tërësi dinamika e zhvillimit të marrëdhënieve tregtare të Shqipërisë pas hapjes së saj me ekonominë botërore, ndërsa në pjesën e dytë analizohet modeli i gravitetit tregtar të vendit me vendet e tjera.

Analiza statistikore e marrëdhënieve tregtare të Shqipërisë: 1991-2010

Statistikat e tregtisë së jashtme përfaqsojnë një burim shumë të rëndësishëm informacioni në analizat ekonomike, duke ndihmuar kështu në vendimmarrje të rëndësishme në nivele të ndryshme egzekutive. Ato janë themelore për të vlerësuar shkallën e hapjes së ekonomisë dhe të integritit të vendit në tregtinë ndërkombëtare, veçanërisht signifikative në ditët tona kur flitet për integrimin në Europë e globalizimin në tërësi. Nga ana tjetër, analiza e këtyre statistikave është një mjet i rëndësishëm në evidentimin e faktorëve të cilët ndikojnë dhe përcaktojnë vëllimin e flukseve të eksporteve apo importeve të vendit. Në këtë këndvështrim, konkluzionet e analizave statistikore do të shërbenin edhe si një argument i rëndësishëm në pohimin apo jo të tendencave të zhvillimit që rezultojnë nga modelet e gravitetit tregëtar, të cilët megjithëse mbështeten në të dhënat statistikore, në fund të fundit paraqesin përfundime apo ligjësi vetëm statistikisht të pranueshme apo jo.


Aktualisht praktika ndërkombëtare për përgatitjen e statistikave të tregtisë së jashtme përdor dy sisteme të dhënash: (a) sistemi gjithpërfshirës i tregtisë (GTS) dhe që aplikohet në të gjitha rastet kur territori statistikor i një vendi përputhet me territorin ekonomik të tij, dhe (b) sistemi specifik i tregtisë (STS), që përfaqëson një koncept më të kufizuar dhe korespondon me rastin kur territori statistikor përfshin (mbulon) vetëm një pjesë të caktuar të territorit ekonomik të vendit. Shqipëria është rasti i aplikimit të sistemit gjithpërfshirës të tregtisë, sistem ky i rekomanduar në të gjitha materialet metodike ndërkombëtare.

1.1 Volumi i transaksioneve tregtare dhe bilanci tregtar

Volumi tregtar i mallrave në vendin tonë në vitin 2010 arriti në 6,215 milionë dollarë ose rreth 11 herë më i lartë se në viti 1993, ndërsa i krahasuar me vitin 2000 ai është pothuaj 4-fishuar.

Gjatë periudhës 1993-2010, volumi tregtar ka shënuar rritje, e cila si mesatare afatgjatë vlerësohet në rreth 15%, duke përfaqësuar mesatarisht rreth 40% të produktit të brendshëm bruto. Vlerën më të lartë, volumi i transaksioneve tregtare e shënoi në vitin 2008, ndërsa si kontribut ndaj GDP në vitin 2010, duke arritur në 53% të tij (grafiku 1).


Grafiku 1: *Volumi tregtar ndaj GDP-së. 1993-2010 (milion USD)*



Burimi: Banka e Shqipërisë

Pavarësisht rritjes në terma nominale analiza e volumit tregtar në formën e një indeksi zinxhir për periudhën 1993-2010, demonstron ngritje dhe ulje të herëpashërshme, por rëniet më të theksuara janë shënuar përkatësisht në vitet 1997 dhe 2009, të cilat përkojnë edhe me momentet e vështira të kolapsit të shtetit apo shfaqjes së pasojave të krizës financiare botërore (grafiku 2).

Grafiku 2: Dinamika e volumit tregtar (1994-2010)




Burimi: Banka e Shqipërisë.

Historikisht ekonomia shqiptare është karakterizuar nga një bilanc tregtar negativ me një rritje mesatare afatgjatë prej rreth 16 përqind. Koefficienti mesatar afatgjatë i mbulimit të importeve nga eksportet, llogaritet në masën 26 përqind. Vetëm në vitin 2010 për shkak të rritjes me 50% të eksporteve, koefficienti i mbulimit shënon vlerën prej 34 përqind, që përfaqëson edhe nivelin më të lartë në këto 20 vjet. Struktura e volumit të transaksioneve tregtare, ku dominojnë transaksionet në formën e importeve, shpjegon edhe ngjashmërinë e dinamikës së bilancit tregtar me atë të volumit tregtar. Kështu gjatë këtyre dy dekadave vlerën më të lartë bilanci tregtar e ka arritur në vitin 2008 duke shënuar rreth 3,9 miliard dollarë ose rreth 30 përqind të Produktit të Brendshëm Bruto, ndërsa rritja mesatare vjetore më e lartë e tij është regjistruar në vitin 2007, me rreth 39 përqind.

Analiza e detajuar e dinamikës së transaksioneve të eksportit dhe importit tregon se pavarësisht se eksportet përfaqësojnë rreth 1/3 e importeve, ritmet e rritjes së tyre janë më të larta se ritmet e rritjes së importeve, konkretisht ritmi mesatar afatgjatë i eksporteve llogaritet në 18 përqind ndërsa ai i importeve në 16 përqind. Vlerën më të lartë të ritmit vjetor të rritjes me rreth 50%, eksportet e kanë shënuar në vitin 2010, ndërsa importet vlerën e tyre më të lartë të ritmit vjetor të rritjes, me rreth 38 përqind, e kanë shënuar në vitin 2007. Ndërkohë kriza botërore financiare nuk mund të kalonte pa pasoja edhe në ekonominë tonë, kështu viti 2009 shënon një rënie vjetore të eksporteve dhe importeve me përkatësisht 23 dhe 13 përqind. Ndërsa viti 2010 u mbyll me një deficit të tregtisë së mallrave prej rreth 3,1 miliardë dollarë nga 3,5 miliardë dollarë në vitin 2009, ose me një ngushtim prej 12%. Ritmet më të shpejta të rritjes të eksporteve ndaj importeve këto vitet e fundit kanë ndikuar edhe në zbutjen e pozicionit negative të bilancit tregtar mallrave (grafiku 3).

Grafiku 3: Vëllimi i tregtisë së jashtme.
(milion USD)



Burimi: Banka e Shqipërisë.

1.2 Struktura e tregtisë së jashtme sipas grup – mallrave.

Krahas analizës së volumit tregtar, me rëndësi të madhe për të kuptuar strukturën e ekonomisë dhe se cilat janë avantazhet konkurruese të saj, është analiza e transaksioneve tregtare sipas mallrave.

Struktura e përgjithshme e importeve sipas mallrave dominohet nga kategoritë: “mallra të përpunuara”, “makineri e pajisje”, dhe “mallrat ushqimore” të cilat së bashku përfaqësojnë rreth 75 përqind të importeve gjithsej. Analiza e dinamikës së strukturës së importeve, duke e ndarë periudhën 20 vjeçare në dy dekada të veçanta, demonstron se importet e kategorive “mallrave të përpunuara” dhe “makineri e pajisje” kanë ruajtur një peshë pothuaj konstante, respektivisht në 32 dhe 22 përqind të importeve gjithsej (tabela 1).

Krejt ndryshe paraqiten kategoritë “mallra ushqimore” dhe “lëndë djegëse” të cilat në dekadën e parë përfaqësonin përkatësisht 21 dhe 6 përqind të importeve gjithsej, ndërsa në dekadën e dytë, është zvogëluar përfaqësimi në strukturë i kategorisë “mallra ushqimore” në rreth 13 përqind dhe është rritur përfaqësimi i kategorisë “lëndë djegëse”, përkatësisht me 12 përqind.

Rritja e peshës së “lëndëve djegëse”, i detyrohet jo vetëm rritjes së kërkesës së brendshme për “lëndë djegëse” por sidomos rritjes së çmimeve që kanë pësuar karburantet në 10 vjeçarin e fundit. Ndryshimi i moderuar i strukturës së importeve në dekadën e dytë në favor të mallrave kapitale dhe mallrave të konsumit final, dëshmon për fillesat e riorientimit të ekonomisë kombëtare drejt aktiviteteve prodhuese por edhe të shtimit dhe zgjerimit të aktiviteteve të shërbimeve.


Tabela 1: Dinamika e ndryshimit të strukturës së importeve 1995-2010 (%)

Struktura e Importeve	1995	2000	2005	2010
<i>Ushqime dhe kafshë të gjalla</i>	23	16	13	13
<i>Pije dhe duhan</i>	3	4	3	4
<i>Materiale të papërpunuara</i>	3	5	4	2
<i>Lëndë djegëse</i>	9	9	9	14
<i>Yndyrna bimore dhe shtazore</i>	2	2	1	1
<i>Produkte kimike</i>	7	8	10	11
<i>Mallra të përpunuar</i>	31	36	37	36
<i>Makineri dhe pajisje</i>	23	21	23	19
Gjithsej, importe	100	100	100	100

Burimi: Banka e Shqipërisë

Aktualisht, për vitin 2010, struktura e importeve shqiptare paraqitet në grafikun 4:

Grafiku 4: Struktura e importeve sipas grup mallrave 2010 (%).




Burimi: Banka e Shqipërisë

Struktura e përgjithshme e eksporteve gjatë periudhës 1993-2010 tregon se rreth 70 përqind e eksportit shqiptar përbëhet nga ri-eksportet në formën e mallrave të veshmbathjes dhe të lëkurë –këpucëve. Pesha e ri –eksporteve vlerësohet në të njëjtin nivel gjatë dy dekadave ndërkohë kategoritë e tjera të mallrave të eksporteve kanë pësuar ndryshime, konkretisht kategoritë “materiale të përpunuara” dhe “lëndë djegëse” në dekadën e parë përfaqësonin përkatësisht 14 dhe 3 përqind të eksporteve gjithsej, ndërsa në dekadën e dytë pesha e tyre vlerësohet me 9 përqind për të dyja kategoritë e mësipërme.

Eksportet shqiptare në fund të vitit 2010 shënuan një vlerë prej rreth 1,6 miliard dollarë, ose 5 herë më shumë se sa vlera e eksporteve në vitin 2000. Me përjashtim të kategorisë “pije dhe duhan” të gjitha kategoritë e tjera kanë shënuar rritje, por rritjen më të lartë e ka shënuar kategoria “lëndë djegëse” dhe “materiale të përpunuara”, përkatësisht 55 dhe 13 herë.

Eksportet gjatë vitit 2010 regjistruan një rritje vjetore prej rreth 56%, kryesisht si pasojë e rritjes së konsiderueshme të vlerës së eksporteve të kategorisë ‘mallra të përpunuara të klasifikuara sipas materialit’ si edhe të kategorisë ‘lëndë djegëse’. Të ardhurat nga eksportet e lëndëve djegëse gjatë vitit 2010 ishin rreth 120 milionë euro më shumë se një vit më parë, kryesisht si pasojë e rritjes së eksporteve të energji elektrike. Eksportet e energjisë elektrike gjeneruan rreth 3.5 herë më shumë të ardhura vjetore, ndërsa sasia e eksportuar u rrit me 4.3 herë krahasuar me vitin 2009. Struktura e mallrave dhe shërbimeve të importuara në vitin 2010 paraqitet në grafikun 5.

Grafiku 5: Struktura e eksporteve sipas grup mallrave 2010 (%).



Burimi: Banka e Shqipërisë

1.3 Struktura e tregtisë së jashtme sipas vendeve.


Dinamika e strukturës së importeve sipas vendeve, e analizuar sipas dekadave, tregon orientimin e përqëndruar të saj drejt vendeve europiane, importet me të cilat përfaqsojnë rreth 82 përqind të totalit të importeve (deri në vitin 2000) dhe rreth 64 përqind të importeve gjithsej në vitin 2010. Brenda vendeve europiane, shtetet fqinje (Italia dhe Greqia) përfaqësojnë respektivisht rreth 78 dhe 68 përqind të importeve të Shqipërisë. Megjithatë në terma nominale, volumi i importeve nga këto vende është pothuaj 3 fishuar në dekadën e dytë. Struktura e përgjithshme e mallrave demonstroi edhe një zgjerim të dimensionit gjeografik të importeve nga vendet aziatike dhe amerikane së veriut. Ndërkohë edhe brenda grupit të shteteve europiane, analiza e detajuar me rajone gjeografike, tregon se ka një rritje të konsiderueshme të importeve në dekadën e dytë, kryesisht nga Rusia, rritje e cila vlerësohet të jetë rreth 26 herë më e lartë dhe që ka ndikuar edhe në strukturën e përgjithshme të importeve, duke bërë që të rritet përfaqësimi i importeve me Rusinë nga 1 në rreth 5 përqind të importeve nga vendet europiane. Importet me vendet e Ballkanit në strukturën e përgjithshme me vendet e Europës, kanë shënuar një rritje të lehtë në dekadën e dytë nga 4 në 6 përqind. Nga vendet e Ballkanit, rreth 50 përqind e importeve vijnë nga Maqedonia, importet e së cilës janë 5- fishuar në dekadën e dytë, krahasuar me periudhën paraardhëse 1993-2000.

Edhe gjatë vitit 2010 tregtia në mallra e Shqipërisë me pjesën tjetër të botës ka ruajtur strukturën gjeografike të viteve të mëparshme. Rreth 65% e importeve të regjistruara ka ardhur nga vende të Bashkimit Evropian, ndër të cilat peshën kryesore vijon ta zërë Italia me 28% të importeve të përgjithshme dhe 44% të

importeve nga Bashkimi Evropian. Në vend të dytë renditet Greqia me 14% të importeve të përgjithshme dhe 20% të importeve nga Bashkimi Evropian. Ndryshe nga viti 2009, gjatë të cilit importet nga partnerët kryesorë tregtarë shënuan rënie, gjatë vitit 2010 importet nga këto vende janë rritur me rreth 8%. Importet nga Italia janë ishin 16% më të larta se një vit më parë, ndërsa tregtia me Greqinë shënoi rënie vjetore prej 9%.

Gjatë vitit 2010 është regjistruar një rritje prej 5% në importe nga vendet jashtë Bashkimit Evropian. Në këtë grup vendesh, peshën kryesore e zënë Kina dhe Turqia, prej të cilave kanë ardhur 12% e importeve të përgjithshme. Importet nga Kina dhe Turqia kanë shënuar rënie vjetore prej përkatësisht 8% dhe 6%. Për vitin 2010, struktura e importeve sipas vendeve paraqitet në grafikun 6.

Grafiku 6: Struktura e importeve sipas shteteve 2010 (%).



Burimi: Banka e Shqipërisë

Në krahun e eksporteve, dinamika e zhvillimit të tyre sipas shteteve, shënon ndryshime të dukshme në drejtim të rritjes së volumit dhe peshës specifike të tyre duke u fokusuar në analizën në dy periudha të mëdha kohore, 1993-2000 dhe 2001-2010. Shtetet kryesore drejt të cilave janë të orientuara eksportet shqiptare janë Italia dhe Greqia të cilat së bashku përfitojnë rreth 72 - 73 përqind të eksporteve gjithsej. Gjermania është vendi i tretë për nga renditja e madhësisë së volumit të eksporteve tona, duke përfutur rreth 6 përqind të totalit të eksporteve. Analiza e strukturës së eksporteve sipas shteteve për të dy dekadat, tregon se pavarësisht rritjes në terma nominale të vlerës së eksporteve, pesha specifike e tyre ka pësuar ndryshime të dukshme, siç paraqitet edhe në tabelën 2:

Eksportet me Italinë janë 5 fishuar dhe po ashtu është rritur edhe pesha specifike e tyre me 7 pikë, ndërsa eksportet me Greqinë janë rritur 2,2 herë ndërkohë që pesha e tyre në totalin e eksporteve ka rënë me 5 pikë. Po

kështu edhe eksportet me Gjermaninë janë pothuaj 2 fishuar. Ndërkohë eksportet me vendet e Ballkanit kanë pësuar ndryshime akoma më të konsiderueshme, ndër të cilat më të rëndësishme janë ritmet e rritjes së eksporteve me Serbinë dhe Maqedoninë, përkatësisht me 7 dhe 3 herë. Gjatë vitit 2010 kontributin kryesor në rritjen prej 56% të eksporteve të përgjithshme e ka dhënë rritja e eksporteve drejt Italisë me 30%. Italia gjatë vitit 2010 ishte destinacioni i 51% të eksporteve të përgjithshme dhe 73% të eksporteve drejt Bashkimit Evropian. Rritje e ndjeshme vjetore është regjistruar edhe në eksportet drejt vendeve jashtë Bashkimit Evropian, të cilat gjatë këtij viti u dyfishuan duke arritur vlerën 350 milionë euro. Në këtë grup vendesh, rritja e të ardhurave ka ardhur kryesisht nga rritja e eksporteve drejt Turqisë, Kinës dhe Zvicrës. Eksportet drejt këtyre vendeve gjatë vitit 2010 ishin rreth 180 milionë euro ose rreth 3 herë më të larta nga eksportet e një viti më parë.

Tabela 2: Dinamika e strukturës së eksporteve sipas shteteve 1993-2010 (%)

Shtetet	1993-2000		2001-2010		(2) / (1)
	Volum (1)	%	Volum (2)	%	%
Gjermani	94	5.98	257	3.14	1.73
Greqi	224	14.24	729	8.9	2.25
Itali	906	57.6	5.29	64.6	4.84
Serbi & Mali i Zi	15	0.95	120	1.47	7
Maqedoni	47	2.99	170	2.08	2.62
Turqi	28	1.78	191	2.33	5.82
Të tjera	259	16.47	1.432	17.49	4.53
Totali	1.573	100	8.189	100	4.21

Burimi: Banka e Shqipërisë

Modeli i gravitetit tregtar në rastin e Shqipërisë

2.1 Natyra e modeleve të gravitetit tregtar

Një mënyrë alternative e studimit të marrëdhënieve tregtare midis vendeve është edhe ajo e bazuar në modelet e gravitetit tregtar. Këto modele, ashtu sikurse edhe teoria e gravitetit të Newton-it, mbështeten në idenë se vendet e ndryshme “tërhiqen” në marrëdhëniet tregtare midis tyre nga “forca” apo faktorë të caktuar, ndër të cilët më kryesorët janë masa e ekonomive përkatëse dhe distanca midis tyre. Ashtu sikurse në teorinë e gravitetit, edhe këtu mendohet se sa më e madhe të

jetë “masa” e vendeve dhe sa më afër të jenë ata me njëri tjetrin, aq më shumë do të “tërhiqen” ata në marrëdhëniet tregtare.

Karakteristikë në modelet e gravitetit është fakti se në to mund të integrohen edhe faktorë të tjerë “rëndesë” përveç madhësisë së ekonomisë dhe distancës së vendeve. Kështu llogjikisht në model mund të analizohet vartësia e flukseve tregtare edhe nga diferencat në specializimin e vendeve të ndryshme në drejtim të një intensiteti, apo produktiviteti, më të madh të punës; teorikisht mund të supozohet se industritë e vendet me produktivitet relativisht më të madh të punës, do të kenë avantazhe krahasuese në krahasim me të njëjtat industri të një vendi tjetër, duke ndikuar kështu në flukset eksportuese apo importuese midis vendeve.

Faktorë të tjerë të cilët mund të merren në konsideratë në modelet e gravitetit tregtar janë për shembull edhe marrëveshjet e veçanta që mund të kenë nënshkruar vendet e ndryshme, si për shembull marrëveshjet doganore marrëveshjet e tregtisë së lirë, unionet ekonomike, etj. Këto marrëveshje duke ndikuar në lehtësimin e marrëdhënieve tregtare midis vendeve, do të influencojnë edhe në madhësinë e këtyre flukseve.

Më tej në model mund të përfshihen edhe treguesit të cilët lidhen me konkurueshmërinë e çmimeve midis vendeve të ndryshme, si dhe ndryshimin e kurseve reale të këmbimit. Në raste specifike, marrëdhëniet tregtare përcaktohen edhe nga faktorë të tjerë, si për shembull, gjuha, kultura, apo zakonet e popujve të ndryshëm. Në këto raste modelet e gravitetit mund të zgjerohen duke përfshirë pikërisht edhe këto faktorë.

Modelet e para të gravitetit tregtar u ndërtuan në mënyrë intuitive, ndoshta pa një mbështetje të qëndrueshme teorike. Ndër këto modele përmenden ato të Beckerman (1956), Linnemann (1966), Tinbergen (1962) dhe Poyhonen (1963). Flukset tregtare në analizat e tyre mbështeteshin kryesisht në tre faktorë: madhësinë e ofertës së vendeve eksportuese, kërkesën e vendeve importuese dhe faktorë të cilët lidhen me “rezistencën” në tregti, siç është për shembull distanca midis vendeve, kosto e transportit dhe marrëveshjet tregtare midis tyre. Modelet e gravitetit morën një argumentim më të mirë teorik më vonë me ndërtimin e teorisë së re të tregtisë ndërkombëtare bazuar në konkurrencën jo perfekte. Në këtë aspekt në literaturë theksohet kontributi i Helpman dhe Krugman (1985), të cilët formalizuan në model unifikimin e flukseve tregtare brenda të njëjtës industrie (intra – trade), me ato midis industrive të ndryshme (inter – trade). Më vonë modeli i gravitetit u zgjerua më tej nga Bergstrand (1989) i cili përfshiu në model edhe variablin e të ardhurat për frymë të popullsisë, variabël i cili konkretizon në model intensitetin (produktivitetin) e punës në vendet e ndryshme. Diferenca në të ardhurat për frymë, në fund të fundit do të thotë një diferencë e produktivitetit të punës midis vendeve dhe rezulton nga një paisje më e mirë me fonde kapitale e një vendi, në krahasim me një vend tjetër. Në këtë këndvështrim, diferencat midis GDP-së për frymë midis vendeve, do të paraqesin edhe një avantazh konkurses të një vendi ndaj një tjetri,

duke ndikuar kështu edhe në flukset tregtare midis tyre. Përfshirja e këtij variabli në model, si dhe e disa të tjerë variabla monetarë, (kompetitiviteti i çmimeve, pariteti i fuqisë blerëse, etj.), i dhanë modelit të gravitetit tregtar një trajtim më kompleks.

2.2 Ndërtimi i modelit të gravitetit tregtar në rastin e Shqipërisë

Në aspektin ekonometrik, modelet e gravitetit tregtar janë të ndryshme. Në tërësi përpunimet trajtojnë aspekte metodologjike të ndërtimit të një modeli të tillë, i cili të jetë sa më i përafërt me vlerat reale, (shih Matyas 1997).

Në këtë punim, si model ekonometrik është marrë ai i *panel data*, i cili jep rezultate më të mira krahasuar me modelet e *cross – sector data*, Egger (2000). Ndërtimi dhe analiza e të dhënave bazohen në të dhënat e marra nga *CHELEM – CEPII French data base*, i cili mund të sigurojë kompleksitetin e të dhënave të përdorura në model. Data base i zgjedhur pasqyron marrëdhëniet e eksport – importit të Shqipërisë më 15 vende, për periudhën 1991-2009. Numri i vendeve është kufizuar në 15, pasi për to mund të siguroheshin edhe të dhënat e tjera të nevojshme për modelin, sidoqoftë këto vende përfaqësojnë rreth 70% të eksporteve dhe mbi 85% të importeve shqiptare për vitin 2010.

Në model si faktorë variabël dhe graviteti të flukseve të eksporteve dhe importeve janë marrë: (a) GDP e Shqipërisë dhe e vendeve përkatëse, ky tregues konsiderohet në model si një faktor që përcakton madhësinë e ekonomive të dy vendeve të ndryshme në marrëdhëniet e tyre tregtare. Mund të supozohet se sa më e madhe të jetë GDP e një vendi aq më e fuqishme do të jetë edhe “fuqia” e tij tërheqëse në flukset ekonomike, apo aq më shumë eksporte do të këtë ky vend ndaj vendit tjetër. (b) Diferenca e GDP-së për frymë të popullsisë midis vendeve. Të ardhurat për frymë të popullsisë, (GDP/frymë), konsiderohet një tregues i cili shpreh avantazhet e paisjes me fonde (kapital) të vendit përkatës. Sa më i madh të jetë ky tregues, aq më i lartë pritet të jetë edhe efektiviteti i punës, apo GDP për një punonjës, kjo pasi rendimenti i punës konsiderohet përpjestimor më paisjen me fonde të një punonjësi.

Nga ana tjetër, GDP/frymë, konsiderohet edhe si një tregues i cili shpreh avantazhet relative të një vendi, ndaj një vend tjetër në drejtim të kontributit të kapitalit apo të punës së gjallë në GDP. Sa më e madhe të jetë diferenca për këtë tregues midis dy vendeve, aq më shumë mendohet të jenë diferencat në avantazhet relative konkurruese, pra aq më shumë pritet të tregtojnë vendet midis tyre. (c) Distanca midis vendeve konsiderohet si një tjetër faktor i rëndësishëm në model. Largësia midis vendeve konsiderohet si një faktor frenues i tregtisë, sa më larg të jëne ato nga njëri-tjetri, aq më të pakta priten flukset tregtare midis tyre. (d) Ndryshimi i kursit real të këmbimit është një variabël tjetër në model, i cili sigurisht nxit eksportet e një vendi, në rast rivlerësimi të monedhës vendase, apo importet, në rast të zhveftësimit të kësaj monedhe. (e) Pariteti i fuqisë blerëse (PPP – *Purching Power Parity*), është variabli i cili merr në konsideratë konkurrueshmërinë e sistemit të çmimeve në vende të ndryshme. Ekziston një analogji midis kursit të këmbimit dhe PPP. Nga ana tjetër

kursi real i këmbimit është i lidhur më drejtpërdrejtë në marrëdhëniet tregtare, pasi ai rezulton mbi bazën e ofertës dhe kërkesës së monedhës së huaj. Megjithatë, mjaft tregues të shprehur në monedhë ndërkombëtare, zakonisht USD, mund të kenë diferenca nëse ato vlerësohen mbi bazën e kursit të këmbimit apo PPP, e cila llogaritet për një shportë të caktuar mallrash dhe shërbimesh. Për këtë arsye në model mund të përfshihet edhe PPP, normalisht sa më i rritur të jetë PPP të një vendi, aq më kompetitive konsiderohen çmimet e mallrave të këtij vendi ndaj vendit tjetër, pra aq më e rritur mund të konsiderohet fuqia e tij eksportuese. (f) Variabël tjetër është ai i ekzistencës apo jo i marrëveshjeve tregtare midis vendeve të ndryshme. Ekzistenca e këtyre marrëveshjeve sigurisht favorizon tregtinë midis vendeve.

Në aspektin metodologjik nënvizojmë se, variablat e mësipërm në modelin e trajtuar në këtë punim, janë marrë nga *CHELEM – CEPII French data base*. Vlerësimet e treguesve si eksportet dhe importet, GDP dhe GDP/frymë janë shprehur në million USD. Distanca midis vendeve, sipas data base është llogaritur në mënyrë të ponderuar duke marrë parasysh distancën e qyteteve kryesore të vendeve për të cilën është llogaritur kjo distancë. Përsa i takon kurseve reale të këmbimit si dhe PPP, treguesit e marrë në data base shprehin në fakt ndryshimin e tyre relative nga një vit në tjetrin, ndërsa për paritetin e fuqisë blerëse, vlerësimet bëhen në mbi bazën e dollarit amerikan (USD). Ekzistenca apo jo e marrëveshjeve të veçanta tregtare në rastin e Shqipërisë, ka marrë parasysh nënshkrimin e marrëveshjeve të tregtisë së lirë midis vendit tonë dhe vendeve respektive Ballkanike, sipas viteve përkatëse të nënshkrimit të këtyre marrëveshjeve. Ky variabël është trajtuar në punim si variabël *dummy*, në rastin e ekzistencës së marrëveshjes ai ka marrë vlerën 1, ndërsa në rastin e mos ekzistencës së marrëveshjes është shënuar me 0.

Pas këtyre trajtimeve metodologjike, modelin ekonometrik të vartësive të flukseve tregtare, eksporteve dhe importeve të Shqipërisë, nga variablat përkatës, do ta paraqisim nëpërmjet dy barazimeve respektive të mëposhtëmë:

$$Ex_{jt} = e^{a_0} GDP_t^{a_1} GDP_t^{a_2} GDPF_{jt}^{a_3} Dist_j^{a_4} Exh_{jt}^{a_5} PPP_{jt}^{a_6} e^{a_7 Agr_{jt}} e^{\varepsilon_{jt}}$$

$$Im_{jt} = e^{a_0} GDP_t^{a_1} GDP_t^{a_2} GDPF_{jt}^{a_3} Dist_j^{a_4} Exh_{jt}^{a_5} PPP_{jt}^{a_6} e^{a_7 Agr_{jt}} e^{\varepsilon_{jt}}$$

ku:

Ex_{jt}	eksporti i Shqipërisë ndaj vendit –j, në periudhën –t.
Im_{jt}	importi i Shqipërisë ndaj vendit –j, në periudhën –t
GDP_t	produkti i brendshëm bruto i Shqipërisë në vitin –t
GDP_{jt}	produkti i brendshëm bruto i vendit –j në vitin –t
$GDPF_{jt}$	diferenca e produktit të brendshëm bruto për frymë, e vendin –j ndaj produktit të brendshëm bruto për frymë të Shqipërisë, për vitin –t
$Dist_j$	distanca midis Shqipërisë dhe vendit –j

Exh_{jt}	ndryshimi i kursit real të këmbimit të vendit -j ndaj Shqipërisë, në vitin -t
PPP_{jt}	ndryshimi i paritetit të fuqisë blerëse të vendit -j ndaj Shqipërisë, në vitin -t
Agr_{jt}	variabli <i>dummy</i> i ekzistencës së marrëveshjeve të tregëtisë së lirë midis Shqipërisë dhe vendit përkatës -j në vitin -t, (merr vlerën 1 ose 0).
ε_{jt}	termi i gabimit në model
a_i	koeficientët e proporcionalitetit.
e	baza e logaritmit natyror

Sipas analizave të kryera në mjaft studime, rezultate më të mira i jep logaritimi anë për anë i funksioneve të mësipërme, nga ku do të kemi:

$$\ln(Ex_{jt}) = a_0 + a_1 \ln(GDP_t) + a_2 \ln(GDP_{jt}) + a_3 \ln(GDPF_{jt}) + a_4 \ln(Dist_j) + a_5 \ln(Exh_{jt}) + a_6 \ln(PPP_{jt}) + a_7 Agr_{jt} + \varepsilon_{jt}$$

$$\ln(Im_{jt}) = a_0 + a_1 \ln(GDP_t) + a_2 \ln(GDP_{jt}) + a_3 \ln(GDPF_{jt}) + a_4 \ln(Dist_j) + a_5 \ln(Exh_{jt}) + a_6 \ln(PPP_{jt}) + a_7 Agr_{jt} + \varepsilon_{jt}$$

Në rastin e këtyre funksioneve logaritmikë, vlera e koeficientëve $-a_i$, (për i nga 1 në 6), do të interpretohet si përqindje e ndryshimit të variablave të varur (Ex dhe Im), për çdo 1 përqind të ndryshimit të variablave të varur në model; ndërsa vlera e koeficientit a_7 , do të tregojë se sa përqind ndikon në variablat e varur ekzistenca e marrëveshjeve të tregëtisë së lirë midis vendeve.

Përpunimi statistikor me programin STATA i të dhënave të marra është pasqyruar në tabelen 3. Nga llogaritjet fillestare, *p-value* për mjaft tregues ka rezultuar e lartë, gjë që do të thotë se vlera e koeficientëve përkatës, është statistikisht jo e rëndësishme dhe për këtë arsye ato nuk janë marrë në konsideratë. Më tej është përsëritur analiza e korelacionit vetëm me variablat signifikativ dhe të dhënat përfundimtare janë pasqyruar në tabelën 3.

Nga rezultatet e marra vihet re se faktorët kryesorë “tërheqës”, si në eksporte ashtu edhe në importetet Shqiptare, kanë qenë dy: së pari distancat midis vendeve dhe së dyti madhësia e ekonomive me të cilat Shqipëria ka patur marrëdhënie tregtare. Sidoqoftë, në dhjetvjeçarin e fundit 2001-2009, ndikim në marrëdhëniet e tregëtisë së jashtme ka luajtur edhe madhësia e GDP së vendit.: Në vitet 1991 – 2000, të dhënat tregojnë se në importetet e vendit ka patur influencë edhe diferenca e të ardhurave për frymë (GDPF), por karakteristike është se ky ndikim ka shenjë minus, gjë që do të thotë se nuk është vërtetuar, qoftë edhe për këtë periudhë, teoria e avantazheve krahasuese (sipas teorisë klasike dhe modelit H-O), apo e thënë ndryshe, struktura e importeve shqiptare nuk ka qenë e orientuar nga

produktet me nivel relativisht më të lartë teknologjik, ashtu sikurse pritet nga teoria e mësipërme. Dy faktorë të tjerë evidentohen vetëm në tërësi për periudhën 1991 – 2001: (i) ndikim në importe ka patur ndryshimi i kursit real të këmbimit, fuqizimi i kursit të monedhës vëndase ka nxitur importet. (ii) Marrëveshjet e tregtisë së lirë me vendet e rajonit kanë ndikur pozitivisht vetëm në drejtim të flukseve importuese, ndërsa statistikisht nuk mund të evidentohet ndikimi i tyre në eksporte.

Tabela 3

Variablat		1991-2000		2001-2009		1991-2009	
		Eksporte	Importe	Eksporte	Importe	Eksporte	Importe
GDP	Coef.			2.9351840	3.2786430	0.8871083	2.3304650
	Std. Err.			0.4541331	0.2436294	0.1817706	0.3138638
	p			0.000	0.000	0.000	0.000
GDP _j	Coef.	1.0725330	1.2860530	1.5124950	1.2599210	1.4421330	1.1779890
	Std. Err.	0.2201991	0.2096792	0.1882853	0.1815627	0.2178461	0.1651868
	p	0.000	0.000	0.000	0.000	0.000	0.000
GDPF _j	Coef.		-0.6207727				
	Std. Err.		0.2318220				
	p		0.007				
Exh _j	Coef.						0.8605470
	Std. Err.						0.2322537
	p						0.000
PPP _j	Coef.						
	Std. Err.						
	p						
Dist _{tal}	Coef.	-2.0224980	-1.9613830	-2.7168860	-2.5353720	-2.7087960	-2.5089510
	Std. Err.	0.4610340	0.3965615	0.3692412	0.4008498	0.4922577	0.3574876
	p	0.000	0.000	0.000	0.000	0.000	0.000
Reg _j	Coef.						0.3844551
	Std. Err.						0.2004481
	p						0.055
Cost.	Coef.		5.9511560	-25.8592400	-27.3539000	-6.7200020	-17.8080900
	Std. Err.		1.8015700	4.7000270	2.7887900	2.5763310	3.0478020
	p		0.001	0.000	0.000	0.009	0.000
R-square		0.5455	0.6273	0.729	0.7473	0.6332	0.6213
Observation		128	136	127	134	259	256
Number of Groups		14	14	15	15	14	14
Wald chi2(7)		23.95	37.94	134.87	349.11	137.89	365.02
Prob > chi2		0.0004	0.0000	0.0000	0.0000	0.0000	0.0000

Konkluzione:

- Analiza statistikore e marrëdhënieve tregtare të Shqipërisë me vendet e tjera tregon se kjo tregti është përqendruar kryesisht me vendet fqinjë, Italinë e Greqinë. Nga ana tjetër, vitet e fundit vihet re rritja e peshës së importeve me vendet të cilat janë karakterizuar nga një rritje e konsiderueshme ekonomike, siç është Kina dhe Turqia, por edhe Rusia
- Sipas modelit të gravitetit tregtar, në tërësi për periudhën 1991 – 2009, statistikisht ndikim statistikisht në flukset tregtare të Shqipërisë kanë patur dy faktorë kryesorë: GDP koresponduese e ekonomive të huaja dhe distanca gjeografike midis Shqipërisë dhe këtyre vendeve. Ndikimi i këtyre faktorëve vërehet si për eksportet ashtu edhe për importet, si dhe në secilin nga dy 10-vjeçarët e marrë në analizë. Së bashku me tre faktorët e tjerë, si madhësia e GDP së vendit, ndryshimi i kursit real të këmbimit dhe marrëveshjet e tregtisë së lirë, (ndikimi i të cilëve nuk ka qënë konstant gjatë gjithë periudhës së marrë në studim), këto faktorë përfaqësojnë rreth 55-73% të faktorëve që kanë ndikuar në eksporte dhe rreth 63% të faktorëve që kanë ndikuar në importe.
- Madhësia e ekonomive të vendeve koresponduese, (shprehur në GDP e tyre) ka patur një ndikim pozitiv në flukset tregtare. Koeficientët e proporcionalitetit, tregojnë se për të gjithë periudhën 1991 – 2009, rritja e madhësisë së ekonomive partnere me 1%, sjell përkatësisht 1,44% rritje në eksporte dhe 1,78% rritje në importe.
- Ndikimi në tregti i madhësisë së ekonomisë vendase vërehet vetëm në 10-vjeçarin e dytë 2001-2009. Për këtë periudhë, një rritje 1% e GDP-së së vendit, statistikisht ka ndikuar 2,94% në eksporte dhe 3,28% në importe. Kjo nga ana tjetër tregon se ndikimi në marrëdhëniet tregtare është influencuar më shumë nga rritja e kërkesës vendase se sa nga rritja e ofertës.
- Distanca midis vendeve, sigurisht ka patur një ndikim negativ në tregti. 1% e rritjes së saj ka sjellë një ndikim prej -1,71% në eksporte dhe -2,51% në importe. Nga të dhënat shihet se statistikisht ky ndikim negativ është më i fuqishëm në periudhën 1991-2000 në krahasim me periudhën 2001-2009 (ndoshta pasi në vitet 2001-2009 kanë ndikuar edhe faktorë të tjerë).
- Ndikimi i avantazheve konkurruese, të shprehura në model nëpërmjet diferencës së të ardhurave për frymë midis vendeve, duket se nuk ka qënë një faktor nxitës për marrëdhëniet tregtare. Statistikisht ky ndikim vërehet vetëm për vitet 1991-2000 dhe vetëm për importet Shqiptare. Nga ana tjetër, shenja negative e koeficientit -0.62, tregon se edhe për këtë periudhë ndikimi ka qënë negativ, pra nuk është vërejtur një strukturë importesh në drejtim të produkteve të industrializuar, apo të teknologjisë së lartë, sikurse mund të pritët nga teoria e avantazheve krahasuese në rastin e Shqipërisë.
- Marrëveshjet e tregtisë së lirë, të miratuara me vendet e rajonit, statistikisht

nuk kanë patur ndikim të konsiderueshëm në tregti. Nënshkrimi i këtyre marrveshjeve është bërë në periudhën 2002-2006, megjithatë statistikisht nuk mund të evidentohet impakti i tyre në periudhën 2001-2009. Edhe për të gjitha vitet e marra së bashku ndikimi është minimal, koeficienti përkatës tregon se, nëse në një vend ekziston një marrëveshje e tregtisë së lirë, atëherë kjo do të influencojë vetëm 0.38% në rritjen e importeve të këtij vendi.

- Ndikimi i ndryshimit të kursit real të këmbimit statistikisht vërehet vetëm nëse merret në analizë në tërësi periudha 1991-2009. Sidoqoftë ky ndikim ka qënë i reduktuar dhe vetëm në drejtim të importeve. Koeficienti paraqet se 1% rritje e kursit real të monedhës vendase, ka sjellë rreth 0.86% rritje në importe.

Bibliografia:

Banka e Shqipërisë <http://www.bankofalbania.org/>

Beckerman, W. (1956) "Distance and the pattern of intra-European trade", *Review of Economics and Statistics*, 38, 31-40

Linnemann, H., "An Econometric Study of International Trade Flows", *North Holland Publishing Company, Amsterdam*, 1966.

Tinbergen, J. (1962) "Shaping the world economy: suggestions for an international economic policy", *Twentieth Century Fund, New York*.

Poyhonen, P. (1963) "A Tentative Model for the Volume of Trade between Countries", *Weltwirtschaftliches Archiv*, 90, 93-9.

Helpman, E. dhe Krugman, P. (1985) "Market Structure and Foreign Trade. Increasing Returns, Imperfect Competition, and the International Economy", *Cambridge MA/ London: MIT Pres.* 1985.

Matyas, L., (1997) "Proper Econometric Specification of the Gravity Model", *The World Economie*, 20 (3), 363-368, 1997.

Egger, P., "A note on the Proper Econometric Specification of the Gravity Equation", *Economics Letters*, Vol. 66, pp.25-31, 2000.

Rault, Ch., Sova, R., Sova, A. (2007) "Modeling International Trade Flows Between Eastern European Countries and OECD Counries" *Forschungsinstitut zur Zukunft der Arbeit*, Discussion Paper Nr. 2851; June 2007.

Vangjeli, A. (2010) "Impact of trade openness on Albania's foreign trade" *LAP Lambert Academic Publishing* ISBN 978-3-8433-8491-9. 2010, 164 fq.

Reforma e Zhvillimit të Sektorit të Ujit të Pijshëm dhe Ujrave të Zeza: Progresi, Rezultatet, Analiza dhe Vlerësimi

_____ Dr. Arben Bakllamaja _____

Abstrakt. Shërbimi publik i ujësjellës-kanalizimeve (U&K) gjatë këtyre 20 vjetëve të fundit ka ardhur në përmirësim të vazhdueshëm. Në këtë periudhë, ashtu si edhe në vendet e tjera ish-komuniste, në Shqipëri janë kryer reforma të mëdha në fushat e stabilizimit makroekonomik, liberalizimit të çmimeve, reduktimit të subvencionit direkt, transformimit të ndërmarrjeve shtetërore në entitete të tipit komercial, krijimi i kuadrit rregullator, pjesëmarrja e sektorit privat në shërbimet publike, duke përfshirë edhe shërbimin e ujit të pijshëm dhe të largimit të përpunimit të ujrave të zeza.

Kompanitë publike të ujësjellës-kanalizimeve (KPUK) vuajnë nga probleme serioze të efikasitetit operacional dhe financiar. Hendeku relativ midis kostos operative dhe tarifave po ngushtohet me ngadalë nga sa parashikohet. Një problem i madh mbetet menaxhimi i prapambetur i krahësuar me ekonomitë e avancuara të rajonit. Po ashtu, rrjeti inxhinjrik është mjaft i amortizuar.

Eksperiencia e vendeve ish-komuniste, ka treguar se reformat që synojnë në krijimin e kuadrit rregullator të shërbimeve publike, forcimin e institucioneve dhe vendosja e një sistemi të zbatueshëm ligjor janë më të vështira dhe kërkojnë më shumë kohë në arritjen e objektivave të tyre. Kjo vëhet re edhe në Shqipëri. Në vendet ku theksi më i madh u është vënë zhvillimit dhe funksionimit të sistemit ligjor dhe qeverisjes korporative të kompanive publike, kanë ecur më shpejt në zbatimin e reformave, në krahasim me vendet e tjera.

Në këtë artikull vlerësohet hartimi dhe zbatimi i reformës së sektorit të ujit të pijshëm dhe kanalizimeve në Shqipëri, rezultatet në performancën e këtij sektori gjatë dy dekadave të periudhës së tranzicionit. Po ashtu në këtë artikull duam të provojmë se përdorimi i metodikës së vlerësimit të programeve dhe projekteve që zbatohen në vendet e OECD dhe KE është një domosdoshmëri për hartimin e politikave më të mira dhe për zbatimin me efektivitet dhe efikasitet të investimeve në sektorin e ujësjellës-kanalizimeve, me qëllim që ndikimet të jenë të qëndrueshme në afat-mesëm dhe afatgjatë.

HYRJE

Shqipëria ka burime ujore me shumicë, por trashëgoi nga sistemi i mëparshëm një rrjet të ujësjellës - kanalizime mjaft të amortizuar. Shërbimi kryhej nga ndërmarrje shtetërore që financohej nga buxheti i shtetit për investime dhe shpenzime operative. Tarifat e ujit ishin të caktuar nga qeveria dhe nën kosto. Në vitet e para të tranzicionit shërbimi i ujit të pijshëm karakterizohej nga: a) humbje të larta në rrjet, b) orë të kufizuara furnizimi me ujë, c) ujë pothuaj i papërdorshëm nga çezmat për të pirë dhe gatim në një pjesë të mirë të zonave urbane, d) ndërmarrjet e ujësjellsave mbijetojnë me subvencionet operative nga shteti.

Përmirësimi i vazhdueshëm i këtij shërbimi të rëndësishëm publik, e kombinuar me ndërmarrjen e reformave në përshtatje me kërkesat e ekonomisë së tregut përbënin detyra të mëdha për qeverinë Shqiptare gjatë 20 viteve të para të krijimit të sistemit të ekonomisë së tregut dhe të institucioneve përkatëse.

Në këtë artikull do të trajtohen: a) fillimi i reformave në vitet 1991-2000, b) roli i organizatave ndërkombëtare në ndërmarrjen e reformave në sektor, c) strategjia e reformës dhe d) rezultatet e reformës dhe përdorimi i metodikës së vlerësimit të programeve dhe projekteve që zbatojnë vendet e OECD dhe Komunitetit European (KE).

Fillimi i Reformave në Dhjetëvjeçarin e parë 1991-2000

Në fillim dhe gjatë viteve 90 sektori i ujësjellës-kanalizimeve u gjend përballë kushteve të reja politike, ekonomike, sociale dhe demografike të cilat diktonin këndvështrime të reja të politikës sektoriale për të ardhmen e tij.

Presioni i parë i madh ndaj shërbimeve të këtij sektori erdhi nga lëvizjet masive dhe të pakontrolluara të popullsisë në zonat e mëdha urbane dhe ato bregdetare, që solli si pasojë lidhjet masive ilegale me sistemin dhe humbje të mëdha në rrjet. Brenda disa viteve ndërmarrjet e ujësjellsave duhej t'i shërbenin një popullsie shumë më të madhe, një pjesë e mirë të cilëve ishin vendosur në zona të reja informale apo ilegale ku mungonte rrjeti i shërbimeve të U&K.

Presioni i dytë i madh erdhi nga vjetërimi fizik i rrjetit inxhinjerik, për shak të mungesës së investimeve kapitale për më shumë se 20 vjet në shumë qytete të vendit, e cila po përkeqësonte cilësinë e shërbimit dhe po rrezikonte vazhdimësinë e ruajtjes së shërbimit ndaj qytetarëve dhe konsumatorëve të tjerë të rëndësishëm. Humbjet teknike ishin të larta dhe për pasojë efienca operationale e ulët.

Presioni i tretë i madh erdhi nga kultura e trashëguar e menaxhimit të ndërmarrjeve shtetërore në një sistem socialist ku efienca financiare nuk shikohej si e rëndësishme dhe zgjedhja e drejtorit të ndërmarrjes mbështetej në kredencialet e partisë. Ky lloj menaxhimi po e përkeqësonte më tej efiençën e operimit të sistemit dhe atë financiare, dhe që i mbante këto ndërmarrje me subvencione nga buxheti i shtetit.

Në këto kusht, në periudhën 1991-2000 qeveria Shqiptare filloi të hartonte politikat e para që shënonin fillimin e reformave të rëndësishme në këtë sektor. Këto politika synonin në transformime të mëdha të këtij sektori në drejtimet që vijojnë.

- a) Shndërrimin e ndërmarrjeve shtetërore në kompani tregtare që nënkupton menaxhim të ri të kompanive të ujit mbi principet e autonomisë dhe të vet-financimit.
- b) Decentralizimin e shërbimeve të ujit të pijshëm dhe largimit të ujrave të zeza tek pushteti vendor, me qëllim që shërbimet të jenë më afër konsumatorit, ndërsa qeverisja vendore bëhet përgjegjëse për sigurimin e cilësisë së shërbimeve tek konstituentet e tyre.
- c) Inkurajimin e pjesëmarrjes së sektorit privat në menaxhimin e ujësjesave, me synimin për të sjellë praktika të reja menaxhimi që do të përmirësonin ndjeshëm efikasitetin e operimit dhe atë financiare të ujësjesave, si edhe cilësinë e shërbimeve tek konsumatorët.
- d) Liberalizimin e tarifave të ujit të pijshëm me qëllim që kompanitë e ujit të vendosnin tarifat mbi bazën e kostos së shërbimit në zonat e tyre respektive të shërbimit.

Këto politika të rëndësishme të reformës u konkretizuan në një sërë ligjesh dhe vendimesh të Këshillit të Ministrave (Aneks 1).

Roli i Organizatave Ndërkombëtare Financiare dhe atyre të shteteve të veçanta Europiane në reformimin dhe zhvillimin e sektorit të ujësjellës-kanalizimeve.

Ashtu siç ka ndodhur edhe në vende të tjera në zhvillim, shtytësit e parë në reformimin e këtij sektori në Shqipëri kanë qenë organizatat ndërkombëtare financiare të zhvillimit. Për shkak të përvojës ndërkombëtare të këtyre organizatave, si edhe burimeve financiare që ato ofronin, Qeveria Shqiptare u mbështet në mënyrë të fuqishme tek asistenca e Bankës Botërore, Komisionit Europian, Phare Programe, Banka Europiane e Investimeve, si dhe të qeverive Gjermane (KfW), Italiane (Cooperazione Italiana), Austriake (ADA), Sviceriane, Suedeze (SIDA), Japoneze (JICA), etj. (BOX 1)

Por rolin udhëheqës e ka luajtur Banka Botërore, jo përse i takon shumës së financimit të sektorit, por në asistencën ndaj qeverisë Shqiptare për reformimin e këtij sektori që në vitet e para të viteve 90.

BOX 1

Banka Botërore ka financuar nëpërmjet IDA-s katër projekte të ujësjellës kanalizimeve, të cilat tashmë kanë përfunduar. Këto projekte të Bankës Botërore kanë mbuluar qytetet si Durrësi, Lezhë, Fier dhe Sarandë. Një projekt të ri për zonën e Durrësit është në fazën e përgatitjes nga Banka Botërore. Banka Europiane e Investimeve ka financuar projekte për ndërtimin e impjanteve të ujrave të zeza në Durrës, Lezhë dhe Sarandë. Komisioni Europian ka financuar rehabilitimin dhe zgjerimin e rrjetit të ujrave të zeza. KfW ka financuar projekte të ujit të pijshëm dhe të largimit të ujrave të zeza në Kavajë, Elbasan, Kukës, Krujë, Korçë dhe Pogradec, dhe së fundi në Shkodër. KfW ka financuar ndërtimin e impjantit të përpunimit të ujrave të zeza në Pogradec, Korçë dhe Kavajë. ADA ka financuar kryesisht në Shkodër. Cooperazione Italiana ka financuar projekte të ujit në Tiranë, në veçanti ndërtimi i impjantit të parë të pastrimit të ujit të pijshëm që vjen nga rezervuari i Bovillës. Po të shikosh hartën e qyteteve kryesore të Shqipërisë pothuaj të gjithë qytetet kanë përfituar nga asistenca e organizatave ndërkombëtare financiare si dhe nga marrëdhëniet bilaterale me shtete të veçanta.

Siç shikohet në Tabelën e mëposhtëme (Tabela 1), pesha specifike e financimeve të huaja në totalin e investimeve kapitale në këtë sektor, ka qenë më e madhe sesa financimet nga burimet e brendëshme.

Tabela 1: *Financimi i Huaj i Investimeve Kapitale në Sektorin e Ujësjetës – Kanalizimeve gjatë 2001 – 2010 (miliarda Lekë)*

Burimet e Investimeve kapitale	2001	2002	2003	2004	2005	2006	2007	2008	2009	2010
Totali i investimeve kapitale	5.4	4.6	5.8	5.6	5.8	5.4	5.4	7.5	7.6	7.5
Financimi i huaj	3.1	2.5	3.6	3.0	3.0	2.9	2.9	4.3	5.0	5.1
Në përqindje	57%	54%	62%	54%	52%	54%	54%	57%	66%	68%

Burimi: a) “Reforma e sektorit të furnizimit me ujë dhe të kanalizimeve pas procesit të transferimit të kompanive të furnizimit me ujë dhe kanalizimeve tek autoritetet e qeverisjes vendore” Një plan dy vjeçar 2007 – 2009. Këshilli i Ministrave, 23.7.2008; b) DPUK, web Site Qershor 2011.

Për rjedhojë, edhe ndikimi i asistencës së këtyre organizatave ndërkombëtare në reformën e sektorit, në përmirësimin e cilësisë së furnizimit me ujë të pijshëm, në rritjen e mbulimit të qytetarëve që shërbehen, si edhe në trajtimin e ujrave të zeza, nëpërmjet projekteve të investimeve, ka qenë i ndjeshëm.

Strategjia e Reformës së Zhvillimit të Sektorit të Ujësjetës-kanalizimeve

Reforma e ndërmarrë nga qeveria Shqiptare për zhvillimin e këtij sektori, dhe mbështetur nga organizatat ndërkombëtare financiare dhe shtetet e veçanta në këto dy dekada, ka qenë e ndarë në dy faza kryesore. Faza e parë ka synuar në: a) rehabilitimin e sistemeve ekzistuese që të garantohej siguria e furnizimit me ujë të pijshëm për popullsinë në zonën e shërbimit, dhe b) në fillimin e reformave strukturore. Kjo fazë i takon periudhës 1991-2000 (BOX 2).

BOX 2

Në vitin 1999 qeveria Shqiptare aprovon “Dokumentin e Zhvillimit të Politikës për Sektorin e Infrastrukturës së Ujit në Republikën e Shqipërisë”, sipas së cilës zhvillimi i sektorit do të ndiqte këto drejtime kryesore:

- rehabilitimin e sistemeve ekzistuese;
- zgjerimin e tij në zonat e zhvilluara urbane ku popullsia është rritur me shpejtësi nga migracioni i brendshëm;
- decentralizimin e shërbimeve tek pushtetet vendore, dhe
- pjesëmarrjen e sektorit privat.

Siç shikohet, në këtë dokument hidhen bazat kryesore të hartimit të strategjisë kombëtare të zhvillimit të këtij sektori, që do të aprovohet pak vite më vonë nga Këshilli i Ministrave.

Ajo që pikas në këtë fazë është rëndësia që i jepet reformës strukturore që përfshinte:

- a) Transformimin e ndërmarrjeve shtetërore të ujësjellsave në kompani tregtare.
- b) Bashkimin e shërbimit të ujit të pijshëm me largimin e ujrave të zeza në një kompani të vetme.
- c) Krijimin e kuadrit rregullator të këtij shërbimi të rëndësishëm publik, si dhe i institucionit që do të ishte përgjegjës për zbatimin e tij.
- d) Decentralizimin e shërbimeve të ujësjellës kanalizimeve tek pushtetet vendore.
- e) Pjesëmarrjen e sektorit privat nëpërmjet formave të ndryshme të PPP.

Këto politika të reformës fillojnë të zbatohen gradualisht dhe ne shohim se në dhjetëvjeçarin e parë të tranzicionit ndërmerren një sërë hapash konkrete siç janë:

a. Regjistrimi i ndërmarrjeve të ujësjellsave në gjykatë si kompani tregtare të tipit sh.a.¹

b. Shërbimi i largimit të ujrave të zeza, që ishte përgjegjësi e bashkive i bashkohet kompanive të ujit të cilat quhen tani kompani të ujit të pijshëm dhe të ujrave të zeza.

c. Krijohet për herë të parë enti rregullator i ujit, i cili harton politikat tarifore, dhe i aprovon ato, vendos standarte të shërbimit, si dhe liçenson të tërë operatorët publik apo privatë që kryejnë këtë shërbim publik tek konsumatorët.²

d. Liberalizohen tarifat e ujit të pijshëm³

e. Kompanitë e ujit fillojnë të vendosin tarifa për shërbimin e largimit të ujrave të zeza

f. Krijohet kuadri ligjor për pjesëmarrjen e sektorit privat në këtë shërbim publik.⁴

Periudha 2001-2010

Politikat e qeverisë gjatë dhjetëvjeçarit 1991-2000 krijuan kushtet për hartimin e Strategjisë së parë Kombëtare në sektorin e ujësjellës-kanalizimeve

¹ Ligji Nr. 7926, datë 20. 04. 1995, Për Transformimin e ndërmarrjeve Shtetërore në Kompani Tregtare.

² Ligji Nr. 8102, datë 28.3.1996, Për Kuadrin Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit të Ujrave të Zeza dhe Trajtimin e Ujrave të Zeza.

³ Vendim I KM, Nr.479 datë 29.7.1998, Për Liberalizimin e Tarifave të Ujit të Pijshëm.

⁴ Ligji Nr.8103, datë 28.3.1996, Për Privatizimin e Ndërmarrjeve të Furnizimit me Ujë dhe largimin e ujrave të zeza.

që hapte rrugën vazhdimësisë së reformave të rëndësishme gjatë dhjetëvjeçarit 2001-2010.

Banka Botërore ka asistuar direkt Qeverinë Shqiptare për hartimin e Strategjisë Kombëtare të Ujësjellës-kanalizimeve që u miratua nga Këshilli i Ministrave në Tetor të vitit 2003⁵. Kjo Strategji vendosi objektiva afatmesëm dhe afatgjatë për përmirësimin e cilësisë së shërbimit që paraqiten në tabelën e mëposhtëme (Tabela 2).

Tabela 2: Objektivat e Sektorit të U&K deri në 2015⁶
Zonat urbane

Treguesit	Njësia matëse	Viti bazë	Objektivat	
		2007	2010	2015
1. Aksesit tek uji i pijshëm ²	%	95	96.5	99
2. Aksesit tek shërbimi i largimit të ujrave të zeza ³	%	75	78	85
3. Operimi i kompanive të ujit pa humbje ⁴	%	40	70	100
4. Mesatarja e orëve të furnizimit në 24 orë	ore	9	12	18
5. Cilësia e ujit (% e kampioneve që plotësojnë standartet për klorin rezidual)	%	83	92	100

Kjo strategji është mbështetur tërësisht nga të gjithë aktorët ndërkombëtarë të angazhuar në këtë sektor në Shqipëri.

Momentet më kyçe të politikës së reformave në këtë periudhë janë.

1. Në vitin 2003 Qeveria Shqiptare aprovon Strategjinë Kombëtare të Furnizimit me Ujë dhe Sanitetit
2. Në vitin 2007 Qeveria Shqiptare aprovon tre vendime për transferimin e të gjithë kompanive të ujit dhe kanalizimeve tek pushtetet vendore.
3. Në vitin 2009 pothuajse të gjithë kompanitë e ujit dhe kanalizimeve kaluan ligjërisht në pronësi të pushteteve vendore, përveç Durrësit dhe Tiranës.
4. Në vitet 2001-2010 investohen rreth 55 miliard lekë në këtë sektor, të cilat investime sjellin përmirësime të ndjeshme në sistemet e ujësjellës-kanalizimeve dhe në shërbimet ndaj konsumatorëve.
5. Gjashtë KPUK të mëdha dhe të mesme manaxhohen dhe operohen nga operatorë private ndërkombëtarë nëpërmjet kontratave të konçensionit dhe të menaxhimit, për një periudhë disa vjeçare. Këto kontrata zbatohen në kuadrin e marrëveshjeve dhe kredive me Bankën Botërore dhe Kfw-në.

⁵ Vendim i Këshillit të Ministrave “Për Miratimin e Strategjisë Kombëtare të Furnizimit me Ujë dhe të Sanitetit”, Nr. 76, Dt. 16.10.2003

⁶ Strategjia e Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Saniteti për Shqipërinë, Shtator 2003, Ministria e Rregullimit të Territorit dhe Turizmit, Drejtoria e përgjithëshme Ujësjellës Kanalizime.

Vlerësimi i Progresit të Reformës së Sektorit

Në praktikën ndërkombëtare vendet e OECD zbatojnë një metodologji rigoroze për vlerësimin e programeve dhe projekteve që mbështetet në përdorimin e pesë kriterëve që janë: përshtatshmëria, efektiviteti, eficientia, qëndrueshmëria dhe ndikimi. Ndërkaq, në politikat e ndihmës së Komunitetit Europian përdoren edhe dy kritere të tjera, siç janë, koherenca dhe shkalla në të cilin ndërhyrja për zhvillim shton përfitimet tek vendet partnere të KE.⁷

Dihet se vlerësimi i politikave të qeverisë nëpërmjet zbatimit të programeve dhe projekteve ka rëndësi të madhe: (i) për përmirësimin e zbatimit të politikave dhe të vendimmarrjeve, (ii) për të ndihmuar në shpërndarjen sa me racionale të burimeve, (iii) për të rritur transparencën e institucioneve publike, (iv) për të forcuar përgjegjshmërinë duke vlerësuar se çfarë është arritur me paratë e taksapaguesve, si dhe (v) për të nxitur njohjen dhe zbatimin e eksperiencave efektive organizative dhe praktikave të mira.

Në dokumentin e “Strategjisë Kombëtare të Sektorit të Shërbimit të Furnizimit me Ujë dhe Kanalizimeve 2011-2017”, Mars 2011 nuk bëhet asnjë referencë ndaj dokumentit të “Strategjisë së Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Saniteti për Shqipërinë” Shtator 2003. Për më tepër nuk bëhet asnjë vlerësim i zbatimit të kësaj strategjie të aprovuar nga KM në 2003. Pra mungon një ekzaminim i efektivitetit, eficientës, ndikimit të projekteve dhe programeve tek objektivat e tyre dhe të strategjisë, si dhe përshtatshmëria dhe dobia e politikave të miratuara në atë kohë në zbatim të strategjisë së atëhershme. Nga kjo mungesë e vlerësimit, nuk nxirren as mësimet e duhura që duhet të merren në konsideratë për politikat që rekomandon kjo strategji.

Sa efektive ka qënë zbatimi i strategjisë që nga viti 2003 dhe deri në vitin 2010 këtë na e tregon edhe tabela e mëposhtme (Tabela 3). Dokumenti i Strategjisë së 2003, parashikon një numër të kufizuar treguesish të performancës, por edhe për këto tregues asnjë objektiv nuk është arritur.

Por, nëse do të krahasojmë arritjet e reformës nga viti 2005 deri në vitin 2010 pa dyshim shërbimet e furnizimit me ujë të pijshëm dhe ai i largimit të ujrave të zeza kanë pësuar një përmirësim të dukshëm⁸. Siç e tregojnë edhe të dhënat në tabelën e mëposhtme, do të veçojmë: a) rritja e përqindjes së popullsisë që furnizohet me ujë të pijshëm, b) rritja e kohës së furnizimit me ujë, c) rritja e normës së arkëtimeve, d) përmirësimet në eficientësi operationale të sektorit, e) rritja mesatare e tarifave të ujit drejt mbulimit të koston të shërbimit.

⁷ Europe Aid Co-operation Office, Families of Evaluation Criteria, Metodological Bases Evaluation Process. The questions are classified in different families that correspond to different “viewpoints” on what is being evaluated. Seven of these viewpoints, also called evaluation criteria, are to be considered: relevance, effectiveness, efficiency, sustainability, impact, coherence/complementarity, and Community value added.

⁸ Per mungese te dhenash per 2003, perdorem si vitin baze 2005.

Tabela 3: Realizimi i Treguesve Kryesorë të Performancës në Sektorin e U&K

Treguesit Kryesorë	Objektivat e Strategjisë Kombëtare e U&K për vitin 2010	Realizimi	
		2005	2010
1. Uji pa të ardhura (%)		72	63
2. Popullsia që faktikisht furnizohet me ujë nga kompanitë e U&K në qytet (%).	96.5	86	91
3. Popullata që faktikisht shërbehet për largimin e ujrave të zeza nga kompanitë e U&K në qytet. (%)	78	67	69
4. Vazhdimësia e furnizimit me ujë të pijshëm në 24 orë	12	9	11
5. Norma e mesatare e arkëtimit		79	84
6. Mbulimi i koston operative dhe të mirëmbajtjes (%)		51	60
7. Çmimi mesatar Ujësjiellës+Kanalizime (lekë/m3)		36	43
8. Kosto mesatare e shitjes Ujësjiellës+Kanalizime (lekë/m3)		56	61
9. Personel per 1000 lidhje		10.6	8.8
10. Konsumatorë me matesa uji (%)		33	42

Burimi: Strategjia e Furnizimit me Ujë dhe Sanitetit për Shqipërinë, fq. 109, Tiranë Korrik 2003, DPUK, Raporti i Monitorimit dhe Benchmarking, 2005, 2010.

Përsa i takon efijencës ne sektor nga zbatimi i projekteve dhe programeve, treguesi i Strategjisë, “Operimi i Kompanive të ujit pa humbje” nuk është realizuar. Objektivit në 2010 për popullatën e shërbyer nga sisteme që mbulojnë koston e funksionimit dhe mirëmbajtjes” ishte në 70 %, ndërsa në fakt në këtë vit ishte 15%.

Qëndrueshmëria e rezultateve të arritura është bërë një çështje e rëndësishme në projektet e zhvillimit që financohen nga donatorë dhe organizata ndërkombëtare financiare. Në rastin e mësipërm, ky kriter nënkupton paksimin e qëndrueshëm të financimit të sektorit nga burimet e jashtme dhe të qeverisë. Nëse do të arrihej objektivi që 70% e popullatës urbane do të furnizohej nga kompani të U&K që mbulojnë koston operacionale dhe të mirëmbajtjes, atëherë edhe subvencioni operativ nga buxheti i shtetit do të ulej ndjeshëm në vitin 2010, por ky nivel do të ruhej edhe në vitet në vazhdim. Ajo që kërkohet të arrihet këtu është se kompanitë e U&K, që nga arkëtimet mbulojnë koston operacionale dhe të mirëmbajtjes, duhet të ruajnë këtë performancë financiare, nderkaq numuri i kompanive te U&K që arrijnë këtë nivel performance duhet të rritet.

Vlerësimi i ndikimit është i vështirë në procesin e vlerësimit, sepse kërkon përgjigjen e një sërë pyetjesh esenciale siç janë: çfarë ndryshimi ka sjellë zbatimi i reformës në sektor tek përfituesit, cilat janë efektet sociale, ekonomike, mjedisore, dhe të tjera direkte ose indirekte, tek komunitetet & institucionet, cilat janë efektet pozitive ose negative, të parashikuara ose të paparashikuara, si rezultat i zbatimit të


projekteve dhe programeve gjatë këtyre viteve të zbatimit të strategjisë? Padyshim zbatimi i reformës në sektor ka sjellë ndikime pozitive sociale, përderisa është rritur numuri i familjeve që shërbehen nga sistemet e ujesjellës dhe kanalizimeve, dhe është rritur orari i furnizimit me ujë. Po ashtu, ndikime pozitive ka sjellë edhe në ekonomitë lokale të turizmit në qytetet bregdetare. Por këto ndikime janë mjaft mikse. Në tërësi nuk bëhet krahasimi se sa kanë qënë objektivat nga projektet e financuara nga buxheti i shtetit dhe organizata jashtë vendit dhe sa ka qënë realizimi i tyre në përfundim të këtyre projekteve. Le të marrim si shëmbull Durrësin. Durrësi, si zona më e madhë turistike bregdetare e vendit ka një orar të ulët të furnizimit me ujë, 6.6 orë në 24 orë mesatarisht në vitin 2010. Në zonën e Durrësit janë financuar katër projekte të ujesjellës kanalizimeve nga Banka Botërore, dhe një projekt nga Banka Europiane e Investimeve, dhe përsëri zona e Durrësit mbetet pas nga qytetet bregdetare si Vlora, Saranda, Shkoder, Lezha për sa i takon orarit të furnizimit me ujë dhe shtrirjes. Po të krahasojmë me objektivat në projektin Bashkiak të Ujesjellës-kanalizimeve, në vitin e pestë dhe të fundit të projektit Durrës duhej të furnizohej mesatarisht me 6 orë në 24 orë mesatarisht, ndërsa realizimi ishte 3.3 orë. Ndonëse ndaj vitit bazë ka një përmirësim në këtë tregues, ndikimi i investimeve të shumta në këtë zonë urbanë në këtë tregues të rëndësishëm ka qënë minimal.

Komisioni European përdor në veçanti kriterin e koherencës brënda programeve të zhvillimit të Komisionit për të gjykuar nëse aktivitetet dhe produktet e parashikuara synojnë arritjen e objektivave të caktuara në vendet ku financohen këto programe, siç është edhe rasti i Shqipërisë. Po ashtu, Komisioni është i interesuar të dijë nëse politikat dhe objektivat për arritjen e tyre nga qeveria, dhe partnerë të ndryshëm në sektor nuk janë në konflikt me njëri tjetrin. Me aprovimin e Strategjisë të sektorit nga Qeveria dhe e miratuar nga partnerët e saj është vendosur baza e nevojëshme që programet dhe projektet që financohen nga partnerë të ndryshëm të qeverisë, të mbështesin objektivat e strategjisë së sektorit. Ndërkaq e rëndësishme është vlerësimi i ndikimit të financimeve nga këto partnerë në arritjen e objektivave në sektor gjë që deri më sot mungon, dhe për pasojë e bën të vështirë të gjykosh për shkallën e koherencës së programeve të zhvillimit të këtyre partnerëve.

Megjithë arritjet e reformës, problemet e dukëshme të efektivitetit, efijencës, ndikimit dhe qëndrueshmërisë dëshmojnë për një progres të ngadalshëm në realizimin e objektivave të reformës në këtë sektor.

Po ta krahasojmë performancën e këtij sektori në Shqipëri me disa nga vendet ish komuniste në rajon dhe më gjërë, Shqipëria në shumë tregues qëndron më pas nga këto vënde. Figura 1 tregon se Shqipëria ka nivelin e ujit pa të ardhura më të lartë së 14 vënde të marra në vëzhgim, edhe lë prapa Armeninë dhe Rusinë.

Figura 1: Uji pa të ardhura – Shqipëria dhe vendet e BE (%)⁹



Në 2010 Shqipëria kishte tregues më të ulët se Republika Çeke, Rumania, dhe Moldova (Tabela 4).

Tabela 4: Disa Tregues Kryesorë 2010¹⁰

Shtete	Uji pa të ardhura	Arkëtimet	Mbulimi kostos	Aksesi tek uji
1) Republika Çeke	20%	97%	1.25	96%
2) Rumania	51%	100%	1.14	84%
3) Moldova	45%	98%	1.08	80%
4) Shqipëria	63%	84%	0.60	80%

Siç shikohet, problemet kyçe në këtë sektor që janë adresuar në vitet 1990 dhe 2000 vazhdojnë të mbeten të rëndësishme edhe në dekadën e tretë 2011-2020 të tranzicionit të zgjatur në Shqipëri.

Një nga pritshmëritë e mëdha në këtë dekadë është edhe rezultatet nga decentralizimi. Dihet që një arritje e rëndësishme e reformës së sektorit në dhjetëvjeçarin e kaluar është edhe transferimi i pothuajse të gjithë kompanive të ujit në pronësi të pushteteve vendore. Ndokush mund të thotë se është ndoshta shpejt për të parë ndikimet e këtij procesi në shërbime cilësore të këtij sektori. Eksperiencia në vendet e tjera ka treguar se do të kërkohet kohë që njësitë e qeverisjes vendore të fitojnë kapacitetet e duhura për kontrollin, monitorimin dhe vlerësimin e këtij shërbimi, të rrisin burimet e të ardhurave nga ekonomia lokale për të mbështetur investimet në këtë shërbim jetik, të arrijnë shkallën e kërkuar të përgjegjshmërisë ndaj konstituentëve për të siguruar shërbimet e nevojshme cilësore, si dhe të shkëputjes së politikës nga menaxhimi i kompanive të ujit me synimin për vendosjen e qeverisjes korporative. Kjo nënkupton se ndryshimet e mëdha nuk priten të jenë të shpejta, por ndryshime progresive duhet të priten, prandaj duhet të vihen objektiva vjetorë, ato të monitorohen dhe vlerësohen me qëllim korigjimin

⁹ ALBANIA A Public Expenditure and Institutional Review, Volume II, June 2006, World Bank, Report No. 36453 – AL., pg.99

¹⁰ The International Benchmarking Network for Water and Sanitation Utilities (IBNET)

dhe përmirësimin në kohë të çdo praktike apo politike që nuk jep frytet e dëshiruara, dhe për më tepër pengon progresin.

Përfundime

1. Është pozitive që Qeveria ruan një vazhdimësi në hartimin dhe miratimin e strategjisë së sektorit. Strategjia e dytë vjen pas tetë vjetëve të miratimit të Strategjisë së parë. Ndonëse Strategjia e dytë ruan të njëjtat objektiva të reformës së sektorit me Strategjinë e parë, ajo nuk duket që është mbështetur në analizën, vlerësimin dhe mësimet që dalin nga realizimi prej rreth tetë vjetësh të strategjisë së parë.
2. Ministria e Punëve Publike dhe Transportit raporton çdo vit rezultatet e performancës së sektorit nëpërmjet programit të Monitorimit dhe Benchmarkut, e cila përbën një bazë të shëndoshë për vlerësimin e progresit që po bën sektori në tregues të rëndësishëm që prej vitit 2004. Ndërkaq, vlerësimi i performancës sipas kriterëve të OECD dhe të KE përbën një metodologji të nevojshme për të gjykuar për progresin dhe për të nxjerrë mësimet e nevojshme dhe në kohë për politika më të dobishme për sektorin.
3. Zgjidhja e shumë prej problemeve të sektorit do të kërkojë investime të shumta. Sipas vlerësimit të Strategjisë së dytë të sektorit, investimet që kërkohen nga 2011 deri në 2017 për të arritur objektivat strategjike në 2017 vlerësohen në rreth 448 milion Euro. Qeveria qëndrore është larg nga mundësitë financiare për të financuar këto investime nga burimet e veta. Aksesit tek financimi i kapitaleve nga pushtetet vendore është akoma më i limituar. Të ardhurat e bashkive janë akoma të vogla për të financuar përmirësimin e këtij shërbimi, pavarësisht nga tendenca e fundit të rritjes së të ardhurave lokale. Kompanitë e U&K aktualisht janë të pamundura për të mbuluar koston e tyre operative dhe të mirëmbajtjes (O&M costs) me tarifat aktuale dhe normën e arkëtimit. Kjo padyshim e bën angazhimin e komunitetit ndërkombëtar për financimin e nevojave për investime në këtë sektor në Shqipëri të domosdoshëm edhe në vitet në vijim, ndonëse edhe ky burim i jashtëm ka një kufi. Prandaj dhe ajo që është më e rëndësishme për të arritur objektivat e Strategjisë në sektor dhe sigurimin e rezultateve të qëndrueshme është arritja e efektivitetit dhe efikasitetit të investimeve në këtë sektor dhe përmirësimi i ndjeshëm i menaxhimit të kompanive publike mbi bazën e principeve të qeverisjes korporative.
4. Organizata financiare ndërkombëtare, si dhe qeveritë e veçanta kanë investuar me dhjetra miliarda lekë në këto dy dekada të fundit, duke mbajtur rolin kryesor në financimin e investimeve në këtë sektor. Ndërkaq vlerësimi i ndikimit të financimeve nga këto partnerë në arritjen e objektivave në sektor deri më sot mungon, dhe për pasojë nuk të lejon të gjykosh për shkallën e koherencës së programeve të zhvillimit të këtyre partnerëve, si dhe për dobinë e shtuar të këtyre investimeve në zbatim të reformave të strategjisë së sektorit. Kjo përbën një deficiençë për përmirësimin e ndikimit të këtyre investimeve në sektor për shërbime cilësore nga ana e këtyre organizatave.

Aneks 1: Ligjet & Vendimet e Qeverisë në Sektorin e Ujit dhe të Kanalizimeve për periudhën 1991-2000

Nr.	Ligji	Titulli
Ligjet dhe vendimet e KM gjatë viteve 1991-2000		
1	Ligji Nr. 7638, datë 19. 11. 1992	Për Kompanitë Tregëtare
2	Vendim I KM, Nr.102 datë 16.3.1992	Për Normat e Përdorimit dhe Çmimin e Ujit të Pijshëm në Qytet dhe në Fshat
3	Vendim I KM, Nr.236 datë 10.5.1993	Për Administrimin e Furnizimit me Ujë për Përdoruesit Familjarë dhe jo Familjarë
4	Ligji Nr. 7926, datë 20. 04. 1995	Për Transformimit e ndërmarrjeve Shtetërore në Kompani Tregëtare
5	Ligji Nr. 8093, datë 21.03.1996,	Për Rezervat e Ujit
6	Ligji Nr. 8102, datë 28.3.1996	Për Kuadrin Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit të Ujrave të Zeza dhe Trajtimin e Ujrave të Zëza.
7	Ligji Nr.8103, datë 28.3.1996	Për Privatizimin e Ndërmarrjeve të Furnizimit me Ujë dhe largimin e ujrave të zeza
8	Vendim I KM, Nr.479 datë 8.5.1997	Për Tarifat e Ujit të Pijshëm
9	Vendim I KM, Nr.479 datë 29.7.1998	Për Liberalizimin e Tarifave të Ujit të Pijshëm
10	Vendim I KM, Nr.400 datë 19.8.1999	Miratimin e Kategorive të Liçensimit dhe të ____për aplikimin për liçensë për të gjithë personat fizikë dhe Juridikë, që ushtrojnë apo do të ushtrojnë veprimtaritë e grumbullimit, të trajtimit dhe shpërndarjes së ujit për Konsum Publik, si dhe të Largimit, të Përpunimit të Ujrave të Ndotura
11	Vendim I KM, Nr.577 datë 8.12.1999	Pjesëmarrjen me Kontratë Menaxhimi të Sektorit Privat në Ndërmarrjet e Ujësjellës-kanalizimeve të Bashkive, Fier, Lezhë, Sarandë dhe Durrës.
12	Ligji Nr. 8652, datë 31. 07. 2000	Për Organizimin dhe Funkcionimin e Pushtetit Lokal.
13	Ligji Nr. 8744, Datë 22.2.2001	“Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”,
14	VKM Nr. 660, Datë 12.09.2007	“Për transferimin e aksioneve të shoqërive të ujësjellës kanalizimeve tek njësitë e qeverisjes vendore”
15	VKM Nr. 678, Datë 3.10.2007	“Për disa shtesa tek VKM Nr. 271, datë 09.05.1998 për miratimin e statutit tip të shoqërive anonime shtetërore”
16	VKM Nr 677, Datë 3.10.2007	“Për disa shtesa tek VKM Nr. 642, datë 11.10.2005, për këshillat mbikëqyrëse të shoqërive shtetërore
17	VKM Nr. 678, Datë 3.10.2007	“Për disa shtesa tek VKM Nr. 271, datë 09.05.1998 për miratimin e statutit tip të shoqërive anonime shtetërore”
18	Udhëzim METE Nr. 965, Datë 11.12.2007	“Për transferimin e aksioneve të shoqërive anonime të ujësjellës kanalizimeve tek njësitë e qeverisjes vendore”
19	Ministria e Punëve Publike dhe Transportit	“Strategjia Kombëtare e Sektorit të Shërbimit të Furnizimit me Ujë dhe Kanalizimeve 2011-2017”, Mars 2011
20	Vendim i Këshillit të Ministrave, Datë 14.09.20011	Për miratimin e strategjisë kombëtare sektoriale të shërbimeve të furnizimit me ujë dhe kanalizimeve.

Bibliografia:

Albania Development Policy Loan, Water Sector Policy Note and Action Plan, May 2007, MoPTT

ALBANIA A Public Expenditure and Institutional Review, *Volume II*, June 2006, World Bank, Report No. 36453 – AL.

Country Assistance Strategy (CAS), World Bank,

“Reforma e sektorit të furnizimit me ujë dhe të kanalizimeve pas procesit të transferimit të kompanive të furnizimit me ujë dhe kanalizimeve tek autoritetet e qeverisjes vendore” Një plan dy vjeçar 2007 – 2009, 23.7.2008, Prof. Dr. Kryeministri i Shqipërisë Sali Berisha

Vendim i Këshillit të Ministrave “Aprovimi i Dokumentit të Zhvillimit të Politikës për Sektorin e Infrastrukturës së Ujit në Republikën e Shqipërisë” Nr. 571, dt. 8.12.1999.

Ligji Nr. 7926, date 20. 04. 1995, Për Transformimit e ndërmarrjeve Shtetërore në Kompani Tregëtare.

Ligji Nr. 8102, datë 28.3.1996, Për Kuadrin Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit të Ujrave të Zeza dhe Trajtimin e Ujrave të Zeza.

Vendim i KM, Nr.479 date 29.7.1998, Per Liberalizimin e Tarifave te Ujit te Pijshem.

Ligji Nr.8103, datë 28.3.1996, Për Privatizimin e Ndërmarrjeve të Furnizimit me Ujë dhe largimin e ujrave të zeza.

Vendim i Këshillit të Ministrave “Për Miratimin e Strategjisë Kombëtare të Furnizimit me Ujë dhe të Sanitetit”, Nr. 76, Dt. 16.10.2003

Vendim i Këshillit të Ministrave “Për miratimin e strategjisë kombëtare sektoriale të shërbimeve të furnizimit me ujë dhe kanalizimeve”, 14/09/2011.

Vendim i Këshillit të Ministrave, Nr. 550, datë 07.11.2002

The EU Water Framework Directive foresees water management based on river basins, and it is upon this basis that it considers making funds available for larger scale projects. Albania is currently a pre-accession country, but in the process of joining the EU will face greater demand to comply with the future obligations under the Water Framework Directive of the European Union.

The International Benchmarking Network for Water and Sanitation Utilities (IBNET)

Kultura Kombëtare dhe Gratë në Leadership

_____ Dr. Edlira GJURAJ (TUKAJ) _____

Abstrakt. Zhvillimet e reja globale dhe ekonomike po riformatojnë profilin e leadershipit. Jo vetëm njohja dhe vlerësimi, por është mirëmanaxhimi i diversitetit në organizata që krijon sot avantazh konkurrues. Studjuesit dhe konsulentët e fushave sociale dhe manaxheriale që në vitet '80 të shekullit të XX-të adresuan çështjet gjinore të leadershipit duke tentuar të zbulojnë, bazuar në metoda të ndryshme kërkimore, praninë ose jo të dallimeve gjinore në stilet e leadershipit. (Eagly & Johnson, 1990) Manaxhimi i diversitetit është çështje e të gjithëve dhe për të arritur këtu kërkon ndryshim të sjelljes së leadershipit përmes programeve trajnuese, krijimin e vizioneve të reja të organizatave diverse, hartimin e strategjive dhe selektimin e teknikave për ta bërë diversitetin motor ndryshimi dhe suksesi. Kur dimensionit gjinor të diversitetit i shtohet edhe ai kulturor, disa alternative dhe modele zgjidhje në një kontekst të caktuar kulturor nuk mund të jenë lehtësisht të zbatueshme në një kontekst tjetër kulturor. Ky diversitet të paktën dydimensional kërkon analiza të veçanta për të arritur në zgjidhje konkrete.

Punimi ka në qendër pikërisht impaktin e një prej dimensioneve të kulturës, atij maskilist, në mospjekjen e grave në leadership në Shqipëri. Studimet pohojnë se gratë demostrojnë më shpesh në sjelljet e tyre disa prej sjelljeve të leadershipit të vlerësuara sot si kritike për arritjen e sfidave globale të së ardhmes. (Desvaux & Devillard, 2008) Po ashtu trajtohet nëse ka devianca nga ky trend botëror dhe nëse janë këto me origjinë kulturore.

Fjalë kyçe:

kulturë, leadership, dimension gjinor

HYRJE

Shqipëria nuk është pjesë e asnjë prej studimeve kulturore të bëra deri tani. Duke filluar që nga studimi i shumëpërmendur i Hofstede (1967-1973) ku kemi një dimensionim të kulturës kombëtare me qëllim të gjetjes së një shpjegimi mbi zhvillimet në organizata kur këto fillojnë dhe shtrihen ndërkombëtarisht apo kur tregu i punës bëhet shumë kulturalisht divers, deri tek më të fundit realizuar nga GLOBE¹(Chhokar, Brodbeck, & House, 2007) Kjo nuk do të thotë aspak që Shqipëria është jashtë këtyre zhvillimeve. Pas ndryshimeve politike, ekonomike dhe sociale të viteve '90, izolimi rreth 50 vjeçar mori fund dhe Shqipëria filloi të rivendosë lidhjet e humbura me botën. Shumë shpejt u bëmë pjesë e zhvillimeve botërore në të gjitha fushat. Lëvizja e lirë e njerëzve, investimet e huaja në vendin tonë dhe shtrirja e bizneseve jashtë kufijve të Shqipërisë solli nevojën për një njohje më të thelluar të botës jo vetëm në dimensionet ekonomike, politike dhe sociale por edhe ato kulturore. Studiuesit në fushat e manaxhimit kishin kohë që kishin shtrirë studimet e tyre në një dimension shumë të padukshëm, por me një influencë të madhe në zhvillimet mikro dhe makro ekonomike siç ishte kultura. Lidhja e saj si një variabël me variabla të tjerë organizativë dhe socialë u kthye në fokus të studimeve organizative dhe më gjërë.

Ekserienat botërore organizative, të suksesshme apo jo, vënë theksin në rolin domethënës të liderit në zhvillimet e organizatës. "Lidershipi që sjell ndryshime" apo "lidershipi që krijon vizione" janë të lakuar gjërësisht. Nga ana tjetër dekadat e fundit të shekullit të XX-të dhe të fillimit të shekullit të XXI-të sfiduan organizatat me nevojën për një manaxhim ndryshe, manaxhim diversiteti. Një fuqi puntore diverse, tregje diverse të shitjes së produkteve kërkonin një mënyrë të re të të menduarit dhe vepruarit për krijimin e një avantazhi konkurrues. Manaxhimi i diversitetit është çështje e të gjithëve duke filluar nga lidershipi deri tek çdo antar i thjeshtë i organizatës. Studjuesit e fushave tashmë kanë arritur të panomarizojnë diversitetin duke bërë përpjekje të vazhdueshme në mirëmanaxhimin e tij. Ka arritje ashtu si ka edhe vende për përmirësim apo adaptim. Sfidat kryesore tani është përqëndruar në një lider divers, duke lënë prapa figurën shumë të skalitur të liderit burrë dhe i racës së bardhë.

Metodologjia

Punimi është mbështetur në një analizë të zgjeruar të literaturës mbi kulturën, nën spektrin dimensional, dhe të lidershipit përmes librave, artikujve, studimeve të thelluara, të rejave më të fundit dhe statistikave përkatëse nga Shqipëria. Gjithashtu

¹ Global Leadership and Organizational Behavior Effectiveness (GLOBE)

janë shfrytëzuar gjetjet empirike nga punimet me fokus Shqipërinë dhe organizatat Shqiptare.² Eksperienca dhe vrojtimi formatojnë analizën dhe shtojnë komente në lidhje me çështjet nën shqyrtim.

Në arritjen e vërtetimit të hipotezës: “*Kultura maskiliste minon suksesin e grave në lidhshmëri*”, punimi ndalet në disa analiza më të detajuara: së pari, një paraqitje e shkurtër e kulturës dhe lidhshmërisë, në konceptin teorik në vite; së dyti, shtrirja e kulturës shqiptare në dimensionin maskilist-feminist; së treti, sfidat që sjell rritja e diversitetit sot për organizatat; së katërti, vendi i shoqërisë shqiptare në një botë, ku gratë shikohen si lider të së ardhmes, si lider të ndryshimeve dhe si lider që kthejnë në vlerë diversitetin që ofron globalizimi.

Kultura dhe lidhshmëria

Duke ditur tashmë që shumica e njohurive tona faktike është e influencuar prej kushteve sociale dhe ambjentit ku jetojmë, kur sistemi i vlerave që mbartim shërben si një filter për kuptimin e kulturave të tjera duhet pra që në kushtet ndërveprimit global lideret të kenë një kuptim të fortë të kulturës së tyre dhe se si ajo shihet prej të tjerëve. Liderët duhet të kenë një sens të fortë të vendit që ato zënë brenda kulturës së vendit të tyre të origjinës dhe nëse vlerat e tyre personale perfaqësojnë këtë kulturë.

Përkufizimet e kulturës janë mbi 160 dhe çdo studiues tenton të shtojë mbi një përkufizim ekzistues. Duke qëndruar nën strehën e ndikimit të kulturës në stilet e lidhshmërisë GLOBE³ I referohet House et al., (1999) mbi kultures si: “motive, vlera, besime, identitete të ndara (midis anëtarëve) dhe interpretime ose kuptime të ngjarjeve të veçanta që rezultojnë prej eksperiencës së përbashkët të anëtarëve të kolektiviteteve dhe transmetohen përmes gjeneratave moshore.” (Koopman, Den Hartog, & Konrad)

Ndarja përfundimtare apo dallimi midis termit manaxhim dhe lidhshmëria nuk është pjesë vetëm e konkludimeve teorike, por evidencë shumë e qartë praktike ku secili prej nesh kupton që ndërsa manaxherët kërkojnë rregull e kontroll, dallohen në konflikte të hapura dhe sigurojnë përmbushjen e aktiviteteve të përditshme,

² Edlira GJURAJ (TUKAJ) “Impakti i kulturës Kombëtare në kulturën organizative. Tendencat dhe ndryshime në vite, sfida dhe perspektiva”, teme doktorature Universiteti i Tiranës, Fakulteti Ekonomik, korrik 2006.

³ The Global Leadership and Organizational Behavior Effectiveness Research Program (GLOBE) është projekt kërkimor ndërkulturor, konceptuar prej Robert House dhe financuar në tetor 1993. Që atëherë, GLOBE është përfshirë në një projekt kërkimor shumë-fazësh dhe shumë-metodësh në të cilin 170 investigatorë prej më tepër se 60 kombe duke përfaqësuar të gjithë rajonet kryesore kulturore në botë bashkëpunojnë për egzaminimin e marrëdhënieve midis kulturës sociale, kulturës organizative dhe lidhshmërisë organizativ”. (Koopman, Den Hartog, & Konrad)

liderët lulëzojnë në kaos dhe në mënyrë të vazhdueshme shikojnë për oportunitete dhe mënyra të ndryshme të arritjes së qëllimeve⁴. Pra ndërsa manaxherët realizojnë objektiva përmes të tjerëve, liderët janë ato që vizionojnë organizatat dhe janë shpirti i realizimit të tyre. “Leadershipi është gjëresisht i lidhur me aftësinë për të përdorur fuqinë për të influencuar veprimin për ndryshim.” (Kanyoro, 2006, p. 2)

Për më tepër analizat studimore bashkëkohore, ndryshe nga ato klasike⁵, po theksojnë format e reja të konceptimit të leadershipit⁶ si një akt ndërveprimi midis eprorit dhe vartësve, ku theksohet veçantia e perceptimit subjektiv të një individi për zhvillimin dhe formimin e marrëdhënieve të leadershipit dhe ku roli i trajtimit si lider (nga vartësit) është pjesë e rëndësishme e procesit ndërveprues duke zhvendosur analizat e të qënurit vetëm një karakteristikë e personalitetit të individit.

Duke e parë në këtë këndvështrim kultura nuk ndikon vetëm në formimin e një individi (që konsiderohet si lider), por të individëve si dhe marrëdhënies mes tyre. Marrëdhëniet në grup kultivohen kulturalisht dhe mbarten në sjelljet në organizata.

Lidershipi ekziston në të gjitha shoqëritë dhe është bazë e funksionimit të organizatave të ndryshme brenda tyre. Dimensionimi i kulturës solli një analizë më të detajuar të impaktit që kultura kombëtare mund të ketë në sjelljet e qëndrimet e njerëzve në organizata.⁷ Grupe të ndryshme kulturore kanë përcëptime të ndryshme se çfarë është leadershipi dhe nxitur nga këto “vlerësimi dhe kuptimi i sjelljeve dhe karakteristikave të ndryshme të liderit mund të ndryshojë fuqishëm midis kulturave.” (Koopman, Den Hartog, & Konrad)

Kultura Shqiptare në dimensionin gjinor

Duke konsideruar që kultura nuk është stabël por është në ndryshim, por nga ana tjetër këto ndryshime i përkasim ndikimit të periudhave apo faktorëve të shtrirë në kohë, nuk mund të anashkalojmë vitet e diktaturës komuniste në Shqipëri për të qënë më realist në analiza. Siç është argumentuar kohë më parë (Tukaj, September 1998) shoqëria shqiptare ishte vërtet e izoluar dhe një shoqëri e mbyllur, por që pati ndryshime në norma, implikuar këto nga ndryshimet e theksuara të institucioneve dhe mënyrës së funksionimit të tyre. Kështu në përpjekjet për ta konsideruar veten forcë drejtuese të shoqërisë Shqiptare, Partia Komuniste e Shqipërisë deklaroi të

⁴ Sipas Zaleznik (1977). (Gregoire & Arendt, March, 2004)

⁵ “Lideret janë parë tradicionalisht si një personalitet i veçantë me karakteristika të ndryshme prej atyre të vartësve të tyre. Ato janë konceptuar si lojtarë aktivë në procesin e leadershipit. Në kontrast vartësit janë marrë si pasivë dhe reagues.” (Winkler, 2010, p. 11)

⁶ “Në kontrast, trajtimet aktuale fokusohen në leadershipin si një proces kompleks interaktiv (e.g., Van Seters and Field 1990; Yukl 2006; Hollander 2008)”. (Winkler, 2010, p. 11)

⁷ Geert Hofstede ishte i pari që realizoi një studim të tillë duke e pasuruar modelin e tij katër dimensional me një dimension të huazuar nga Bond.

qënurit promotor i një jete dhe kulture moderne. Duke synuar që të zotëronte besnikërinë pa kushte të qytetarëve, komunistët ekstremisht kufizuan mundësitë për aktivitete shoqërore, politike dhe ekonomike dhe ndërveprimin midis individëve. Qeveria komuniste aplikoi një ekonomi të planifikuar dhe komanduar e cila provoi shpejt të ishte jo efektive dhe një dështim total. Në çdo lloj organizate koercioni dhe autoritarizmi u bënë stile udhëheqje. Vendimarrja në të gjitha nivelet ishte e monopolizuar prej rangjeve më të larta të lidërshit nën një mbikëqyrje strikte dhe pa kompromis të njësive të Partisë Komuniste. Instrumente të tjerë për kontrollin e shoqërisë dhe shkatërrimin e solidaritetit dhe kooperimit midis njerëzve dhe grupeve të njerëzve u përdoren efektivisht prej regjimit. Marrëdhëniet ndërpersonale midis njerëzve karakterizoheshin prej frikës, dyshimit, mosbesimit dhe mungesës së konfidencës. Ideologjia komuniste kishte penetruar në çdo sferë të jetës. Regjimi komunist në Shqipëri shkoi më tej se sa vendet e tjera ish-komuniste të Evropës Qendrore dhe Lindore. Strukturat e tij ishin të bazuara në norma dhe praktika që nuk mund të mbështeteshin prej mentalitetit, dinjitetit dhe moralit shqiptar.

Gjithashtu qeverisja komuniste u mundua nën frymën e një propagande partiake të ndryshonte panoramen e një shoqërie maskiliste duke kërkuar mes të tjerash 'barazi' për burrat dhe gratë në të gjitha fushat. Pati tendenca të eliminimit të punëve vetëm për burra apo vetëm për gra, por kjo shumë e sforcuar dhe artificiale; dhënia e shpërblimeve materiale apo në formë statusi ishte vetëm në bazë të arritjeve partiake dhe jo të tjera; investime ekonomike në drejtime krejt të pastudiara në dëm të ambientit sollën shkatërrim dhe jo rritje ekonomike, etj. Pra ndërhyrja në këtë dimension ishte vetëm sipërfaqësore sepse asgjë nuk ndryshoi në familjet shqiptare ku rolet midis gjinive përmbusheshin krejt të ndara si më parë, por përkundrazi u shtua më tepër barra e grave. Gjithashtu mënyra e zgjedhur për vendosjen e barazisë gjinore, tentonte një shpërndarje të tipareve mashkullore edhe tek femrat (gra në aksion apo stërvitje ushtarake përkrah burrave), ndërsa kulturat feministe flasin për rritje apo zgjerim të tipareve femërore në shoqëri. Po ti referohemi fakteve mbi zhvillimet shoqërore aktuale, vërehet një prezencë gjithnjë në rritje e lëvizjeve feministe, që duke mosmohuar efektin e lartë ndërgjegjësues për rolin e gjysmës së papërfaqësuar si duhet të popullsisë (grave) në aspekte të ndryshme të jetës, tregon për vazhdimësinë e dominancës së tipareve të theksuara maskiliste në shoqërinë shqiptare. Kjo bën që gratë të jenë minoritet jo nga përqindja e tyre në kuadër popullsie (ku raportet janë pothuaj të barabarta) por nga niveli i përfaqësimit të tyre. Shumica e partive politike, kryesisht e atyre të mëdha, në frymën e përfaqësimit të grave kanë vendosur përqindje fikse të anëtarësive në parti dhe forumet e tyre drejtuese (nga 20-30%), por të realizuara minimalisht. (Gjuraj, 2006, pp. 120-121)

Kjo analizë tregon për prezencën e një lidërshi patriarkal, i cili "është identifikuar me dominimin, autoritarizmin dhe fuqi absolute. Në këtë sistem përgjigjia finale është vendosur në një person i cili është konsideruar përtej pyetjes. Ky person është një lider ultimativ, si në familje apo organizatë." (Kanyoro, 2006, p. 3)

Sipas Hofstede (1985) maskiliteti përshkruan shtrirjen e ndarjes së roleve midis gjinive në të cilën njerëzit, në një shoqëri, vendosin thekse të ndryshme të qëllimeve ndaj punës e sigurisë kundrejt atyre personale dhe kujdesit. Në kalkulimin e këtij indeksi, referuar metodologjisë së Hofstede, në studimin e Gjuraj, E (2006) Shqipëria shfaqet një shoqëri maskiliste ku vlera e dimensionit është 86.4, duke e rënditur Shqipërinë midis pozicionit 2 (Austri 79) dhe 1 (Japoni 95) të listës së Hofstede.

Sipas Hofstede G. , (1984: 205-207) shumica e dallimeve shoqërore femërore/ mashkullore duhet të jenë të përcaktuara historikisht dhe tradicionalisht ashtu sikur edhe antropologët raportojnë ndryshimet në dallueshmëritë e rolit të gjinive midis tribuve aq të ngjashme që mund të kenë vetëm origjinë historike. Shumë e rëndësishme për transmetimin e roleve të seksit është familja në të cilën fëmijët modelojnë vet-konceptin e tyre të rolit të seksit sipas vlerave në përdorim që ato vërejnë tek adultët e të dy seksëve me të cilët janë në kontakt të vazhdueshëm. Kështu ky tipar lidhet me dallimet e hasura midis prindërve në familje ose edhe adulateve femra dhe meshkuj, më gjerë në shoqëri. Në përputhje të plotë edhe me disa nga faktorët e dhënë nga Hofstede (1984), në Shqipëri ky dimension e ka origjinën në: përmasat e pakontrolluara të familjes (historikisht dhe përgjithësisht shumë e madhe, tipar i vendeve të varfra); pozicion i dobët i nënës në familje; baballarë që përdoren si modele për djemtë dhe nënat si modele për vajzat; dhe tradita të cilat kthehen prapa me dhjetëra gjenerata, të përforcuara nga ngjarjet historike që kanë bërë ndarje të theksuara të roleve tradicionale të gjinive. Ndërsa konsekuencat shihen në mënyrë të veçantë për shoqërinë dhe më në veçanti për organizatën.

Për shoqërinë si një e tërë:

Ka shpërblime në formë materiale ose statusi për arritësit e suksesshëm;
Sistem shkollor i orientuar nga performanca;
Disa vende pune të konsideruara vetëm për gra ose vetëm për burra;
Rritja ekonomike shihet shumë më e rëndësishme se sa ruajtja e ambjentit.

Për organizatën:

Burrat priten që të bëjnë karrierë;
Interesat organizative konsiderohen legjitime për të ndërhyrë në jetën private të njerëzve;
Më pak gra në vende me të kualifikuara dhe më të paguara mirë.
Duke bërë një lidhje midis stileve të lidhshpimit dhe dimensioneve kulturore sipas Hofstede (1994) dhe Swierczek (1994) dimensionin gjinor të kulturës e shpreh në variabla më të detajuar si më poshtë:
(Maskilist) ARRITES – Konfident, Sukses, Arritje, Sasi, Performancë
(Feminist) SHOQËRUESHEM – Pranues, Kënaqësi, Shoqërizim, Cilësi, Emocion

Gratë në lidërsip (studime dhe statistika)

“Grove dhe Montgomery (2000) përcaktuan liderët si njërëz “të cilët sigurojnë vision dhe kuptim për një institucion dhe përsônifikojnë idealet drejt të cilave synon organizata”(p. 1). Prej kësaj perspektive, liderët janë njëlloj dhe jogjinor. Sidoqoftë akoma ka dyshim kur gratë drejtojnë dhe në shumë situatë gjinia, më tepër se sa mosha, eksperiencia apo kompetenca përcakton rolin (pozicionin) ku është vendosur.” (Kiamba, 2008)

Në 2005 një studim një vjeçar i realizuar nga Caliper⁸ dhe Aurora⁹ arriti të identifikonte një varg karakteristikash të cilat dallojnë gratë nga burrat në lidërsip, kur bëhet fjalë për cilësinë e lidërsipit. Ndër to më të spikaturat janë:

- Gratë lidere janë më bindëse se sa burrat kolegë.
- Kur ndjejnë mohimin, gratë mësojnë prej fatkeqësisë dhe e manaxhojnë situatën me një qëndrim “Unë do të jua tregoj ju”
- Gratë lidere demostrojnë një stilt ë zgjidhjes së problemeve dhe vendim-marrjes përfshirës dhe grup ndërtuese.
- Gratë lidere injorojnë më shpesh rregullat dhe ndërmarrin risk. (Lowen)

Sipas Kanyoro (2006) stili dominant i lidërsipit po bëhet përherë e më pak popullor dhe ka një rritje të vënies së theksit tek karakteristika që shpesh vlerësohen t’i përkasin femrave. Me anë të tyre gratë mbajnë familjen bashkë, organizojnë njësi vullnetare sjellin ndryshin në jetën e përbashkët komunitare. Këto cilësi të reja të admiruara të lidërsipit si lidërsipi i ndarë me të tjerët, kujdesi ndaj të tjerëve dhe të bësh mirë për të tjerët, janë shumë të nevojshme për të bërë diferencën në botën që jetojmë. Indikatorët e suksesit duhet të përfshijnë paqen, përkushtimin, miqësinë dhe kooperimin më tepër se sa konkurrencën. Dhe këto janë cilësitë tashmë të studjuara që gratë sjellin në lidërsip.

Por procesi është i mundur kur gratë arrijnë nivelet e lidërsipit. Sfidë sot nuk është më aq e madhe në krijimin e mundësive për punësim të grave por në zhdukjen e “tavaneve të qelqta” që pengojnë arritjen e këtyre pozicioneve. Por “Për atë që gratë të jenë prezent kudo, ne duhet të punojmë me barrierat që limitojnë, kufizojnë dhe margjinalizojnë gratë. Disa prej këtyre barrierave janë kulturore dhe sociale.” (Kanyoro, 2006, p. 3)

Kështu një meta-analizë¹⁰ e re e Universitetit Northwestern dëshmon që edhe sot akoma lidërsipi vazhdon të shikohet kulturalisht si mashkullor. Kështu studimi theksoi që në këtë situatë gratë vuajnë nga dy forma paragjykimi. E para ato shikohen si më pak të kualifikuara apo natyraliste në stilet e lidërsipit, dhe së dyti kur gratë adoptojnë sjellje kulturalisht mashkullore, shpesh të kërkuara prej këtyre roleve, ato shihen si jo të duhura.

⁸ Një firmë konsultative manaxheriale e bazuar në Princeton, New Jersey.

⁹ Një organizatë me bazë në Londër që për avancimin e grave.

¹⁰ Një integrim i një numri të madh studimesh që adresojnë të njëjtën pyetje. (Northwestern University, 2011)

Dhe këto janë reflektime të stereotipit gjinor sipas të cilit karakteristikat e të qënurit i mirë, i ndjeshëm i veshen grave ndërsa vetë siguria dhe konkurrenca i vishen burrave. Meqënëse burrat i përshtaten më mirë stereotipit kulturor të lidërshit, ato kanë akses më të mirë ndaj roleve të lidërshit dhe më pak sfida në arritjen e suksesit të tyre.

Pra rruga për arritjen e roleve dhe përmbushjen me sukses të tyre është plot pengesa, paragjykimet dhe mosbesimet. “Një qëndrim sensitiv gjinor ndaj lidërshit fillon në të njëjtën kohë me bërjen e lidërshit femëror të dukshëm dhe të vlefshëm dhe afirmuar mënyra shumëfishtë të ushtrimit të lidërshit.” (Kanyoro, 2006)

Në Shqipëri kemi përpjekje konkrete, edhe ligjore, për rritjen e numrit të grave në përfaqësime politike, zbatimin e të cilës sjell jo vetëm rritje sasiore të grave në lidërship por edhe të grave politikëbërëse duke zgjeruar mundësitë e marrjes së vendimeve në favor të këtij grupi deri tani të marginalizuar. Po si paraqitet realiteti panoramë.

Gjatë tre vjetëve të SKBGJ-DHF janë shënuar rezultate në rritjen e numrit të grave në jetën politike. Kodi Elektorale miratuar më 19.11.2008 sanksionoi përfundimisht zbatimin e kuotave të përfaqësimit gjinor në listat shumë-emërore të partive politike për zgjedhjet e përgjithshme. (Strategjia Kombëtare për Barazim Gjinor, Dhunen ndaj Grave dhe Dhunen në Familje, 2011-2015, 2010) Realisht vërehen përparime legjislative në Shqipëri, të nxitura jo vetëm nga Kodi Elektorale (dhjetor 2008), por edhe nga ligji “Barazia Gjinore në Shoqëri” (korrik 2008). Në 2009 në zgjedhjet në nivel qëndror kemi një dyfishim të numrit të grave në parlament prej 7% në 2005 në 16.4%¹¹ në 2009, por që akoma është poshtë kuotës 30% të përfaqësimit. Gratë në Shqipëri akoma përpiqen shumë për të zgjedhur dhe emëruar në pozicione vendim-marrëse. Psh ka vetëm një grua Ministre prej 14 kabinetëve ministri dhe 8 zv/ministre (22.8%) dhe 5 gra ambasadore (10.2%). Që në 2005 për herë të parë një grua u emërua Kryetare e Parlamentit. Gjithashtu, aktualisht ka një grua Kryetare të Gjykatës së Lartë dhe një Prokurore të Përgjithshme, por prapë përfaqësimi i grave në drejtësi mbetet i ulët. Në Këshillin e Lartë të Drejtësisë dy janë gra nga 10 antarë dhe Gjykata Kushtetuese ka 1 grua antare prej 8 antarë në total. (Albanian Center for Economic Research & ASET, September, 2010, p. 11) Gjithashtu ka edhe dy agjenci shumë të rëndësishme nën varësi direkte të Kryeministrit që janë AMF dhe Autoriteti i Konkurrencës, që drejtohen nga gra profesioniste të fushës përkatëse. Pra problematike mbetet: shpërndarja e duhur territoriale e përfaqësimit gjinor, sidomos zonat rurale¹² ndaj atyre urbane janë shumë më mbrapa; rritja e numrit të grave sipërmarrëse¹³; si dhe rritja e numrit të grave në pozicione ekzekutive.

¹¹ Kemi një ndryshim të vogël të kësaj % sot në favor të numrit të grave deputete ku është rritë me një deputete të re socialiste.

¹² “Gratë rurale në Shqipëri janë të pozicionuara në skaj të jashtëm të jetës politike dhe janë më pak të mundura të votojnë, e cila i bën ato afërsisht të padukshme ndaj vendim marrësve. Kjo është një kujtesë e hendekut të madh gjinor që mbetet në terma të aftësive të burrave dhe grave për të përfshirë në jetën politike.” (Albanian Center for Economic Research & ASET, September, 2010, p. 14)

¹³ Në fakt nuk është nën fokus të këtij studimi.

Konkluzione dhe Rekomandime

Në këtë artikull theksohet që “Promovimi i barazisë gjinore shkon në një ritëm me fuqizimin e grave dhe të vajzave për të zënë vendin e tyre në botë pa diskriminimin e vetvetes dhe të diskriminuar prej të tjerëve. Fuqizimi i gruas vjen në shumë forma.” (Kanyoro, 2006, p. 3)

Stilet e rekomanduara të lidërshiptit që sjellin performancë organizative dhe avantazh konkurrues në një botë globale dhe diverse, kanë të trupëzuara tiparet femërore më tepër se sa ato mashkullore të përmbushjes së këtyre roleve në shoqëri. Ajo që kërkohet nuk është heqja dorë nga tiparet femërore, pra mashkullizim i femrës (shpesh në pozicione vendimmarrëse dhe lideri) por shtrirje më të gjërë të tipareve femërore në shoqërinë si një e tërë. Ky edukim i ri përceptual duhet të integrohet në sistemet sociale dhe kulturore duke filluar nga familja, sistemet edukative dhe arsimore, të jetë pjesë e vazhdueshme e mediave vizive dhe të shkruara. Është një proces i gjatë ku krahas sfidave të përgjithshme të këtyre dallimeve gjinore i shtohet edhe impakti kulturor. Pra nëse për një shoqëri feministe siç është shoqëria daneze është e thjeshtë dhe komode ndjekja e një stili lidërshipti me tipare dominuese femërore, është shumë më e vështirë për një shoqëri maskiliste, siç është shoqëria shqiptare, pranimi i këtyre stileve të lidërshiptit ku dominanca dhe vetëvlerësimi i individit zëvendësohet nga dëshira e ndarjes së rolit me të tjerët, tolerance ndaj mendimit ndryshe dhe rritja e bashkpunimit në grup.

Pra kultura maskiliste rrit mundësitë e dështimit të grave në lidërshipt, duke u shprehur me moszbatim kuotash ligjore përfaqësimi, përfaqësim në lista dhe jo pozicione konkrete, përfaqësim në nivele të ulëta dhe jo vendim-marrëse, dhe çfarë vërehet dukshëm në gratë në lidërshipt në Shqipëri, përqaftim nga ana e tyre e roleve të lidërshiptit mashkullor ku dominon agresiviteti mbi butësinë dhe tolerancën.

Tashmë eksperiencat kanë vërtetuar që nuk ka receta universale që ndihmojnë ndryshimin e kësaj situatë. Së pari, gratë vetë duhet të heqin dorë nga vetëdiskriminimi që sjell stepjen e tyre në ndërmarrjen e iniciativave të njëjta me burrat. Së dyti, modernizimi dhe rritja e standartit të jeës duhet të reflektohet në një ndarje të re të roleve në familje, më në favor të grave, si dhe një transmetim më të zbutur të roleve të ndara gjinore brënda familjes në fëmijët e gjinive të ndryshme. Së treti, duhet patjetër të zbatohen kuotat ligjore të përfaqësimit të grave në politikë dhe që rrit prezencën e tyre në vendim marrjen politike dhe përcaktimin e strategjive të duhura dhe zgjedhjen e teknikave funksionale për rritjen e rolit të gruas në shoqëri si një e tërë. Zbatimi i këtyre kuotave ligjore, që në terminologjinë manaxheriale quhen teknika të veprimeve pozitive, shërbejnë si një hap i parë, shpesh jo pak i paragjykuar për pasojat e kundërta që sjell, i domosdoshëm në arritjen e vlerësimit të diversitetit dhe në fund manaxhimin e duhur të tij për të sjellë krijimin e avantazhit konkurrues në nivel organizate dhe shoqërie në përgjithësi. Së katërti, realizimi i studimeve të thelluara në çështje të tillë shumë delikate e bën prezente në diskutime masime duke rritë ndërjegjësimin e të gjithëve për të qënë aktiv në procesin e përfaqësimit gjinor, gjithmonë nxitur nga njohja siç duhet e përfitimeve të këtij angazhimi.

Bibliografia

- Northwestern University. (2011, July 13). Stereotypes About Leadership Still Pose Barriers to Women's Advancement. *Science Daily*.
- Albanian Center for Economic Research & ASET. (September, 2010). *The Situation of Women Leaders at the Local Level in Albania. A Baseline Analysis*. Albanian Center for Economic Research & ASET. Tirana: United Nation Entity for Gender Equality and the Empowerment of Women.
- Chhokar, J. S., Brodbeck, F. C., & House, R. J. (Eds.). (2007). *Culture and Leadership Across the World: The GLOBE Book of In-Depth Studies of 25 Societies*. New York, NY 10016: LAWRENCE ERLBAUM ASSOCIATES, PUBLISHERS Mahwah, New Jersey, London.
- Den Hartog, D., House, R., Hanges, P., Ruiz-Quintanilla, S., Dorfman, P., & Associates, G. (1999). Culture specific and cross-culturally generalizable implicit leadership theories: Are attributes of charismatic/transformational leadership universally endorsed? *Leadership Quarterly*, 10(2) (Special Issue: Charismatic and Transformational leadership: Taking Stock of the present and future (Part I)), 219-156.
- Desvaux, G., & Devillard, S. (2008). *Women Matter 2: Female Leadership, a competitive edge for the future*. France: McKinsey & Company.
- Eagly, A. H., & Johnson, B. T. (1990). Gender and Leadership Style: A Meta-Analysis. *Psychological Bulletin*, Vol. 108, No. 2,, 233-256.
- Gjuraj, E. (2006). *Impakti i kulturës Kombëtare në kulturën organizative. Tendencat dhe ndryshime në vite, sfida dhe perspektiva*. Tezë Doktorature, Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Ekonomisë, Tiranë.
- Gregoire, M. B., & Arendt, S. W. (March, 2004). Leadership: reflections over the past 100 years-perspectives in practice. *Journal of American Dietetic Association*.
- Hofstede, G. (1980). Culture's consequences- International Differences in Work-related Values. (A. Edition, Re.) *Cross-Cultural Research and Methodology Series*, 5.
- Hofstede, G. (1984). *Culture's Consequences: International Differences In Work-related Values*. Beverly Hills, CA: Sage Publications.
- Kanyoro, M. (2006, July 13). CHALLENGES TO WOMEN'S LEADERSHIP. *Speech in honour of YWCA of Salt Lake 100 years celebration*.
- Kiamba, J. M. (2008). Women and Leadership Positions: Social and Cultural Barriers to Success. *Wagadu*, v. 6 (Special Issue: Women's Activism for Gender Equality in Africa).
- Koopman, P. L., Den Hartog, D. N., & Konrad, E. (a.d.). National culture and leadership profiles in Europe: Some results from the GLOBE study. *European Journal of Work and Organizational Psychology* (Special Issue on Organizational culture).

- Lipman-Blumen, J. (1992). Connective Leadership: Female Leadership Styles in the 21st-Century Workplace. *Sociological Perspectives* .
- Lowen, L. (a.d.). *Qualities of Women Leaders The Unique Leadership Characteristics of Women*. Gjetur December 01, 2011, nga About.Com.Women's Issue. Gender Bias: <http://womensissues.about.com/od/intheworkplace/a/WomenLeaders.htm>
- Piterman, H. (March, 2008). *The leadership Challenge: Women in Management*.
- (2010). *Strategjia Kombetare per Barazine Gjinator, Dhunen ndaj Grave dhe Dhunen ne Familje, 2011-2015*. Draft.
- Tukaj, E. (September 1998). *A Study of the National Cultural Impact Upon the Way in Wich Albania & UK operate in their Universities (Dissertation Theses on MBA Course)*. Stoke-on-Trent: Staffordshire University, Business School.
- Winkler, I. (2010). *Contemporary Leadership Theories*. Denmark: Physics-Verlag, Springer Heidelberg Dordrecht, London, New York.

A funksionon taksa e sheshtë?

_____ Enea Zafiri, MA _____

Abstrakt. *Një nga premtimet me të rëndësishme të taksës së sheshtë është rritja e efikasitetit të sistemit fiskal. Për të analizuar këtë efekt janë marrë në shqyrtim 14 vendet ish-komuniste të cilat e kryen reformën pas vitit 2001. E përbashkët e këtyre vendeve është që kanë qenë shumë të zellshëm në reformën e taksës së sheshtë duke ulur shumë nivelin e taksave. Për t'i krahasuar është përdorur një database i Bankës Botërore "Paying Taxes" që rendit çdo vit sipas efikasitetit sistemet fiskale të rreth 180 vendeve të ndryshme në vartësi të efikasitetit të tyre. Nga ecuria e renditjes në këtë data-bazë të vendeve të marra në shqyrtim për një periudhë 5 vjeçare (2007–2011) arrihet në përfundimin që taksa e sheshtë në shumicën e rasteve nuk e ka përmirësuar ndjeshëm efikasitetin e sistemit fiskal. Me përjashtim të Maqedonisë, Kazakistanit dhe Gjeorgjisë, efikasiteti i sistemeve fiskale të të gjithë vendeve të tjera qëndron pak a shumë i njëjtë megjithë reformën e taksës së sheshtë. Ndërkohë, në Rumani, janë ndjerë pasojat negative të taksës së sheshtë mbi shpërndarjen e të ardhurave. Rekomandohet që vendet ish-komuniste të bëjnë dorë nga taksa e sheshtë dhe t'i rikthehen taksimit progresiv, duke përshtatur legjislacionin fiskal me vendet e zhvilluara.*

HYRJE

Taksa e sheshtë është sot një nga temat më të nxehta të debatit midis ekonomistëve të djathtë dhe të majtë. Megjithatë ka qenë një eksperience e hershme (Jersey në vitin 1940, Hong Kongu në vitin 1947) taksa e sheshtë filloi të merrej seriozisht si formë e re për të reformuar sistemin tatimor pas vitit 1994, vit në të cilin u adoptua nga vendet baltike (Estonia, Letonia, Lituania). Debatimi për taksën e sheshtë u ndez sidomos pas adoptimit të saj nga Rusia në vitin 2001. Pas kësaj ngjarje kemi një bum vendesh ish-komuniste që njeri pas tjetrit aplikojnë taksën e sheshtë. Brenda periudhës 2001–2011 numri i shteteve që aplikojnë taksën e sheshtë shkon nga 9 në 35. Shumë politikane të djathtë, kërkojnë adoptimin e

taksës së sheshtë edhe në shtetet perëndimore. Megjithatë, më përjashtim të Islandës që eksperimentoi për një periudhë të shkurtër, asnjë vend perëndimor nuk e ka adoptuar ende këtë formë të re taksimi.

Avantazhet teorike të një takse të sheshtë

Sipas themeluesve të teorisë së taksës së sheshtë Hall dhe Rabushka (2007)¹, në të ashtuquajturën “Bibla e Taksës së Sheshtë” një taksë e sheshtë takson cash-flow-n e një biznesi dhe pagat e punonjësve në të njëjtën masë, thënë ndryshe në të njëjtën përqindje. Taksimi i sheshtë ndryshon nga taksimi progresiv në mënyrën e taksimit. Puna dhe kapitali nuk taksohen në përqindje progresive (sa më të larta të ardhurat nga puna ose fitimi nga kapitali aq më e madhe përqindja e taksës) por në një përqindje të njëjtë (për çdo nivel të ardhurash nga puna ose fitimi nga kapitali, përqindja e taksës është e njëjtë).

Avantazhet kryesore që sjell reforma e taksës së sheshtë janë thjeshtëzimi, barazia dhe efikasiteti më i lartë i sistemit të taksave. Thjeshtëzimi i sistemit vjen nga vendosja e një niveli taksash të njëjtë për të gjithë të ardhurat duke hequr të gjitha përjashtimet; nuk llogariten nivele të ndryshme taksash për kategori të ndryshme por ka vetëm një bazë llogaritje për çdo kategori. Veprimet dhe koha e harxhuar për llogaritjet e taksave shkurtohen në maksimum. Në vendet e zhvilluara, deklarata e taksave thjeshtëzohet nga disa faqe, në një deklaratë të thjeshtë me përmasat e një kartoline (Forbes 2005).²

Barazia vjen nga vendosja e një niveli të njëjtë taksash për të gjithë. Përqindja e taksave vendoset më e ulët sesa mesatarja aktuale. Pavarësisht një niveli më të ulët taksash, niveli i të ardhurave në buxhet mund të rritet. Rënia në të ardhura që vjen nga ulja e taksave për të ardhurat e larta kompensohet nga rritja e të ardhurave që vjen nga rritja e taksave për të ardhurat e ulëta. Teorikisht, një nivel më i ulët taksash rrit edhe dëshirën për të paguar taksa.³

Sipas avokatëve të taksës së sheshtë, thjeshtëzimi dhe barazia bëjnë që taksa e sheshtë të jetë një formë taksimi shumë më efikase sesa taksimi progresiv. Hall dhe Rabushka (2007) deklaroje se: “*Taksa jonë e sheshtë plotëson kushtet e efikasitetit, barazisë dhe thjeshtësisë më mire sesa çdo plan [taksash] tjetër që është propozuar ndonjëherë*”.⁴

Teoria e mësipërme sugjeron që shtetet që adoptojnë taksën e sheshtë duhet të rrisin ndjeshëm efikasitetin e sistemit të tyre fiskal. Rritja e efikasitetit do të ndjehej më shumë në vendet e zhvilluara me sisteme dhe administrate tatimore të

¹ Hall E.R., Rabushka A., (2007)

² Forbes, S. (2005).

³ Hall E.R., Rabushka A., (2007)

⁴ Ibid fq: XV

konsoliduar dhe me deklarata taksash të detajuara. Por edhe vendet në zhvillim, me sisteme taksash në ndërtim e sipër, do të përfitonin nga një sistem më i thjeshtë dhe i barabartë. Në realitet, vetëm vendet në zhvillim e kanë adoptuar taksën e sheshtë.

Kritika teorike e taksës së sheshtë

Kritiket e taksës së sheshtë ngrenë dyshime mbi argumentet teorike ku bazohet teoria e taksës së sheshtë. Së pari, vendosja e një takse të sheshtë nuk garanton thjeshtëzimin e sistemit. Taksa e sheshtë është komplekse për tu zbatuar në praktikë në vendet e zhvilluara pasi vetë sistemi ekonomik në këto vende është kompleks. Thjeshtëzimi i sistemit mund të arrihet edhe me reforma të tjera të ndryshme nga taksa e sheshtë.⁵ Kjo sepse thjeshtëzimi i sistemit nuk është domosdoshmërisht i lidhur me taksën e sheshtë.⁶ Së dyti, barazia e ofruar nga taksa e sheshtë rishpërndan të ardhurat dhe rrit pabarazinë në masë të papranueshme për sistemet perëndimore më demokraci të zhvilluar si Danimarka (Larsen 2006)⁷, Gjermania (Fuest etj 2007)⁸, Hollanda (Heineken 2006)⁹ etj. Së treti, taksa e sheshtë nuk e garanton efikasitetin e sistemit. Me ndryshimin e sistemit nga progresiv në të sheshtë njerëzit do të gjejnë mënyra të tjera për të shmangur taksat¹⁰.

Autorë të tjerë shkojnë më tej duke kundërshtuar edhe bazat ideologjike të taksës së sheshtë. Taksimi i sheshtë shikohet si ide që dëmton demokracinë. Hettich dhe Winer (1999) deklarojnë në mënyrë provokuese se *“është e mundur të kesh një takse të sheshtë, ose të kesh demokraci, por jo të dyja [njëkohësisht]”*. Murphy (2006) shkon akoma më tej. Duke parë bazat ideologjike të dhathta ku bazohen avokatët e taksës së sheshtë, ai e shikon taksën e sheshtë si konspiracion të të pasurve ndaj sistemit demokratik. Duke argumentuar dëmet që taksa e sheshtë sjell mbi sistemin, ai arrin në konkluzionin se *“[taksa e sheshtë] është efektivisht një sulm mbi të gjithë strukturën shoqërore ku jetojmë”*.

Siç shikohet, si bazat teorike, ashtu dhe ato ideologjike të taksës së sheshtë janë të debatueshme. Arsyeja e mundshme është se argumentet pro taksës së sheshtë bazohen më shumë në retorike sesa në analize dhe evidence.¹¹ Për rrjedhojë, nuk ka arsye të qenësishme pse një vend duhet të adoptojë taksën e sheshtë¹².

⁵ Weisbach, D. A. (2000)

⁶ Martin, D. (2005)

⁷ Larsen, T. (2006)

⁸ Fuest, etj (2007)

⁹ Heineken, K. (2006)

¹⁰ Weisbach D. A. (2000)

¹¹ Keen, M., etj (2006)

¹² Peichl A. (2008)

Taksa e sheshtë në vendet e zhvilluara

Efektet pozitive të taksës së sheshtë në vendet perëndimore më demokraci të zhvilluar janë analizuar nga një sërë analistësh (Grecu (2004)¹³ dhe Adam and Browne (2006)¹⁴ për Mbretërinë e Bashkuar, Kuismanen (2000) për Finlandën¹⁵, Jacobs de Mooij dhe Folmer (2007)¹⁶ për Holandën, Kirchhof (2003) dhe Mitschke (2004) për Gjermaninë etj). Megjithatë, përveç eksperimentit tre vjeçar të Islandës, në asnjë nga vendet e pasura të perëndimit nuk është adoptuar ende taksa e sheshtë.

Presioni nga elektorati duket të jetë arsyeja kryesore. Pasojat negative të taksës së sheshtë mbi shpërndarjen e barrës së taksave dhe përfitimet e vagëta teorike duket se e bëjnë elektoratin kundërshtues. Megjithë argumentet teorike, politikanët e djathtë në këto vende nuk kane pasur guximin të përballen me elektoratin me taksën e sheshtë. Në SHBA, Partia Republikane, ku militojnë mbrojtësit më të flakte të taksës së sheshtë, ka rrezuar gjithnjë, që në zgjedhjet paraprake brenda partisë, të gjithë kandidaturat për president që kanë deklaruar që do të adoptojnë taksën e sheshtë në rast se fitojnë (Steve Forbes në vitet 1996 dhe 2000 Mike Huckabee dhe Tom Tancredo, në vitin 2008). Në Gjermani, në zgjedhjet e vitit 2005, mbrojtësi i flakte i taksës së sheshtë dhe kandidati për Ministër Financash i koalicionit të djathtë Paul Kirchhof, për pak u kushtoi humbjen e zgjedhjeve të djathtëve. Kundër-reagimet nga elektorati ishin aq të forta sa Kirchhof u detyrua të tërhiqet fare nga politika¹⁷. Në Slloveni, pas shumë vite debatesh u vendos që të mos kryhej reforma e taksës së sheshtë¹⁸. Ndërkohë, Islanda, pas eksperimentimit më taksën e sheshtë në vitin 2007 e braktisi këtë taksë në vitin 2010 duke iu rikthyer një sistemi progresiv taksash.¹⁹

Faktet e mësipërme tregojnë që, pavarësisht deklaratave, taksa e sheshtë në vendet e zhvilluara mbetet vetëm në kuadrin e retorikës politike. Duket se është e vështirë që në një të ardhme të afërt të shikojmë ndonjë vend perëndimor të adoptojë taksën e sheshtë.²⁰

Taksa e sheshtë në vendet në zhvillim dhe ish-komuniste

Ndërkohë që në Evropën Perëndimore vazhdojnë debatet për reformën për

¹³ Grecu, A. (2004)

¹⁴ Adam, S. etj (2006)

¹⁵ Kuismanen, M. (2000)

¹⁶ Jacobs, B., etj (2007)

¹⁷ Baturu, A. etj (2009)

¹⁸ Cok, M., (2011)

¹⁹ Rabushka, A. (2010)

²⁰ Keen, M. etj (2006)

Taksën e Sheshtë, kjo reforme është tashmë realitet për shumicën e vendeve të ish bllokut komunist dhe një sërë vendesh në zhvillim. Të parat ishin vendet e Baltikut; Estonia në 1994 e ndjekur nga Lituania po në 1994 dhe Letonia në vitin 1995. Vrulli i vërtetë i reformës së taksës së sheshtë nisi pas adoptimit nga Federata Ruse në vitin 2001. Që nga ai vit e mbrapa, pothuajse çdo vit vende të reja ish-komuniste i shtohen listës së taksës së sheshtë.

Tabela në vazhdim paraqet një liste të plote të shteteve që kanë adoptuar taksën e sheshtë deri në vitin 2011.²¹

Tabela 1. Lista e shteteve që kanë adoptuar taksën e sheshtë deri në vitin 2011

Nr.	Vendi	Viti reformes	Ish Komunist	Ishull/ Kontinent	Tatimi mbi të ardhurat	Tatimi mbi fitimin
1	Jersey	1940	Jo	Ishull	20.00%	20.00%
2	Hong Kong	1947	Jo	Ishull	16.00%	17.50%
3	Guernsey	1960	Jo	Ishull	20.00%	20.0%*
4	Xhamajka	1986	Jo	Ishull	25.00%	33.30%
5	Tuvalu	1992	Jo	Ishull	30.00%	30.00%
6	Estonia	1994	Po	Kontinent	21.00%	21.0%*
7	Lituania	1994	Po	Kontinent	15.00%	15.00%
8	Letonia	1995	Po	Kontinent	26.00%	15.00%
9	Rusia	2001	Po	Kontinent	13.00%	24.00%
10	Serbia	2003	Po	Kontinent	19.00%	19.00%
13	Iraku	2004	Jo	Kontinent	15.00%	15.00%
11	Slovakia	2004	Po	Kontinent	19.00%	19.00%
12	Ukraina	2004	Po	Kontinent	15.00%	25.00%
15	Gjeorgjia	2005	Po	Kontinent	20.00%	20.00%
14	Romania	2005	Po	Kontinent	16.00%	16.00%
16	Turkmenistani	2005	Po	Kontinent	10.00%	20.00%
17	Kirgistani	2006	Po	Kontinent	10.00%	10.00%
18	Pridnestrovie	2006	Po	Kontinent	10.00%	10.0%*
19	Trinidad dhe Tobago	2006	Jo	Ishull	25.00%	25.00%
24	Shqiperia	2007	Po	Kontinent	10.00%	10.00%
20	Kazakistani	2007	Po	Kontinent	10.00%	15.00%
22	Maqedonia	2007	Po	Kontinent	10.00%	10.00%
25	Mauritiusi	2007	Jo	Ishull	15.00%	15.00%
21	Mongolia	2007	Po	Kontinent	10.00%	10.0%, 25.0%
23	Mali i Zi	2007	Po	Kontinent	9.00%	9.00%
27	Bulgaria	2008	Po	Kontinent	10.00%	10.00%

²¹ Lista dhe niveli i taksave është marre nga blogu personal i Alvin Rabushka (2010) ndërsa të dhënat për pozitën gjeografike janë marre nga Google Maps (2011)

26	Republika Çeke	2008	Po	Kontinent	15.00%	19.00%
28	Timori Lindor	2008	Jo	Ishull	10.00%	10.00%
31	Bjellorusia	2009	Po	Kontinent	12.00%	24.00%
29	Belize	2009	Jo	Kontinent	25.00%	25.00%
30	Bosnje Hercegovina	2009	Po	Kontinent	10.00%	10.00%
33	Paraguai	2010	Jo	Kontinent	10.00%	10.00%
32	Ishujt Seishelle	2010	Jo	Ishull	15.00%	35.00%
34	Hungaria	2011	Po	Kontinent	16.00%	10.00%
35	Abkazia*		Po	Kontinent	10.00%	18.00%

*Abkazia njihet si vend sovran shtet vetëm nga Rusia dhe 7 shtete të tjerë

Nga lista dalin dy fakte interesante. Së pari, nga 35 shtetet që kanë kryer reformën e taksës së sheshtë 23 shtete ose gati 2/3 janë vende ish komuniste dhe 9 janë ishuj të vegjël ose shumë të vegjël. Tre shtetet e mbetura janë Iraku i dalë nga lufta në vitin 2003, Belize, një mikro-shtet në Amerikën e Veriut më vetëm 320,000 banorë²² dhe Paraguai. Pra, më përjashtim të Paraguit dhe Irakut, reforma e takes së sheshtë është kryer ose në vendet ish-komuniste, ose në ishuj dhe mikro-shtete. Së dyti, numri i shteteve që kishin adoptuar taksën e sheshtë ishte vetëm 8 para adoptimit të taksës së sheshtë nga Federata Ruse në vitin 2011. Numri shkon në 35, pra katërfishohet pas këtij viti. Duket se reforma në Rusi ka qenë shtytësi kryesor për adoptimin e taksës së sheshtë nga vendet ish-komuniste.

Ka një arsye të thjeshte për reformën e taksës së sheshtë nga shtetet të cilat nuk i përkasin grupit ish-komunist. Këto vende janë në përgjithësi aq të vogla dhe jo efektive në grumbullin e taksave sa nuk mund ta përballojnë një sistem progresiv taksash²³. Për këto vende kosto e një administrate taksash efektive është shumë e madhe. Në këto kushte taksa e sheshtë ka kuptim. Për më tepër, vende si Tuvalu grumbullojnë 10% të buxhetit vetëm nga shitja e të drejtës për të përdorur prapashtesën .tv në internet²⁴.

Arsye të tjera shtynjë vendet ish-komuniste drejt taksës së sheshtë. Përpara se të shndërroheshin në demokraci këto vende nuk kishin një sistem të mirëfilltë taksash dhe mbrojtje sociale²⁵. Ky fakt bënte që ato ishin në kushte shumë më të mira sesa vendet e zhvilluara për të kryer reformën. I pamësuar më komoditetin e mbrojtjes sociale dhe më një sistem të mirëfilltë taksash, elektorati në këto vende ka një reagim shumë më të dobët sesa ai në vendet e zhvilluara. Si pasojë, këto

²² CIA, (2011)

²³ Me përjashtim të Xhamajka dhe Hong-Kong të tjerët kanë popullsi më të vogël sesa 1.3 milion banorë. CIA (2010)

²⁴ Orenstein, M. A., (2011)

²⁵ Aslund, A. (2007)

vende duket se kanë qenë kandidatët perfekt për të eksperimentuar me taksën e sheshtë.²⁶

Edhe vetë brenda për brenda grupit të vendeve ish komuniste ka ndryshime. Vendet që e reformuan sistemin para vitit 2001 karakterizoheshin nga norma taksash në nivele relativisht të larta, afërsisht sa ose saktësisht sa niveli maksimal i taksave para reformës. Ndërkohë vendet që kryen reformën pas vitit 2001 karakterizohen nga nivele shumë më të ulëta sesa nivelet para reformës, më pak sesa 20% dhe në disa raste shumë më ulët sesa kaq²⁷. Duket sikur qeveritë në vendet që bëjnë pjesë në grupin e dytë kanë pasur përparësi më shumë reformimin e sistemit duke përfituar në maksimum efikasitetin e taksës së sheshtë sesa të krijojnë hapësira për mbrojtje sociale të shtetasve të tyre. Analiza në vazhdim tregon se sa ja kanë arritur qëllimit.

Taksa e sheshtë dhe efikasiteti i sistemit fiskal

Nga tabela në Shtojcën 1 shikohet se vendet ish komuniste që adoptuan taksën e sheshtë pas vitit 2001 kanë qenë veçanërisht të zellshme për t'i shkuar më thellë se të tjerat reformës se taksës së sheshtë. Shtrohet pyetja: A e ka përmirësuar efikasitetin e sistemit fiskal në këto shtete reforma e taksës së sheshtë?

Për t'iu përgjigjur kësaj pyetje nga lista e shteteve më taksë të sheshtë janë marre në shqyrtim sistemet fiskale të shteteve që kryen reformën pas vitit 2001. Si baze krahasimi është përdorur renditja në raportin vjetor "Paying taxes" që botohet nga Banka Botërore në bashkëpunim me kompaninë ndërkombëtare PricewaterhouseCoopers (PWC) si pjesë e projektit "Doing Business"²⁸. Ky raport rendit shtetet sipas efikasitetit të sistemit të tyre të taksave. Tabela filloi të përpilohet për herë të parë në vitin 2007 duke renditur sistemet fiskale të 178 vendeve të botes me sisteme taksash kryesisht proporcional por edhe të sheshte. Renditja bazohet në dy nga parametrat kryesorë të sistemit të taksave; thjeshtësinë dhe nivelin e barrës fiskale. Thjeshtësia matet duke u bazuar në kohën e harxhuar për të përpiluar deklaratat e taksave si dhe numrin e përgjithshëm të taksave që duhen paguar. Barra fiskale mat, në përqindje, barrën e të gjitha detyrimeve që duhet të paguaj një biznes. Avokatet e taksës së sheshtë argumentojnë që pikërisht këto parametra përmirësohen nga kryerja e reformës se taksës së sheshtë. Si rezultat, duhet të presim që, vendet e përzgjedhura, për vetë thellësinë e reformave, të kenë ndryshuar ndjeshëm në krahasim me vendet e tjera duke u ngjitur shpejt në këtë renditje.

Tabela në vazhdim paraqet renditjen sipas PWC për 5 vite të sistemit fiskal

²⁶ Ellis J. M. (2011)

²⁷ Keen, M. etj (2006)

²⁸ www.doingbusiness.org/reports/thematic-reports/paying-taxes/

te secilit nga shtetet e përzgjedhura krahasimisht me shtetet e tjera. Me germa të trasha janë vitet në të cilat shteti përkatës ka ngjitje në renditjen e PWC. Tabela është renditur sipas vitit që është kryer reforma e taksës së sheshtë.

Nr.	Shteti*	Viti reformës	2007	2008	2009	2010	2011
1	Serbia	2003	121	126	136	138	143
2	Sllovakia	2004	122	126	119	122	129
3	Ukraina	2004	177	180	181	181	181
4	Gjeorgjia	2005	102	110	64	61	39
5	Romania	2005	134	146	149	151	154
6	Kirgistani	2006	152	155	156	150	162
7	Kazakistani	2007	44	49	52	39	17
8	Maqedonia	2007	99	27	26	33	20
9	Mali i Zi	2007	129	139	145	139	114
10	Shqipëria	2007	118	143	138	149	152
11	Bulgaria	2008	88	94	95	85	84
12	Republika Çeke	2008	113	118	121	128	117
13	Bosnje Hercegovina	2009	142	154	129	127	118
14	Bjellorusia	2009	178	181	183	183	156
	Numri total i vendeve të shqyrtuara		178	181	183	183	183

*Në listë nuk përfshihen Turkmenistani, Pridnestrovie dhe Abkazia të cilat nuk janë pjesë e një databaze të PWC si dhe Mongolia e cila nuk ka një taksë të sheshtë të pastër

Burimi: Banka Botërore 2008, 2009, 2010, 2011, 2012 raporti "Të paguash taksa"

Fakti i parë që bie menjëherë në sy nga tabela është efikasiteti shumë i dobët i sistemeve fiskale të shteteve të përzgjedhura në vitin 2007 në krahasim me vendet e tjera. Ky efikasitet i dobët reflektohet tek renditja shumë poshtë në tabelën me 178 shtete të përpiluar nga PWC. Nga tabela me sipër shihet se, vetëm sistemi fiskal i Kazakistanit renditet mirë, në pjesën e sipërme të tabelës, në vendin e 44 nga 178. Sistemi fiskal Bullgar renditet diku nga mesi, në vendin e 88. Sistemet fiskale të të gjithë shtetet të tjera ku është aplikuar ose pritet të aplikohet taksa e sheshtë renditen në pjesën poshtë të tabelës (vendi i 99 e poshtë). Për më tepër, Ukraina dhe Bjellorusia mbyllnin tabelën duke zënë vendet e parafundit dhe të fundit, përkatësisht 177 dhe 178. Rënditja e keqe tregon që, pothuajse të gjitha vendet ish komuniste që kane aplikuar ose pritet të aplikojnë taksën e sheshtë kanë pasur nevojë të madhe për të reformuar sistemet fiskale në vitin 2007 pasi efikasiteti ka qenë shumë i ulët në krahasim me pjesën tjetër të botës.

Fakti i dytë që bie në sy është që, edhe pas adoptimit të taksës së sheshtë, gjatë

periudhës 2007-2011, renditja e sistemeve fiskale të shumë prej këtyre shteteve vazhdon të mbetet pak a shumë e njëjtë. Nga tabela shikohet se, në vitin 2011, vetëm 3 prej shteteve që kanë kryer reformën, Gjeorgjia, Kazakistani, Maqedonia renditen ndër vendet e para në tabelë. Mbas tyre, Bullgaria vazhdon të ketë një renditje disi të mire por përsëri nga mesi i tabelës. Sistemet fiskale të të gjithë shteteve të tjera vazhdojnë të renditen nga fundi i tabelës më 183 vende (nga vendi 114 e poshtë). Rast ekstrem janë Ukraina dhe Bjellorusia (përjashto vitin e fundit) sistemet fiskale të të cilave, vit pas viti, edhe pse shtohen shtete të tjera në tabelën e PWC, vazhdojnë të renditen ndër 3 vendet e fundit të tabelës. Ky fakt tregon se, përzgjedhja e taksës së sheshtë si forma më e efikase për të reformuar sistemin fiskal nuk ka dhënë rezultat në pjesën më të madhe të rasteve.

Duke parë në tabelë ecurinë e renditjes vit pas viti të sistemeve fiskale të 14 vendeve të marra në konsideratë zbulohen edhe fakte të tjera që mbështesin idenë që, taksa e sheshtë, si reformë për të rritur efikasitetin e sistemit fiskal, përgjithësisht nuk funksionon. Sistemet fiskale të 8 nga 14 shtetet ish-komuniste që kanë kryer reformën e taksës së sheshtë pas vitit 2001 kanë pasur vetëm një ose asnjë vit ku ka një përmirësim në renditje. Sistemet fiskale të Serbisë, Rumanisë dhe Ukrainës, edhe pas reformës se taksës se sheshte, renditen vit pas viti ose njësoj, ose më keq sesa një vit më parë. Ndërkohë sistemet fiskale në 5 shtete të tjera, Sllovakisë, Shqipërisë, Kirgistanit, Bjellorusisë dhe Republikës Çeke kanë në një rast të vetëm një ngritje në renditje dhe më pas i janë kthyer përsëri trendit në rënie. Vlen të theksohet që sistemet fiskale të Sllovakisë, Shqipërisë dhe Kirgistanit, në periudhën pasardhëse, pozicionohen në renditje edhe më keq sesa më parë. Mbetet për tu parë renditja në vitin pasardhës e Bjellorusisë dhe Republikës Çeke pasi ndryshimi ka ndodhur vetëm në vitin 2011.

Renditja vit pas viti tregon edhe shpejtësisë më të cilën ka vepruar taksa e sheshtë në reformimin e sistemit tatimor. Janë 8 shtete që kanë aplikuar reformën e taksës së sheshtë pas vitit 2007. Me përjashtim të Bosnje Hercegovinës, në asnjë rast tjetër periudha e ngritjes në renditje nuk përkon më momentin e reformës. Për më tepër, edhe për shtetet që e kanë kryer reformën më herët se viti 2007, në periudhën 2007-2008 ka përkeqësim në renditje. Ky fakt tregon se ka një mospërputhje pothuajse të plotë midis momentit të kryerjes së reformës dhe momentit kur, për disa vende, fillon të përmirësohet renditja në tabele. Kjo mospërputhje konfirmon përfundimin e kritikeve të taksës se sheshtë se reformimi i sistemit fiskal dhe adoptimi i taksës së sheshtë janë dy gjëra të cilat jo domosdoshmërisht shkojnë bashkë.

Nder shtetet që kanë dy ose më shumë vite përmirësim në renditje, Maqedonia duket së është kampionia e reformave, më një kërcim shumë të ndjeshëm më 72 vende në 5 vitet e marre në konsideratë. Sistemet fiskale në Gjeorgji dhe Bosnje Hercegovinë duket së kanë pasur reforma të suksesshme për tre vite radhazi. Ndërkohë, Kazakistani, Mali i Zi dhe Bullgaria duket të kenë hyre në rrugën e reformave në vitin 2010 dhe kanë përmirësuar sistemet e tyre tatimore për dy vite

njeri pas tjetrit

Megjithatë, duke krahasuar renditjen e këtyre shteteve midis periudhës 2007-2011, vetëm sistemet fiskale të Maqedonisë dhe Gjeorgjisë janë përmirësuar aq shumë sa kanë arritur të shkëputen nga mesi i tabelës në drejtim të vendeve të para. Kazakistani ka përmirësuar më tej renditjen duke iu afruar fillimit të tabelës. Sistemet fiskale të Bosnje Hercegovines dhe Malit të Zi, megjithë përmirësimet për 2-3 vite radhazi, përsëri nuk kanë arritur të ngjiten në renditje as deri në gjysmën e parë të tabelës së vitit 2011 me 183 vende. Ndërkohë që Bullgaria, megjithë përmirësimin modest në renditje, vazhdon të mbetet vendi i fundit i BE përsa i përket kohës që i nevojitet një biznesi për të paguar taksat²⁹.

Diskutime dhe rekomandime

Megjithë dobitë teorike të deklaruara nga avokatet e saj, taksa e sheshtë mbetet larg të qenit forma më e mire për të reformuar sistemin fiskal. Stimulimet ekonomike në vendet e zhvilluara tregojnë se adoptimi i taksës së sheshtë krijon pabarazi të theksuara të cilat, krijojnë kundërshtime shumë të forta nga elektorati dhe vene në dyshim të forte mundësinë për një reforme të tillë në një të ardhme të afërt. Në vendet ish komuniste elektorati është më pak kundërshtues por, rezultatet pozitive të reformës së taksës së sheshtë, në përgjithësi, mungojnë. Reformat kanë qene domosdoshmëri për këto shtete pasi sistemet e tyre fiskale kanë pasur mungese të theksuar efience. Megjithatë, përzgjedhja e taksës së sheshtë nuk duket të ketë qene zgjidhja më e mire. Faktet e mësipërme tregojnë se, në shumicën e rasteve, sistemet e taksave të shteteve ish komuniste që u treguan më të zellshmet në adoptimin e filozofisë së taksës së sheshtë, mbeten përsëri, më përjashtime të pakta, pothuajse po në të njëjtin nivel efience ose patën edhe rënie të mëtejshme efience pas aplikimit të taksës së sheshtë. Ky fakt reflektohet nga mbetja në vend ose renditja me keq në tabelën e PWC krahasuar me shtetet e tjera ku përdoret taksimi progresiv. Kjo tregon që, në përgjithësi, taksa e sheshtë është e pafuqishme të ofrojë çfarë premtion: një sistem më efikas dhe më të thjeshtë sesa taksimi progresiv. Të vetmet vende për të cilat taksa e sheshtë mund të ketë kuptim janë vendet me popullsi të vogël të cilët janë të detyruar të adoptojnë taksën e sheshtë për vete kushtet specifike të vendeve të tyre.

Kritiket e taksës së sheshtë arrijnë në përfundimin se taksa e sheshtë dhe thjeshtëzimi i sistemit jo domosdoshmërisht duhet të shihen si dy çështje të lidhura me njëra tjetrën³⁰. E thënë ndryshe, një sistem taksimi i sheshtë nuk është domosdoshmërisht edhe i thjeshtë. Ky përfundim konfirmohet edhe nga analiza

²⁹ World Bank (2012)

³⁰ Martin, D. (2005)

e shteteve ish komuniste qe aplikuan taksimin e sheshtë pas vitit 2001. Analiza konfirmon se ka mospërputhje midis momentit të reformës dhe momentit kur sistemi fiskal nis të përmirësohet.

Ndërkohë, një sistem taksimi progresiv mund të jete shume me i thjeshte sesa një sistem taksimi i sheshtë. Ky përfundim shihet qarte nëse krahasojmë në raportin e PWC vende më takse të sheshtë dhe ato më taksim progresiv. Ka vende të cilat, edhe pse më taksim progresiv dhe taksa të larta, përsëri kane sisteme shumë më të thjeshtëzuara sesa vendet më takse të sheshtë. Një shembull janë Bullgaria dhe Republika Ceke, anëtare tashme e BE, të dyja me sisteme fiskale të sheshta. Ne vitin 2011, një biznesi i janë dashur 195 ore në vit në Bullgari dhe 165 ore në vit në Republikën Ceke për të paguar TVSH. Këto shifra janë shumë më të larta sesa mesatarja e BE prej 68 orësh³¹.

Shembull tjetër vjen nga krahasimi midis Shqipërisë dhe Suedisë i kryer nga "Paying Taxes" (2011)³². Suedia ka një sistem taksash progresiv dhe një barre të lartë taksash 52.8%, ose 8.8% më e lartë se mesatarja botërore prej 44%. Ky nivel i lartë taksash e lejon Suedinë të ofroje shërbime sociale më cilësi shumë të lartë që reflektohet në standarde jetese shumë të mira për qytetaret e saj. Por, megjithë taksat e larta, sistemi fiskal është shumë efikas dhe renditet në vendin e 44 në renditjen e PWC. Kjo pasi një biznesi në Suedi i duhen vetëm 122 ore në vit për të paguar taksat të cilat janë vetëm 4 cope. Nga ana tjetër, Shqipëria, më një takse të sheshtë, ka një barre fiskale pre 38.5%, ose 5.5% më të ulët sesa mesatarja botërore. Por megjithë taksat e ulëta dhe taksimin e sheshtë, Shqipëria renditet në vendin e 152 pasi sistemi i saj fiskal, edhe pse më takse të sheshtë, është shumë i ndërlikuar. Kjo sepse, në vitin 2011, një biznesi në Shqipëri i duhen plot 371 ore në vit (mesatarja botërore 277) për të paguar 44 taksat e ndryshme (mesatarja botërore 28.5).

Zelli i vendeve ish komuniste për të adoptuar taksen e sheshtë duket se është shprehur më shumë në uljen e nivelit të taksave sesa në reformim të vërtetë të sistemit. Shembull tipik është Maqedonia, kampionia e reformave që e ka çuar barrën fiskale në vitin 2011 në vetëm 9.7%³³. Tani, vetëm 3 ishuj, Timori-Lindor, Vanuatu dhe ishujt Maldive kanë taksa më të ulëta se Maqedonia e cila renditet e katërta në bote për taksat më të ulëta³⁴. Këto ulje drastike taksash duket se do të sjellin në të afërmen ne vendet me takse të sheshtë atë që i tremben më shumë vendet e zhvilluara, deformimin e sistemit duke rritur pabarazinë. Shenjat e para janë dhënë. Analiza e Voinea etj (2009)³⁵ në Romani tregon që, një vit pas reformës se taksës së sheshtë, të varfrit janë akoma më të varfër dhe të pasurit akoma më të

³¹ World Bank 2012 fq. 52

³² Ibid fq. 26

³³ Ibid fq. 126

³⁴ Ibid fq. 126

³⁵ Voinea L, (2009)

pasur. Ky përfundim konfirmon analizën e Murphy (2006) sipas të cilit, taksa e sheshtë është një mënyrë për të pasurit që të shmangin përgjegjësitë e tyre shoqërore duke i lejuar të paguajnë pak ose aspak taksa dhe që shteti të marrë sa më pak të ardhura. Nevojitet një studim më i plote për të parë nëse ky konkluzion aplikohet në të gjitha shtetet ku është adoptuar taksa e sheshtë.

Rekomandimi për vendet ish-komuniste në përgjithësi, duket të jetë heqja dore nga taksa e sheshtë dhe adoptimi i një sistemi taksimi progresiv dhe një sistemi legjislativ tatimor perëndimor. Elektorati në këto vende më të vërtetë e ka pranuar pa shumë kundërshtime taksën e sheshtë por, thellimi i ndasisë sociale, mund të çojë në pasoja të pakëndshme.

Një rikthim në taksimin progresiv, i shoqëruar më një përafrim legjislativ në tërësi dhe atij tatimor në veçanti më vendet e Evropës Perëndimore duket të jetë rruga më e mire për të rritur efikasitetin dhe drejtësinë e sistemit fiskal për vendet që tashmë aplikojnë taksën e sheshtë. Përshtatja e legjislativit do të çonte në një sistem fiskal më modern dhe më efikas. Taksimi progresiv do të kryente një rishpërndarje më të drejtë të barrës fiskale midis grupeve të ndryshme shoqërore duke shmangur tensionet e pritshme. Shteti do të luante më mirë funksionin e tij pasi do të kishte më shumë mundësi për politika sociale dhe menaxhim të sistemit të taksave. Në afatin e gjatë, duket se modeli Suedez më taksa të larta dhe mirëqenie të lartë është shumë më i lakmueshëm sesa modeli që ofron taksa e sheshtë.

Bibliografia:

- Adam, S., Browne, J. (2006). “*Options for a UK’ flat tax’: some simple simulations*”, IFS Briefing Note No. 72.
- Aslund, A. (2007). “*How Capitalism Was Built: the Transformation of Central and Eastern Europe, Russia and Central Asia*”. Cambridge, UK: Cambridge University Press.
- Baturo, A., J. Gray. (2009). “*Flatliners: ideology and rational learning in the adoption of the flat tax*”, European Journal of Political Science. 48 (1): 130–159
- CIA, (2011). “*The world factbook*”, <https://www.cia.gov/library/publications/the-world-factbook/geos/bh.html>
- CIA, (2010). “*The world factbook*”, https://www.cia.gov/library/publications/the-world-factbook/rankorder/rawdata_2119.txt
- Cok, M., Sambt J., Košak M, Verbic M., Majcen B. (2011) “*Distribution of Personal Income Tax Changes in Slovenia*”, Institute for Economic Research - IER, Ljubljana WORKING PAPER No. 57, 2011
- Ellis, J. M., (2011). “*The Flat Tax in Central Europe: Slovakia and the Czech Republic in Comparative Perspective*”, Central European Journal of Public Policy Vol. 5 – 1 – June 2011 – pp 24–51

- Forbes, S. (2005). *Flat Tax Revolution: Using a Postcard to Abolish the IRS*, Washington D.C., Regnery Publishing, Inc.
- Fuest, C., A. Peichl, and T. Schaefer (2007). *Is a Flat Tax Feasible in a Grown-up Welfare State?* Institute for the Study of Labor. IZA Discussion Paper 3142.
- Grecu, A. (2004). *Flat Tax – The British Case*, London: Adam Smith Institute.
- Google Maps (2011) <http://maps.google.com/>
- Hall, E.R., Rabushka, A., (2007). *The Flat Tax (Hoover Classics)* Hoover Institution Press; 2nd edition
- Heineken, K. (2006). *A Flat Tax Rate in the Netherlands – An Option for the Next Coalition Agreement?* (Ministria e Financës, Departamenti i Politikave të Taksave, Holande) Punim i paraqitur në konferencën për taksen e sheshtë në Bled, Slovenia, Shkurt 2006,
- Jacobs, B., de Mooij, R. A., Folmer, K., (2007). *Analyzing a flat income tax in the Netherlands*, Tinbergen Institute Discussion Paper 2007-029/3.
- Keen M., Kim Y., Varsano R. (2006). *The “Flat Tax(es): Principles and Evidence.”* International Monetary Fund, IMF Working Papers: 06/218.
- Kuismanen, M. (2000). *Labour supply and income tax changes: A simulation study for Finland*, Bank of Finland Discussion Paper 5/2000.
- Larsen, T. (2006) *A flat tax in Denmark?*, (Ministria e Finances, Danimarke). Punim i paraqitur në konferencën për taksen e sheshtë në Bled, Slovenia, Shkurt 2006,
- Martin, D. (2005), *An overview of the flat tax* London: Centre for Policy Studies
- Orenstein, M. A., (2011). *Who needs a flat tax?* <http://www.project-syndicate.org/commentary/orenstein4/English>
- Peichl, A. (2008). *Could the World be Flat? Simulating Flat Tax Reforms in Western Europe* Punim Doktorature i dorëzuar në Universitetin e Kelnit në 18 Korrik 2008
- Rabushka, A., (2010). *Iceland Abandons the Flat Tax*, <http://flattaxes.blogspot.com/2010/03/iceland-abandons-flat-tax.html>
- Rabushka, A., (2010). *Flat Tax Countries and Jurisdictions September 2010*, <http://flattaxes.blogspot.com/2010/03/iceland-abandons-flat-tax.html>
- Voinea, L., Mihaescu, F., (2009). *The Impact of the Flat Tax Reform on Inequality – the case of Romania*, Romanian Journal of Economic Forecasting, 2009, volume 12 issue 4, 19-41
- Weisbach, D. A., (2000). *Ironing Out the Flat Tax*, Stanford Law Review, Vol. 52, No. 3 (Feb., 2000), pp. 599-664
- World Bank, PricewaterhouseCoopers, (2007) *Paying Taxes 2008, the Global Picture* www.pwc.com/gx/en/paying-taxes/pdf/paying_taxes_2008.pdf
- World Bank, PricewaterhouseCoopers, (2008) *Paying Taxes 2009, the Global Picture* www.pwc.com/gx/en/paying-taxes/pdf/paying_taxes_2009.pdf
- World Bank, PricewaterhouseCoopers, (2009) *Paying Taxes 2010, the Global Picture* www.pwc.lu/en/tax-consulting/docs/pwc_payingtaxes_2010.pdf

- World Bank, PricewaterhouseCoopers, (2010) *"Paying Taxes 2011, the Global Picture"*
www.pwc.com/gx/en/paying-taxes/pdf/paying-taxes-2011.pdf
- World Bank, PricewaterhouseCoopers, (2011) *"Paying Taxes 2012, the Global Picture"*
[http://www.doingbusiness.org/~media/FPDKM/Doing%20Business/Documents/
Special-Reports/Paying-Taxes-2012.pdf](http://www.doingbusiness.org/~media/FPDKM/Doing%20Business/Documents/Special-Reports/Paying-Taxes-2012.pdf)

Shembja e një shteti: Shkëlqimi dhe rënia e piramidave financiare shqiptare në 1997

____ Prof. Dr. Adrian CIVICI _____

Abstrakt. *Në vitin 1997, ekonomia, financat, por dhe gjithë shteti e shoqëria shqiptare njohën një nga krizat më të rënda të historisë së tyre. Disa qindra mijëra njerëz që humbën tërësisht paratë e tyre, miliarda dollarë të përpirë nga një sistem firmash rentiere të tipit Ponzi, një shtet i tërë i paralizuar dhe pjesa dërrmuese e popullsisë në revoltë, ushtri dhe polici totalisht e shkatërruar dhe miliona armë në duart e popullsisë, me mijëra të vrarë e të plagosur pa qenë asnjëherë e qartë se kush ishte realisht “armiku”, dhjetëra mijëra shqiptarë u larguan si refugjatë drejt Italisë, Greqisë, etj. Dukej sikur Shqipërisë po i ndodhte një apokalips i vërtetë ekonomik, politik e social. U desh ndërhyrja e trupave të huaja ushtarake, kryesisht italiane që vendi “të qetësohej” dhe të rifillonte jetën dhe aktivitetin normal.*

Shqipëria, vendi i vogël ballkanik, i konsideruar si “bastion i socializmit ortodoks” që e kishte filluar tranzicionin “nga plani drejt tregut të lirë” më vonë se të gjithë vendet e tjera të Evropës Qendrore e Lindore, ose më saktë, i fundit prej tyre, arriti megjithatë që brenda pak vitesh (1992-1996) të ishte e suksesshme në reformat e saj strukturore makroekonomike në konformitet të plotë me rekomandimet e FMN-sw dhe “Konsensusin e Washingtonit”¹. Gjatë periudhës 1992-96, Shqipëria arriti të kontrollonte inflacionin e saj galopant të fillimit të periudhës post-socializëm, rriti në mënyrë konstante PBB, zvogëloi papunësinë, përmirësoi deficitin buxhetor, adoptoi regjimin e këmbimit të lirë të monedhës, ndërtoi një sistem bankar me dy nivele duke garantuar funksionimin e një

¹ Williamson, J. 1994. *The Political Economy of Policy Reform*. Washington, D.C.: Institute for International Economics

Banke Qendrore të pavarur, liberalizoi tregtinë dhe çmimet², etj., duke u cilësuar si nxënësi i shkëlqyer i FMN-së³. Me gjithë tensionin e madh politik, kur ishte fjala për ekonominë, ristrukturimin mikro dhe makroekonomik, financat dhe reformat fundamentale gjithçka dukej se po ecte perfekt për Shqipërinë. Por, falimentimi i firmave piramidale financiare në fillim të 1997 e “hodhi në erë” këtë situatë pozitive.

Por, ndërsa meritat për këtë rrugë të suksesshme i merrte vazhdimisht FMN, Banka Botërore, apo dhe institucione të tjera ndërkombëtare që ishin prezente në çdo vendimarrje në vend, lindja dhe përhapja e jashtëzakonshme e skemave piramidale financiare dhe shkatërrimi brenda pak javësh i shtetit u konsideruan si “kuptim i gabuar që shqiptarët kishin për kapitalizmin”⁴, ndërkohë që Shqipëria filloi të vlerësohej si një “eksperiencë laboratorike” për realizimin e tranzicionit. Argumenti themelor që tentonte të shpjegonte arsyen e përhapjes kaq të madhe të skemës Ponzi në Shqipëri ishte “kombinimi i efekteve të politikave monetare restriktive, mungesës së instrumenteve e institucioneve të rregullimit të tregut, hyrjes masive të kapitaleve dhe dobësive në qeverisje”⁵.

Cilat janë arsyet kryesore që përgatitën terrenin për lulëzimin e skemave financiare piramidale Ponzi në Shqipëri? Megjithëse doza e informalitetit në ngritjen dhe funksionimin e tyre është shumë e lartë, ekzistojnë disa indikatorë e dukuri që shpjegojnë arsyet direkte apo indirekte të lindjes dhe shtrirjes kaq masive të tyre në një vend në tranzicion. Regjimet financiare të tipit Ponzi⁶ gjejnë terren të

² Në fillim të vitit 1992 rreth 1/3 e popullsisë shqiptare ishte e papunë, deficit i buxhetor rezultonte 50% në raport me PBB, inflacioni arriti në 45%, leku shqiptar u zhvleftësua në mënyrë drastike në raport me dollarin ameriakn, apo monedhat e tjera europiane, etj.

³ McAdams, D. 1997. *An Albanian Tragedy*. Albania - CRISIS '97 News Centre. Internet address <http://www.albania.co.uk/crisis/daniel.html>;

⁴ Wall Street Journal (1997: March 24). “Anarchy in Albania” in the *Europe Section of the Wall Street Journal*.

⁵ Dirk J. Bezemer, “Post-Socialist Financial Fragility: the Case of Albania”, Tinbergen Institute and University of Amsterdam, 2000.

⁶ Charles Ponzi njihet si krijuesi dhe aplikuesi i parë në botë i të ashtuquajtura “skema piramidale financiare”. Skema e Ponzit është një circuit financiar iluzor që konsiston në pagesën e fitimeve të klientëve të parë nga depozitat dhe financimet e klientëve të tjerë që hyjnë në sistem më vonë, ndërkohë që klientët e valës së dytë paguheshin nga investimet e klientëve të valës së tretë e kështu me radhë duke u zgjeruar gjithnjë e më tepër në bazën e tij dhe formuar një piramidë imagjinare financiare. Kjo skemë mban emrin e Charles Ponzi, sepse ai ishte i pari që e zbatoi atë në vitin 1920 në Boston të SHBA duke u shndërruar brenda 6 muajve nga një njeri anonim me vetëm 2 usd në xhep, në një nga milionerët më të mëdhenj amerikanë me 15 milion usd pasuri.

Sistemi është i thjeshtë në dukje : për çdo shumë të investuar në këtë skemë financiare premtohet një fitim vjetor prej 100-120%, ose të paktën mbi 10-15 herë më i lartë se përqindjet e interesit për paratë e depozituara në bankë. Për një shumë prej 1000 usd të depozituara në fillim të vitit mund të përfitohet 2000-2400 usd në fund të tij. Sistemi funksionon aq kohë sa klientët tërhiqen prej tij dhe vazhdojnë të depozitojnë paratë e tyre në këtë piramidë financiare. Klientët e valëve të para fitojnë gjithmonë, duke shërbyer njëkohësisht edhe si një reklamë e mirë dhe e besueshme për të tërhequr sa më shumë të tjerë në sistem. Skema funksionon vetëm nëse numri i klientëve rritet në mënyrë eksponenciale, 2,4,8,16,32,64,...etj. Kur kjo skemë ndërpritet, dmth, kur numri i valës së fundit të klientëve është më i vogël se shifra eksponenciale e kërkuar, atëherë kjo fluskë financiare shpërthen dhe të gjithë pjesëmarrësit e saj ose i humbin të gjitha paratë e depozituara, ose në rastin më të mirë, rikuperojnë vetëm një përqindje të vogël të tyre nëse arrihet që një pjesë e parave të bllokohet menjëherë sa konstatohet pamundësia e vazhdimit të funksionimit të skemës. Ata që fitojnë janë vetëm ata që mbasi kanë përfituar në fillim të kësaj veprimtarie janë larguar prej saj, si dhe organizatorët.

përshtatshëm falë kombinimit të disa faktorëve: politikave monetare të shtrënguara, hyrjes masive të kapitaleve kryesisht në formën e investimeve dhe transfertave të emigracionit, dobësitë e bankave publike dhe tregjeve financiare të cilat ju lënë shumë hapësirë e lehtësi ndërmjetësve financiarë informalë⁷.

Në mënyrë që të realizonte objektivat themelore të reformimit të sistemit financiar në bazë të marrëveshjes me FMN të tilla si kontrolli i inflacionit, reduktimi i deficitit buxhetor, ristrukturimi i borxhit të jashtëm, krijimi i sistemit bankar me dy nivele, etj., Banka e Shqipërisë dhe Ministria e Financave vepruan në drejtim të shtrëngimit të politikës monetare dhe buxhetore duke bërë që gjatë periudhës 1992-95 të kishte një ulje të konsiderueshme të ekspansionit të kredisë, të shpenzimeve publike, një zvogëlim të agregatit monetar në raport me PBB⁸ si dhe vështirësi në licencimin dhe fillimin e aktivitetit të bankave tregtare private. Kështu p.sh., gjatë 1992-93 subvencionet për ndërmarrjet publike u zvogëluan nga 16% në 2% në raport me PBB, rritja e masës monetare u reduktua ndjeshëm, pagat reale u zvogëluan me 26%, sektori publik u reduktua me 2/3 e efektivave të tij, etj⁹. Edhe bursa e Tiranës që mund të ishte një element i rëndësishëm në qarkullimin formal të kapitaleve u hap zyrtarisht në maj të vitit 1996, ndërkohë që u tregua mjaft e dobët në tërheqjen dhe qarkullimin e kapitaleve në funksion të zhvillimit ekonomik. Hapja e bursës mbeti thjesht një gjest formal.

Këto “shtrëngime” si dhe mungesa e lindjes dhe zgjerimit të ndërmjetësuesve financiarë normalë për tregjet financiare, bëri që të lindte një sektor financiar jo formal shumë i madh. Kërkesa dhe orientimi masiv drejt këtij tregu joformal erdhi nga tre burime kryesore.

Së pari, gjatë periudhës 1991-96 mbi 400 000 shqiptarë ose rreth 12% e popullsisë së vendit emigroi në masë drejt Greqisë dhe Italisë, duke dërguar në vend në formën e remitançave shuma kolosale parash që arrinin deri në 15-20% të PBB. Vlerësohet se gjatë kësaj periudhe hynë në Shqipëri mbi 1 miliard dollarë në këtë rrugë¹⁰.

Së dyti, efekti i madh financiar dhe i sasive të konsiderueshëm të dollarëve apo markave gjermane që hynë në Shqipëri si pasojë e trafikut ilegal apo kontrabandës të karburanteve që shumë shqiptarë bënë me vendet e ish-Jugosllavisë të cilat në këtë periudhë lufte midis ish-republikave jugosllave i nënshtroheshin regjimit të

⁷ Dirk J. Bezemer, Post-Socialist Financial Fragility: the Case of Albania, Tinbergen Institute and University of Amsterdam, <http://www.tinbergen.nl/discussionpapers/99045.pdf>

⁸ McNeilly, C. and Schiesser-Gachnang, D. 1998. Reducing Inflation: Lessons from Albania's Early Success. IMF Working Paper Series, WP/98/97. Washington, D.C.; International Monetary Fund

⁹ Haderi, S., Papapanagos, H., Sanfey, P. and Talka, M. 1999. Inflation and Stabilisation in Albania. *Post-Communist Economies*, vol. 11, no. 1, 127-141

¹⁰ Elbirt, C. 1997. Albania Under the Shadows of the Pyramid Schemes. *Transition*, October 1997. Washington: World Bank

embargos ndërkombëtare për karburantet. Shuma e tyre llogaritet në rreth 500-600 milionë dollarë.

Së treti, në këto vite Shqipëria përftoi sasi të mëdha parash në formën e ndihmës së huaj duke u renditur si vendi i parë për sasinë e ndihmave financiare për banor në raport me të gjithë vendet e Evropës qendrore e lindore. E gjithë kjo pati një efekt të dukshëm tek niveli i të ardhurave dhe kursimeve të shumë shqiptarëve duke krijuar teprica të cilat mund të përdorëshin kollaj në tregun informal.

Në kushtet kur tregu formal i kredisë dhe mundësitë legale për investime ishin pothuajse të « tharë », ndërkohë që tregu informal ishte « plot me para », fillimisht pronarët e bizneseve të ndryshme dhe më vonë qytetarët e thjeshtë ju drejtuan këtij tregu për plotësimin e nevojave dhe dëshirës së tyre për investime apo fitime. Në « ndihmë » të kësaj kërkesë erdhën menjëherë disa « fondacione bamirëse » apo « kompani investuese » të cilat pranonin depozita, jepnin kredi si dhe ofronin interesa marramendëse për depozitat të cilat shkonin nga 10-50% në muaj. Emra si « Sudja », « Vefa », « Xhaferi », « Populli », « Kamberi », « Gjallica », etj., u bënë menjëherë emrat më familjarë për shqiptarët. Gjatë 4-5 viteve të ekzistencës së tij ky sektor financiar informal u tolerua dukshëm nga autoritetet financiare shqiptare dhe ndërkombëtare që mbikëqyrnin ecurinë e reformave në vend.

Kompanitë rentiere financiare nuk deklaroin burimin e të ardhurave të tyre, ndërkohë që nuk paraqisnin asnjë bilanc për kreditë apo interesat që jepnin. Ato mund të përdornin bankën shtetërore « Banka e Kursimeve » si dhe « Bankën Kombëtare Tregëtare » për depozitim dhe tërheqjen e parave pa patur asnjë kontroll mbi llogaritë e tyre bankare. Megjithatë disa prej kompanive financiare vepronin si banka, aktiviteti i tyre financiar nuk i nënshtrohej ligjit dhe supervizionit bankar apo detyrimeve për licencë zyrtare, por konsiderohej thjesht si « marrëveshje e përbashkët ndërmjet një huadhënësi dhe një huamarrësi » ashtu siç parashikohej nga Kodi Civil i Shqipërisë.

Por, përtej fasadës investuese¹¹ që më shumë përdorej si maskë publike, i gjithë sistemi funksiononte në bazë të skemës Ponzi¹². Thithja e depozitave mbulonte pagesën e interesave të jashtëzakonshme që varionin nga 100% deri në 600% në vit. Njerëzit depozitonin jo vetëm kursimet apo tepricat financiare të tyre në këto kompani, por shitën në mënyrë masive edhe shtëpitë apo prona të ndryshme me shpresën së shpejt do dyfishonin apo trefishonin paratë e tyre për të blerë të tjera akoma më të mëdha e moderne. Fshatarët shitën masivisht bagëtitë në mënyrë që të kishin para dhe ti depozitonin ato në firmat rentiere me shpresën se shpejt do të bëheshin të pasur.

¹¹ Kompania « Vefa » u angazhua në sferën e tregëtisë, turizmit, transportit dhe industrisë agro-ushqimore; « Gjallica » në tregëti, infrastrukturë, mjekësi dhe turizëm; « Kamberi » në industrinë agroushqimore dhe turizëm, etj. Fondacionet « bamirëse » realizuan gjithashtu investime në turizëm, pasuri imobiliare, ndërtim, qendra tregëtare, karburante, komplekse zyrash, etj.

¹² McAdams, D. 1997. *An Albanian Tragedy*. Albania - CRISIS '97 News Centre. Internet address: <http://www.albania.co.uk/crisis/>

Kompanitë financiare të tipit Ponzi përdornin një strategji marketingu e publiciteti mjaft agresive duke vënë në shërbim të tyre televizionin shtetëror dhe ata privatë, radiot e ndryshme, politikanë të lartë, ministra e funksionarë publikë, figura të shquara të sportit, artit, kulturës, akademisë, etj., financuar me zhurmë e bujë « njerëz në nevojë » apo « talente », etj. Ata shfrytëzuan mjaft mirë nevojën që kishte qeveria e asaj kohe dhe « Partia Demokratike » që zotëronte shumicën parlamentare për të servirur « zhvillimin e vrullshëm të kapitalizmit shqiptar » dhe « sukseset sociale, ekonomiko-financiare në favor të shqiptarëve » në këtë epokë post-socialiste. Shumë nga këta politikanë apo zyrtarë të lartë reklamoheshin si klientë të rregullt të këtyre firmave. Në Nëntor të vitit 1996, kryetari i Parlamentit dhe Kryeministri pranuan medalje në 5-vjetorin e krijimit të kompanisë VEFA. Edhe zgjedhjet e përgjithshme elektorale të vitit 1996, të cilat degjeneruan në një fitore « historike » të Partisë Demokratike, por që u braktisën nga opozita socialiste, u zhvilluan nën prezencën, « mbështetjen » politike dhe efektin e këtyre kompanive rentiere. Firmat piramidale i jepnin besueshmëri qeverisjes, ndërkohë që vetë qeverisja duke qenë në krah të këtyre firmave apo “bosëve” të tyre, i jepte po kaq kredibilitet dhe këtyre të fundit.

Në fillim të vitit 1997, vlera totale e depozitave në firmat piramidale rentiere arrinte në shifrat 1.2 miliard dollarë, ose rreth 50% të PBB të Shqipërisë¹³. Por, duke patur parasysh informalitetin e lartë të këtij aktiviteti si dhe pretendimet e mëvonshme të njerëzve që kishin humbur totalisht kursimet e tyre në këto skema piramidale, vlerësohet se shumata e depozituara aty e kalonin vlerën 1.8 miliard dollarëve. Depozitat në banka nga ana e qytetarëve u reduktuan ndjeshëm, ndërkohë që çdo para e lirë apo kursim i familjeve shqiptare u përdor për tu depozituar në këto firma. Të vendosura kryesisht në Tiranë dhe zonat në jug të vendit të cilat kishin dhe përqindjen më të lartë të emigracionit dhe për pasojë të remitancave e parave të lira të disponueshme, këto kompani arritën të kishin si klientë të tyre mbi 2.2 milionë shqiptarë, ose rreth 70% të popullsisë së vendit.

Në një vend të varfër si Shqipëria, ku rrogat mesatare në këto vite varionin në intervalin 50-150 usd/muaj, ku papunësia ishte në nivelet 20-30% të popullsisë aktive, dhe ku mbi 60% e popullsisë jetonte në zonat rurale me një parcelë të vogël toke në dispozicion, kompanitë rentiere u shfaqën si « pionieret e kapitalizmit që po realizonte ëndrrën e shqiptarëve për të jetuar më mirë dhe fituar më shumë ». Imazh i përsosur për të joshur një popull të tërë drejt sporteleve të tyre edhe pse ata që shfaqeshin si « bosët » apo « bamirësit » në krye të piramidave ishin njerëz pa vlera menaxheriale apo intelektuale. Në krye të firmës më të madhe « Sudja » qëndronte një grua me origjinë rome që kishte vetëm 8 klasë shkollë, në krye të « Vefës » një ish nën-oficer anonim, në krye të fondacionit « Xhaferi » një personazh humoristik që

¹³ Elbirt, C. 1997. Albania Under the Shadows of the Pyramid Schemes. *Transition*, October 1997. Washington: World Bank

pretendonte se « do shpëtonte Shqipërinë duke bërë gjithshka për njerëzit e varfër e në nevojë», etj.

Fundi i skemave piramidale u çfaq në 6 mujorin e dytë të vitit 1996, kur ato filluan të ndjejnë vështirësi në pagesën e fitimeve, dhe në pamundësi që të shtonin numrin e klientëve filluan të ofrojnë interesa marramendëse që varionin nga 30-100% fitim në muaj. Ndërkohë shqetësimi për aktivitetin e tyre u bë publik. FMN dhe Banka Botërore paralajmëruan direkt dhe indirekt qeverinë shqiptare për rrezikun që paraqisnin këto kompani rentiere¹⁴. Ndërkohë, edhe Banka e Shqipërisë e kishte paralajmëruar disa herë qeverinë shqiptare « për natyrën piramidale » të këtyre firmave. Edhe Ministri i Financave, në tetor 1996 paralajmëroi publikun për rreziqet që paraqiste kjo veprimtari financiare. Por, qeveria shqiptare bëri veshin e shurdhët, ndërkohë që presidenti shqiptar që priste me ngut rizgjedhjen e tij në fillim të 1997, në përgjigje të fjalëve të përhapura se «firmat rentiere po qarkullonin para në interes të mafias italiane», u shpreh në mbrojtje të hapur të tyre duke thënë se «paratë e shqiptarëve ishin të pastra e të ndershme» dhe se «këto ishin firma të ligjshme dhe të suksesshme». Kjo situatë e nxiti akoma më shumë euforinë e publikut drejt këtyre firmave dhe interesat e ofruara nga ato u «çmendën» totalisht duke kaluar çdo lloj imagjinate normale.

Por, në 10 janar 1997, Banka e Shqipërisë që kishte muaj që ndjehej e shqetësuar për fenomenin e firmave piramidale finansiare në vend, vendosi që të limitonte tërheqjet ditore të këtyre kompanive nga bankat ku ato kishin llogaritë tyre, duke fiksuar një tavan ditor prej 300 000 usd. Në 18 janar u arrestua e ashtuquajtura Sudja, menaxherja e fondacionit «Sudja» që ishte dhe kompania rentjere më e madhe në vend. Disa ditë më vonë, « Vefa » dhe «Kamberi» njoftuan se do bllokonin pagesat e interesave dhe kapitalit për një periudhë 3-6 mujore duke shkaktuar një klimë të fortë dyshimi dhe paniku për gjithë depozituesit e tyre. Në kryeqytetin e vendit Tiranë dhe në disa qytete të tjera të vendit shpërthyen revoltat. Në 26 janar u bllokuan depozitat e «Popullit» dhe «Xhaferit» në të cilat u gjendën vetëm 250 milionë dollarë, shumë më pak se detyrimet e tyre reale ndaj publikut. Në javët në vazhdim të gjitha firmat rentiere u mbyllën duke deklaruar se «kishin falimentuar totalisht» dhe i gjithë vendi u përfshi nga protesta të dhunshme, kaosi dhe krimi.

Revolta ekonomike e qindra-mijë shqiptarëve që kishin humbur totalisht jo vetëm paratë e tyre, por dhe ëndrrën për pasurim e mirëqenie të shpejtë, u kthye shpejt nga revoltë ekonomike në revoltë politike. Shumica e zyrave të policisë dhe kazermat e depot e ushtrisë u sulmuan duke u vjedhur dhe djegur. Me miliona automatikë kallashnikov dhe armë të tjera të tjera të rënda u përhapën

¹⁴ Albanian Times 1997. "Pyramid Schemes Worry IMF". *Albanian Times* on Internet, December Issue.

në gjithë vendin. Shteti u shemb dhe grupe të ndryshme kriminale filluan të kontrollojnë qytete dhe zona të tëra të vendit. Dhjetëra-mijëra njerëz u larguan nga Shqipëria si refugjatë në drejtim të Italisë apo Greqisë. Mbi 1500 njerëz u vranë apo humbën jetën nga trazirat dhe kaosi, ndërkohë që me mijëra të tjerë u plagosën. Qeveria dha dorëheqjen dhe Parlamenti u shpërnda duke ja lënë qeverisjen e vendit një qeverie të unitetit kombëtar. Një trupë e huaj prej 6000 mijë ushtarësh u instalua për disa muaj në Shqipëri deri sa të organizoheshin zgjedhjet e reja parlamentare. Ekonomia shqiptare që deri në këtë vit kishte patur rritje ekonomike të lartë e të qëndrueshme, në 1997 njohu një « rritje ekonomike negative» prej - 7%.

Shqiptarët provuan ashpërsinë e tmerrshme të një iluzioni të gabuar e naiv për paranë, kapitalizmin dhe fitimet e lehta e të shpejta. Ata nuk arritën të kuptonin “mashttrimin” dhe lojën me fitimet e lehta që qëndronte brenda këtyre skemave dhe këtij sistemi, apo akoma më konkretisht të kishin nxjerrë mësim nga situata e skema të ngjashme që kishin ndodhur vetëm pak kohë më parë në Rusi e Rumani, shtete që po kalonin të njejtën periudhë tranzicioni si Shqipëria.

Bibliografia:

- Albanian Times (1997). “Pyramid Schemes Worry IMF”. *Albanian Times* on Internet, December Issue.
- Dirk J. Bezemer, (2000). “Post-Socialist Financial Fragility: the Case of Albania”, Tinbergen Institute and University of Amsterdam.
- Elbirt, C. (1997). Albania Under the Shadows of the Pyramid Schemes. *Transition*, October 1997. Washington: World Bank
- Haderi, S., Papapanagos, H., Sanfey, P. and Talka, M. (1999). Inflation and Stabilisation in Albania. *Post-Communist Economies*, vol. 11, no. 1, 127-141
- [Kindleberger](#) et Robert Aliber (2005). *Manias, Panics, and Crashes: A History of Financial Crises (5th ed.)*, John Wiley & Sons, Hoboken, New Jersey
- McAdams, D. (1997). *An Albanian Tragedy*. Albania - CRISIS '97 News Centre. Internet address :<http://www.albania.co.uk/crisis/>
- McNeilly, C. and Schiesser-Gachnang, D. (1998). *Reducing Inflation: Lessons from Albania's Early Success*. IMF Working Paper Series, WP/98/97. Washington, D.C.; International Monetary Fund
- Peter Symes, (2003). “MMM Corporation”, Peter Symes Home Page, www.pjsymes.com.au
- Rely Miko-Indre, Bogdan Eduard (28 februarie 2011) “Ioan Stoica, patronul Caritasului, e sarac lipit si a suferit trei infarcturi”, Zilei Informatia
- Stefan Trandafir, Caritas - prima escrocherie românească, GAZETA de Bistrita, 21-08-2010

[*The Economist*](#) – « *Ponzi squared* », , 15.12.2008

Verdery, Katherine (October 1995). "Faith, Hope, and Caritas in the Land of the Pyramids: Romania, 1990 to 1994". [Comparative Studies in Society and History](#) (Cambridge: Cambridge University Press)

Wall Street Journal (1997: March 24). "Anarchy in Albania" in the *Europe Section of the Wall Street Journal*.

Williamson, J. (1994). *The Political Economy of Policy Reform*. Washington, D.C.: Institute for International Economics

Zuckoff, Mitchell. (2005). *Ponzi's Scheme: The True Story of a Financial Legend*. Random House: New York.

Rreth bisedimeve shqiptaro-italiane për zbatimin e Traktatit të Pages me Italinë – 1947

*(Rregullimi i çështjeve me karakter ekonomik dhe financiar
që rridhnin nga Traktati i Pages me Italinë)*

_____ Prof. Dr. Ksenofon KRISAFI _____

Abstrakt. *Traktati i Pages me Italinë, i nënshkruar në Paris, më 10 shkurt 1947, i dha fund gjëndjes së luftës midis Italisë dhe shteteve ndërluftues të Koalicionit Antifashist të Luftës së Dytë Botërore, ndër të cilët përfshihej edhe Shqipëria. Në preambulën e Traktatit dhe në një sërë nenesh të tij pohohej dhe konkretizohej përgjegjësia e Italisë për luftën. Traktati përkufizonte shprehimisht edhe statusin e Shqipërisë në raport me Italinë dhe në përgjithësi me Traktatin e Pages. Aty thuhej se çdo anëtar i Organizatës së Kombeve të Bashkuara, në luftë me Italinë dhe që nuk e ka nënshkruar këtë traktat, si edhe Shqipëria, mund të aderojnë në Traktat, duke u konsideruar menjëherë, pas aderimit, si fuqi shoqe për zbatimin e Traktatit. Ky nen i jepte mundësi Shqipërisë, që edhe pse nuk e kishte nënshkruar Traktatin, të aderonte dhe të përfitonte nga të gjitha dispozitat e tij të përgjithshme. Traktati i Paqës me Italinë parashikonte se rregullimi definitiv midis të dy vendeve i të gjitha çështjeve me karakter ekonomik dhe financiar që rrjedhin nga klauzolat e Traktatit të Pages, si dhe shlyerja e reparacioneve dhe dorëzimi i mallrave, sendeve, pajisjeve etj, do të kryhej në bazë të marrëveshjeve që do të lidhnin midis tyre shteti i interesuar dhe Italia. Mbi këtë bazë qeveria shqiptare nisi demarshet pranë qeverisë italiane, për kryerjen e veprimeve të nevojshme që lypseshin për zbatimin e tij. Pas gati 10 vjetësh përpjekjesh ngulmuese u arrit që të dy vendet të përfundonin negociatat dhe të nënshkruanin më 22 qershor 1957, në Romë, Marrëveshjen për rregullimin e çështjeve që rrjedhin nga Traktati i Pages, nënshkruar në Paris, më 10 shkurt 1947, midis Fuqive Aleate e Shoqe dhe Italisë.*

Fjalët kyçe:

Lufta e Dytë Botërore, Koalicioni Antifashist, Trakati i Pages, Italia, Shqipëria, Konferenca e Pages, Tirana, Roma, negociatat shqiptaro-italiane, reparacionet, OKB, etj.

Në historinë diplomatike shqiptare të periudhës së pas Luftës së Dytë Botërore, një vend me rëndësi kanë pasur zhvillimet në marrëdhëniet shqiptaro-italiane. Si dy popuj fqinj të vendosur përballë njeri tjetrit, kanë jetuar gjithmonë pranë dhe, sipas rrethanave historike, interesave dhe mundësive, kanë instaluar dhe zhvilluar raporte të shumta e të ndryshme. Historiku i marrëdhënieve shqiptaro-italiane është i pasur dhe i larmishëm. Nuk mungojnë traumat e rënda, por as edhe episode ekzemplare të bashkëpunimit dhe fqinjësisë së mirë. Mund të zbresim në mesjetë për të përmendur traktatet e Skenderbeut me Alfonsin e Napolit dhe të birin, Ferdinandin, si dhe rreshtimin e tij luftarak në beteja në ndihmë të tyre. Mund të përmendim gjithashtu trajtimin human ndaj ushtarëve dhe robërve italianë të mbetur në Shqipëri pas kapitullimit të Italisë fashiste në Luftën e Dytë Botërore, apo pritjen dhe sistemimin e disa dhjetra mijëra shqiptarëve që u larguan nga atdheu i vet në fillimin e viteve '90 të shekullit të kaluar etj. Ka mjaft episode që në vetvete përfaqësojnë ngjarje të rëndësishme si nga ndikimet ashtu edhe nga investimi dypalësh për tejkalimin e pasojave të dëmshmeme vendosmëri, mentalitet e kulturë demokratike integruese e europiane nga të dyja palët. Vend të veçantë zënë ato që lidhen me mbarimin e Luftës së Dytë Botërore, të cilat u gërshtuan gjithashtu edhe me përpjekjet e Shqipërisë për të riafirmuar dhe garantuar statusin e shtetit të pavarur, për të siguruar njohjen e kontributit të saj si pjesëtare në Koalicionin Antifashist dhe sigurimin e avantazheve politike e ekonomike që meritonte.

Shqipëria u bë pjesë e teatrit gjigand të operacioneve të Luftës së Dytë Botërore, të cilën Stefan Cvajgu e ka përkufizuar si luftën më të llahtarshme e më të madhe se kurrë ndonjëherë mbi këtë tokë... si luftën e të gjithëve kundër të gjithëve, që e bëri hi e pluhur bashkimin paqësor të Evropës.¹ Lufta e Dytë Botërore është konsideruar si më e madhja dhe më e përgjakshme që ka njohur njerëzimi. Ajo është cilësuar si "thertorja gjigande".² Siç thotë Uolltër Lakër „Që nga shekulli i 17 asnjë luftë në Europë nuk kishte qënë kaq mizore dhe me kaq shumë shkatërime... Paqja... e rikthyer... ishte një paqe e ngritur mbi një varrezë..."³ Shqipëria ishte një ndër vendet e para që provoi pushtimin fashist italian, gjatë Luftës së Dytë Botërore dhe që, në raport me numurin e popullsisë, pati humbje të konsiderueshme në njerëz, në të mira materiale e kulturore. Në këtë epokë të lavdishme që vlerësohet si lufta më heroike që kanë bërë shqiptarët gjatë historisë së tyre, spikati me forcë guximi,

¹ Stefan Zweig, *Bota e djeshme, Kujtime të një evropiani*, Shtëpia botuese Elena Gjika, Tiranë, 2004, f.482-484

² Edgar Mori, *Europa në mendje*, Ora, Tiranë, 2001, f.6.

³ Uolltër Lakër, *Europa në kohën tonë, 1945-1992*, Dituria, Tiranë, 2003, ff.22-23.

trimëria, shpirti i sakrificës dhe vitaliteti i popullit shqiptar. Përkrah popujve të tjerë të Koalicionit Antifashist, i angazhuar në një luftë me përmasa epike, e kreu me nder detyrën e vet.

Gjatë zhvillimit të luftës, e veçanërisht në momentet e përfundimit të saj nisën diskutimetpërpërgjegjësinë juridiko-ndërkombëtare të shteteve fashiste, shkaktare të Luftës së Dytë Botërore, sepse u konstatua që normat ekzistuese të së drejtës ndërkombëtare ishin të pamjaftueshme për vënien e tyre para përgjegjësisë së merituar.⁴ Filloi plotësimi i vakuumit juridiko-ndërkombëtar dhe përgatitja e normave përkatëse, një pjesë e të cilave u integruan në traktatet e paqes që do t'i jepnin fund zyrtarisht luftës dhe do të përpunonin modalitetet dhe procedurat e përballimit të përgjegjësisë politiko-morale-ekonomike e materiale të shteteve fajtorë. Në bazë të vendimeve të Konferencës së Potsdamit, Traktati i Paqes me Italinë, si dhe ato me aleatët e tjerë fashistë, do të përgatiteshin nga një organ ndërkombëtar i krijuar posaçërisht me pjesëmarrjen e Ministrave të Punëve të Jashtme të BRSS, Kinës, SHBA, Britanisë së Madhe dhe Francës, që u quajt Këshilli i Ministrave të Punëve të Jashtme (KMPJ). Konferenca e Potsdamit kishte vendosur ndër të tjera që sa herë Këshilli merr në shqyrtim çështje që i interesonin drejtëpërdrejtë një shteti që nuk përfaqësohet në të, ai duhet të ftohet të dërgojë përfaqësuesit e vet për të marrë pjesë në diskutimin dhe shqyrtimin e çështjes.⁵ Meqënëse përgatitja e projekt-traktatit të paqes me Italinë, i interesonte drejtëpërsëdrejti Shqipërisë, qeveria shqiptare iu drejtoi më 4 shtator 1945 nga një telegram, Klement Etli (Clement Attlee)- Kryeministër i Britanisë së Madhe, Harry Truman - President i SHBA dhe J.V.Stalin, President i Sovjetit Suprem të BRSS.⁶ Ajo kërkonte të dërgonte në Londër një delegacion që të shfaqte para Këshillit kërkesat e veta për dëmshpërblimet që duhet t'i paguante Italia. Më vonë, në kohën e duhur do të paraqiste, në destinacionin përkatës listën e hollësishme të dëmeve që kishin gjymtuar rëndë dhe në mënyrë të pandreqshme sektorët e ndryshëm të ekonomisë shqiptare.⁷ Nga KMPJ nuk pati reagim ndaj kërkesës shqiptare, e cila u përsërit në sesionin pasardhës, që u mbajt po në Londër. Në sesionin e Parisit të KMPJ u vendos që të thirrej së shpejti Konferenca e Paqes, e cila duhej t'u jepte rrugë problemeve të pazgjidhura. Ajo u mbledh në Paris, prej 29 korrikut gjer më 15 tetor 1946, me pjesëmarrjen e përfaqësuesve të 21 shteteve: BRSS, SHBA, Franca, Anglia, Kina, Austria, Zelanda e Re, Norvegjia, Polonia, RSS e Ukrainës, RSS e Bjellorusisë, Çekosllavakia, Etiopia, Jugosllavia, Bashkimi Jugafrikan, India, Belgjika, Kanadaja, Brazili, Greqia, Holanda. Shqipëria, edhe pse

⁴ Për më gjerë shih edhe Ksenofon Krisafi, *Diplomaci pas lufte, - Negociatat me Italinë dhe Gjermaninë për dëmet e luftës në Shqipëri*, Botimet Dita 2000, Tiranë, 2009.

⁵ Rezolucioni i Konferencës së Potsdamit, 41, germa A, pika 4.

⁶ Telegram kryetarëve të qeverive të tri Fuqive të Mëdha, BRSS, Angli, SHBA, me anën e të cilit kërkohet pjesëmarrja e Shqipërisë në diskutimin e Traktatit të Paqes me Italinë, 4 shtator 1945, E.Hoxha, *Vëpra*, vëll. 3, fq. 89.

⁷ Po aty.

i kishte të gjitha atributet e nevojshme për t'u trajtuar si fuqi aleate e shoqe në Traktatin e Paqes me Italinë, nuk u thirr në Konferencë. Shkak u bë refuzimi i qeverive amerikane e angleze, të cilat invokonin si pengesë pretendimin grek mbi gjoja pjesëmarrjen e Shqipërisë në luftë në anën e shteteve fashiste si edhe faktin që qeveria shqiptare nuk kishte marrë ende një njohje të gjerë ndërkombëtare, duke iu referuar posaçërisht mosnjohjes nga qeveritë e tyre. Ky qendrim bazohej në teorinë konstitutive të njohjes ndërkombëtare.⁸ Megjithatë, Konferenca e Paqes e mori në shqyrtim kërkesën shqiptare.

Pas diskutimesh të gjata, në seancën e 12 gushtit 1946, u vendos që Shqipëria të thirrej, veçse jo si fuqi aleate e shoqe, por vetëm për të paraqitur pikëpamjet e saj në lidhje me Traktatin e Paqes me Italinë në seancat plenare dhe në komisionet përkatëse.⁹ Vendimi që e pranonte Shqipërinë të asistonte në Konferencë vetëm për t'u dëgjuar rreth pretendimeve ndaj Italisë, u vlerësua në Tiranë si padrejtësi e madhe ndaj popullit shqiptar. E drejta e tij për të marrë pjesë në Konferencën e Paqes, me titull dhe të drejta të njëjta me ato të njëzetënjë shteteve të tjerë, nga pikëpamja e fakteve dhe provave, cilësohej e pakontestueshme. Në bazë të këtij vendimi qeveria shqiptare dërgoi delegacionin e vet në Konferencë, që kryesohej përkohësisht nga Hysni Kapo, i cili në atë kohë ishte titullar i legatës shqiptare në Beograd. Më pas, duke marrë parasysh rëndësinë e çështjes, u vendos që drejtimin e delegacionit ta merrte kryeministri i vendit, Enver Hoxha.¹⁰ Më 21 gusht 1946, kryetari i delegacionit shqiptar i parashtrori seancës plenare të Konferencës së Paqes, pikëpamjet e qeverisë së vet për problemet e Traktatit të Paqes. Që në fillim të fjalimit deklaroi se „Shqipëria e quan të padrejtë vendimin për të mos ta ftuar atë si pjesëtar të Konferencës“.¹¹ Pasi përmendi me hollësi luftën e popullit shqiptar, kontributin që Shqipëria dha në luftën kundër fashizmit, dëmet dhe shkatërrimet që pësoi, i parashtrori Konferencës kërkesën për dëmshpërblime nga Italia, të cilat kapnin shumën 3 544 232 626 franga ari.¹² Kërkesat që kishin të bënin me Shqipërinë dhe sugjerimet për pasqyrimin e tyre në traktat, delegacioni do t'i parashtronte me

⁸ Sipas përfaqësuesve të teorisë konstitutive Openhajn, Lauterpaht, Sel, Kelzen e të tjerë njohja ndërkombëtare është akti formalo juridik që e konstituon (kushteton) apo krijon një shtet si subjekt të së drejtës ndërkombëtare dhe e pajis atë me disa të drejta dhe detyrime të caktuara. Mirëpo, pikëpamja mbizotëruese në doktrinën e së drejtës ndërkombëtare e përfaqësuar nga teoria deklarative, me përkrahës juristët Anciloti, Russo, Ferdross, e hedh poshtë pikëpamjen konstitutive. Sipas saj, shteti ekziston që në çastin e lindjes së tij. Ai i gëzon të drejtat dhe atributet e subjektit edhe pa njohjen ndërkombëtare. Njohja edhe pse një akt me rëndësi politike që shoqërohet me pasoja juridike nuk është kurrë më shumë se sa konstatimi, deklarimi i një fakti. Ajo nuk ka vlerën e krijimit të një shteti si subjekt të së drejtës ndërkombëtare.

⁹ *Recueil des documents de la Conférence de la Paix de Paris*, Vol.I, f.178, (më tutje do të citohet “*Recueil*..).

¹⁰ E.Hoxha, *Vepra*, vol.3.

¹¹ E.Hoxha, Fjalim i mbajtur në seancën plenare të Konferencës së Paqes në Paris, më 21 gusht 1946, *Vepra*, vol.3, f.422.

¹² Po aty.

hollësi në komisionet e posaçme dhe në seancat plenare të Konferencës. Komisioni ekonomik për Italinë ishte një ndër ta. Ai filloi nga puna më 13 gusht 1946 dhe kishte si detyrë të studjonte problemet me karakter ekonomik të projekt-traktatit të paqes me Italinë, që përfshiheshin në nenet 64 deri 71, 73-74 si dhe në shtojcat 3, 6-8 të projektit.¹³ Komisioni do të studjonte edhe të dhënat që mund t'i paraqiteshin nga qeveritë e interesuara. Shqipëria, si vend i interesuar drejtpërdrejtë, dorëzoi në komision brenda afatit dhe në konformitet me rregullat procedurale, kërkesat e saj për dëmshpërblime lufte nga Italia. Në çdo rast, kur komisioni diskutonte probleme që i interesonin Shqipërisë, delegati shqiptar thirrej të merrte pjesë në debat dhe të shfaqte mendimin e qeverisë së tij. Në nënkomisionin e reparacioneve, ku debatet ishin veçanërisht të gjalla për shumat, nuk mbeti jashtë edhe kërkesa shqiptare. Përfaqësuesit e SHBA dhe të Anglisë, ndoshta për konjunkturë, në funksion të kompromiseve apo edhe për shkak të argumentave dhe provave të paraqitura nga delegacioni shqiptar, nuk e mohuan atë. Por, insistuan se kapitalet e investuara prej Italisë në Shqipëri ishin më se të mjaftueshme për t'u konsideruar krejtësisht e përmbushur kërkesa shqiptare për reparacione.¹⁴ Në seancën e pasdrekës të datës 4 tetor 1946, pas propozimit anglo-amerikan për ta konsideruar të mbyllur llogarinë e reparacioneve nga Italia për Shqipërinë, e morën fjalën disa delegacione. Vlen të përmendet sidomos qëndrimi i përfaqësuesit francez, i cili me doza të ndjeshme realizmi dhe objektiviteti, pohoi se do të ishte shkelje t'i mohohet Shqipërisë e drejta për dëmshpërblim nga Italia.

Në vijim të përpjekjeve për gjetjen e një kompromisi delegacioni francez propozoi caktimin e një shume prej 5 milionë dollarësh si reparacione lufte për Shqipërinë.¹⁵ Por nuk u formua shumica e nevojshme që Shqipërisë t'i akordoheshin reparacione lufte nga Italia. Përfaqësuesi shqiptar, i cili e mori fjalën pas votimit, shfaqti pakënaqësinë për shifrën e propozuar dhe deklaroi se „populli shqiptar nuk kërkon mëshirë nga Komisioni. Ai kërkon që lufta që ka bërë dhe gjaku i tij fisnik i derdhur për fitoren aleate, të mos mohohen në një mënyrë të tillë. Delegacioni i Shqipërisë proteston kategorikisht ndaj këtij trajtimi të padrejtë, që përbën një fytyrë të hidhur për sakrificat e mëdha që bëri populli ynë.”¹⁶ E mbetur pa zgjidhje, çështja iu kalua Konferencës. Ajo e diskutoi në seancën plenare të 9 tetorit 1946. U bënë disa propozime, një pjesë e të cilëve u hodhën në votë, por që nuk u miratuan.¹⁷ Kërkesa shqiptare u shqyrtua në seancat e KMPJ në Nju Jork, më 4 dhe 5 nëntor 1946,¹⁸

¹³ Seanca e parë, që kryesohej nga Fukë Dypark (Fouque Duparc) Sekretar i Përgjithshëm, iu kushtua problemeve procedurale. U zgjodhën presidenti, zëvendëspresidenti dhe raportuesi i komisionit, respektivisht - Bhore (Indi), Bebler (Jugosllavi) dhe Alfand (Alphand) (Francë). *Recueil...* vol.II, fq.343.

¹⁴ Po aty.

¹⁵ Po aty.

¹⁶ Po aty.

¹⁷ Propozoi së pari delegati jugosllav që në favor të Shqipërisë të caktoheshin 25.000.000 dollarë USA.

¹⁸ Gazeta *Bashkimi*, 7 nëntor 1946.

ku u vendos që Shqipëria të merrte si dëmshpërblim lufte nga Italia shumë prej 5 milionë dollarë. Ky vendim u fiksua në një nga dispozitat e Traktatit të Paqes me Italinë.

Traktati i Paqes me Italinë, i nënshkruar në Paris, më 10 shkurt 1947, i dha fund gjëndjes së luftës midis Italisë dhe shteteve ndërluftues të Koalicionit Antifashist, ndër të cilët përfshihej edhe Shqipëria. Në preambulën e Traktatit pohohej përgjegjësia e Italisë për luftën, e cila konkretizohej dhe detajohej në një sërë nenesh.¹⁹ Statusi i Shqipërisë në raport me Italinë dhe në përgjithësi me Traktatin e Paqes, përkufizohej nga një dispozitë e qartë, e redaktuar si më poshtë:

1. Çdo anëtar i Organizatës së Kombeve të Bashkuara, në luftë me Italinë dhe që nuk e ka nënshkruar këtë traktat, *si edhe Shqipëria*, (korsivi i autorit) mund të aderojnë në Traktat, duke u konsideruar menjëherë, pas aderimit, si fuqi shoqe për zbatimin e Traktatit. 2. Instrumentet e aderimit do të depozitohen pranë qeverisë së Republikës Franceze dhe do të kenë efekt që nga momenti i depozitimit të tyre.²⁰

Ky nen i jepte mundësi Shqipërisë, që edhe pse nuk e kishte nënshkruar Traktatin, të aderonte dhe të përfitonte nga të gjitha dispozitat e tij të përgjithshme, siç ishin nenet 27-31, 74-76, 78-82 etj, të cilët trajtonin drejtëpërsëdrejti marrëdhëniet politike e ekonomike midis Italisë dhe Shqipërisë. Pas hyrjes së tij në fuqi, më 15 shtator 1947, Presidiumi i Kuvendit Popullor, me Dekretin nr. 480, të datës 9 tetor 1947, vendosi aderimin e Shqipërisë në Traktatin e Paqes me Italinë. Instrumentet e aderimit u depozituan pranë qeverisë franceze, më 24 tetor 1947,²¹ datë prej të cilës Shqipëria konsiderohet si fuqi shoqe për zbatimin e Traktatit. Në tërësi Traktati i Paqes me Italinë ka shumë dispozita që sanksionojnë të drejtat politike dhe ekonomiko-financiare të Shqipërisë.

Shqipëria duhej të merrte nga Italia një shumë të barabartë me vlerën e dëmeve që iu shkaktuan prej agresionit të saj, e vlerësuar me 3 639 491 626 fr. ari. Në nenin 74 pjesa B-(1) të Traktatit të Paqes parashikohej që t'i jepeshin vetëm 5 milionë dollarë. Traktati përcaktonte gjithashtu që diferenca midis shumës së kërkuar prej Shqipërisë – 3 639 491 626 fr. ari dhe sasisë së caktuar prej tij, në bazë të nenit 74 B6 të Traktatit, duhet të nxirrej nga vënia dorë mbi pasuritë italiane që ndodheshin në Shqipëri.²² Përmbajtja e dispozitës së mësipërme zgjoi diskutime

¹⁹ *Recueil des Traités -Traités et accords internationaux enregistrés ou classés et inscrits au repertoire du Secretariat de l'Organisation des Nations Unies*. Vol.49, 1950, I.N. 747, ff.4-5, në vijim do të citohet «*Recueil de l'ONU.*»

²⁰ Po aty.

²¹ Me notën Nr. 13/1/701, dt. 20 tetor 1947, qeveria shqiptare i përcolli Legatës shqiptare në Paris instrumentin e aderimit në Traktatin e Paqes me Italinë, e cila ia dorëzoi këtë notë Ministrisë së Punëve të Jashtme franceze më dt. 24 tetor 1947. Pak ditë më vonë, më 31 tetor 1947, Ministria e Punëve të Jashtme franceze njoftonte legatën shqiptare mbi marrjen në dorëzim të notës dhe të instrumenteve të aderimit në Traktat. AMPJ i RSH, Fondi Traktati i Paqes me Italinë, Pako 1, Dosje II/30, v. 1947.

²² *Recueil de l'ONU*, Vol.49, 1950, I.N. 747, fq. 37.

për sa i përkiste kuptimit dhe interpretimit të termit “pasuri italiane”. Në Shqipëri u ndodhën në atë kohë pasuri që i përkisnin tërësisht shtetit italian, pasuri të institucioneve parashtetërore ose gjysëmpublike italiane,²³ pasuri të institucioneve fetare ose filantropike dhe pasuri të personave private. Por, këtë problem, në dukje të ndërlikuar, e zgjidhte traktati nëpërmjet dispozitave të tij. Në nenin 74 B 6 thuhej:

Kërkesat e shteteve që përmenden në paragrafin 1 të pjesës B të këtij neni (domethënë të Shqipërisë, Etiopisë, Greqisë dhe Jugosllavisë - shënim i autorit) për pjesën që tejkalojnë sasitë e specifikuar në këtë paragraf, do të plotësohen me ndihmën e aktiveve italiane të vendosura në juridiksionin përkatës të këtyre shteteve nga neni 79 i këtij traktati.²⁴

Kjo dispozitë referuese nuk e jepte vetë direkt zgjidhjen, por e përcillte te neni 79, i cili thoshte:

Secila prej fuqive aleate ose shoqe do të ketë të drejtë të vëjë dorë, të mbajë ose të likuidojë të gjitha pasuritë, të drejtat dhe interesat, të cilat në datën e hyrjes së traktatit në fuqi, gjenden në territorin e tyre dhe iu përkasin Italisë ose shtetasve italianë dhe të marrë çdo vendim në lidhje me këto pasuri, të drejta dhe interesa. Ajo do të ketë të drejtë njëkohësisht t’i përdorë këto pasuri ose të ardhurat nga likuidimi i tyre për qëllimet që ajo dëshiron, por gjer në masën e kërkesave të saj ose të shtetasve të vet ndaj Italisë ose shtetasve italianë (duke përfshirë aty edhe kreditë) që nuk do të jenë rregulluar nga nene të tjerë të këtij Traktati. Të gjitha pasuritë italiane ose vlera e likuidimit të tyre, që kapërcejnë shumën e kërkesave për reparacione, do t’u kthehen të zotërve.²⁵

Së këtëjmi del se aktivet italiane, të vlefshme për të shlyer diferencën midis shumës së kërkuar dhe asaj të fiksuar në paragrafin 1 të pikës B të nenit 74 të Traktatit, përbëheshin nga pasuritë, të drejtat dhe interesat që iu përkisnin Italisë ose shtetasve italianë, domethënë shtetit italian, institucioneve gjysëmpublike italiane, institucioneve fetare ose filantropike dhe personave privatë. Mirëpo në rastin e Shqipërisë kjo dispozitë e përgjithshme nuk mund të zbatohet pa u kombinuar edhe me nenin 29 të traktatit, i cili kishte vlerë specifike vetëm për Shqipërinë. Një pjesë e paragrafit të parë të këtij neni përcaktonte se :

Italia heq dorë shprehimisht në favor të Shqipërisë nga të gjitha pasuritë (me përjashtim të godinave të zëna normalisht nga misionet diplomatike ose konsullore), nga të gjitha të drejtat, koncensionet dhe avantazhet e çdo lloji në Shqipëri që i përkasin shtetit italian ose institucioneve gjysëmpublike italiane.²⁶

Një interpretim i kombinuar dhe i gjithëanshem i dispozitave të lartpërmendura të çon në përfundimin se pasuritë, të drejtat, koncensionet dhe avantazhet e çdo

²³ Me institucione parashtetërore ose gjysëmpublike kuptoheshin të gjitha organizatat në të cilat shteti italian ka pasur kontroll efektiv, interesa materiale dhe që i subvenciononte drejtëpërsëdrejti ose tërthorazi.

²⁴ *Recueil de l'ONU*, Vol.49, 1950, I.N. 747, fq. 37.

²⁵ Po aty, f.46.

²⁶ Po aty, f.19.

lloji që i përkisnin shtetit italian ose institucioneve gjysëmpublike italiane kalonin në dispozicion të shtetit shqiptar jashtë llogarisë së reparacioneve. Duhet të përjashtoheshin prej tyre vetëm godinat e zëna normalisht nga misionet diplomatike ose konsullore dhe pasuritë e tyre si dhe ndërtesat dhe pasuritë që iu përkisnin institucioneve fetare ose institucioneve filantropike private, që kishin shërbyer ekskluzivisht për qëllime fetare ose filantropike (neni 29 & 1 dhe neni 79, pika 6, gjerat a dhe b të Traktatit të Paqes).²⁷ Pra, diferenca midis shumës së 5 000 000 dollarëve, që caktonte neni 74 B 1 i Traktatit dhe shumës së kërkuar nga qeveria shqiptare, duhet të nxirrej nga likuidimi i pasurive të shtetasve italianë në Shqipëri. Sipas Traktatit, shuma prej 5 000 000 dollarësh duhej të paguhej brënda 7 vjetëve nga dita e hyrjes së tij në fuqi, (duke filluar prej 15 shtatorit 1947) dhe sipas nenit 74 B(2) ajo do të nxirrej nga këto burime:

a)një pjesë e instalimeve dhe pajisjeve industriale italiane të vlefshme për fabrikimin e materialeve të luftës që nuk janë as të nevojshme për forcat ushtarake të lejuara as të adoptueshme menjëherë për përdorim civil dhe që do t'i merreshin Italisë në bazë të nenit 67. Këtu përfshiheshin edhe luftanijet dhe materiali ushtarak i tepërt (nenet 57, 61, 64 dhe 67 të Traktatit të Paqes). b)Prodhimi industrial i zakonshëm i Italisë, duke përfshirë edhe prodhimet e industrisë nxjerrëse. c)Të gjitha llojet e tjera të furnizimeve në kapital ose në shërbime, me përjashtim të pasurive italiane, të cilat në bazë të nenit 79 të Traktatit ishin nën juridiksionin e Shqipërisë.²⁸

Është e qartë se bëhet fjalë për pasuritë italiane që ndodheshin në Shqipëri dhe që ishin likuiduar ose do të likuidoheshin nga ana e shtetit shqiptar, të cilat nuk do të llogariteshin në shumën e reparacioneve prej 5 milionë dollarë. Furnizimet në kapitale mund të përfshinin edhe anijet për udhëtarë Saturnia dhe Vulcania si dhe farëra të ndryshme. Sasirat dhe llojet e mallrave dhe shërbimet, që do të furnizoheshin si reparacione, do të caktoheshin me marrëveshje me Italinë. Traktati i Paqes me Italinë në nenin 75 trajtonte një tjetër çështje me rëndësi të veçantë për Shqipërinë, rikthimin në vendin e origjinës të të gjithë sendeve të transferuara me dhunë apo në çdo mënyrë të paligjshme në Itali dhe që ishin gjetur e identifikuar, veprim juridiko-ndërkombëtar i njohur me termin “restitucionet”. Neni 75, paragrafi 8 bënte fjalë për kthimin e arit të grabitur nga Italia në tokën e Kombeve të Bashkuara.

Në zbatim të dispozitave përkatëse të Traktatit të Paqës me Italinë që parashikonin se rregullimi definitiv midis të dy vendeve i të gjitha çështjeve me karakter ekonomik dhe financiar që rrjedhin nga klauzolat e Traktatit të Paqes, si dhe shlyerja e reparacioneve dhe dorëzimi i mallrave, sendeve, pajisjeve etj, objekt restitucioneesh do të kryhej në bazë të marrëveshjeve që do të lidhnin midis tyre shteti i interesuar dhe Italia, qeveria shqiptare nisi demarshet pranë qeverisë

²⁷ Po aty, ff. 19 dhe 47.

²⁸ Po aty, ff. 28,31,31,33.

italiane, për kryerjen e veprimeve të nevojshme që lypseshin për zbatimin e tij.²⁹ Më 11 mars 1948, ajo paraqiti zyrtarisht kërkesën dhe si hap të parë konsideroi pajisjen me vizën e hyrjes të disa ekspertëve shqiptarë, që do të interesoheshin për identifikimin e pasurive, sendeve dhe objekteve shqiptare që gjëndeshin në territorin italian. Përçapja nuk gjeti mirëkuptimin e qeverisë italiane, e cila disa herë u përpoq ta prapsonte me pretekste të pajustificuara, si p.sh. Shqipëria nuk ka aderuar në Traktatin e Paqes³⁰, çka nuk ishte e vërtetë, ose sepse midis të dy vendeve nuk kishte marrëdhënie diplomatike, që nuk ishte kusht për zbatimin e Traktatit e që megjithatë u kapërcye sepse Tirana dhe Roma ranë dakord që të rivendoseshin marrëdhëniet diplomatike.³¹ Por, edhe eliminimi i asaj pengese që vlerësohej serioze nuk solli asgjë të re. Në këto rrethana, qeveria shqiptare, për ta zhbllokuar situatën, në mars 1950, i propozoi qeverisë italiane dërgimin në Romë të një delegacioni, për të negociuar rreth zgjidhjes së çështjeve të rrjedhura nga Traktati i Paqes me Italinë.³²

Sërish pala italiane iu shmang hapjes së negociatave, duke vënë kushte dhe duke kërkuar që midis qeverisë shqiptare dhe legatës italiane në Tiranë, të arrihej një sqarim i kënaqshëm përsa i përket të gjitha pasurive dhe interesave italiane në Shqipëri, si dhe për trajtimin juridik, ekonomik, etj., që u është siguruar teknikëve, specialistëve dhe gjithë shtetasve italianë në përgjithësi, pas 8 shtatorit 1943.³³ Pretendimet italiane çuan në shtyrjen e fillimit të procedurave. Ministria e Punëve të Jashtme të Shqipërisë dha shpjegimet përkatëse, që nuk u morën në konsideratë. Ngurtësimi i të dyja palëve në qëndrimet e veta i la marrëdhëniet shqiptaro-italiane në nivele gati formale dhe të zakonshme. Qëndrimet konstante divergjente, që përshkuan për disa vjet marrëdhëniet shqiptaro-italiane, nuk linin hapësirë dhe nuk krijonin atmosferë të përshtatshme për fillimin e negociatave. Ato vazhduan të mbeteshin pezull, të fiksuara në të njëjtën pikë si më parë. Vetëm nga mesi i vitit 1954, në horizontin e marrëdhënieve midis dy brigjeve filluan të shfaqen shenjat e para të një optimizmi të matur. Në shkurt të vitit 1954, me anën e legatës së saj në Romë, Tirana zyrtare i propozoi qeverisë italiane fillimin e negociatave për lidhjen e një marrëveshjeje tregtare midis të dy vendeve.³⁴ Pas qëndrimit reticent të Romës, njoftoi se ishte e gatshme të njëkohësisht të bisedonte edhe për fatin e të burgosurve italianë në Shqipëri si dhe të kontribuonte për gjetjen dhe riatdhesimin e eshtrave të

²⁹ Çështja e Traktatit të Paqes me Italinë është trajtuar në mënyrë analitike dhe thuajse ezauruese në një studim që ndodhet në arkivin e MPJ të RSH, i cili është shfrytëzuar edhe nga autori i këtij shkrimi.

³⁰ AMPJ- Fondi - Traktati i Paqes me Italinë, Pako, Nr.1, Dosje II/30, v.1948.

³¹ Zanafilla e tyre i përket vitit 1921.

³² Nota Nr. 34137/1, dt. 2 mars 1950 e qeverisë shqiptare drejtuar legatës italiane në Tiranë, AMPJ. Fondi Traktati i Paqes me Italinë, Pako 1, dosja A/II/30, viti 1950.

³³ Notë e legatës italiane drejtuar Ministrisë së Punëve të Jashtme të Shqipërisë, Nr. 420, dt. 24 mars 1950. - në AMPJ F. Traktati i Paqes me Italinë, pako Nr.1, D.A/II/30, viti 1950.

³⁴ Shih edhe Ksenofon Krisafi, *Në kërkim të arit, historia e arit shqiptar të rrëmbyer gjatë Luftës së Dytë Botërore*, DITA 2000-UET PRESS, Tiranë, 2009.

ushtarakëve italianë të rënë në Shqipëri gjatë luftës. Në gusht të vitit 1954, italianët kthyen një përgjigje me nuanca të dukshme inkurajuese.³⁵

U hap rruga e fillimit të bisedimeve zyrtare, të cilat nisën në Romë, më 21 dhjetor 1954. Rendi i ditës përfshinte negociatat për përfundimin e një marrëveshjeje tregtare bilaterale, çështjet që rridhnin nga Traktati i Paqes me Italinë për reparacionet dhe restitucionet ndaj Shqipërisë si dhe diskutimin e transferimit të eshtrave të italianëve të rënë në Shqipëri, lirimit të të burgosurve politikë italianë që kishin kryer krime dhe faje në Shqipëri etj. Në fjalën e vet, kryetari i delegacionit shqiptar vuri në dukje se marrëdhëniet e mira shqiptaro-italiane ishin aspiratë e të dy popujve. Shprehu dëshirën që qeveria italiane t'i përgjigjej vullnetit të mirë të palës shqiptare dhe të merrte përsipër zbatimin e dispozitave të Traktatit të Paqes. Me këtë akt të dyja palët do të mbyllnin një periudhë të errët fatkeqësie për popullin italian, gjatë së cilës populli shqiptar u bë objekt agresioni dhe përballoi humbje të mëdha në njerëz dhe dëme të shumta materiale dhe do të hapnin faqe të re në marrëdhëniet midis tyre. Fillimi i zbatimit të Traktatit të Paqes nga Italia do të vlerësohej si provë e dëshirës për marrëdhënie të fqinjësisë së mirë. Në mbledhjen e dytë, që u zhvillua më 28 dhjetor 1954 dhe që iu kushtua shqyrtimit të pikës së parë të rendit të ditës, reparacioneve për Shqipërinë, përfaqësuesi shqiptar bëri një ekspozë të shkurtër. Ai tha, ndër të tjera, se neni 74, pjesa B, e Traktatit të Paqes me Italinë, i ka njohur Shqipërisë shumën prej 5 milionë dollarë USA si reparacione. Diferenca midis kërkesës së saj për dëmshpërblime dhe shumës së mësipërme, do të mbulohej nga shtetëzimi i pasurive italiane të ndodhura në Shqipëri, sikurse parashikonte neni 79 i Traktatit të Paqes me Italinë.³⁶ Në bazë të nenit 74, paragrafi 2, i pjesës B, reparacionet duhet të jepeshin brenda 7 vjetëve nga dita e hyrjes në fuqi të Traktatit të Paqes.

Për shkak të mungesës së gatishmërisë nga pala italiane për zbatimin me kohë të detyrimeve, afati 7 vjeçar i caktuar nga Traktati i Paqes kishte kaluar. Duke qënë se kjo periudhë letargjie kishte rënduar pozitën e Shqipërisë, delegacioni shqiptar kërkoi që realizimi i tyre të kryhej në një periudhë sa më të shkurtër. Përfaqësuesi italian, përpara se të shprehej në thelb për kërkesën shqiptare për reparacione, paraqiti një objeksion të karakterit procedural, kërkoi që njëkohësisht me të, të shqyrtohej edhe kërkesa për pasuritë italiane në Shqipëri. Duke përmendur referimin e nenit 74 të nenit 79 i Traktatit, theksoi se këto çështje nuk mund të ndaheshin.³⁷ Sipas një interpretimi të gabuar të nenit 79 si dhe mbi bazën e vlerësimeve të ekzagjeruara Roma kishte llogaritur që vlera e pasurive italiane në Shqipëri, në të cilat përfshinte pasuritë shtetërore, parashetërore, ato të institucioneve fetare e filantropike si dhe pasuritë e personave private, tejkalonte

³⁵ Po aty.

³⁶ Po aty.

³⁷ Po aty.

në përmasa të konsiderueshme sasinë e dëmshtëpërblimeve që kërkonte Shqipëria, – të vlerësuar në 3 639 491 626 fr. ari. Nga këto llogari dilte se Shqipëria jo vetëm që s’kishte për të marrë reparacione, sikurse përcaktonte neni 74 B 1 i Traktatit të Paqes, por përkundrazi duhej t’i kthente Italisë kompensime. Kalkulimet e mësipërme si dhe arsyetimet e provat e parashtruara u kontestuan. Delegacioni shqiptar nuk e pranoi objeksionin dhe komentoi se duhej që propozimi synonte të zhvendoste vëmendjen nga reparacionet, detyrim i njohur i Italisë ndaj Shqipërisë, që buronte drejtpërdrejtë nga Traktati i Paqes, te pasuritë italiane në Shqipëri. Ai tha se nuk mohohej e drejta e palës italiane për të kërkuar shpjegime rreth fatit të pasurive të saj në Shqipëri. Por, theksoi se arsyetimi dhe provat e paraqitura nga pala italiane, nuk mund të pranoheshin. Në rastin e Shqipërisë, neni 79 i Traktatit të Paqes me Italinë, do të zbatohet i kombinuar edhe me nenet 29 dhe 74 B 6. Në zbatim të tyre shteti shqiptar i kishte shtetëzuar pronat italiane të ndodhura në Shqipëri.³⁸ Delegacioni italian edhe në seancën pasardhëse, e cila u zhvillua më 3 janar 1955, nguli këmbë në oportunitetin e shqyrtimit të të dy çështjeve së bashku, sepse sipas pikëpamjes së tij, ato përbënin një të vetme e të pandarë. Çdo trajtim tjetër rrezikonte të vinte në pikëpyetje fatin e bisedimeve.³⁹ Kundërshtimi i palës shqiptare u mbështet në arsyetimin se përfundimi i veçantë i çështjes së reparacioneve pa u kushtëzuar dhe pa u ndërthurrur me atë të pasurive italiane në Shqipëri, nuk e cenonte dhe as e kompromentonte diskutimin e pikave të tjera të rendit të ditës.⁴⁰ Në seancën e 15 janarit, duke e lënë mënjane këtë çështje, pala italiane shtroi për diskutim kthimin e selive të përdorura para lufte nga misionet diplomatike dhe konsullore italiane në Tiranë, Durrës, Vlorë, Shkodër dhe Sarandë, kthim që duhej realizuar në bazë të neneve 29 dhe 79/6/a të Traktatit të Paqes me Italinë. Përfaqësuesit shqiptarë shpjeguan se sipas pikëpamjes së tyre, pretendimi italian nuk qëndronte. Neni 29 i Traktatit të Paqes stipulonte shprehimisht se objekti i veprimt të tij kishte të bënte me „...seli të përdorura normalisht (korsivi i autorit) për misione diplomatike dhe konsullore...“. Palës shqiptare i rezultonte se selitë e përfaqësive diplomatike dhe konsullore, që ka patur Italia në Shqipëri, u përdorën nga strukturat e autoriteteve dhe ushtrive pushtuese si qendra administrative, ushtarake dhe policore. Ato e humbën karakterin e tyre origjinal. Ky pozicion u shtjellua hollësisht dhe u argumentua me prova të shumta që u ekspozuan gjerësisht nga pala shqiptare.⁴¹

Për shkak se delegacioni italian ishte mbërthyer në pikëpamjen e vet, çështja mbeti pezull për një farë kohe. Megjithatë, edhe pse në atmosferë mosmarrëveshje, bisedimet nuk u ndërprejnë. Në vazhdim u arrit kompromisi që problemi i pasurive

³⁸ AMPJ - Fondi - Traktati i Paqes me Italinë - Dosja A/II/30, 1954 N/D, nr. 1.

³⁹ Po aty.

⁴⁰ Po aty.

⁴¹ AMPJ- D A/II/30, N/D, Nr. 1, viti 1955. Bisedimet shqiptaro-italiane mbi Traktatin e Paqes. Protokollet e mbledhjeve plenare të bisedimeve.

italiane në Shqipëri të konsiderohej i mbyllur, me kusht që pala shqiptare të ndihmonte në verifikimin dhe vlerësimin e pasurive private, për të cilat qeveria italiane, në bazë të Traktatit të Paqes me Italinë, detyrohej të shpërblente pronarët e tyre. Historia e tërheqjes së palës italiane nga pretendimet rreth pasurive italiane në Shqipëri është tepër kurioze. Në fillim delegacioni italian insistoi në ekspozimin nga të dyja palët të dokumentacionit për vlerësimet e pasurive italiane në Shqipëri, duke e konsideruar atë kusht prej nga do të varej fati i diskutimit të mëtejshëm të çështjes së reparacioneve. Me sa duket qeveria italiane gjykonte se autoritetet shqiptare nuk posedonin dokumentacion autentik dhe me cilësitë e duhura provuese. Delegacioni italian paraqiti dokumentacionin e vet, të cilin ajo e mendonte si provë të padiskutueshme. Ai përbëhej kryesisht prej dëftesave dhe faturave të agjensive spedicionere italiane. Nëpërmjet tyre ajo shpresonte se do ta hidhte poshtë kërkesën shqiptare për reparacione.⁴² Mirëpo, ato dëshmonin vetëm nisjen e pajisjeve apo mallrave në drejtim të Shqipërisë, dhe nuk vërtetonin mbërritjen në destinacion. Për pasojë vlera dhe besueshmëria e tyre ishte e kontestueshme. Sipas kësaj logjike, përfshiheshin në vlerën e pasurive italiane në Shqipëri edhe pajisje e mallra që, për arsye të ndryshme, mund të mos kishin mbërritur në destinacion. Fjala vjen mund të ishin mbytur gjatë lundrimit, ishin rrëmbyer dhe përdorur prej ushtrisë gjermane, kishin ndryshuar drejtim gjatë udhëtimit dhe kishin përfunduar diku tjetër etj.

Delegacioni shqiptar paraqiti një dokumentacion të plotë, i cili nga pikëpamja juridike kishte vlera të mirëfillta provuese. Në dosjen shqiptare të dokumentacionit gjëndeshin ndër të tjera edhe vërtetime të nënshkruara e të vulosura nga pronarët apo disponuesit e pasurive italiane në Shqipëri, në ditët e para të çlirimit. Nëpërmjet tyre ata, kishin deklaruar dhe vërtetuar gjëndjen dhe vlerën reale të pasurive që kishin në pronësi apo në administrim. Sasia e përgjithshme ishte shumë e vogël në krahasim me sa tregonin faturat dhe dëftesat e nisjes të agjensive italiane të transportit. Dokumentacioni italian, i ballafaquar me atë shqiptar, nuk rezultoi i besueshëm. U megjullua shpresa se pasuritë italiane në Shqipëri arrinin në sasira të konsiderueshme. Në këto rrethana, pala italiane pranoi arsyetimet dhe provat e palës shqiptare dhe u tërhoq nga pozicioni i saj, por me sa duket e gjykoi me vend që ta kundërshtonte pagimin e shumë prej 5 000 000 dollarë nga një tjetër drejtim. Iu rikthye diskutimit të statusit dhe trajtimit të selive të misioneve diplomatike e konsullore dhe të institucioneve fetare e filantropike, të cilat, sipas përcaktimeve të nenit 29 të Traktatit të Paqes, i duheshin kthyer Italisë. Ekspertët italianë e kishin përllogaritur vlerën e tyre në 4 800 000 USD, e cila, dukej qartë se i afrohej shumë sasisë prej 5 milionë dollarë, që ishte caktuar për t'u paguar si reparacion për Shqipërinë. Vlera e selive të misioneve diplomatike e konsullore arrinte në

⁴² Ka pasur përpjekje për të llogaritur vlerën e pasurive italiane në Shqipëri deri në mbarimin e Luftës së Dytë Botërore. Sipas Gualtierio Macci, ajo arrinte në shumën e 663 644 609 USD.-Citohet sipas Hamit Kaba, *Shqipëria në rrjedhën e Luftës së ftohtë (Shënime dhe dokumente)*, Botimpeks, Tiranë 2007, f.127.

2 milionë dollarë, kurse ajo e selive të institucioneve fetare e filantropike në 2.8 milionë dollarë.⁴³

Qeveria shqiptare e quajti të padrejtë si interpretimin që i bënte pala italiane përmbajtjes dhe kuptimit të nenit 29 të Traktatit të Paqes për çështjen e pasurive të selive të përfaqësive diplomatike e konsullore apo të institucioneve fetare e filantropike, ashtu edhe përlllogaritjen e fryrë të vlerës së tyre. Delegacioni shqiptar u mundua t'i përjashtonte nga sfera e veprimit të nenit 29 të Traktatit dhe të përlligjte vënien dorë mbi to nga ana e shtetit. Ai arsyetoi se selitë e përfaqësive diplomatike e konsullore italiane në Shqipëri ishin përdorur për qëllime që nuk përputheshin me përmbushjen normale të funksioneve të veta. Personeli i tyre kishte dhunuar statusin e njohur nga e drejta diplomatike e konsullore dhe ishte përfshirë në veprimtari që binin ndesh me detyrat institucionale që duhet të kryenin. Përsa i takonte pasurive të institucioneve fetare e filantropike, u paraqitën një numër i madh dokumentash, dëshmi, procesverbale, fotografi etj., që, sipas palës shqiptare, provonin shndërrimin në institucione ku kryhej në mënyrë sistematike veprimtari në dëm të interesave të popullit shqiptar. Karakteri fetar e filantropik ishte cenuar dhe kompromentuar. Kjo përlligjte përjashtimin nga trajtimi i veçantë, që u rezervonte Traktati i Paqes me Italinë.⁴⁴ Pala italiane nguli këmbë në pretendimin e vet. Duke parë insistimin e vazhdueshëm delegacioni shqiptar sugjeroi si zgjidhje kompromisi propozimin që selitë të bliheshin nga shteti shqiptar. Propozimi i saj u pranua. Delegacioni shqiptar avancoi si alternativë kompromisi që mund t'i kënaqte të dyja palët, pagimin e 2.5 milionë USD nga Italia, që ishte e barabartë me gjysmën e shumës prej 5 milionë USD, të caktuar nga neni 74 B 6 i Traktatit të Paqes. Pas kësaj çështja e reparacioneve do të quhej e zgjidhur përfundimisht. Roma u shpreh dakord dhe pika e parë e rendit të ditës u konsiderua e ezaauruar.

Pika tjetër kishte të bënte me restitucionet, rikthimin e pasurive, sendeve apo objekteve të rrëmbyera ose të mara jo në formë normale nga pikëpamja juridike. Qeveria shqiptare kërkonte prej Italisë me titull restitucioni: Rezervën në ar të Bankës Kombëtare të Shqipërisë, e cila në histori njihet me emërtimin *Ari Monetar shqiptar*; Kanonierën *Iliria*; Objektet arkeologjike e artistike të ekspozitës së *Oltra Mares-Përtej Detit*; Pajisjet dhe arkivat e përfaqësive diplomatike dhe konsullore shqiptare në Athinë, Bari, Beograd, Berlin, Bukuresht, Gjenevë, Manastir, Romë, Selanik, Shkup, Sofje, Vjenë etj, të cilat pas pushtimit u morën nga përfaqësitë diplomatike dhe konsullore italiane; Dokumente të rëndësishme të ministrive të Bujqësisë, Punëve Botore etj; Anije, motobarka, automjete transporti etj; Pajisjet e oborrit mbretëror të Zogut, të rekuizuara nga pushtuesit italianë gjatë pushtimit; Një koleksion me vlerë librash dhe dokumentesh të antikuarit të Bibliotekës Kombëtare shqiptare; etj. Vlera e tyre, sipas përlllogaritjeve të bëra nga autoritetet shqiptare

⁴³ AMPJ- Fondi - Traktati i Paqës me Italinë, Dosja A/II/30 N/D, Nr.1.

⁴⁴ Po aty.

të asaj kohe, arrinte në 42 286 065 USD.⁴⁵ Në këtë kategori përfshiheshin edhe mallrat, lëndët e para, pajisjet e makineritë e kontraktuara nga tregtarët shqiptarë në Itali, por që për shkak të luftës nuk mbërritën dhe nuk u vunë në dispozicion të porositësve edhe pse mbi 95 % e tyre ishin paguar. Ato janë vlerësuar në 39 539 984 lira italiane dhe 165 499 franga shqiptare.⁴⁶ Çështja e arit shqiptar të rrëmbyer nga gjermanët në Romë, në shtator të vitit 1943, u diskutua e lidhur me atë të kredive që qeveritë shqiptare kishin marrë nga Italia në periudhën midis dy luftrave. Për të kuptuar qëndrimin që mbajti delegacioni shqiptar rreth statusit të kredive italiane, është i nevojshëm një sqarim i shkurtër se ç'përfaqësonin ato sipas konceptit të qeverisë shqiptare. Sistemi i kredive italiane, zë fill nga dispozitat e "një traktati sekret ushtarak, me anë të të cilit Shqipëria vinte në dispozicion të Italisë territorin e saj në rast të ndonjë lufte me Jugosllavinë, kjo në këmbim të lejimit të përdorimit të zonave naftëmbajtëse, koncesioneve bujqësore në zona që do të përcaktoheshin, krijimit të Bankës së Emetimeve Shqiptare me kapital Italian."⁴⁷ Traktati u nënshkrua më 26 gusht të vitit 1925 dhe u pasua edhe nga dy akte të tjerë, Traktati i miqësisë dhe i sigurisë, ose Pakti i Parë i Tiranës, i nënshkruar më 27 nëntor të vitit 1926 dhe nga Pakti i Dytë i Tiranës, i quajtur "Traktati i aleancës mbrojtëse", i nënshkruar, më 22 nëntor 1927.⁴⁸

Një pjesë substanciale e sistemit të akteve nëpërmjet të cilave Italia kishte projektuar legalizimin e shtrirjes së saj në Shqipëri ishte edhe Konventa për krijimin e Bankës Kombëtare të Shqipërisë. Njëkohësisht me të u mbyllën edhe procedurat ligjore e institucionale për kredinë e Shoqërisë për Zhvillimin Ekonomik të Shqipërisë, SVEA - (*Societa per lo Sviluppo Economico dell'Albania*), me një kapital shtetëror italian prej 15 000 000 lireta italiane. Në vijim sistemi i kredive u plotësua edhe me disa të tjera, ndër të cilat ishin, kredia 10-vjeçare e 26 qershorit 1931, kredia bujqësore e 11 marsit 1936, kredia për vendosjen e monopolit të duhanit e 19 marsit 1936 dhe ajo për ndërtimin e skelës së Durrësit. Historiografia zyrtare shqiptare ka ardhur në konkluzionin se ato i shërbyen fare pak zhvillimit ekonomik të Shqipërisë apo përmirësimit të jetës së popullit shqiptar. Ajo i ka stigmatizuar si instrumente që kontribuan në humbjen e pavarësisë politike e ekonomike, që përgatitën e sollën 7 prillin e 1939-ës. Insistimi i delegacionit italian për shqyrtimin e përbashkët dhe të kushtëzuar të çështjes së arit monetar shqiptar dhe të kredive, rrezikoi rezultatet e arritura gjer në atë kohë gjatë negociatave. Në këto rrethana qeveria shqiptare mendoi që çështja e arit të përjashtohet për momentin nga objekti i bisedimeve. Ky mund të ishte një *modus vivendi* për kapërcimin e situatës delikate të krijuar. Nuk mund të mohohet se në të vërtetë kishte edhe një shkak tjetër. Çështja e arit kishte

⁴⁵ Arkivi Qendror Shqiptar, Fondi, Komisioni i Planit të Shtetit, v. 1946, D. 28.

⁴⁶ Arkivi Qendror Shqiptar, Fondi, 890, v. 1950 D. 956.

⁴⁷ Francesco Jacomoni, *Gjysma ime shqiptare*, botimet "Ora", Tiranë, 2005, fq. 20.

⁴⁸ *Historia e Popullit Shqiptar*, Vëll.3, Botimet Toena, Tiranë, 2007, f.269.

tejkualuar hapësirat e bisedimeve bilaterale dhe ishte shndërruar në objekt shqyrtimi nëpër organizma ndërkombëtare.⁴⁹ Prandaj delegacioni shqiptar propozoi që ajo të lihej për t'u biseduar në të ardhmen, në rrethana të tjera më oportune.⁵⁰ Delegacioni italian nuk e pranoi arsyetimin e mësipërm dhe përsëriti që çështja e arit të lidhej me kredinë e SVEA-s, kredinë bujqësore të vitit 1930, kredinë e portit të Durrësit, shuma e të cilave llogaritej në rreth 44 miliardë lireta. Duke u kompensuar me njëra tjetrën, të konsideroheshin të regulluara përfundimisht. Sipas propozimit italian, Shqipëria duhej të hiqte dorë në favor të Italisë nga kërkimi i arit monetar dhe kjo e fundit, t'i quante të shlyera kreditë që ishin marrë nga Italia.⁵¹ Të drejtën e kërkimit të kredive, pala italiane e justifikonte me nenin 81 të Traktatit të Paqes, prej të cilit citonte fragmentin e mëposhtëm:

...asnjë klauzolë e këtij Traktati nuk duhet të kuptohet se prek marrëdhëniet midis huamarrësve dhe huadhënësve...⁵²

Sipas palës shqiptare, neni 81 nuk e përligjte rivendikimin italian, sepse nenet 81 dhe 79/1 nuk mund të zbatoheshin ndaj Shqipërisë, të shkëputur nga konteksti dhe përmbajtja e nenit 29, i cili fliste posaçërisht për Shqipërinë. Aty thuhej ndër të tjera se Italia heq dorë nga të gjitha të drejtat në Shqipëri.⁵³ Termi „të drejtat“ përfshinte pa dyshim edhe „kreditë“ apo „të drejtat e kredive“.⁵⁴ Në vend të tij pala shqiptare paraqiti këtë propozim:

Të dyja palët e larta kontraktgjyese deklarojnë se me këtë janë rregulluar definitivisht midis të dy vendeve të gjitha çështjet me karakter ekonomik dhe financiar që rrjedhin nga klauzolat e Traktatit të Paqes, si edhe çështjet me karakter ekonomik e financiar e çdo detyrim tjetër në të holla të kohës së kaluar, me përjashtim të nenit 75, paragrafi 8, të Traktatit të Paqes në lidhje me arin monetar, çështje që qeveria e Republikës Popullore të Shqipërisë rezervohet ta ngrejë në të ardhmen, në qoftëse do ta konsiderojë oportune.⁵⁵

Roma në vend të përgjigjes dorëzoi një „Projekt-marreveshje italo-shqiptare mbi rregullimin e çështjeve që rrjedhin nga Traktati i Paqes“.⁵⁶ Tirana e hodhi poshtë sepse ai përmbante çështje që nuk kishin të bënin me Traktatin e Paqes. Të tilla ishin transferimi i eshtrave të ushtarëve italianë të vrarë në Shqipëri, lirimi

⁴⁹ Ajo vazhdonte të trajtohej në strukturat e Komisionit Tripalësh për Restitucionin e Arit Monetar, në Bruksel, pasi ishte diskutuar në Arbitrazhin Ndërkombëtar dhe mandej në Gjykatën Ndërkombëtare të Drejtësisë në Hagë. Shih për këtë edhe Ksenofon Krisafi, *Në kërkim të arit, historia e arit shqiptar të rrëmbyer gjatë Luftës së Dytë Botërore*, DITA 2000-UET PRESS, Tiranë, 2009

⁵⁰ AMPJ Fondi - Traktati i Paqes me Italinë, Dosja A/II/30, v.1955 f.144.

⁵¹ Po aty.

⁵² Po aty.

⁵³ *Recueil de l'ONU*. Vol.49, 1950, I.N. fq.49.

⁵⁴ AMPJ - Fondi - Traktati i Paqes me Italinë D A/II/30, v.1955. N/D, Nr. 4 Bisedimet shqiptaro-italiane.

⁵⁵ Po aty.

⁵⁶ Po aty.

dhe riatdhesimi i të burgosurve që ndodheshin në Shqipëri. Për këto çështje palët ishin marrë vesh se do të shkëmbeheshin letra. Në korrik të vitit 1955 pala shqiptare paraqiti, një projekt i cili përfaqësonte një alternat kompromisi. Në nenin 1 të tij parashikohej detyrimi i Italisë për t'i paguar Shqipërisë me titull „reparacione“ shumën prej 2 600 000 dollarë USA. Ajo përbëhej, siç u tha nga gjysma e vlerës prej 5 milionë USD, të caktuar për Shqipërinë nga Traktati i Paqes me Italinë dhe nga 100 000 USD, që ishte vlera e kanonierës *Iliria*. Ky detyrim do të realizohej nëpërmjet furnizimit me mallra të ndryshme, sipas një aneksi “A”, që i bashkëngjitej marrëveshjes dhe brenda afatit të përcaktuar prej saj. Projekti u hodh poshtë nga Roma, e cila si kundërpërgjigje, më 5 shtator 1955, dorëzoi një projekt të dytë. Në njërën prej letrave që i bashkëngjiteshin atij përsëriste propozimin që shuma e borxhit të shtetit shqiptar që rridhte nga marrëveshjet midis qeverive shqiptare të periudhës së paraluftës dhe SVEA të kompensohej duke i dhënë qeverisë italiane arin monetar të Bankës Kombëtare të Shqipërisë të marrë nga gjermanët në Romë, në shtator të vitit 1943.⁵⁷ Pala italiane pranoi vetëm një pjesë të vërejtjeve që iu paraqitën më 30 shtator 1955. Propozimi i saj i fundit për vitin 1955 u bë më 22 dhjetor 1955. Ai rikthehej sërish në idenë e mëparshme të kompensimit të borxheve të vjetra të SVEA-s me arin monetar shqiptar.⁵⁸

Qeveria shqiptare e interpretoi këtë insistim të përsëritur të italianëve si mungesë interesi dhe mungesë dëshire për mirëkuptim, çka u bë shkak për shtyrjen e bisedimeve. Pati një periudhë të gjatë ku progresi ishte minimal. Krejt viti 1956 dhe pjesa e parë e 1957 u konsumua me shkëmbime formale projektesh midis palëve.⁵⁹ Ndër projektet e paraqitura nga italianët meriton të vihet në dukje ai i dorëzuar më 4 shkurt 1956. Lihej të kuptohej se mund të hiqnin dorë nga borxhet e paraluftës, por kërkonin që në marrëveshje të vihej një formulë, me të cilën të saktësohej se me përfundimin e bisedimeve dhe nënshkrimin e marrëveshjes përkatëse, do të konsideroheshin të zgjidhura të gjitha çështjet me karakter ekonomik e financiar që rridhnin nga Traktati i Paqes.⁶⁰ Roma sqaronte se e kërkonte për të siguruar ratifikimin e marrëveshjes në parlament. Ajo nuk ishte kundër që në marrëveshje të vihej një rezervë nga pala shqiptare për çështjen e arit monetar.⁶¹ Propozimi i lartpërmendur u pranua. Më 2 prill 1956, qeveria shqiptare i transmetoi qeverisë italiane se ishte dakord me propozimin që në marrëveshje të parashikohej shprehimisht që të gjitha çështjet me karakter ekonomik dhe financiar që rridhnin nga Traktati i Paqes, si dhe tërë çështjet me karakter ekonomik e financiar e çdo detyrim në të holla me prejardhje nga koha e kaluar konsideroheshin të zgjidhura definitivisht. Qeveria

⁵⁷ Po aty.

⁵⁸ Po aty.

⁵⁹ Po aty.

⁶⁰ AMPJ - Fondi - Traktati i Paqes me Italinë D A/II/30, v.1956. N/D, Nr. 4 Bisedimet shqiptaro-italiane.

⁶¹ Po aty.

shqiptare ritheksonte rezervën për nenin 75 paragrafi 8, të Traktatit të Paqes në lidhje me arin monetar, çështje që mund ta ngrinte në të ardhmen, në se do ta quante oportune.⁶²

Ministria e Punëve të Jashtme të Italisë më 7 shtator 1956, njoftoi se pranonte propozimin e mësipërm dhe i dorëzoi legatës shqiptare në Romë kundërprojektin e vet. Ai e përfshinte formulën e qeverisë shqiptare dhe sugjeronte redaktime, ndryshime dhe shkurtime në disa prej neneve të projektit shqiptar. Kërkonte gjithashtu shtyrjen e afatit përfundimtar të pagimit të shumës prej 2 600 000 dollarë që Italia do t'i jepte Shqipërisë si reparacion dhe restitucion (kanoniera *Iliria*) edhe për një vit tjetër. Siç shihet, në rreth tre vjet negociata direkte apo me shkëmbim letrash, notash verbale etj, kur u duk se ishte arritur konsensusi dhe marrëveshja mund të konsiderohej e përfunduar, mbeteshin ende pengesa. Duhet të kalonte edhe rreth një vit tjetër deri sa palët të sheshonin të gjitha mosmarrëveshjet, duke shkëmbyer sërish projekte, në kërkim të një qëndrimi unik përfundimtar. Në vazhden e përpjekjeve për konsensus, pala shqiptare, i përcolli vërejtjet e veta më 26 shtator 1956.⁶³ Tre muaj më pas, më 27 dhjetor 1956, dy funksionarë të legatës italiane në Tiranë, në një bisedë që patën në Ministrinë e Punëve të Jashtme, prekën ndër të tjera edhe çështjet e mbetura pezull nga reparacionet. Njëri prej tyre, i cili do të largohej ato ditë për në Romë, mori përsipër që t'i diskutonte me qendrën.⁶⁴ Pas kthimit, më 11 shkurt 1957, dorëzoi në Ministrinë e Punëve të Jashtme në Tiranë, kundërprojektin e 4-të të qeverisë italiane.⁶⁵ Roma kishte pranuar pothuajse gjithë sugjerimet e palës shqiptare, megjithëse mbante ende rezerva për disa dispozita të kontestueshme, siç ishte p.sh. ajo e disponibiliteteve të italianëve në Shqipëri.⁶⁶ Për këtë çështje, të negociuar edhe më parë, ishte arritur në marrëveshje që të gjitha depozitat dhe disponibilitetet e shtetasve italianë në Shqipëri, të konsideroheshin të likuiduara dhe të mbyllura. Supozohej se ato ishin përfshirë në diferencën prej 2 500 000 dollarë, që do t'i zbritej shumës së përgjithshme të reparacioneve për Shqipërinë, për llogari të selive të përfaqësive diplomatike dhe konsullore italiane si dhe të godinave e pasurive të institucioneve fetare e filantropike italiane në Shqipëri.

Qeveria italiane pretendonte se marrëveshja ishte arritur vetëm për ato shuma që ishin depozituar para datës së hyrjes në fuqi të Traktatit të paqes me Italinë, që ishte 16 shtatori i vitit 1947. Ajo insistonte që shumat e depozituara pas kësaj date duhet të likuidoheshin prej qeverisë shqiptare dhe jo prej saj, sikurse ishte rënë dakord më parë.⁶⁷ Tirana, në përgjigjen e vet, kërkoi që në projektin italian të bëhej një

⁶² Po aty.

⁶³ Po aty.

⁶⁴ Po aty.

⁶⁵ AMPJ - Fondi - Traktati i Paqes me Italinë D A/II/30, v.1957. N/D, Nr. 4, Bisedimet shqiptaro-italiane.

⁶⁶ Po aty.

⁶⁷ Po aty

ndryshim. Fjala ishte për nenin 13, i cili fliste për mallrat e porositura nga tregtarët shqiptarë në Itali. Qeveria italiane angazhohej të lehtësonte lëshimin e lejës së eksportimit të tyre në Shqipëri, por kufizohej vetëm për ato që ishin porositur para fillimit të Luftës së Dytë Botërore. U kërkuar që ajo të përfshinte të gjithë mallrat e porositura para, gjatë dhe pas lufte, deri më 16 shtator 1947. Projekti i fundit italian, i paraqitur zyrtarisht më 30 mars 1957, në të cilin ishin përfshirë edhe ndryshimet e bëra nga pala italiane për nenin 13, u konsiderua i pranueshëm. Miratimi iu dorëzua titullarit të legatës italiane në Tiranë, Giovanni Revedini di San Martino, të cilit, më 16 prill 1957, iu kërkuar që t'i njoftonte Romës propozimin e qeverisë shqiptare për të caktuar një datë sa më të afërt për nënshkrimin e marrëveshjes në Romë.⁶⁸

Gjatë muajve maj-qershor përfunduan procedurat dhe formalitetet juridike, diplomatike dhe praktike dhe më 22 qershor të vitit 1957, në praninë e delegacioneve të të dy vendeve, u firmos në Palacio Kixhi,⁶⁹ "Marrëveshja për rregullimin e çështjeve që rrjedhin nga Traktati i Paqes, nënshkruar në Paris, më 10 shkurt 1947, midis Fuqive Aleate e Shoqe dhe Italisë". Për palën shqiptare marrëveshjen e firmosi ish zv/ministri i punëve të jashtme Nesti Nase, kurse për palën italiane Alberto Folchi, nënsekretar shteti për punët e jashtme. Disa muaj më vonë, më 19 tetor 1957, me Dekretin Nr. 2543 Presidiumi i Kuvendit Popullor të Shqipërisë ratifikoi Marrëveshjen e 22 qershorit 1957. Ajo parashikonte detyrimin e Italisë për t'i paguar Shqipërisë një shumë prej 2.6 milionë dollarë amerikanë, e cila përbëhej, siç u tha, nga 2.5 milionë dollarë që ishte gjysma e vlerës prej 5 milionë USD, të caktuar për Shqipërinë nga Traktati i Paqes me Italinë dhe nga 100 000 USD, që ishte vlera e kanonierës *Iliria*. Shlyerja e këtij detyrimi do të bëhej nëpërmjet livrimit të mallrave në katër këste. Kësti i parë, në shumën e 1 milionë dollarëve amerikanë, do të shlyhej brenda 45 ditëve nga hyrja në fuqi e marrëveshjes. Një vit më vonë do të shlyhej kësti i dytë në vlerën e 600 000 dollarëve amerikanë. Kësti i tretë i fiksuar në shumën e 500 000 dollarëve amerikanë do të likuidohej pas një viti e gjysëm, kurse i katërti, gjithashtu në shumën e 500 000 dollarëve amerikanë, pas dy vjetësh, nga hyrja në fuqi e marrëveshjes së 22 qershorit 1957.⁷⁰ Kështu, 10 vjet pas hyrjes në fuqi të Traktatit të Paqes me Italinë, u bë e mundur që midis Shqipërisë dhe Italisë të zgjidheshin me anë marrëveshjeje problemet e rrjedhura prej tij. Siç u vu në dukje edhe më lart, një punë e madhe dhe e gjatë, demarshe të shumta e të përsëritura, takime e negociata të zgjatura i paraprinë arritjes dhe nënshkrimit të marrëveshjes.

Një varg faktorësh ndërkombëtarë e rajonalë ushtruan ndikimin e vet në ndërgjegjësimin gradual të politikanëve dhe të qeverive shqiptare e italiane për domosdoshmërinë e kapërcimit të vakuumit ekzistues në marrëdhëniet midis tyre.

⁶⁸ Po aty.

⁶⁹ Emri i ndërtesës ku ishte vendosur selia qendrore e Ministrisë së Punëve të Jashtme të Italisë, i cili është përdorur si sinonim i vet ministrisë.

⁷⁰ AMPJ - Fondi - Traktati i Paqes me Italinë D A/II/30, v.1957. N/D, Nr. 4, Bisedimet shqiptaro-italiane.

E ardhmja kërkonte ndërtimin e një atmosfere bashkëpunimi e mirëkuptimi. Me përpjekje të përbashkëta kjo logjikë ngadhënjeu. Qeveria shqiptare, e udhëhequr nga dëshira e zhvillimit të marrëdhënieve të fqinjësisë së mirë me Italinë, ka dëshmuar vullnet pozitiv në disa raste. Menjëherë pas mbarimit të luftës, autoritetet shqiptare ndihmuan riatdhesimin e të gjithë robërve italianë të mbetur në Shqipëri, u kujdesën për transferimin në Itali të eshtrave të partizanëve italianë të rënë në luftën kundër okupatorit nazist, realizuan më pas riatdhesimin e të gjithë italianëve të mbetur në Shqipëri pas çlirimit, liruan dhe riatdhesuan të gjithë të burgosurit italianë të dënuar për faje të kryera gjatë ose pas luftës, iu përgjigjën pozitivisht kërkesës për transferimin në Itali të eshtrave të ushtarakëve italianë të vrarë ose të vdekur në Shqipëri, etj. Këto qëndrime u pritën me interes nga qeveria italiane dhe u vlerësuan si shprehje e dëshirës për normalizimin e marrëdhënieve. Përfundimi i marrëveshjes së 22 qershorit 1957, shënonte një hap me rëndësi. Zbatimi i saj me korrektësi, shërbeu si kontribut në përmirësimin dhe zgjerimin e tyre. Qeveria italiane dorëzoi disa nga objektet dhe sendet që ishin rivendikuar nga pala shqiptare nën titullin e reparacioneve. Ato ishin shumë pak në krahasim me kërkesat shqiptare, sepse siç informuan autoritetet italiane shumica kishin humbur, kurse një pjesë ishin dëmtuar në atë masë sa që ishin bërë të papërdorshme ose të padobishme. Realizimi i pjesës tjetër të marrëveshjes, shlyerja e detyrimit prej 2.6 milionë USD do të bëhej nëpërmjet kontratave që do të përfundoheshin midis Ministrisë së Tregtisë për palën shqiptare dhe enteve private apo shtetërore italiane. Shqipëria e shfrytëzoi këtë mundësi për të kontraktuar importimin e automjeteve të transportit, anijeve, makinerive bujqësore, tekstileve etj. Deri në gjysmën e parë të vitit 1960, në zbatim të marrëveshjes së qershorit 1957, Shqipëria kishte marrë mallra, pajisje, makineri etj në një vlerë të përgjithshme prej 2 584 000 dollarë amerikanë. Pak kohë vonë mbërriti edhe pjesa tjetër me një vlerë prej 16 000 dollarë amerikanë, duke e konsideruar të zgjidhur përfundimisht çështjen e reparacioneve nga Italia. Qeveria shqiptare, në zbatim të angazhimeve të marrëveshjes, i furnizoi qeverisë italiane dokumentacionin për pronat dhe pasuritë e shtetasve italianë në Shqipëri, kurse ajo kontribuoi për saktësimin e vlerës së mallrave që tregtarët shqiptarë kishin kontraktuar në Itali, para shtatorit të vitit 1947.

Në dekadat që pasuan, veçanërisht pas përmbysjes së regjimit monist, në marrëdhëniet midis dy vendeve, u krijuan hapësira të gjera për zgjerimin, intensifikimin dhe përmirësimin cilësor. Prej shumë vjetësh marrëdhëniet me Italinë janë klasifikuar në kategorinë e marrëdhënieve me karakter strategjik. Ato janë pasuruar me elementë të rinj me rëndësi të posaçme dhe përkufizohen si shumë pozitive. Shteti dhe qeveria italiane, kanë mbështetur vazhdimisht Shqipërinë në fushën ekonomike, politike, por sidomos në ecurinë e proceseve demokratike, në forcimin e institucioneve si dhe në procesin e integritetit të Shqipërisë në strukturat euro-atlantike.

Bibliografia:

- Historia e Popullit Shqiptar (2007) *Toëna*, Vëll.3, Tiranë,
Jacmoni, F (2005) *Gjysma ime shqiptare*, “Ora”, Tiranë,
Kaba, H (2007) *Shqipëria në rrjedhën e Luftës së ftohtë (Shënime dhe dokumente)*,
Botimpeks, Tiranë
Krisafi, K (2009) *Diplomaci pas lufte, - Negociatat me Italinë dhe Gjermaninë për
dëmet e luftës në Shqipëri*, Dita 2000, Tiranë
Krisafi, K (2009) *Në kërkim të arit, historia e arit shqiptar të rrëmbyer gjatë Luftës së
Dytë Botërore*, DITA 2000- UET PRESS, Tiranë
Lakër, U (2003) *Europa në kohën tonë, 1945-1992*, Dituria, Tiranë
Macci, G (2007) Citohet sipas Hamit Kaba, *Shqipëria në rrjedhën e Luftës së ftohtë
(Shënime dhe dokumente)*, Botimpeks, Tiranë
Morin, E (2001) *Europa në mendje*, Ora, Tiranë,
Recueil des documents de la Conférence de la Paix de Paris, Vol.I, f.178, (në vijim është
cituat: “Recueil..).
*Recueil des Traités - Traités et accords internationaux enregistrés ou classés et inscrits au
repertoire du Secretariat de l’Organisation des Nations Unies*. Vol.49, 1950, I.N.
747, ff.4-5, në vijim është cituar «Recueil de l’ONU..»
Rezolucioni i Konferencës së Potsdamit, 41, germa A, pika 4.
Zweig, S (2004) *Bota e djeshme, Kujtime të një evropiani*, Shtëpia botuese Elena Gji-
ka, Tiranë.

Burime arkivore:

- AMPJ- Fondi - Traktati i Paqes me Italinë, Pako, Nr.1, Dosje II/30, v.1948. viti
1950, viti 1954, viti 1955, viti 1956, viti 1957.
Arkivi Qendror Shqiptar, Fondi, Komisioni i Planit të Shtetit, v. 1946, D. 28.
Arkivi Qendror Shqiptar, Fondi, 890, v. 1950 D. 956.
Gazeta *Bashkimi*, 7 nëntor 1946

Skema e re e financimit të arsimit të lartë

_____ Henri ÇILI, PhD _____

Abstrakt. *Cili është sot, tipari themelor i rolit të shtetit shqiptar, i qeverisë shqiptare dhe i politikës në përgjithësi në arsimin e lartë, i cili ka një traditë të pandërprerë, si kur në pushtet kanë qenë parti të majta, ashtu edhe kur kanë qenë ato të djathta? Ka vetëm një konkluzion: të gjitha masat janë ose me natyrë sasiore dhe populiste, ose me natyrë etatiste. Sidoqoftë, problemi i financimit të arsimit të lartë dhe koncepti i tij, duhet të dalë nga dallimi publik dhe privat, dhe duhet konsideruar si një i tërë për të gjithë sistemin.*

Fjalë kyçe:

Arsimi i lartë publik, arsimi i lartë privat, skema e financimit

HYRJE

Në dërsa e kemi mjaft të qartë se për cilat arsye shteti është shumë i pranishëm në sektorin e edukimit nëpër ciklet parauniversitare, është koha të rikoncepjmë me themel, “pse –të” e angazhimit të shtetit në arsimin e lartë. Përveç rolit rregullator dhe garantues të standardeve, shteti është sot investitori më i madh në arsimin e lartë. Sipas të gjitha teorive, të majta dhe të djathta, janë 3 arsyet për të cilat shteti është i pranishëm në arsimin e lartë.

- 1 - “**NEED**” (*nevoja*) Për të përmbushur dëshirën për të kryer studime të lartë të gjithë atyre individëve që vijnë nga shtresa modeste të shoqërisë dhe që nuk mund të financojnë vetë direkt studimet e tyre.
- 2 - “**MERIT**” (*ekselenca*) Për të financuar studimet e të gjithë atyre talenteve, të

cilët posedojnë një kapital intelektual të atij niveli, sa meritojnë të mbështeten nga shoqëria në mënyrë që ata t'ia kthejnë një ditë këtë investim shoqërisë.

- 3 - *“DEGET P A TREG”*. Mbështetja tërësore ose thelbësore e atyre degevë apo disiplinave për të cilat, tregu privat i edukimit nuk prodhon ofertë, por që janë degë dhe disiplina për të cilat shoqëria dhe shteti kanë nevojë jetike si mësuesia, historia, gjuhësia, letërsia, arkeologjia etj.
- 4 - *“POLITIK A RAJONALE”*. Mbështetja e një pranie të arsyeshme universitare në rajone të caktuara të vendit për të inkurajuar zhvillimin rajonal dhe përgatitjen e specialistëve të caktuara që lidhen me rajonin (infirmieri, mesuesi, gjuhët e huaja, etj.)

Jashtë këtyre 4 kategorive është e pamundur të gjenden arsye të tjera pse duhen harxhuar paratë publike për arsimin e lartë. Në bazë të këtyre katër arsyeve, ia vlen të harxhohen paratë publike, duke e dedikuar parandë publike për të përmbushur këto tre qëllime.

Sot sistemi i financimit të arsimit të lartë është tipik “financim pasiv” për tre arsye:

- a - financimi nuk shkon tek qëllimi i tij final *“studenti”* por tek institucioni i edukimit të lartë.
- b - financimi u shpërndahet në mënyrë të barabartë të gjithë studentëve njësoj, dhe kjo përmes institucionit, i cili ofron “falas” studimet për të gjithë studentët (taksa e regjistrimit është në sasi të pallogaritshme) kur jo të gjithë studentët kanë nevojë të barabarta.
- c - financimi aktual i trajton njësoj të gjitha degët dhe disiplinat, pavarësisht se sa i mbulon ato oferta edukative alternative që vjen nga sektori privat. Për shembull mbi të njëjtat kritere financohet fakulteti historik – filologjik, degët e të cilit praktikisht nuk ofrohen në asnjë universitet privat në Shqipëri, në të njëjtën mënyrë dhe fakulteti ekonomik apo juridik, kur këto degë i gjejmë në shumë prej universiteteve private.

Reforma

Kalimi në “financimin aktiv”: mbështetja e “kërkesës” në vend të mbështetjes së “ofertës”

1- Ndërrimi i sistemit të financimit: nga mbështetja për *“ofertën publike të edukimit të lartë”* (dhënia e subvencionit për institucionin) dhe kalimi tek mbështetja e *“kërkesës për edukimin e lartë”*, pra dhënia e “bursës” apo financimit studentit direkt, jo tërthorazi si deri tani, përmes ofrimit falas të shërbimit për të gjithë.

- 2- Kalimi në “financimi aktiv” duhet të bëhet përmes parimit *“NEED & MERIT”* pra ndarja e studentëve në tre kategori:

KATEGORIA E PARE: (rreth 30 – 40 përqind) studentët që vijnë nga shtresa të dobëta shoqërore e numrit total të studentëve. Kjo përkon dhe me të gjithë klasifikimit e shoqërisë, ku rreth 30 – 40 përqind e pupullsisë ka të ardhura modeste. Ku grup mbështetet plotësisht me “bursë” që do të thotë “tarifa e shkollimit + shuma e nevojshme për të jetuar studenti gjatë periudhës së studimeve”

KATEGORIA E DYTE: (5- 10 përqind). Studentët e shkëlqyer e numrit total të studentëve. Studentët që janë në krye me rezultatet e shkëlqyera, çlirohen nga detyrimi për të paguar studimet e tyre. Për të përcaktuar ekselentët përpunohen kritere të sakta akademike.

KATEGORIA E TRETE: (40 - 50 përqind e studentëve) Pjesa e tretë, nuk bën pjesë në asnjë prej këtyre kategorive të sistemit “NEED – MERIT”, ajo as nuk është e varfër që të ketë nevojë për paratë e shoqërisë për të studiuar, as nuk është ekselente të meritojë marrjen e parave publik. Kjo kategori i përballon vetë shpenzimet e edukimit. Ajo zgjedh vetë degën apo universitetin, paguan koston e edukimit dhe mban përgjegjësinë vetë për rezultatet. Shoqëria nuk ka asnjë arsye të financojë edukimin e tyre, ata i kanë mundësitë vetë dhe nga ana tjetër ata nuk hyjnë në kategorinë e studentëve të shkëlqyer, që shoqëria të investojë tek ata.

PERFITIMI:

Shpërndarja e financimit publik në këtë mënyrë, na bën të mundur “motivimin e totalitetit të studentëve shqiptarë”. Grupi i parë, ata që kanë nevojë sociale do të përpiqen të justifikojnë gjendjen e tyre në këtë kategori shoqërore, grup tjetër i studentëve që do të paguajnë, do të jenë të motivuar pasi kanë harxhuar paratë e tyre dhe të familjes. Ndërkohë të gjithë studentët së bashku do të luftojnë për të hyrë “: 5-10” e studentëve më të mirë për të përfituar financimin e studimeve të tyre.

Kalimi nga “ZGJERIMI EKSTENSIV tek ZGJERIMI INTENSIV”

1. Stopimi i zgjerimit të “DEGEVE ME TREG” dhe rakordimi i kuotave të tyre në raport me standardet akademike të përcaktuar nga ligji i arsimit të lartë 3.8 m² / student dhe 1 pedagog/ 20 studentë. Kjo do të sillte automatikisht sjelljen e këtyre degëve në kuota optimale për kapacitetet e universitetit publik në degë të tilla si ekonomik, juridik, shkenca sociale, të cilat gjenden sot të superngarkuara dhe disa herë nën standardet e detyrueshme akademike dhe fizike. Nuk ka asnjë nevojë të rriten më pranimet dhe kuotat në këto degë, përtej një numri të arsyeshëm përderisa këto nevojë i plotëson fare mirë universiteti privat.
2. Drejtimi i financimeve të kursyera nga zgjerimi ekstensiv i degëve më treg drejt degëve pa treg dhe mbështetja e tyre përmes formash të ndryshme për t'i

bërë ato tërheqëse. Kështu për fakultetet e mësuesisë, apo për degët të tilla si arkeologjia, gjuhësia, letërsia numri i bursave mund të jetë më i madh për t'i bërë ato më tërheqëse për studentët.

3. Kalimi në parimin e ZGJERIMIT INTENSIV, (cilësor) që do të thotë paratë që tashmë nuk shkojnë në “zgjerim ekstensiv” (sasior) do të shkojnë në drejtime të tjera të universitetit publik: rritje pagash, biblioteka, fonde për kërkim shkencor.

Kompeticioni mes univesiteteve

Në qoftë se kjo skemë e sipërpërmendur zgjidh në parim, ose krijon premisa për motivimin e studentëve, kriza e dytë po aq e rëndësishme dhe që madje shkakton në një masë të madhe edhe të parën, është pikërisht “motivimi financiar i stafëve akademike”. Kjo është baza themelore për avancimin e cilësisë së universiteteve tona, kurse konkurenca mes universiteteve publike mes njëri-tjetrit apo me universitetet private, është kushti themelor për përmirësimin e sistemit universitar në tërësi.

Ka nevojë për kalimin nga një sistemit universitar *statik, imobil* në një sistem konkurrencial. *Vetëm vendosja e të gjithë universiteteve pa përjashtim në “luftën për të fituar studentët”, do të jetë mekanizmi i madh i vendosjes së sistemit universitar në kushte kompeticioni.*

Gjendja aktuale

Pedagogu në universitetet publik është së jashtmi tërësisht i pamotivuar. Përtej motivimit personal dhe shpirtit akademik, thuhet se jashtmi asnjë mekanizëm nuk e nxit atë të punojë mirë, ose nuk e ndëshkon nëse punon keq. Sipas sistemit aktual të financimit të universiteve ai ka:

- a - vendin e punës të sigurtë,
- b - rrogën të përcaktuar
- c - studentët e sigurtë pasi deri tani studentët i kanë studimet falas.

Asnjë shtysë nuk ekziston që ai të punojë më mirë, apo asnjë ndëshkim nuk pëson nëse punon pa cilësi. Përveç sistemit të kalimit nëpër tituj dhe grada, ku statusi i tij financiar ndryshon paksa, e gjithë gjendja tjetër paraqitet statike dhe jo motivuese.

Sot pedagogët dhe drejtuesit e universiteve publike nuk kanë asnjë pasojë pozitive apo negative në funksion të faktit që universiteti shkoi mirë apo keq. Çdo

vit përsëritet financimi publik thuhet në të njëjtat shifra, gjendja është përgjithësisht në vend numëro.

Reforma për motivimin e stafit akademik

Vetëm nëse vendi i punës, paga dhe promovimi financiar i pedagogëve në universitetin publik, do të varen nga numri i studentëve dhe për pasojë nga shumica e të ardhurave që çdo departament mbledh, vetëm atëherë do të kemi një motivim nga ana e pedagogëve, një liberalizim të arsyeshëm të pagave, shpërblimeve, fondeve për kërkimin shkencor dhe projektet.

Kjo kërkon që:

- Studentët që përfitojmë bursën sipas sistemit “NEED”, të mos jenë të detyruar ta marrin dhe ta harxhojnë këtë bursë vetëm në sistemin publik të edukimit të lartë. Ata duhet të marrin “BURSEN”, ose “ÇEKUN E STUDIMEVE” dhe të vendosin vetë se ku do ta harxhojnë atë, në një universitet publik apo privat. Në këto rrethana sistemi universitar vendoset në kushte konkurrence në treg për të fituar studentët.

- Drejtuesit dhe pedagogët e universitetit publik tanimë, në të njëjtën mënyrë si ata të universiteteve private janë të gjithë të barabartë përpara kërkesës studentore. Ata duhet të punojnë gjithnjë e më mirë, për të bërë atraktive katedrat e tyre, për të tërhequr sa më shumë studentë, qoftë nga KATEGORIA E PARE: studentët nga shtetasat në nevojë, të cilët subvencionin publik për edukimin e tyre, vendosin vetë se ku ta harxhojnë, pa i detyruar kush që të vijnë patjetër në universitetin publik siç është sot. KATEGORIA E DYTE, ata që nuk janë as nevojtarë dhe as ekselentë, tashmë e bën vetë zgjedhjen për vendin ku do të studiojë. Ai paguan vetë dhe e merr vetë përgjegjësinë. Kjo zgjidh dhe problemin e shfryrjes së dyndjes në sektorin publik.

- KATEGORIA E TRETE: ekselentët duhet ta përfitojnë skontimin nga detyrimi financiar qoftë në sektorin publik, qoftë në sektorin privat. Universitetet publike private mund të detyrohen me ligj të mbështesin në masën e 5-10 përqind të numrit të studentëve më të mirë.

Defiskalizimi i sektorit të arsimit privat

Edukimi konsiderohet si një detyrimet parësor të shtetit dhe përmbushja e tij për të gjithë qytetarët që kanë nevojë për të është një nga fushat kryesore të veprimtarisë së çdo qeverie, të majtë apo të djathtë. Për këtë qeveria takson shoqërinë dhe financon sektorin publik të edukimit.

Në këtë prizëm, prania e sektorit privat në edukim “*ia lehtëson detyrën*” shtetit

për të përmbushur këtë detyrim, që shteti e ushtron duke harxhuar taksat tona. Sa më shumë studentë të marrë përsipër sektori privat, aq më i lehtësuar është shteti. Ai e kryen më me cilësi shërbimin për pjesën e studentëve që mbetet. Sektori privat, “i kursen” qeverisë shumë fonde për këtë numër studentësh, që në fakt janë sërish paratë e qytetarëve, të cilët zgjedhin të paguajnë direkt paratë për arsimimin e fëmijëve të tyre. Në këtë kuptim, nuk ka logjikë dhe madje ka një padrejtësi të dyfishtë në faktin që arsimi privat të paguajë taksa.

- 1 - Defiskalizimi total i sektorit të edukimit
- 2 - Vënia në kushte të barabarta të përfitimit të subvencionit publik si për universitetet publike dhe ato private
- 3 - Defiskalizimi i të ardhurave të bizneseve të tjera, të cilat shkojnë për investime në arsim (si rasti i sponsorizimit në sport, art, kulturë)

Janë në një keqkuptim të madh, të gjithë ata që, në qendër ose në bazë, majtas ose djathtas, mendojnë se vazhdimi i etatizmit dhe populizmit në arsimin e lartë, është diçka që i shërben popullit, është diçka që u shërben masave, është diçka që i shërben të majtës. Kjo nuk është aspak e vërtetë.

Politikat tipike etatiste dhe populiste në arsimin e lartë shqiptar, janë të papërshtatshme për të gjithë. Ato janë të papërshtatshme për shoqërinë shqiptare, janë të papërshtatshme për studentin, janë të papërshtatshme për arsimin publik, janë të papërshtatshme për arsimin jopublik dhe do të duhej të ndryshohej ky model me themel; do të duhej të ndryshohej ky model në funksion të efikasitetit, i cili është i dobishëm, në radhë të parë për të pamundurit, në radhë të parë për ata, që si të thuash, nuk arrijnë të aksesojnë dot sipas mekanizmave normalë në nivele të caktuara të shoqërisë, në nivele të caktuara të mirëqenies.

Problemi i financimit të arsimit të lartë dhe koncepti i tij, duhet të dalë nga dallimi publik dhe privat, dhe duhet konsideruar si një i tërë për të gjithë sistemin. Qoftë kur ne subvencionojmë në universitetin publik përmes taksave tona, qoftë kur paguajmë drejtpërdrejt në një universitet jopublik apo privat, fakti që është shoqëria shqiptare, janë qytetarët shqiptarë ata që financojnë. E rëndësishme është një gjë: si mund të financojmë në një mënyrë më efikase, në një mënyrë më të drejtë, dhe se si mund t'i pajtojmë këto të dyja. Kjo është plotësisht e mundur. Një filozof i të majtës amerikane, Xhon Rolls, i cili ishte shumë bashkëkohor thoshte një gjë shumë esenciale, për politikat publike në përgjithësi, përfshirë këtu edhe për programet e majta: “Një subvencion, që iu jepet në mënyrë të barabartë, atyre që nuk kanë nevojë të barabarta, krijon një pabarazi edhe më të madhe se ajo që ai tenton të korrigjojë”. Pikërisht në të tilla kushte ndodhemi për sa i përket shëndetësisë dhe arsimit në Shqipëri. Kemi një shërbim publik falas në arsimin e lartë, ose praktikisht falas, i cili iu ofrohet të gjithëve, edhe pse nevojë e të gjithëve nuk është e barabartë. Kjo i penalizon të dyja palët, penalizon edhe sektorin e ri të edukimit privat të lartë në

Shqipëri. Pse e penalizon? *Së pari*, me një sistem të tillë financimi, është e qartë që oferta universitare që mund të formohet me kaq pak financim nuk është cilësore. Arsimi kushton, sidomos arsimi i lartë dhe sa më lartë të ngjitemi në nivelet e tij; pra oferta edukative që mund të formohet në këtë nivel është e ulët. Studenti është i pamotivuar, pedagogët janë edhe më të pamotivuar, sepse ata paguhen keq, nuk kanë asnjë arsye për të punuar mirë, nuk kanë asnjë arsye shtesë, sepse ata, as ndëshkohen, as shpërblehen në qoftë se do të punonin në një mënyrë më shumë apo më pak kompetitive. Për shembull, në qoftë se shoqëria ka 100 lekë për të shpërndarë për arsimin e lartë, në vend që ajo t'ua japë pesë vetëve nga 20 lekë secilit, më mirë t'iu japë dy vetëve që kanë nevojë nga 50 lekë dhe të formohet një ofertë edukative, jo më e vlerës 20 lekë, por e vlerës 50 lekë. Kjo është pak a shumë situata e shprehur në mënyrë figurative.

Së dyti, duke i tejmbushur auditoret e universiteteve publike dhe duke e ofruar falas për të gjithë universitetin publik mund të thuhet se as arsimi jopublik nuk ka ndonjë të ardhme. Ai mbetet i vogël në sasi pa shanse rritjeje.

Në cilat drejtime mund të ndërhyhet sot, për të prishur këtë status quo të sistemit të edukimit të lartë në Shqipëri, atij publik dhe privat, i cili vuan të njëjtat pasoja, të njëjtat probleme dhe një problem i njërit afekton dhe tjetrin dhe anasjelltas? Paraprakisht duhet thënë se mbështetja financiare e shtetit për arsimin e lartë është pa asnjë parim bazë, është pa asnjë parim themelues, pa asnjë parim racional të zgjedhur që në fillim, në mënyrë që të vazhdohet.

Cilat mund të ishin tre-katër parime bazë të kësaj ndërhyrje, të cilat do ta vinin të gjithë sistemin në lëvizje në raport me përgjumjen ose me pengesën e ndërsjellë që sot arsimi publik i lartë dhe arsimi privat i sjellin njëri-tjetrit?

Elementi i parë do të duheshin të mbështeteshin ato grupe sociale, të cilat kanë realisht nevojë. Duke dhënë universitetin falas për të gjithë, në fakt, ne penalizojmë më të varfërit, penalizojmë shtresat e marginalizuara, penalizojmë grupet sociale të marginalizuara, të cilat nuk arrijnë dot të shkojnë realisht në degët më të mira, në universitetet më të mira publike, për një arsye të thjeshtë, sepse kjo mënyrë financimi barazitiste, vetëm sa e riprodhon pabarazinë sociale, ndërkohë që ka nevojë për një diskriminim pozitiv. Pra, e thënë në një formë më të thjeshtë: më mirë t'i paguajmë bursën plotësisht dhe pagesën e përshtatshme për të jetuar në Tiranë, një fëmije nga zonat e thella të Macukullit, apo një student i origjinë rome nga Bregu i Lumit, se sa ta ofrojmë këtë shërbim falas për të gjithë, dhe për ata që s'kanë nevojë. Duke ofruar për të gjithë, diferenca mbetet e njëjta. Pabarazia riprodhohet kështu strukturalisht dhe nuk korrigjohet.

Elementi i dytë është që politikat publike në arsimin e lartë, pra politikat e financimit, duhet të mbështesin kryesisht ato degë për të cilat shoqëria ka më shumë nevojë, ose kanë një rëndësi strategjike. Rasti klasik është mësuesia. Mësuesia ndodhet sot në një situatë të tillë, që bëhet vetëm në universitetet e periferisë, me një cilësi të ulët. Ndërkohë, në universitetet publike shkollohen

rreth 17 mijë ekonomistë, 7 mijë juristë. Jo se këto degë nuk duhet të jenë në universitetin publik. Ato s'kanë pse të kenë të tilla përmasa. Shumë fonde që harxhohen sot për degë që kanë treg mund të drejtoheshin drejt degëve, për të cilat ka nevojë shoqëria apo kombi por nuk ka shumë kërkesë për to. Ato mund të subvencionoheshin më shumë, për tu bërë më cilësore dhe më atraktive.

Elementi i tretë: nuk është më eficiente, nuk është e vlefshme kjo mënyrë financimi jokonkurrese. Universiteti publik duhet të ketë tarifa reale dhe bursa reale për të pamundur dhe ekselentët. Po ashtu universitetet publike, duhet ta fitojnë vetë studentin, nuk duhet të vazhdojë të përfitojnë apriori të siguruara: dhe studentët dhe pagat, dhe dritat dhe ujin, dhe qiranë. Ata duhet ta kërkojnë dhe ta gjejnë vetë studentin, atë student i cili i zgjedh ata me koshiençë dhe jo për faktin që është falas. Kjo do t'i bëjë ato më kompetitive, më cilësorë.

Elementi i katërt: i një roli të ardhshëm të qeverisë, në politikat publike në arsimin e lartë do të ishte: kritere të njëjta dhe standarde të njëjta për operatorët publikë ose privatë në arsimin e lartë. Për shumë universitete, kemi një administratë e cila kërkon edhe vrimën e gjilpërës për universitetet private dhe si të thuash është krejtësisht jashtë standardeve gjendja në universitetet jo publike, nga pikëpamja e hapësirës, e personelit, e bazës teknike, pavarësisht disa përmirësimeve të fundit që po bën qeveria.

Së treti do të duhej, dhe kjo i takon qeverisë, sigurimi i cilësisë në të gjitha institucionet e arsimit të lartë, pa përjashtim, publike dhe private. Kërkohet një akreditim dhe një vlerësim i jashtëm, i besueshëm, i përhershëm, për cilësinë e diplomave tona, në mënyrë që në rradhë të parë publiku, të jetë i qartë se ku studion, të ketë transparencë në çdo fillim viti, të dijë se çfarë përfaqëson një universitet dhe çfarë përfaqëson një universitet tjetër, çfarë përfaqëson kjo degë apo ajo degë; me një masë për të gjithë sistemin, në mënyrë që ai të vendosë në mënyrë racionale se ku të shkojë dhe të studiojë.

Nga ana tjetër, arsimi jopublik, mund të shihet si një ndihmës i rolit të qeverisë, ose i rolit të shtetit, për të rritur aksesin e shoqërisë në arsim. Në këtë pikëpamje do të kishte kuptim dhe do të bënte sens defiskalizimi i sektorit të edukimit privat, qoftë edhe me çmimin që ky sektor të shndërrohej nga një kompani tregtare, në një institucion të parimit të bamirësisë, pra jo fitimprurëse, gjë të cilën shumë prej aktorëve janë të gatshëm ta bëjnë, mjafton që të kishim vërtet një defiskalizim dhe si të thuash të mund të riinvestonim në të njëjtin qëllim.

Nga ana tjetër, nuk është e pamundur dhe as e pasens që autoriteti publik t'iu vendosë universiteteve jopublike disa detyrime shtesë kundrejt shoqërisë: për shembull mund të vendosë një detyrim, që 10 përqind e vendeve, ose e kapaciteteve të mund të jepeshin në formën e bursave për shtresat e marginalizuara, për zonat periferike. Ka shembuj nga universitetet në Tiranë që ka kohë që e bëjnë një gjë të tillë, duke ofruar bursa sociale në masën 10 përqind të vendeve në universitet.

Terma të lidhur me financimin e universiteteve:

- a - **“financim aktiv”**; Nënkupton një skemë tjetër financimi, e cila ka për qëllim të motivojë studentin dhe pedagogun shqiptar. Kjo nënkupton që përfituesi i subvencionit është direkt *“studenti”* dhe jo institucioni i arsimit të lartë publik siç është sot.
- b - **“bursë”** nënkupton një grant të caktuar që jep shteti për studentin, në të cilën përfshihet një kosto e përafërt e studimeve të tij plus një shumë parash të përshtatshme për të jetuar gjatë periudhës së studimit.
- c - **“ofertë e edukimit të lartë”** nënkupton të gjithë insitucionet e arsimit të lartë. Ato ndahen në publike dhe jopublike.
- d - **“kërkesë në edukimit e lartë”** nënkupton të gjitha kërkesat e të rinjve shqiptarë për të studiuar në universitetet brenda vendit.
- e - **“degët dhe disiplina pa treg”** nënkupton të gjithë ato disiplina për të cilat ose nuk ka ofertë private të edukimit, ose ajo është në një nivel të papërshtatshëm dhe shtetit i duhet të mbajë një prani të domosdoshme për interesa kombëtare, strategjike apo zhvillimit (arkeologji, mesuesi, sizmiologji, gjuhësi, etj).
- f - **“degët dhe disiplinat me treg”** nënkupton ato degë për të cilat ekziston një ofertë e përshtatshme private dhe për pasojë nuk ekzistojnë arsye që shteti të harxhojë para publike përtej disa kapaciteteve të përshtatshme (drejtësi, mjekësi, ekonomik, informatikë, arkitekturë).
- g - **“zgjerim ekstensiv”** nënkupton rritjen e kapaciteteve sasiore të arsimit të lartë publik (shtimi i numrit të studentëve, shtimi i numrit të universiteteve, fakulteteve etj të pashoqëruar me standardet akademike dhe teknike).
- h - **“zgjerim intensiv”** nënkupton rritjen e kapaciteteve cilësore të universiteteve publike (shtim i pedagogëve, rritja e pagave, shpërblimeve, fondit për kërkimin shkencor, interneti, biblioteka, kualifikime).

Kundër populizmit në arsimin e lartë

Populizmi vijon të jetë i dëmshëm në universitet. Shtesa të tjera në kuotat e pranimeve, që sa vijnë e rriten çdo vit, nuk bëjnë gjë tjetër vetëm se rrisin krizën e infrastrukturës së universitetit publik shqiptar. Ky i fundit ka mbingarkesë në numër studentësh, referuar hapësirave, pedagogëve dhe infrastrukturave të tjera për një universitet me standarde. Në vend që të kalohej nga politika për zgjerimin sasior në universitetin publik, në politika të nivelit të dytë, për rritjen e cilësisë, për ndërhyrje dhe investime në degë, për të cilat ka pak interes studentit dhe shumë nevojë shoqëria; në vend që të investohet në shkenca dhe fusha me interes strategjik e kombëtar, ku tregu nuk zgjidh dot punë; në vend që të investohet për aksesin në universitet të shtresave të marginalizuara si periferia e fshati, shtresat sociale në

nevojë, komunitetet me ngjyrë, zonat verilindore etj, i bihet fare thjesht: “shtohen nga 5 vende në çdo degë”. Asnjë politikë e nivelit të dytë e të tretë, asgjë përveç lajmit populist të prodhuar: “qeveria shton kuotat në universitete”.

Është momenti që aktorët politikë kryesorë dhe në përgjithësi shoqëria shqiptare, t’i japë fund paradigmës iluministe si paradigma kryesore dhe e vetme e ndërtimit të sistemit tonë arsimor, nga çerdhja deri në doktoraturë, bashkuar kjo me një etatizëm të vjetëruar edhe për vetë kohën kur u instalua. Iluminizmi dhe etatizmi në politikat publike qëndrojnë në këmbë ende sot me ndihmën e populizmit të radhës e për nevojat e ditës së aktorëve politikë që e kupton gjendjen, por nuk guxon të rrezikojë politikisht. Për momentin ajo i shërben vetëm burokrasisë universitare publike, asaj pjese që është parazite dhe jokonkurruese. Një sistem arsimor modern është sot një sistem ku bashkëjetojnë shumë parime, ku ndërveprojnë shumë qëllime. Por sidomos universiteti duhet të jetë në radhë të parë në shërbim të atyre që e marrin, të studentit dhe pastaj të shoqërisë dhe ë tregut.

Debati për universitetin, me të gjithë të vërtetat e tij, duhet të bëhet pronë e të gjithë aktorëve shoqërorë dhe politikë për të arritur atë transformim drejt modelit më të suksesshëm bashkëkohor, modelit anglo-sakson. Ky model vë në qendër në radhë të parë studentin, interesat e tij për një shërbim cilësor, i cili realizohet përmes mekanizmash financiare konkurrues dhe të vetëqëndrueshëm. Ky model duhet të vërë në qendër të drejtat e studentit dhe të prindërve si taksapagues, të cilët kanë të drejtë të përfitojnë në mënyrë të drejtë nga kontributi i tyre dhe ajo që është më e rëndësishmja, kërkojnë me forcë përdorim efikas të taksave të tyre. Studenti, si taksapagues duhet të jetë vetë ai, në finale, disponuesi dhe përdoruesi i taksave të tij. Ai duhet të vendosë vetë se ku të studiojë, të vendosë vetë se ku do shpenzojë paratë, që shoqëria ka vënë në dispozicion për edukimin e tij, pa qenë nevojë që qeveria t’i dërgojë me listë në universitetin që qeveria përcakton. Ashtu sikurse ne nuk i themi dikujt që merr ndihmë sociale, të shkojë të “blejë” me detyrim një supermarket të caktuar, po ashtu hierarkinë e universiteteve, që preferon studentin duhet ta vendosë ajo dhe jo qeveria. Kjo e fundit thjesht duhet të garantojë cilësinë dhe standardet e operatorëve universitarë në treg, publikë apo privatë qofshin.

INEFIKASITETI- Etatizmi dhe populizmi në arsimin e lartë nuk janë efikas në funksion të një oferte universitare cilësore. Duke marrë një shërbim falas dhe të barabartë për të gjithë, studentët nuk janë të motivuar në përgjithësi për rezultate të mira, janë të dekurajuar nga cilësia e ulët, kushtet e këqija, topitja dhe imobilizmi i këtij modeli shtetëror universitar. Duke patur të garantuar vendin e punës, pagesën dhe studentin, trupa akademike universitare është edhe më pak e motivuar për të qenë konkurruese, bashkuar kjo me paga të vogla e të pamjaftueshme e kushte të këqija pune e infrastrukturë të mangët.

PABARAZIA: Një sistem universitar “falas për të gjithë” është një sistem që riprodhon pabarazi. Në universitetin e Tiranës apo në degët e preferuara, edhe pse janë praktikisht falas nuk mbërrijnë dot zakonisht studentë nga shtresa në nevojë, aq më të rrallë janë studentët nga periferia e fshati, asfale grupe të marginalizuara si romët etj. “Një subvencion që u jepet në mënyrë të barabartë atyre, që nuk kanë nevoja të barabarta, krijon një pabarazi edhe më të madhe se ajo që tenton të korrigjojë” – thoshte filozofi Xhon Rolls. Në vend që shoqëria të shpenzojë për t’u afruar të gjithëve universitetet falas në mënyrë të barabartë, më mirë t’u ofrojë një bursë (taksë regjistrimi + shpenzime jetese) shtresave në nevojë. Duke paguar për studimet e tyre ata që kanë mundësi dhe nuk kanë nevojë reale për “universitetin falas”, do të kemi një universitet më cilësor, i cili do t’u gjendet më mirë edhe atyre që paguajnë, edhe shtresave në nevojë, duke subvencionuar tek këta të fundit, jo vetëm tarifën e shkollimit, por dhe një jetesë dinjitoze për kohën e studimeve.

EKSELENCA E PAMUNDUR: Një sistem universitar i ngritur mbi parimet barazitiste vërtet mund t’i sjellë të gjithë në universitet, por ai penalizon ekselencën universitare. Një sistem që mbështet ekselencën, kundrejt mediokritetit studentor duhet të instalohet si një motor më i fuqishëm për të çuar përpara, përmes energjisë së ekselentëve të gjithë sistemin.

FINANCIMI AKTIV: Financimi aktual i sistemit universitar është me plot kuptimin e fjalës, jo motivues, i vjetëruar. Një skemë e re financimi e sistemit universitar shqiptar do të duhej të kombinonte disa qëllime njëkohësisht: Së pari, mbështetje më e madhe dhe esenciale e studentëve nga shtresat në nevojë, kundrejt mbështetje “pak për të gjithë” që kemi aktualisht. Së dyti, mbështetje e fortë financiare për degë të tilla me interes të fortë publik, por jo atraktive për studentet si mësuesia, shkencat e natyrës etj. Së treti, mbështetje e atyre degëve për të cilat shoqëria ka më shumë nevojë, të cilat tregu i edukimit të lartë nuk i siguron plotësisht, degë me interesa strategjike për vendin dhe kombin si: gjuhësia, albanologjia, arkeologjia etj. Së katërti, mbështetja e studentit ekselent, pavarësisht origjinës së tij, pavarësisht gjendjes sociale dhe ekonomike, si motori i auditorit shqiptar.

SHUARJA E DIFERENCES PUBLIK-PRIVAT: Të gjitha këto do të shërbenin për shndërrimin e të gjithë sistemit universitar shqiptar në një sistem të vetëm publik, pavarësisht nga pronësia, publike, jopublike, private apo shtetërore e universiteteve. Të gjithë janë në dilemë: universiteti publik është i prangosur në një mungesë totale të autonomisë financiare, universiteti jopublik e privat po vepron në një mjedis krejtësisht jo konkurrues dhe diskriminues ndaj tij.

Si përfundim, Qeveria duhet të tërhiqet nga roli i saj si “pronar” e universiteteve shtetërore, duke i lënë lirinë akademike dhe autonominë financiare universiteteve publike, duke i hequr atyre njëkohësisht privilegjet në financim, duke i lënë në

treg të fitojnë vetë studentin. Ashtu sikurse duhet të heqë diskriminimin fiskal dhe financiar për arsimin jopublik e privat. Modelet duhen marrë atje ku janë të suksesshëm. Më të suksesshmet e tyre, të cilat elitat politike të vendeve përkatëse kanë arritur t'i ngrenë jashtë populizmit, brenda ndërtimit të një të ardhmeje më të mirë për universitetin shqiptar.

Roli i Arsimit të lartë në Ekonomi dhe format e Financimit të tij

____ Prof. Asoc. Dr. Engjëll PERE _____

____ Prof. Dr. Luljeta MINXHOZI _____

Abstrakt. Në teoritë e reja të rritjes ekonomike, rritja e nivelit arsimor e profesional zë një vend qëndror si një element themelor i cili karakterizon kapitalin human. Nga ana tjetër, zhvillimet shoqërore në mjaft vende, kanë ndryshuar strukturën sociale të shoqërisë, duke rritur në mënyrë signifikative kërkesën për arsim. Në këtë këndvështrim, reformat në arsimin e lartë paraqesin prej disa vitesh një dukuri ndoshta nga më karakteristiket e zhvillimit të përgjithshëm social ekonomik në mjaft vende.

Problemet, me të cilat është ndeshur dhe ballafaqohet ky zhvillim, përfshijnë një spektër mjaft të gjerë e të diskutueshëm, ato prekin mjaft dukuri të rëndësishme sasiore dhe cilësore. Ky punim nuk synon të trajtojë tërësinë e këtyre aspekteve. Këndvështrimi i tij është kryesisht ai i trajtimit të anës ekonomike e financiare, që karakterizon zhvillimin e arsimit të lartë sot. Ky aspekt, megjithëse nuk trajtohet shpesh në diskutimet publike, në fakt shoqëron të gjitha ndryshimet që vihen re në këtë fushë, në mos po në disa raste, ai është në themel të këtyre ndryshimeve. Më gjerë problemi mund të shihet si një tendencë e transformimit të vetë sektorit publik, duke kaluar kështu në debatin e diskutueshëm të partnershipit midis këtij sektori dhe atij privat.

Në këtë këndvështrim, punimi synon të trajtojë në tërësi përmbajtjen e reformave të financimit të arsimit të lartë, duke vënë në qendër të vëmendjes, raportet midis zhvillimit të arsimit publik dhe atij privat. Ideja kryesore e punimit është të trajtojë dhe të argumentojë, si në rrafshin teorik ashtu edhe në atë praktik, se zhvillimi i arsimit të lartë sot bën të domosdoshme harmonizimin e zhvillimit të arsimit publik me atë të financimeve privat në këtë fushë.

Fjalë kyçe:

Financimi i arsimit; arsimi publik dhe ai privat, reformat në arsim (JEL Classification; H44; I22; I28)

HYRJE

Diskutimi i raportit arsimim – zhvillim ekonomik është vërtet i hershëm, por duhet pranuar që është edhe i përhershëm. Edhe në raportin e Komisionit European “Arsim në Shekullin e 21” pranohet se “arsimi është një nga mjetet më të vlefshme për të nxitur formën më të thellë dhe më harmonike të zhvillimit të kapitalit njerëzor, të uljes së varfërisë, shmangies së pabarazisë, injorancës, shtypjes sociale dhe luftrave.”

Gjithnjë e më tepër debati mbi dinamikën, cilësinë dhe ndikimin e arsimit universitar, në zhvillimin shoqëror, po përqëndrohet në disa terma më ekonomikë, që kanë të bëjnë me karakteristikën e tregut të arsimit të lartë dhe mënyrën e financimit të tij.

Në literaturën teorike përcaktimi teorik i arsimit, si një nga të mirat, që prodhohen në një shoqëri, është se **arsimi është një e mirë private**, kërkesa për të cilën është formuluar nga nevoja që kanë individët, për të rritur kapacitetet e tyre për punë, në mënyrë që të sigurojnë një mirëqenie të qëndrueshme dhe më afatgjatë.

Po ta vendosim problematikën e përcaktimit të arsimit, në kontekstin e zhvillimit të sotëm shoqëror, do të lindte pyetja: “Kur arsimi është një e mirë private atëherë pse qeveritë janë kaq të angazhuara për të investuar në arsim dhe nuk e lënë këtë të mirë private në dorë të rregullimit të tregut të lirë konkurrencial?”

Përgjigjen e kësaj pyetje jemi të detyruar ta vendosim në një kontekst global të shoqërive kur raportet e të mirave publike dhe private ndërveprojnë intensivisht. Për këtë lidhje të dyfishtë arsimi krijon përfitime ekonomike e cilësore si për individin edhe për shoqërinë. Nëse do të radhisim disa nga përfitimet që kanë individët dhe shoqëria nga arsimi mund të listojmë:

Së pari përfitime private financiare të individit. Një investim në arsim, në çfarëdo lloj niveli të sistemit, do të thotë më shumë mundësi punësimi dhe më shumë të ardhura monetare për individin, që ka kryer investimin në arsimim.

Se dyti përfitime private, por jo financiare të individit. Një person i arsimuar përfiton, por jo vetëm në mënyrë të drejtëpërdrejtë prej dijës së tij. Niveli arsimor krijon kushte më të mira në punë, te sasi më të madhe të kohës së pushimit, përfitime të një shërbimi shëndetësor më cilësor, rritje të jetëgjatësisë etj

Së treti, përfitimi shoqëror nga arsimi. Rritja e nivelit arsimor rrit kapacitetet edhe të çdo komuniteti të përbërë nga njerëz të arsimuar. Me anë të arsimimit, grupet shoqërore rrisin të ardhurat, krijojnë profesione të reja, rrisin mobilitetin e punës, nxisin aftësitë sipërmarrëse, krijojnë novacione dhe transferojnë teknologji.

Të gjitha këto përfitime shoqërore, që krijohen nga arsimimi, na bëjnë të pranojmë se **arsimi është edhe një e mirë publike**.

Kështu arsimi që krijon sa përfitime private aq edhe përfitime publike dhe të bën të mendosh se kategorizimi i prerë i arsimit, si një e mirë private apo publike bëhet edhe më e paqartë.

Konfuzioni, në termat privat e publik për arsim, mëe tepër lidhen me paqaratësinë rreth pronësisë dhe statusit ligjor të institucioneve arsimore, sesa me llojin e produktit që këto dy sektorë prodhojnë. Në fakt outputi i sektori arsimor nuk ka dallime. Të gjithë institucionet arsimore, të arsimit të lartë prodhojnë “dije” si mësim dhe mësimdhënie, shërbime të kërkimit shkencor, në nivel kombëtar e ndërkombëtar, diploma, tituj shkencorë dhe certifikata graduimi. Të gjitha këto produkte e shërbime janë sa publike dhe aq private.

Ky tipar universal i produktit të sistemit arsimor krijon një efekt pozitiv të shumëfishtë në sistemin ekonomik. Këto efekte, ose ato që ekonomistët i quajnë eksternalitete, të cilat shfaqen, si në nivelin mikroekonomik edhe në atë makroekonomik.

I gjithë ky diskutim përbën background-in teorik, i cili ka mbështetur dhe mbështet të gjitha përpjekjet që janë bërë në dekadat e fundit për të financuar investimet në arsim dhe sidomos në arsimin e lartë. Në shkallë botërore, në të gjitha vendet, ka një rritje të dukshme, si në fondet private e publike, të shpenzuara në arsim ashtu edhe në numrin e të regjistruarve në sistemin arsimor.

Për të vlerësuar cilësinë e përdorimit të këtyre shpenzimeve, mund të shtrojmë pyetjen: A ndikojnë shpenzimet më të larta, në një cilësi më të mirë të arsimit?

Përgjigja e kësaj pyetje, shumë shpesh, është mjaft kontradiktore. Shumë nga teoritë e rritjes e konsiderojnë kapitalin njerëzor, të krijuar nga arsimi i lartë, motorrin kryesor të rritjes së produktit kombëtar dhe mirëqënies. Por nga ana tjetër, ka edhe studime të tjera (Hanishek 1997, Psacharopoulos 2007), të cilat provojnë se ndikimi i rritjes së shpenzimeve të arsimit në rritjen ekonomike, sidomos në vendet në zhvillim, por edhe në ekonomitë europianolindore në tranzicion, është relativisht i kufizuar.

Shpjegimi që mund t'i jepet efektit të ndryshëm, që vjen nga përdorimi i shpenzimeve për arsim nuk mund të jetë shkalla e zhvillimit të tregut në të cilin produkti i sektorit arsimor do të shitet. Outputi i sistemit të arsimit të lartë, kapitali njerëzor është një produkt i orientuar nga tregu pavarësisht, nëse ky produkt krijohet nga një pronësi publike apo pronësi private.

Sasia e institucioneve të arsimit të lartë (publike apo private) dhe politikat e arsimit të lartë janë dy inpute të rëndësishme, për të prodhuar ofertën e këtij tregu që është në cdo rast privat. Kërkesa, për dije treg krijohet nga shkalla e zhvillimit të sektorëve bazë të ekonomisë dhe matet me aftësinë, që kanë sektorët ekonomikë për të absorbuar dije. Një ekonomi e pazhvilluar nuk arrin, që ofertën e krijuar të dijes, të mund ta absorbojë në dobi të zhvillimit të rritjes ekonomike.

Deri tani politikat publike në sektorin e arsimit kanë qenë të përqendruara në

zhvillimin dhe reformimin e ofertës për dije dhe arsim. Në të vërtetë, gjithë procesi për të reformuar sektorin e arsimit të lartë, duhet të përqendrohet zhvillimin e tregut të produktit të arsimit universitar. Njerëzit e arsimuar, me dijet dhe aftësitë që ata kanë fituar në shkollë, duhet të verifikohen, kur ata të dalin në tregun e punës. Ballafaqimi me tregun vlerëson vlefshmërinë e dijeve të tyre, cilësinë e tyre dhe përshtatshmërinë e këtyre dijeve, me kërkesat e tregut të punës.

Në një ekonomi dinamike, me mundësi të mëdha, për investime në të ardhmen, do të krijonte më shumë nxitje për të gjithë palët e interesuara për një sistem arsimor cilësor. Perspektivat e zhvillimit do të nxisin studentët, që të kërkojnë të studiojnë gjithnjë e më shumë. Prindërit do të jenë të interesuar të monitorojnë një sistem arsimor cilësor dhe pedagogët do të jenë nën një presion, për të rritur cilësinë e tyre të mësimdhënies.

Mendoni situatën në një ekonomi stanjante, pa nxitje për të investuar në të ardhmen dhe pa një perspektivë dinamike. Në këto kushte, studentët do të ndjekin gjithnjë e më pak klasat e mësimi, e do të kërkojnë të rrinë më gjatë në sistemin arsimor. Prindërit do të jenë më të interesuar që t'i dërgojnë fëmijët e tyre në punë sesa të rrinë në një universitet, që nuk do t'ju siguronte një diplomë konkurruese dhe pedagogët nuk do të kenë asnjë nxitje për t'u kualifikuar.

Lidhja e dinamikave të arsimit të lartë, me tregun e punës dhe të profesioneve do të krijonte nxitje gjithnjë e më të mëdha për një sistem arsimor dinamik dhe eficient.

Nëse do të duhen nderhyrje publike në sistemin e arsimit të lartë, unë do të mendoja se ato do të ishin më eficiente e afatgjatë, nëse do të orientoheshin politika të studiuara në investime e në teknologji, zhvillimin e profesioneve të reja dhe në lehtësimin e informacionit midis biznesit e institucioneve universitare.

Me anë të këtyre ndërhyrjeve të tërthorta, fondet publike do të inkurajonin konkurrencën e ndershme midis institucioneve të arsimit të lartë, pavarësisht nga pronësia publike apo private mbi Universitetet.

1. Finacimi i arsimit të lartë: Sektori publik dhe ai privat i financimit të arsimit të lartë

Fillimisht mendojmë të qartësojmë se çfarë kuptohet realisht me sektorin publik dhe atë privat, në arsimin e lartë. Dallimi konceptual i universiteteteve publike nga ato private shpesh herë nuk është i qartë dhe i thjeshtë. Në vendet e Europës Lindore, të cilët kanë një eksperiencë modeste në këtë fushë, ndryshimi midis universiteteteve publike dhe private, bazohet drejtpërdrejtë tek mekanizmi, sipas të cilit ato funksionojnë: janë fitimprurëse apo jo. Ndërsa eksperinca e vendeve të zhvilluara perëndimore dhe veçanërisht e SHBA-së, dallimin midis këtyre institucioneve e

mbështet më shumë në mënyrën sesi realizohet vendimmarrja e tyre, nëse ajo bëhet në mënyrë të centralizuar, nga organet qeverisëse, apo bëhet nga një trupë e caktura, e cila drejton universitetin, (psh. Senati, Këshilli drejtues, etj). Kështu, sipas OECD universitetet publike konsiderohen ato institucione të arsimit të lartë, drejtimi i të cilave kryhet nga një organizëm publik, i cili në përgjithësi emërohet nga qeveria. Ndërsa universitetet private janë ato institucione, të cilat drejtohen dhe organizohen nga një bord drejtues, në përgjithësi, jo i emëruar nga organet e qeverisë. Këtu dëshirojmë të theksojmë, se sipas këtij përcaktimi, universitetet private funksionojnë më shumë në formën e organizatave jo fitimprurëse. Pra dallimi midis publikut dhe privatit, në arsimin e lartë, megjithëse mbështetet në dallimin e formës së pronësisë, nuk është i njëjtë me atë që kemi në sektorët e aktiviteteve të tjera ekonomike. Në arsim, ky dallim është i përafërt me dallimin, që kanë dy sektorët e veçantë institucional të ekonomisë: sektori i institucioneve të administratës publike dhe ai i institucioneve sociale private (jo fitimprurëse). Nga ana tjetër, prona private, mbi të cilin mbështeten, i ka kthyer disa universitete private edhe në qendra të biznesit; dhe kjo vihet re, jo vetëm në vende të zhvilluara si psh SHBA-ja, etj, por edhe në vendet e Europës Lindore. Në këtë këndvështrim, këto universitete ngjasojnë më shumë me institucionet fitimprurëse. Shihet se dallimi publik – privat, në arsim, nuk është aq i thjeshtë sesa në sektorët e tjerë; këtu, në sektorin privat, mund të kemi organizata jofitimprurëse, por edhe fitimprurëse.

Por, pavarësisht nga kjo, duke ruajtur përcaktimin e OECD, për dallimin midis universiteteve publike dhe private dhe duke u interesuar më shumë në aspektin e financimit të universiteteve, mund të evidentojmë këtë fakt: në universitetet publike shërbimi i arsimit si dhe financimi i tij i ofrohen studentit, por duke mos qenë drejtpërdrejt, nën kontrollin e tij. Siç treguam më sipër, në universitete publike vendimmarrja bëhet nga organet qendrore qeverisëse dhe të emëruarit prej saj. Nga ana tjetër edhe financimi kryhet nga fondet publike, mbi bazën e taksimit të përgjithshëm. Ndërsa, në universitetet private, studenti dhe financimi, që vjen prej tij, mund të zgjedhë midis formave të ndryshme të ofertës për arsim, duke qenë, në këtë mënyrë, më aktiv ndaj shërbimit dhe cilësisë së ofruar.

2. Modelet kryesore të financimit të arsimit të lartë

Megjithëse mund të diskutojmë mbi dy mënyrat kryesore të financimit të arsimit të lartë, sistemet e arsimit në vendet e industrializuara karakterizohen nga një ndërthurje, midis arsimit publik dhe atij privat. Secili vend mund të ketë mënyrën e tij të organizimit të arsimit të lartë, me karakteristika të veçanta. Në përgjithësi çdo vend dallon për rrugën e zgjedhur dhe madje ndoshta është e vështirë të gjesh dy vende, të cilat zbatojnë në mënyrë rigorozë të njëjtin sistem.

Megjithatë, duke u nisur nga format e financimit të tyre, nëse janë ato kryesisht publike apo private, sot dallohen modelet kryesore të mëposhtme të sistemeve arsimore¹:

- Modeli europian, kontinental.

Sipas këtij modeli, universitetet janë institucione publike dhe financohen nga buxheti i shtetit. Senati i njëuniversiteti të tillë, i përbërë nga anëtarë të stafit akademik, ka një peshë të madhe në drejtimin e universitetit. Në vendet që aplikojnë këtë model, burimi kryesor i fondeve përcaktohet nga qeveria. Shpesh, në këto universitete janë të ingranuar dhe institucione kërkimore – shkencore, të cilët gjenerojnë të ardhura nga aktiviteti i tyre, por që nuk përbëjnë një burim të drejtpërdrejtë për financimin e procesit mësimor. Ndërtimi i këtyre universiteteteve trashëgon parimet e shtetit të mirëqënies sociale, të cilat e konsiderojnë arsimin si një e drejtë për cilindo. Mbi këtë bazë, në këto vende, studentëve u kërkohet të paguajnë farepak për studimet e tyre të larta, gjë që do të thotë se mundësitë për të financuar sistemin e arsimit të lartë përmes të ardhurave nga regjistrimet e studentëve janë tepër minimale. Kështu, financimi publik, në vendet e Bashkimit Europian (EU 19) për vitin 2006 zinte rreth 81,9% të totalit të shpenzimeve për arsimin e lartë, ndërsa ai i sektorit privat ishte rreth 18,9%². Graph 1 tregon peshën e shpenzimeve të sektorit publik dhe të atij privat, për disa vende Europiane.

Sektori publik, në arsim, është në vecanti i rëndësishëm në Norëey, ku në vitin 2009 ai zinte rreth 97,0% të shpenzimeve, për arsimin e lartë; Denmark 96,4%; Finland 95,5% dhe Belgium 90,6%. Ndërsa ai zë një peshë më të vogël, në Portugal 66,7%; Poland 70,4% dhe Itali 73,0%³.


Megjithëse, arsimi i lartë publik mbetet dominues në vendet europiane, duhet thënë se pesha e tij, relativisht, ka ardhur duke u ulur. Për vendet e EU 19, në tërësi, ndërsa në vitin 2000, ai zinte rreth 85,2 % të shpenzimeve, për këtë arsim, në 2006, kjo peshë ka rënë në 81,9%. Rritja e fondeve publike, për arsimin e lartë, në EU 19, në 2006, në krahasim me 2000, ishte rreth +25%, ndërsa ajo e fondeve private +108%.

¹ G. Psacharopoulos – *"Public versus Private University System"* CESifo DICE Report 4/2004.

² Including subsidies attributable to payments to educational institutions received from public sources.

³ Education on Glance 2009 – OECD Indicators

Grafiku 1: Shpërndarja e burimeve publike dhe private të fondeve për institucionet arsimore pastransferet nga fondet publike të vitit 2005 (%).



Source: Edukimi sipas Glance 2009 - OECD Treguesit dhe përllogaritja e autorit.

- Modeli amerikan, (SHBA dhe Kanada).

Sipas modelit amerikan, të SHBA, universitetet janë në pjesën më të madhe institucione private të arsimit të lartë. Kjo do të thotë se financimi i tyre vjen kryesisht nga pagesat për shkollim, donacionet apo kontributet e ndryshme dhe një pjesë më e vogël nga buxheti i qeverisë federale apo lokale. Një gjë e tillë sjell që edhe administrimi i këtyre universiteteve apo kolegjeve, të ketë në qendër titullarin, i cili njihet edhe si president i institucionit, si dhe të ashtuquajturin “board of trustees”.

Një tipar dallues i sistemit amerikan është se aktivitetet arsimore dhe ato kërkimore, në universitetet e këtij vendi, kanë qenë dhe janë të lidhura mjaft ngushtë midis tyre, dhe kjo që nga koha kur Presidenti Abraham Lincoln themeloi Akademinë Kombëtare të Shkencave më 1863 (Tarifa, F. 2010). Një lidhje e tillë institucionalisht organike midis mësimi dhe kërkimit ka mundësuar që idetë, stafet akademike si dhe resurset njerëzore e financiare të qarkullojnë më mirë midis universiteteve dhe sektorëve të tjerë të shoqërisë. Në vitin 2006, shpenzimet publike, në arsimin e lartë, në SHBA, zinin vetëm 34,0% të totalit, ndërsa ato të sektorit privat, pjesën dominuese, 66,0%. Ky organizim e ka bërë sistemin amerikan të arsimit të lartë, një nga më të sukseshmit. Sot, në Top 100, universiteteve më ekselente në botë, 31 janë universitetet e SHBA-së (2010).

I ngjashëm me sistemin e arsimit të lartë, në SHBA, është edhe ai i Kanadasë. Shkalla e privatizimit këtu është më e ulët se në SHBA, në vitin 2006, në Kanada shpenzimet publike, në arsimin e lartë zinin 53,4%, ndërsa ato të arsimit privat rreth 46,6%.

- Modeli Britanik (United Kingdom, Ireland) dhe ai Spanjoll.

Këto modele përfaqësojnë një formë të veçantë të universiteteve private. Ato dallohen si nga modeli amerikan, ashtu edhe nga ai evropian, pasi nuk janë ekzaktësisht as institucione shtetërore dhe as private. Ato janë institucione publike, të cilat mbështeten dhe subvencionohen nga qeveria, por nuk financohen krejtësisht prej saj. Financimi i tyre bëhet nga British Exchequer, një agjenci e veçantë qeveritare (e krijuar qysh në shekullin e 12-të nga Mbreti Henri I), përmes një procesi, i cili ruan një barrierë midis universiteteve dhe qeverisë, duke udhënë universiteteve britanike më shumë autonomi nga ajo që gëzojnë universitetet publike në Europë⁴. Në modelin britanik, tarifa për ndjekjen e studimeve është më e lartë se në universitetet e tjera evropiane. Njëkohësisht, tërheqja e stafëve akademike, më e xellente, është një tjetër karakteristike e sistemit UK. Në vitin 2006 shpenzimet publike, të arsimit të lartë në UK, zinin 64,8% ndërsa ato private 35,2% të totalit, pra larg nga niveli mesatar evropian. Rreth 75% e fondeve private të arsimit e përbënte kontributi i familjeve.

I ngjashëm me modelin britanik të financimit konsiderohet edhe sistemi spanjoll. Karakteristikat e këtij sistemi qëndrojnë kryesisht në decentralizimin e burimeve të financimit. Në këtë vend, roli i ministrisë përgjegjëse për arsimin, Ministry of Science and Innovation, në aspektin finaciari është i limituar dhe kjo përgjegjësi i është lënë Komunave Autonome, gjë që sjell shpesh diferencime në alokimin e burimeve nga një komune në një tjetër⁵.

- Modeli japonez dhe ai australian.

Ky model konsiderohet si lider në fushën e privatizimit të sistemit arsimor, pra është ekstremi tjetër krahasuar me sistemin kontinental. Ashtu sikurse në vendet e tjera të Azisë Lindore, edhe në Japoni ekziston një traditë karakteristike për financimin e arsimit të lartë nga familja⁶. Në kuptimin fiskal kjo gjë pasqyrohet në rolin kryesor që luan familja në financimin e arsimit të lartë, krahasuar kjo me rolin modest të shpenzimeve publike. Në vitin 2006 financimi i sektorit privat zinte 67,1% të totalit të shpenzimeve për arsimin e lartë, ku 51,4%, pra më shumë se gjysma, ishte financimi i familjeve. Ndërsa financimet publike zinin në të njëjtin vit vetëm 32,2% të totalit. Me këtë strukturë financimi, për nga pesha e sektorit privat në arsimin e lartë, sistemi japonez ndodhet ndër vendet e OECD-së i dyti, vetëm pas Koresë, ku financimi i sektorit privat kap rreth 76,9% të shpenzimeve për arsimin e lartë (2006). Roli signifikant i sektorit privat ka bërë nga ana tjetër që në Japoni t'i kushtohet një vëmendje e veçantë licensimit

⁴ F. Tarifa – “*The American Triumph*” – MAPO 22.07.2010.

⁵ P. Santiago, J. J. Brunner, G. Hang, S. Malo, P. Pietragiacomo – *OECD Reviews of Tertiary Education – Spain*; 2009

⁶ H. Newby, Th. Weko, D. Breneman, Th. Johanneson, P. Maasen – *OECD Reviews of Tertiary Education – Japan*; 2009

të universiteteve private, në mënyrë që të sigurohet që në treg të funksionojnë vetëm ato institucione, të cilat plotëojë në mënyrë të qartë kriteret cilësore të përcaktuara nga shteti.

I ngjashëm është edhe modeli i financimit të arsimit të lartë në Australi. Australia bën pjesë në grupin e vendeve, ku financimet private në arsim zenë pjesën më të rëndësishme, në vitin 2006 rreth 52,4% të shpenzimeve, në arsimin e lartë, e përbënin financimet private dhe vetëm 47,6% ato publike.

Por “kampioni” në drejtim të privatizimit të arsimit të lartë, gjykuar kjo mbi bazën e strukturës së shpenzimeve, publike apo private, sot e përbën Kili. Në sistemin kilian të arsimit të lartë, 83,9% të shpenzimeve financohen nga sektori privat dhe vetëm 16,1% nga ai publik. Mund të nënvizojmë këtu se edhe reforma e financimit të arsimit të lartë e cila po diskutohet në Shqipëri është mbështetur pikërisht në këtë model.

Katër modelet kryesore të financimit të arsimit të lartë, trajtuar më sipër, në mënyrë të sintetizuar, mund t’i klasifikojmë në këtë mënyrë: **a.** modeli kontinental, i bazuar kryesisht në universitetet publike; **b.** modeli britanik dhe ai spanjoll, i cili qëndron midis sektorit publik dhe atij privat; **c.** modeli amerikan, kryesisht institucione private të arsimit të lartë dhe **d.** modeli japonez dhe ai australian, të cilët përbëjnë ekstremin privat të institucioneve të arsimit të lartë. Sigurisht, nisur nga mënyra e financimit, këto modele paraqesin edhe një formë të caktuar të konceptimit të zhvillimit të arsimit, nëse duhet ai të mbështetet në financimin publik të të gjithë shoqërisë, apo duhet menduar më shumë si një shërbim, i cili lidhet me individin. Mbi të gjitha këto modele shtrojnë pyetjen: cila formë është më e mira, në drejtim të cilësisë të cilin ajo ofron?

Përgjigja këtu nuk është e thjeshtë, pasi në cilësinë e arsimit të lartë, nuk ndikon vetëm mënyra e financimit. Deri në mesin e shekullit të kaluar, universitetet europiane ishin qendra të ekselencës në arsim, por nga 50-60 vitet e fundi ky trend ka ndryshuar në drejtim të universiteteve amerikane. Megjithëse shkaqet e këtij ndryshimi janë mjaft komplekse, korelacioni midis midis privatizimit dhe nivelit akademik mund të evidentohet qartë. Kështu, duke qenë në elitën e universiteteve, në rrafshin global, universitetet amerikane konsiderohen edhe si shembull në fushën e privatizimit.

Tabela 1 praqet 100 Top universitetet për vitin 2010, sipas modeleve arsimore të paraqitura më sipër, si dhe përqindjen që zenë financimet private, për arsimin e lartë ndaj totalit të tyre. Megjithëse, siç theksuam, në cilësinë e arsimit të lartë ndikojnë edhe shumë faktorë të tjerë, tabela tregon në përgjithësi, një korelacion pozitiv midis universiteteve të mbështetura në financimin privat dhe numrit të tyre në Top 100.

Tabela 1. 100 Universitetet më të mira në Botë për 2010 dhe pjesa e shpenzimeve private në Arsimin e Lartë.

MODELI	Pjesa e shpenzimeve private në Arsimin e Lartë (%)	Radhitja e 100 Universiteteve më të mira
(1)	(2)	(3)
<u>Kryesisht Publike (Europiane)</u>		<u>21</u>
Belgjika	9,4%	1
Danimarka	3,6%	2
Finlanda	4,5%	1
Franca	16,3%	2
Gjermania	15,0%	5
Holanda	15,7%	4
Norvegjia	3,0%	1
Suedia	10,9%	2
Zvicra	Na	3
<u>Pjëserisht Publike dhe Private</u>		<u>20</u>
Britania e Madhe	35,2%	19
Irlanda	14,9%	1
Spanja	21,8%	0
<u>Kryesisht Private (Amerikane)</u>		<u>35</u>
SHBA	66,0%	31
Kanada	46,6%	4
<u>Në proces privatizimi</u>		<u>12</u>
Japonia	67,8%	5
Australia	27,6%	7
<u>Të Tjerë</u>		<u>12</u>

Burimi: “Rankings of Top 100 Universities in the World 2010” <http://www.university-list.net/index.htm> & “Education on Glance 2009” – OECD Indicators (data for 2006).

3. Financimi privat apo publik: argumentat dhe tendencat

Pavareësisht se universitetet apo kolegjet private përbëjnë elitën e universiteteve më të njohura, universitetet publike vazhdojnë të jenë në tërësi, baza e arsimit të lartë. Nga ana tjetër diskutimi mbi mënyrën e financimit të arsimit të lartë, nëse duhet t’i jepet më shumë peshë investimit privat apo duhet ai të mbetet kryesisht publik, ka përbërë gjithnjë një nga debatet më të mprehta të tij. Argumentet janë

shpesh kontradiktore. Ato sillen në përgjithësi, rreth pyetjes nëse arsimi i lartë është një e mirë për shoqërinë në tërësi, apo duhet ai të konsiderohet kryesisht si një e mirë individuale. Teorikisht mbështetja apo subvencionimi publik i një aktiviteti të caktuar, mund të argumentohet me faktin, që ky aktivitet të përbëjë një të mirë publike. Të mira të tilla siç dihet duhet të zotërojnë dy karakteristika kryesore: të jenë jo rivalë (no rival) dhe jo përjashtuese (non excludable). Në fakt arsimi nuk ka asnjë nga këto karakteristika: ai nuk është jo rival në “konsumin” e tij, përderisa numri i nxënësve, apo studentëve, sidoqoftë është i kufizuar; gjithashtu nuk është jo përjashtues, pasi është e lehtë të pengosh përfitimin e këtij shërbimi nga një individ i caktuar. Në këtë këndvështrim arsimi, në përgjithësi, konsiderohet më shumë si një e mirë private, sesa një e mirë publike. Atëherë, cilat janë disa nga argumentet kryesore pro apo kundër financimit publik të arsimit të lartë?

- Barazia sociale.

Arsimi i lartë konsiderohet si një e drejtë të cilën shoqëria duhet t’ia ofrojë çdo anëtar i saj, pavarësisht nga të ardhurat që ai disponon. Një gjë e tillë, madje, shpesh sanksionohet edhe në kushtetutën e mjaft vendeve. Sigurimi i të drejtave të barabarta, në arsimin e lartë, pavarësisht nga të ardhurat, sigurisht është në favor të universiteteve publike, pasi individët me të ardhura më të pakta, mund të mos përballjnë dot koston e universiteteve private. Ky argument, në favor të arsimit publik, është më shumë social sesa ekonomik, pasi ai merr parasysh më shumë drejtësinë sociale sesa efikasitetin ekonomik.

Megjithatë, disa studiues, (S. Blöndal, S. Field, N. Girouard, 2002; dhe P. Tsakloglou, M. Antoninis, 1999), argumentojnë se sigurimi i kësaj të drejte është shpesh një iluzion. Ky argument mbështetet në dy aspekte: së pari, financimi i arsimit publik bëhet nëpërmjet taksimit të përgjithshëm, i cili në fakt nuk lidhet drejtpërdrejtë me arsimimin e individëve, megjithëse sistemi fiskal mund të jetë progresiv; së dyti, studimet tregojnë se përfituesit kryesorë të arsimit publik janë shtresat e popullsisë me të ardhura më të larta. Megjithëse e drejta për arsim mund të jetë “pa kosto”, shpenzimet që duhen për të ndjekur vitet e shkollimit, në raport me të ardhurat e individëve janë relativisht më të larta për familjet me më pak të ardhura sesa ato me më shumë të ardhura (Psacharopoulos and Papakonstantinou 2005). Në këtë mënyrë, nëpërmjet të drejtave të barabarta për të ndjekur arsimin publik, në fakt krijohet një rishpërndarje e të ardhurave në favor të shtresave më të pasura.

- Arsimi si një eksternalitet pozitiv.

Një tjetër argument për mbështetjen publike të arsimit të lartë është edhe fakti se ai konsiderohet si një aktivitet, i cili shoqërohet me një eksternalitet pozitiv për shoqërinë në tërësi. Një aspekt i rëndësishëm i këtij eksternaliteti është fakti, se rritja e nivelit arsimor shërben si një mundësi për rritjen e nivelit të demokratizimit

dhe civilizimit të shoqërisë në tërësi. Glaeser, Ponzetto dhe Shleifer, në punimin e tyre “*Why Does Democracy Need Education*”⁷ në mënyrë empirike argumentojnë se ekziston një korrelacion i caktuar midis nivelit të arsimit dhe qeverisjes demokratike. Gjithashtu D. Acemoglu (2005) konsideron se demokracia ka një lidhje korrelacioni me numrin mesatar të viteve të arsimit, vendet që kanë mesataren më të lartë të viteve në arsimin, janë edhe më demokratike. Sigurisht, duhet të theksojmë se në nivelin civilizues dhe demokratik të një shoqërie ndikojnë dhe faktorë të tjerë, por studimet e kryera nëse mund të shihen me kujdes, kur bëhen krahasime midis vendeve, ato janë krejtësisht të argumentuara nëse shihen brenda të njëjtit vend.

Por një aspekt tjetër i rëndësishëm i arsimit, si një eksternaliteti pozitiv, evidentohet edhe në drejtim të përfitimit ekonomik që i sjell ai, jo thjesht individit, por edhe shoqërisë në tërësi. Në mjaft statistika të OECD evidentohet se investimi në arsim shoqërohet me përfitime si private ashtu edhe sociale. Në tabelën 2 jepen përfitimet neto private dhe publike sipas vendeve të OECD.

Table 2: Vlera Private dhe Publike neto (në USD) për një individ në përfitimin e Arsimit të Lartë (2005)

Vendet	Private Benefits		Public Benefits	
	Male	Female	Male	Female
Australia	48.714	61.374	47.368	31.357
Austria	60.519	42.915	37.586	25.911
Belgjika	63.414	60.792	96.186	81.858
Kanada	69.235	45.365	23.875	12.839
Republik Çeke	146.673	80.418	160.834	29.239
Danimarka	7.342	11.983	14.236	-22.702
Finlanda ¹	64.664	26.392	55.612	24.003
Franca	40.260	-1.908	36.730	40.903
Gjermania	48.024	10.450	63.604	13.554
Hungaria	127.691	43.432	94.804	63.921
Irlanda ¹	104.410	78.158	74.219	46.027
Italia ¹	173.889	25.806	63.756	32.887
Korea ²	85.586	129.516	21.280	13.752
Zelanda e Re	40.036	33.571	28.193	13.732

⁷ E. L. Gleaser, G. A. M. Ponzetto and A. Schleifer - “*Why Does Democracy Need Education*” - NBER Working Paper No. W12128; April 2006

Norvegjia	23.306	34.032	17.851	-1.116
Polonia	146.539	84.266	57.221	33.925
Portugalia	186.307	123.357	50.271	66.975
Spanja ¹	55.695	73.495	19.752	21.012
Suedia	18.802	5.097	17.197	-10.923
Turqia	41.090	47.695	10.346	12.255
SHBA	169.945	75.492	100.119	43.469
Mesatarja për çdo vend	82.007	51.986	51.954	27.279

Burimi: *Education on Glance 2009 – OECD Indicators*

1. Year of reference 2004.

2. Year of reference 2003

Në këto llogaritje përfitimi neto privat, apo ai social, tregon sesa janë përfitimet neto nga një individ, i cili kryhen arsimin e lartë, duke marrë parasysh shpenzimet gjatë viteve të arsimimit dhe përfitimet bruto gjatë gjithë jetës së tij. Shihet se përfitimi publik neto, mesatarisht për meshkuj i kalon 50.000 USD, ndërsa për femrat është më shumë se 27.000 USD për student. Duke marrë parasysh shpenzimet publike direkte për student, të cilat janë mesatarisht 21.003 USD për meshkujt dhe 20.970 USD për femrat⁸, shihet se përfitimi publik neto për meshkujt është rreth dy herë më shumë sesa shpenzimi i kryer, ndërsa për femrat diferenca është më e vogël.

Këto të dhëna janë një argument për subvencionimin e arsimit të lartë nga ana e sektorit publik. Nga ana tjetër shihet se përfitimi neto privat, është edhe më i konsiderueshëm se ai publik. Kështu mund të shtrohet edhe pyetja, për derisa ekziston një stimul dhe nxitje e vetë individit për kryerjen e studimeve të larta, a duhet konsideruar subvencioni i arsimit të lartë si rruga më e mirë për të “rregulluar” këtë eksternalitet?

- Argumente të tjerë për mbështetjen e arsimit publik.

Përveç argumenteve kryesorë të përmendur më sipër, zhvillimi i arsimit të lartë shpesh argumentohet edhe me faktorë të tjerë. Një prej tyre është për shembull mosfunksionimi i tregut për marrjen e kredive për qëllime studimi (H. S. Rossen, T. Gayer 2009). Kjo për faktin se kapitali human nuk përbën një kolateral për marrjen e kredive. Në këtë mënyrë argumentohet edhe mbështetja publike me kredi, për kryerjen e studimeve të larta, e cila nuk është e njëjtë me subvencionim klasik të këtij arsimi.

Po kështu, argument për arsimin publik është edhe mungesa e informacionit nga individët për mundësitë e gjetjes së punës pas përfundimit të studimeve (G.

⁸ *Education on Glance 2009 – OECD Indicators.*

Psacharopoulos 2004). Në këtë drejtim arsimit publik mendohet se mund të orientojë më mirë studentët nëpërmjet kuotave që ai mund të përcaktojë për çdo degë. Por edhe këtu pyetja shtrohet nëse vetë qeveria a mund të përlllogarisë saktë vendet e punës sipas profesioneve. Faktet tregojnë se shpesh herë numri i të drejtave të studimit në sektorin publik, sidomos në degët ku investimet kapitale nuk janë të konsiderueshme, merr parasysh më shumë kërkesat për studim sesa nevojat reale të ekonomisë.

- Problemet dhe tendencat në financimin e arsimit publik.

Faktorët e mësipërme argumentojnë nevojën e financimit publik të arsimit të lartë. Megjithatë, qoftë në aspektin teorik, këto argumente lënë vend për diskutim. Nga tjetër, jashtë trajtimeve të mësipërme teorike, zhvillimi i arsimit publik duhet të marrë parasysh edhe mundësitë reale që disponon një ekonomi, burimet financiare.

Në këtë drejtim, karatersitikë e përgjithshme e arsimit, në mjaft vende është rritja e konsiderueshme e kërkesës për të, ai konsiderohet si një nga sektorët dhe aktivitetet ekonomike me “boom-in” më të madh në vitete e fundit. Kështu në SHBA, shpenzimet e qeverisë federale dhe të shteteve të veçanta për arsim tejkalojnë shumën prej rreth 750 milion USD (2009).

Në vendet e OECD përqindja e hyrjes (entry rate) të nxënësve që mbarojnë shkollën e mesme (secondary education), në shkollën e lartë (tertiary education), nga viti 1992 në 2005, është rritur mesatarisht rreth 20%, duke shkuar nga 37% në 55%. Në vitin 2007 në disa vende si në Australi, Finlandë, Suedi, Poland etj, kjo përqindje ishte mbi 70% (tabela 3).

Table 3: Normat e pranimit në Arsimin e Lartë për disa vende (në %) (1995-2007)

	1995	2000	2001	2002	2003	2004	2005	2006	2007
Australia	na	59	65	77	68	70	82	84	86
Finlanda	39	71	72	71	73	73	73	76	71
Hungaria	na	64	56	62	69	68	68	66	63
Islanda	na	66	61	72	83	79	74	78	73
Korea	41	45	46	46	47	49	51	59	61
Zelanda e Re	83	95	95	101	107	86	79	72	76
Norvegjia	59	67	69	75	75	72	76	67	66
Polonia	36	65	68	71	70	71	76	78	78
Slovakia	28	37	40	43	40	47	59	68	74
Suedia	57	67	69	75	80	79	76	76	73
SHBA	na	43	42	64	63	63	64	64	65

Kili	na	na	32	33	33	34	48	43	41
OECD Mesatare	37	47	48	52	53	53	55	56	56
EU19 Mesatare	35	46	47	49	50	52	53	55	55

Burimi: *Education on Glance 2009 – OECD Indicators*

Një tendencë e tillë vihet re jo vetëm në vendet e zhvilluara, por edhe për vendet në zhvillim. Kjo karakteristikë shprehet qartë edhe në rritjen e indeksit të përgjithshëm të *enrolment rate*, i cili paraqet përqindjen e nxënësve dhe studentëve aktualë në të gjitha nivelet e arsimit, ndaj atyre potencial. Sipas Bankës Botërore, në raportin e saj të fundit, për të gjitha vendet në zhvillim ky tregues është rritur nga 81% në 1996 në 86% në vitin 2006.

Një rritje e tillë e kërkesës për arsim shpjegohet në tërësi si me rritjen e popullsisë, ashtu edhe me kërkesat për një vend pune më të stabilizuar, për më shumë mobilitet në tregun e punës, për paga më të mira, etj. Gjithashtu zhvillimi i arsimit konsiderohet si një nga rrugët kryesore për transformimin cilësor të shoqërisë, rritjen e mirqënies, sigurimin e një zhvillimi të qëndrueshmë, reduktimin e varfërisë, etj.

Nga ana tjetër, të dhënat tregojnë rritjen graduale të shpenzimeve për një student (per capita). Për vendet e EU 19 shpenzimet mesatare për student në vitin 2006 janë rritur rreth 11%, ndërsa për vendet e OECD rreth 13%.

Megjithë rritjen në masë absolute, pesha e shpenzimeve publike për arsimin e lartë në përqindje ndaj GDP si dhe ndaj totalit të shpenzimeve publike, ka mbetur pothuajse e pandryshuar. Kështu, mesatarisht ndaj GDP, shpenzimet për arsimin e lartë për vendet e EU 19 dhe për ato të OECD, në 2006 ka qenë përkatësisht 1,3% dhe 1,4%; ndërsa ndaj totalit të shpenzimeve publike, kjo peshë zinte përkatësisht 2,9% dhe 3,1%.

Në këtë këndvështrim, mund të nënvizohen tre faktorë kryesorë të cilët karakterizojnë financimin e shpenzimeve për arsimin e lartë:

- Rritja signifikante e kërkesës për arsimin e lartë.
- Rritja e shpenzimeve për një student.
- Kufizimet buxhetore në financimin e arsimit publik.

Të tre këto faktorë kanë rritur kërkesën për financime të arsimit të lartë, duke e konfrontuar atë me buxhetet e kufizuara dhe duke vënë në vështirësi ekonomike mjaft vende, qofshin këto edhe të zhvilluara.

Cila mund të ishte rruga kryesore për të përballuar këto tendenca dhe vështirësi? Mjeti kryesor në këtë drejtim konsiderohet zhvillimi i arsimit privat krahas atij publik. Sipas Bankës Botërore partnerhipi midis sektorit publik dhe atij privat është rruga kryesore për t'ju përgjigjur nevojave gjithnjë në rritje për arsim. *World Economic*

Forum i organizuar në Prill të viti 2010 në Kolumbi⁹, theksoi edhe njëherë nevojën e angazhimit të sektorit privat në fushën e arsimit, nëpërmjet një partnershipi më të mirë, me qëllim rritjen e numrit të të arsimuarve, nxitjen e zhvillimit të njohurive dhe transformin e tyre në prosperitet.

Rrugët kryesore për angazhimin e sektorit privat në arsim mund të jenë dy:

Së pari është ajo e investimeve të drejtpërdrejta të sektorit privat në arsim. Ky drejtim ka të bëjë me trajtimin teorik dhe praktik të mekanizmit të tregut edhe në arsimin e lartë. Qëllimi i adoptimit të mekanizmave të drejtpërdrejtë të tregut mund të synojë objektiva të ndryshëm, ndër të cilat më të rëndësishmet mund të përmenden:

a) mbulimi i kërkesës për arsim të lartë në degë të caktuara; b) gjenerimin e burimeve financiare suplementare në arsimin e lartë; c) përmirsimi i cilësisë së mësimdhënies; d) rritjen e efikasitetit dhe të produktivitetit në arsimin e lartë nëpërmjet konkurrencës¹⁰.

Rruga e investimeve të drejtpërdrejta private në arsim është karakteristike për Japoninë, Korenë si dhe SHBA dhe Kanadanë. Në Japoni 90% e *junior colleges* dhe *professional training colleges* janë private, ndër të cilat afërsisht 78% janë universitete. Në Kore, rreth 85% e universiteteve janë private, gjithashtu në Kinë tendenca e tregut të arsimit të lartë është në zgjerim të vazhdueshëm. Zhvillimi i sektorit privat të arsimit në SHBA ka arritur sot përmasa të bizneseve gjigande, në kuptimin e plotë të këtij termi. Sipas EIA (*Education Industry Association*) arsimi përfaqëson në këtë vend një nga bizneset më të qëndrueshme, duke kapur shifrën e afërt me 1 trilion USD. Në SHBA “industria” e arsimit përfaqëson rreth 10% të GDP-së, duke u renditur e dyta në aktivitetin ekonomik pas shëndetësisë. Krahas formave klasike të universiteteve dhe kolegjeve private, ky zhvillim pasqyrohet dhe në rritjen e korporatave të vërteta, që veprojnë në sferën e arsimit. Kështu mund të përmendet për shembull “*DeVry University*” në Illinois me 90 filiale në SHBA dhe Kanada; “*Estacio Participacoes SA*” në Brazil, një holding kompani e përbërë nga 6 organizata fitimprurëse në fushën e arsimit dhe kualifikim; “*Apollo Group*” me një aktivitet të gjerë në fushën e edukimit, trajnimeve dhe arsimit; “*Illinois-based Career Education*” e shtrirë në SHBA; Britaninë e Madhe; Francë dhe Itali, duke operuar në fushën e arsimit pas atij të mesëm; ndërsa në rajonin e Azisë përmendet “*Raffles Education*” në Singapor, e cila operon me 34 kolegje të arsimit të lartë, në 31 qytete të 12 vendeve të ndryshme të rajonit.

Së dyti, rrugë tjetër e tërheqjes së investimeve private në arsim është edhe ajo e reformës së financimit të shpenzimeve publike. Spektri i këtyre reformave

⁹ World Bank - *World Economic Forum – 2010*; Cartagena, Colombia 6-8 April 2010

¹⁰ F. Kaiser - “*Market type mechanisms in higher education: a comparative analysis of their occurrence and discussions on the issue in five higher education systems*”, CHEPS report / Higher Education Monitor Thematic report -1999.

është mjaft i gjerë¹¹, por të gjitha këto reforma mbështeten në harmonizimin sa më të mirë të interesave të të gjithë aktorëve që përfitojnë nga arsimi i lartë, duke synuar zgjerimin e mundësive për involvimin e arsimit privat, brenda standartëve të caktuar, në mbështetjen financiare të arsimit të lartë. Baza teorike e tyre mbështetet në trajtimin që bëme më lart: ofrimi i arsimit publik është një detyrim shoqërisë, por njëkohësisht edhe një e mirë me karakter “privat”. Ky detyrim shtrihet në kufij të caktuar, siç mund të jenë për shembull ciklet e arsimit të ulët, apo të mesëm, nevojat e shtresave në vështirësi ekonomike, etj. Më tej, ky shërbim “publik” merr karakterin e një të mire me karakter “privat”, që e diferencon mirëqënien e një individi nga një tjetër. Në këtë këndvështrim ofrimi i arsimit publik, e në veçanti të arsimit të lartë, synon sot të tërheqë në financimin edhe sektorin privat e individin. Le të shohim për shembull transformimin themelor të sistemit të arsimit të lartë, të mirë njohurin “Sistem i Bolonjës”.

Thelbi i tij qëndron në përshtatjen më të mirë të sistemit arsimor, ndaj nevojave të tregut. Por a ka ky transformim impakt edhe në aspektin financiar. Sigurisht që po. Më parë, cikli i arsimit të lartë normalisht ishte 4 vjet, të cilat financoheshin kryesisht nga sektori publik. Sot, me sistemin e Bolonjës, vetëm 3 vitet e para, pra një më pak, (diploma “*bachelor*”), mund të konsiderohet si një shërbim, të cilin shoqëria duhet t’ia ofrojë të gjithë individëve. Pas kësaj, kryerja e diplomave master apo të doktoraturës, vlerësohet si një e mirë “private”, që lidhet me individin. Për këtë arsye edhe kryerja e tyre, parashikohet me një kontribut të caktuar edhe të individit, duke realizuar kështu në fakt një bashkëfinancim publik – privat.

Reformat e financimit të arsimit të lartë mbështeten më shumë në sharing të kostove të shkollimit midis: qeverisë (nëpërmjet taksimit të përgjithshëm); familjeve; studentëve dhe donatorëve të mundshëm (sektori privat). Tendencia e përgjithshme në këtë bashkëfinancim është rritja e peshës së burimeve të sektorit privat dhe zvogëlimi i asaj të sektorit publik. Kështu, në Japoni, pesha e financimit të sektorit privat ndaj totalit të financimeve, për arsimin e lartë, nga rreth 61% , në vitin 2000, arriti në rreth 68%, në vitin 2006, në Kanada nga 39% , (2000) u rrit në 45% (2006), në Mbretërinë e Bashkuar nga 31%, në 33%, ndërsa, në Gjermani nga 11%, në 13%. Për vendet e OECD –së të marra së bashku, financimet e sektorit privat, për të njëjtën periudhë 2000 -2006, u rriten nga 21% në 26% të totalit¹².

¹¹ P. Santiago; K. Tremblay; E. Basri; E. Arnal – *Tertiary Education for Knowledge Society* – OECD Thematic Review of Tertiary Education; Volume 1, 2008

¹² *Education on Glance 2008 & 2009 – OECD Indicators.*

Bibliografia

- Arellano Marin, J. P. 2001. Education reform in Chile CEPAL Review 73, 2001
- Gleaser, E. L. and Ponzetto, G. A. M. and Scleifer, A. 2006. *Why Does Democracy Need Education*, NBER Working Paper No. W12128; April 2006.
- Hatakenaka, S and Thompson, Q 2006. *Albanian Higher Education Report* Submitted from European Investment Bank, March 2006.
- Hough, J. R. 1993. *Educational cost-benefit analysis* - Education Research Paper No. 02, 1993
- Kaiser, F. 1999. *Market type mechanisms in higher education: a comparative analysis of their occurrence and discussions on the issue in five higher education systems*, CHEPS report / Higher Education Monitor Thematic report -1999.
- Mueller, U and Tiemeyer, R and Ziegele, F. 2004. *Finanzielle Effekte von Studiengängen* Centrum für Hochschulentwicklung, Arbeitspapier Nr. 58, August 2004
- Newby, H. et al. 2009. *OECD Reviews of Tertiary Education - Japan*; 2009
- OECD Indicators - Education on Glance 2009*.
- Psacharopoulos, G. 2004. *Public versus Private University System* CESifo DICE Report 4/2004.
- Psacharopoulos, G. 1993. *Returns to Investment in Education* World Bank, Working Paper - Education and Employment, January 1993.
- Rankings of Top 100 Universities in the World 2010*. [online] Available on <http://www.university-list.net/index.htm>.
- Santiago, P. et al., 2009. *OECD Reviews of Tertiary Education - Spain*; 2009
- Santiago, P. et al. 2008. *Tertiary Education for Knowledge Society* OECD Thematic Review of Tertiary Education; Volume 1, 2008.
- Santiago, P. et al., 2008. *Tertiary Education for Knowledge Society* - OECD Thematic Review of Tertiary Education; Volume 1.
- Schmidtchen, D. 2005. *Mehr Markt im Hochschulbereich: Zur Effizienz und Gerechtigkeit von Studiengebühren* German Working Papers in Law and Economics, Paper 4, Volume 2005.
- Tarifa, F. 2010. *The American Triumph* - MAPO 22.07.2010.
- World Bank - World Economic Forum - 2010*. Cartagena, Colombia 6-8 April 2010

*Financimi i Arsimit të Lartë në Shqipëri – Sfida dhe mundësi**

_____ Arbjan MAZNIKU, MA _____

_____ Gjergji FILIPI, PhD _____

Abstrakt. *Arsimi i lartë është një ndër shtyllat thelbësore të rritjes ekonomike kombëtare si dhe një instrument kyç për realizimin e aspiratave për zhvillim. Në të gjithë botën, arsimit të lartë po i kushtohet një vëmendje e veçantë në drejtim të reformimit të këtij sistemi me qëllim rritjen e numrit të të diplomuarve dhe llojit të formimeve; lehtësimin e financimit; harmonizimin e diplomave me kërkesat e tregut të punës; dhe rritjen e cilësisë dhe përgjegjshmërisë në edukim. Politikëbërësit në Shqipëri e kanë njohur tashmë nevojën urgjente që ka vendi për të bërë progres drejt përmbushjes së këtyre qëllimeve dhe kjo ka qenë shtysa e reformave të ndërmarra së fundmi në këtë fushë. Por ndërkohë, problemet mbeten ekzistente.*

Arsimi i Lartë mbetet një temë prioritare në diskutimet dhe axhendat publike. Vitet e fundit, ky sistem i është nënshtruar dhe një serie reformash specifike të cilat kanë patur si qëllim kryesor rritjen e numrit të studentëve. Ndërkohë që përtej shumë diskutimeve, është bërë pak për të ndikuar në përmirësimin e cilësisë së ofruar nga sistemi i arsimit të lartë. Së fundmi, qeveria është angazhuar për të ndërmarrë një reformë në financimin e sistemit të Arsimit të Lartë. Duke njohur domosdoshmërinë e reformimit të sistemit dhe impaktin pozitiv që do të kishte adaptimi i një politike të mirë-hartuar, Instituti AGENDA kontribuon duke propozuar një skemë alternative financimi që synon të adresojë sfidat kryesore me të cilat përballlet sot Arsimi i Lartë në Shqipëri.

Fjalë kyçe:

Arsimi i lartë, reforma e financimit, zhvillim

* Kjo analizë është një version i redaktuar i një studimi më të plotë të kryer nga Instituti Agenda dhe mbështetur nga Fondacioni Shoqëria e Hapur për Shqipërinë (SOROS).

Parakushtet e një reforme

Për të realizuar një reformë thelbësore në arsimin e lartë, gjykojmë se ka tre parakushte, pa të cilat asnjë reformë, sado e mirëhartuar të jetë, nuk ka shanse për të qenë e suksesshme. Këto tre parakushte janë: 1. Akreditimi i arsimit të lartë; 2. Përkushtimi i qeverisë për zhvillimin e arsimit të lartë profesional; 3. Konsensusi i gjerë politik e publik, për të siguruar qëndrueshmërinë e reformës.

- Akreditimi dhe renditja e institucioneve të arsimit të lartë

Akreditimi dhe renditja e Institucioneve të Arsimit të Lartë (IAL) është parakushti kyç për çdo reformë që do të synonte të rriste cilësinë, efikasitetin dhe efektivitetin e sistemit.

Trendi global i devoluimit të institucioneve të arsimit të lartë, duhet të shoqërohet detyrimisht me përmirësimin e informacionit të përfituesve të sistemit, por edhe të tregut të punës, mbi cilësinë dhe krahasueshmërinë e shërbimit të ofruar. Çdo reformë që do të bazonte financimin mbi rezultatet dhe produktin e Institucioneve të Arsimit të Lartë, do të qe e pamundur të zbatohet, apo të vlerësohet, nëse IAL-et nuk akreditohen dhe renditen.

Prezenca në treg e Institucioneve të Arsimit të Lartë jo-publikë, e bën madje një detyrim të qeverisjes Akreditimin dhe Renditjen e universiteteve si mjet informues për përfituesit e mundshëm.

- Përkushtimi i qeverisë për zhvillimin e arsimit të lartë profesional

Një ndër mënyrat kryesore për të ulur pjesërisht presionin e kërkesës mbi universitetet në vend, është përkushtimi i Qeverisë për zhvillimin e arsimit të lartë profesional. Në pjesën më të madhe të vendeve të zhvilluara, këto institucione thithin një pjesë të konsiderueshme të studentëve të nivelit të tretë.

Një politikë e tillë, do të përmirësonte dukshëm madje dhe shanset për punësim për atë segment të rinjve që do të ndiqte këtë lloj arsimit terciar. Nisur dhe nga tipologjia e ekonomisë shqiptare, ekzistenca e një sektori të fortë të arsimit të lartë profesional, do të jepte efekte të dobishme edhe për sektorët punësues të vendit.

- Konsensusi i gjerë politik e publik, për të siguruar qëndrueshmërinë e reformës

Reforma në arsim në përgjithësi dhe një reformë në financimin e arsimit të lartë më specifikisht, do të qe e suksesshme vetëm nëse do të gëzojë një mbështetje të gjerë nga publiku dhe nga një spektër i gjerë politik, për të garantuar në këtë mënyrë qëndrueshmërinë e saj në kohë.


Që një politikë e tillë të japë rezultat e që ato rezultate të vlerësohen, nevojitet një periudhë kohore që tipikisht i kalon disa mandate parlamentare. Ndaj dhe një konsensus i gjerë, së bashku me një set mekanizmesh që mund të axhustohen sipas pozicionit të politikëbërësit, do të garantonin jetëgjatësinë e një reforme të tillë.

Sfidat kryesore

1 - Zgjerimi i arsimit të lartë

Gjatë 20 vitevetë fundit ka patur natyrshëm një rritje masive të kërkesës për arsim të lartë. Kjo tendencë e njohur globalisht¹, ka qenë mjaft më e mpërhtë në Shqipëri, si rrjedhojë e mbylljes agresive të sistemit gjatë rregjimit, por edhe si rrjedhojë e moshës së re të popullatës në vend.

Shqipëria ka vuajtur dhe vazhdon të vuajë nga një përqindje shumë e ulët e popullsisë që vazhdon arsimin e lartë: “Norma bruto/neto e përfshirjes në arsimin tericar ishte vetëm 15/11% në 2002/03, dhe kontrastonte fort me nivelet 20%-30% në ekonomi të tjera në tranzicion (Bosnja-Herzegovina 19%; Maqedonia 23%; Serbia dhe Mali i Zi 24%; Rumania 33% dhe Bjellorusia 34%)”². Megjithë rritjen e numrit të studentëve në vitet e fundit, Shqipëria vazhdon të mbetet pas në këtë indeks, jo vetëm krahasuar me vendet e zhvilluara, por edhe me vendet e rajonit.



Grupmoshat përfshirë në arsim. Të dhënat për Shqipërinë INSTAT. Vendet e tjera UNESCO.

Sipas Bankës Botërore, “Shqipëria ka përqindjen më të ulët të individëve që kanë përfunduar arsimin e mesëm dhe të lartë (48,7%) krahasuar me mesataren prej 62

¹ Johnstone, D. Bruce, Arora, A. and Experton, W. (1998) The Financing and Management of Higher Education: *A Status Report on Worldwide Reforms*. Washington, D.C.: World Bank, Departmental Working Paper, <http://www-wds.worldbank.org>.

² Hatakenaka, Sachi and Thompson, Quentin (2006) Albania Higher Education Report - Report submitted to the European Investment Bank

përqind të vendeve të Ballkanit.”³

Rritja e kërkesës për avancim social, është shoqëruar natyrshëm me një rritje të kërkesës për arsim të lartë.⁴

Politika e ka parë hapjen e dyerve të universiteteve si një vegël të vlefshme elektorale dhe jo si nevojë të vendit për zhvillim, ndaj dhe vazhdimisht gjatë gjithë 20 viteve të fundit është rritur numri i studenteve në përpjestim të zhdrejtë me financimin.

Tabela 2.3: Shpenzimet për Student si % e PBB për Frymë						
	2004	2005	2006	2007	2008	2009
Arsimi i Lartë	25,4	22,4	20,9	22,3	23,0	19,7

Burimi: Banka Botërore, *Memorandumi Ekonomik i Vëndit 2010*

Krahasimisht me vende të tjera të rajonit apo BE-së Shqipëria harxhon me pak për student matur në përpjestim me PPB-në për frymë.

Tabela 2.4: Shpenzimet për Student si % e PBB për frymë në vitin 2009

Vendi	%
Azerbaixhan	15,6
Antigua dhe Barbuda	16,9
Shqipëria	19,7
Bullgaria	24,8
Italia	25,0
Kroacia	26,2
Rumania	26,2
Çekia	30,5
Finlanda	32,6
Franca	35,6
Moldavia	38,9

Burimi: Banka Botërore 2010 dhe <http://data.worldbank.org>

Bashkë me rritjen e kuotave të pranimeve në degët ekzistuese, universitetet publike kanë zgjeruar dhe numrin e degëve të studimit.

3 Banka Botërore (2010) -Shqipëria: Axlenda e Re e Rritjes Ekonomike, Memorandum Ekonomik i Vëndit. Raport Nr. 53599-AL.

4 Johnstone, D. Bruce, Arora, A. and Experton, W. (1998) The Financing and Management of Higher Education: A Status Report on Worldwide Reforms. Washington, D.C.: World Bank, Departmental Working Paper, <http://www-wds.worldbank.org>

Hapja e tregut të arsimit të lartë për institucione private ka sjellë një rritje të menjëhershme në këtë sektor që sot numëron 41 IAL-e ⁵, të cilat ofrojnë mbi 310 programe mësimore ⁶.

Numri i Studentëve në Shqipëri.Burimi: Përpunimi i Autorëve bazuar mbi të dhënat e Bankës Botërore⁷

2 - Cilësia dhe përqasja ndaj kërkesave të tregut të punës

Pothuajse çdo raport i kryer mbi arsimin e lartë të vendit, ngre si çështje kryesore cilësinë e ulët të ofertës. (Hatakenaka and and Thompson, 2006, Banka Botërore 2010, etj.)

Parametrat kyç të arsimit të lartë, siç janë raporti student/pedagog, hapësira/student, numri i laboratorëve, numër pedagogësh me gradë/student, cilësia dhe rifreskimi i kurrikulave, ekzistenca e bibliotekave, apo sallave të kompjuterave, numër i studenteve për klasë, etj, janë jashtë parametrave të dëshirueshëm.

Një pjesë e mirë e sipërmarrësve në vend, ankohen për mungesë të specialistëve që përmbushin nevojat e tyre. Në Memorandumin Ekonomik të Vëndit 2010, botuar nga Banka Botërore, thuhet:

“Në Sondazhin për Mjedisin e Biznesit dhe Performancën e Ndërmarrjeve (BEEPS) të vitit 2008, më shumë se gjysma e firmave raportuan se mungesa e fuqisë punëtore të kualifikuar përbën një pengesë në bërjen e biznesit dhe kjo prapë mund të mos tregojë shkallën e vërtetë të problemit. Megjithëse shumë firma pranojnë se kanë nevojë për një menaxher, specialist IT, ekonomist apo inxhinier, ato mund të mos vlerësojnë faktin se po humbasin mundësitë për riorganizim të proceseve të prodhimit, futjen e produkteve të reja apo hyrjen në tregjet e reja (shiko Kutinë 2.1 mbi Inovacionin dhe Rritjen). Gjithashtu, në Studimin për Klimën e Biznesit (ICS) të vitit 2009, 51 përqind e firmave të mëdha, 41 përqind e eksportuesve, dhe 48 përqind e firmave të huaja raportonin aftësitë si pengesën kryesore. Përqindjet ishin më të larta se ato në vendet e tjera në tranzicion.”

3 - Presioni financiar

Shteti Shqiptar shpenzon shumë pak për arsimin e lartë. Ndërkohë që mesatarja e vendeve të BE-së dhe OECD-së është rreth 1% e PBB-së dhe synohet të rritet më tej. Mesatarja e 10 viteve të fundit në Shqipëri është rreth 0,45% e PBB-së. Shumë më e ulët krahasuar edhe me vendet e rajonit.

⁵ Agjencia Publike e Akreditimit të Arsimit të Lartë, Lista e Institucioneve të Licencuara, www.albanking.com

⁶ Banka Botërore (2010) -Shqipëria: Axlenda e Re e Rritjes Ekonomike, Memorandum Ekonomik i Vëndit.Raport Nr. 53599-AL.

⁷ Ibid.

Tabela 2.5 Shpenzimet publike për arsimin e lartë si % e PBB-së				
GEO/TIME	2005	2006	2007	2008
Shqipëria	0,40	0,40	0,41	0,45
Kroacia	0,76	0,88	0,81	0,95
Republika Çeke	0,89	1,23	1,07	0,97
Hungaria	1,03	1,04	1,03	1,02
Lituanian	1,03	1,00	1,01	1,04
Gjermania	1,14	1,11	1,14	1,21
Irlanda	1,11	1,14	1,14	1,31
Hollanda	1,47	1,50	1,45	1,52
Danimarka	2,38	2,26	2,29	2,19
Greqia	1,46	:	:	:
Rumania	0,81	:	1,12	:
Turqia	:	0,91	:	:
Bashkimi Evropian (27 vendet)	1,15	1,13	1,12	1,14
SHBA	1,31	1,43	1,25	1,26

Burimi: EUROSTAT

Arsimi i lartë përballët gjithashtu me një konkurrencë të fortë për financa nga sektorë të tjerë që i marrin të ardhurat nga i njëjti burim, buxheti i shtetit. Sektorë të tjerë, që prej natyrës së tyre japin rezultate më të shpejta në kohë, shtojnë vendim-marrësit politikë të kanalizojnë më tepër fonde në ato drejtime. Edhe brenda vetë sektorit, Arsimi i Lartë ka një presion finciar nga arsimi fillor e ai i mesëm, të cilët gjenden gjithashtu në situatë të vështirë.

Presioni finciar ka sjellë gjithashtu një ulje të mëtejshme të cilësisë së mësimdhënies në universitete publike si rrjedhojë e stafit akademik të nënpaguar dhe konkurrencës në rritje nga sektori privat për të joshur stafin me eksperiencë.

4 - Balancimi i autonomisë dhe llogaridhënies

Përgjatë 20 viteve të fundit ka patur një kërkesë të vazhdueshme nga ana e administratorëve të arsimit të lartë publik për rritje të autonomisë së sistemit. Nuk është vetëm teoria që na lë të kuptojmë se nëse universitetet lihen pjesë e zinxhirit burokratik të administratës, ato do vazhdojnë të zhgënjnë në performacën e tyre. Në Shqipëri, varësia nuk ka dhënë fryte, ndërkohë që eksperiencia rajonale e globale tregon që universitetet më të mirë janë edhe universitetet me nivelin më të lartë të autonomisë.

Nga ana tjetër e argumentit të autonomisë qëndron kërkesa për llogaridhënie që sistemi duhet të ketë kundrejt administratorëve të mandatuar të interesit publik, që janë institucionet shtetërore. Në këtë anë të argumentit gjithashtu qëndron dhe kapja e sistemit nga një kastë pedagogësh, dhe bërja e pamundur për prurjet e reja të hyjnë në sistem.

5- Aksesit dhe diversifikimi i ofertës

Hapja masive e universiteteve private vitet e fundit, sigurisht që ka ndihmuar në rritjen e aksesit ndaj arsimit të lartë, por nga ana tjetër e ka vështirësuar edhe më tej situatën në arsimin publik, duke thithur prej tij staf me ekperiencë si rrjedhojë e ofertës dhe kushteve më të mira finaciare. Universitetet private ende nuk shihen si konkurrentë të atyre publike si rrjedhojë e skemës krejt të ndryshme të financimit. Ky fakt ndikon negativisht duke e privuar arsimin e lartë publik nga shumë zhvillime pozitive që sjell natyrshëm ekzistenca e konkurrencës. Hapja e tregut për universitete private, i ka ofruar mundësi alternative arsimimi atyre të rinjve që vijnë nga familje me të ardhura mbi mesataren, të cilët ju shtuan familjeve me të ardhura të larta që largojnë fëmijët e tyre nga sistemi për ti dërguar jashtë vendit. Kjo tendencë, dalëngadalë, po e kthen universitetin publik në zgjedhje të detyruar vetëm të të varfërve. Vendi gjithashtu vazhdon të vuajë nga një pabarazi e madhe e përfitimit të arsimit të lartë të të rinjve që vijnë nga zonat rurale krahasuar me ata që vijnë nga zonat urbane⁸.

Përqindja e popullatës rezidente që ka kryer studime universitare	
Urbane	
Totali i popullatës urbane	9,86%
Mesatarja jashtë Tirane	7,50%
Tirana urbane	15,39%
Rurale	
Totali i popullatës rurale	1,19%
Mesatarja jashtë Tirane	1,25%
Tirana rurale	1,60%

Burimi: *Përlllogaritje nga Muço, 2008 me të dhëna nga INSTAT*

⁸ Muco, Sagita – (2008), *Reconstructing Higher Education in Albania*

Sfidat e reformës së finacimit të arsimit të lartë

Arsimi i lartë në Shqipëri ka nevojë për një reformë drastike, e cila jo vetëm duhet t'a sjellë këtë sektor në standarde të pranueshme, por ta bëjë atë zhvilluesin e kapitalit njerëzor si dhe një promotor të zhvillimit ekonomik. Duke patur parasysh burimet e limituara që ka vendi në dy burimet kyçe të ekonomisë; TOKA dhe KAPITALI, investimi në burimin me të bollshëm që janë njerëzit në moshë të re do të ndikojë drejt për drejt tek burimi i tretë, PUNA.

Arsimi i lartë në Shqipëri është tërësisht i nënfinancuar, me raportet më të ulta në rajon në shpenzimet për student, si dhe vuan nga probleme madhore të cilësisë. Ndaj reforma në finacim duhet të adresojë pikërisht këto probleme: rritjen e financave që shkojnë drejt sistemit, si dhe rritjen në të njëjtën kohë të cilësisë që sistemi ofron. (Banka Botërore 2010). Rritja e finacimit për sistemin do të krijonte dhe mundësinë për vazhdimin e rritjes së numrit të studentëve, një nevojë thelbësore kjo për vendin, duke patur parasysh numrin e ulët të raportit student për 1000 banorë, si dhe moshën e re mesatare që ka vendi. Sistemi i finacimit gjithashtu duhet të promovojë aksesin ndaj sistemit për grupet e të rinjtë nga familje me të ardhura të ulta, apo të rinjtë nga zonat rurale. Të dy këto parametra me përqindje mjaft të lartë në Shqipëri.

Universitetet publike në të njëjtën kohë nuk duhet të mbeten zgjedhja e vetme për të varfërit, apo për ata që thjesht kërkojnë diplomë e jo dije, por duhet të kthehen në një opsion ndaj emigrimit dhe arsimit privat për nxënësit e shkëlqyer.

Sistemi i financimit duhet gjithashtu të shtyjë përpara autonominë universitare, duke i bërë universitetet institucione realisht të pavarura, që përballen si me avantazhet e autonomisë dhe me përgjegjësitë që ajo sjell. Kontrolli mbikqyrës i shtetit duhet të zëvendësohet nga mekanizma të menaxhimit të ri publik (new public management), me elementë të kontrollit të sistemit nëpërmjet rezultateve dhe produktit, në vend të kontrollit nëpërmjet inputeve (buxhetit).

Format e qeverisjes dhe administrimit të brendshëm të universiteteve duhet të ndryshojnë për tu adaptuar me format e menaxhimit të ri publik. Roli i studentëve duhet të ndryshojë nga përfitues pasiv të sistemit, në rolin e përfituesit vendim-marrës apo klientit të shërbimit.

Universitetet publike duhet të futen në një sistem konkurrimi, mes tyre, apo me operatorë privatë të sistemit, në mënyrë që të shtyhen për tu reformuar, dhe të mbajnë standarde që janë vazhdimisht në përpudhje me kërkesat e përfituesve.

Arsimi i lartë padyshim që është një e mirë publike, dhe si i tillë ka nevojë për investimin e vazhdueshëm nga shteti; por ai shfaq dhe një sërë karakteristikash të një të mire private (studentet që mbarojnë studimet, përmirësojnë të ardhurat e tyre dhe cilësinë e jetës). Si i tillë barra e kostos është mëse e drejtë që të ndahet mes shtetit dhe individit përfitues.

Së fundi, sistemi duhet të ofrojë qëndrueshmëri në plan afat-gjatë, duke u dhënë

mundësinë qeverive të kaheve të ndryshme politike të rakordojnë mekanizmat e tij për ti përqsaur me pozicionin e tyre politik (në të majtë apo në të djathtë) pa patur nevojë për të ribërë sistemin.

Skema e propozuar e financimit

Propozohet finacimi i arsimit të lartë në Shqipëri nëpërmjet kombinimit të tre mekanizmave që mund të akordohen me kalimin e kohës për të kompensuar njëri tjetrin në bazë të interesave të politikëbërësve.

Këto mekanizma janë: 1.Fondi i përgjithshëm 2.Pagesa për studim që përfshin: 2.1-Fondi i Bursave, dhe 2.2-Kreditë për studime, si dhe 3. Fondi për zhvillim.

1- Fondi i përgjithshëm

Është një fond që alokohet në bazë të një marrëveshjeje mes Ministrisë dhe Institucionit të Arsimit të Lartë (IAL). Ky fond duhet të jetë i tipit 'financimi ndjek studentin', por duhet të alokohet në bazë të një formule që merr parasysh performacën e IAL-it. Kjo do të lëvizte menaxhimin e arsimit të lartë drejt një modeli të menaxhimit të ri publik, të bazuar në rezultate e produkt dhe jo thjesht input, pra numër studentësh.

Elementë potencialë për tu përfshirë në formulë do të ishin;

- **Numri i studentëve**
- **Renditja e Universitetit në vitin paradhës ose një numër indikatorësh ku mund të përfshihen:**
 - Vlera totale e krediteve të akumuluar nga studentët
 - Numri i i studentëve të diplomuar
 - Mesatarja e pikëve të maturës shtetore të studentëve të rregjistruar
 - Numri i publikimeve kërkimore
 - Vlerësimi i pavarur i kënaqësisë së studentëve për IAL-in
 - Ecuria e karrierës së të diplomuarëve (pas sanksionimit me ligj ose akte të tjera për ndjekjen e studentëve dhe mbledhje informacioni)
 - Raporti staf/student
 - Raporti hapësirë/student
 - Vazhdimësia e studentëve në nivelet më të larta të arsimit në të njejtin IAL (kur mund të aplikohet)
 - Numër titujsh në librari/student
 - Numër kompjuterash të lidhur me broadband/student
 - Produkti kërkimor me përfshirje të studentëve.
- **Lloji i degës,** çka do të nënkuptonte koeficient të veçantë për studentë që gjenden në fazën klinike/laboratorike të studimeve.

- **Prioritete strategjike të vendosura nga politikëbërsit**, çka do të nënkuptonte koeficientë të veçantë për degë që përbëjnë një prioritet për zhvillimin e vendit.

I gjithë fondi i përgjithshëm do të duhet të alokohet në shumë të përgjithshme (nga ku merr dhe emrin) dhe do të jetë përgjegjësi e IAL-it për t'a detajuar këtë fond në buxhetin e universitetit.

Pjesë e negocimit mes IAL-it dhe qeverisë duhet të jetë dhe numri maksimal i pranimeve që çdo universitet mund të marrë përsipër, çka do të ndikojë dhe një nga komponentët bazë të formulës. Ky numër sidoqoftë, duhet të bazohet në një plan strategjik të IAL-it, si dhe në mundësitë logjistike për ti përballuar ato. Duke marrë parasysh sa më lart, IAL-et duhet të jenë të lira të vendosin kritere pranimesh për studentët që do të regjistrojnë. Ky fond do të përbëjë vetëm një pjesë të buxheti të IAL-it, psh. 40%-50% pasi pjesa tjetër do të përfitohet nga pagesa për studim e studentëve.

2- Pagesa për studim (tuition)

Si rregull, IALi do të paguhet për çdo student. Megjithatë, për një pjesë të mirë të studentëve, arsimi i lartë do të jetë pa pagesë në momentin e përdorimit. Qeveria do të ndërhyjë me dy mekanizma për të realizuar këtë gjë. Këto mekanizma janë; **Bursat e studimit**, dhe **Kreditë për studim**.

2.1- Bursat e studimit

Çdo vit qeveria mund të akordojë një numër të caktuar bursash për tu shpërndarë në bazë të kriterëve të meritës, nevojës dhe degës së përzgjedhur, apo një kombinim të këtyre të trejave. Për shembull:

<i>Kategoria</i>	<i>Kriteri</i>
5% të studentëve që marrin pikët më të larta në maturën shtetërore, u akordohet bursë për pagesën e studimeve, si dhe bursa për jetesë gjatë viteve të studimit	Merita.
Studentëve që arrijnë rezultate të një niveli të caktuar, dhe që provojnë një nivel të caktuar të ardhurash, u akordohet bursë për pagesën e studimeve, si dhe bursa për jetesë gjatë viteve të studimit	Merita dhe mundësia.
Studentëve që arrijnë rezultate të një niveli të caktuar (merita), dhe që provojnë një nivel të caktuar të ardhurash (mundësia), dhe që zgjedhin degë që përbëjnë prioritet për vendin (psh: fizikë, matematike, gjeologji.) u akordohet bursë për pagesën e studimeve, si dhe bursa për jetesë gjatë viteve të studimit	Merita + mundësia + dega e përzgjedhur.

Bursat sidoqoftë duhet të jenë një mekanizëm, nëpërmjet të cilit shteti ndihmon studentin për të përballuar studimin dhe jo IAL-in. Madje duhet të krijohet një konkurrencë e shëndetshme mes IAL-eve publike, apo fakulteteve të ndryshme për të përfituar bursarë.

Të ardhurat që vijnë nga bursat e studentëve, mund të zinin rreth 10%-15% të të ardhurave të universiteteve publike. IAL-et jo-publikë që marrin statusin e institucioneve jo-fitimprurëse mund të bëheshin gjithashtu përfitues nga Fondi i Bursave. Të gjithë studentët e tjerë të pranuar në universitete do të kenë të drejtën të përfitojnë kredi studentore me interesa të subvencionuara.

2.2 - Kredia për studim

Të gjithë studentët që kanë përfituar të drejtën për të studiuar, përfitojnë të drejtën për të marrë një kredi për studim që mund të mbulojë pagesën e studimeve dhe ato të jetesës gjatë studimeve. Kjo mund të arrihet nëpërmjet një marrëveshjeje me një numër bankash të nivelit të dytë apo krijimit të një kompanie me fond shtetëror quajtur Shoqëria e Kredive Studentore. Këto kredi, duhet të garantohen nga një prind, apo një person tjetër vetëm për periudhën e studimit. Në mungesë të mundësisë për ta realizuar këtë (*të rinj jetimë, apo me aftësi të kufizuara*) shteti bëhet garant për këta individë.

Pas mbarimit të studimeve, çdo person fillon ta paguajë kredinë në momentin e punësimit të tij, si një përqindje që i shtohet tatimit të të ardhurave personale. Pra defakto, pagesa e kredisë mbledhet vetëm në momentin që një i diplomuar fillon të punojë, dhe mbledhet në formën e një takse. Të diplomuarit vazhdojnë ta paguajnë këtë taksë/këst kredie deri në momentin që përmbushin detyrimin e tyre, ose deri në një periudhë 25 vjeçare, për ata të diplomuar që do kenë të ardhura të ulta.

Një sistem i tillë do ta bënte faktikisht arsimi e lartë pa pagesë për studentët, pasi ai në fakt paguhet nga të diplomuarit.

Të ardhurat që vijnë nga pagesat për studim e studentëve, që zgjedhin të përfitojnë ose jo, nga skema e kredisë mund të zinin rreth 30%-35% të të ardhurave të universiteteve publike. Skema e Kredive për Studim mund të jetë e hapur edhe për studentët që zgjedhin ti ndjekin studimet në IAL-et jo publike.

3 - Fondi për zhvillim


Fondi për zhvillim do të jetë një fond i dedikuar për zhvillimin infrastrukturor, apo hapje degësh të reja nga IAL-et publike. Ky fond do të mund të merret nëpërmjet konkurrit me projekte dhe strategji zhvillimi nga IAL-et publike, në përputhje dhe me prioritetet e politikëbërësit.

4 - Fondi për Kërkim

Kërkimi bazë duhet të jetë pjesë strukturore e financimit të IAL-eve publike, dhe si i tillë ai duhet të mbulohet nga Fondi i Përgjithshëm dhe outputi kërkimor i IAL-

eve duhet të jetë një koeficient në formulën e shpërndarjes së Fondit të Përgjithshëm. Sidoqoftë, fondet publike (nëpërmjet një agjencie të veçantë për kërkim, apo vetë instiucionet e tjera publike) duhet të vazhdojnë të mbështesin kërkime specifike, me një dobi të mirëfilltë shoqërore. Këto fonde duhet të jenë të hapura për konkurrim mes IAL-eve publike por edhe atyre Jo-Publike.

Skema e propozuar për financimin publik të arsimit të lartë në Shqipëri



Modeli amerikan i universitetit dhe avantazhet e tij në tregun global të dijes dhe ekonomisë

—Fatos TARIFA, PhD—

Abstrakt. *Debati në shkallë globale gjatë këtyre dhjetë vjetëve të fundit mbi arsimin e lartë ka marrë shkas dhe motivohet nga të kuptuarit gjithnjë e më mirë të faktit se arsimi i lartë është një investim me efektivitet të lartë për ekonominë e çdo vendi. Një sistem modern i arsimit të lartë dhe universitete të klasit të parë janë asete me vlerë të jashtëzakonshme për një ekonomi të mbështetur në dije. Në plan individual, diploma e arsimit të lartë po bëhet gjithnjë e më e rëndësishme për karrierën profesionale të një individi dhe për mundësitë e ngjitjes së tij në shkallët e mobilitetit social. Në këtë artikull argumentohet se nga të gjitha modelet tradicionale dhe më të respektuara të universiteteve—modeli amerikan, modeli kontinental, modeli francez dhe ai britanik—modeli amerikan, i orientuar nga kërkimi shkencor dhe i dalluar për diversitetin, autonominë dhe frymën filantropike, gëzon superioritet global. Në artikull argumentohet se, përveç avantazheve të tij të dukshme që kanë të bëjnë me madhësinë dhe pasurinë e tyre, si edhe me një etos të gjerë konkurrueshmërie, superioriteti i sistemit universitar amerikan ka të bëjë, gjithashtu, edhe me sistemin e drejtimit si të univeristeteve private ashtu edhe të atyre shtetërore.*

Komuniteti akademik jeton dhe punon në një shoqëri që desensibilizon.... [Anëtarët e tij] nuk ofrojnë njohuri të veta dhe nuk tregojnë sensibilitetin që kërkohet nga publiku, kur është publiku ai që duhet t'i verë përpara përgjegjësisë ata që marrin vendime "në emër të kombit".

C. Wright Mills

Shkaqet e Luftës së Tretë Botërore
The Causes of World War III (Ballantine Books, 1963), f. 145

Fjalë kyçe:

Universitetet, modeli amerikan, tregu global i dijes dhe ekonomisë

Debari në shkallë globale gjatë këtyre dhjetë vjetëve të fundit mbi domosdoshmërinë e reformimit të sistemit të arsimit të lartë ka marrë shkas dhe motivohet nga të kuptuarit gjithnjë e më mirë të faktit se arsimi i lartë është një investim me efektivitet të lartë për zhvillimin ekonomik dhe shoqëror të çdo vendi. Një sistem modern i arsimit të lartë dhe universitete të klasit të parë janë asete me vlerë të jashtëzakonshme për ekonominë e një vendi të zhvilluar, e cila, në kushtet e shekullit të 21-të, tenton objektivisht të shndërrohet gjithnjë e më shumë në një ekonomi të mbështetur në dijen (*knowledge economy*). Në plan individual, diploma e arsimit të lartë dhe gradat shkencore, sidomos grada PhD, e cila fitohet në përfundim të studimeve pasuniversitare, po bëhen gjithnjë e më të rëndësishme për karrierën profesionale të një individi dhe për mundësitë e ngjitjes së tij në shkallët e mobilitetit social.

Nga ana tjetër, arsimi i lartë është bërë sot *global* në kuptimin më real të fjalës. Lëvizja e studentëve, e stafeve kërkimore dhe pedagogjike dhe e resurseve përtej kufijve nacionalë të një vendi është zgjeruar dhe intensifikuar më shumë se kurrë, duke bërë të ndryshojnë rregullat dhe dinamika e konkurrencës për ekspertizë arsimore, shkencore dhe teknologjike në një botë gjithnjë e më të globalizuar. Në këtë drejtim dallohen veçanërisht universitetet amerikane. Aktualisht, në Shtetet e Bashkuara punojnë rreth 400,000 shkencëtarë nga vende të ndryshme të Europës, pa përmendur qindramijëra të tjerë nga vendet e Azisë, të Amerikës Latine, nga Kanadaja, Australia, Lindja e Mesme, etj.

Përveç një numri të madh profesorësh nga Europa dhe nga vende të tjera, universitetet amerikane, veçanërisht programet e tyre pas-universitare, tërheqin një numër shumë më të madh studentësh të huaj sesa të gjitha universitetet e botës të marra së bashku. Sipas një raporti të botuar në buletin *Chronicle of Higher Education*, më 9 dhjetor 2005, mbi 61 përqind e studentëve që fituan atë vit gradën PhD në degët inxhinierike dhe mbi 46 përqind e atyre që fituan një PhD në shkencat natyrore në universitetet amerikane ishin studentë të huaj, kryesisht nga vendet e Azisë Lindore (Baber 2006: 45-46). Sot, në Shtetet e Bashkuara, rreth 30 përqind e atyre që kanë një PhD në shkencat natyrore, në profile të ndryshme të shkencave inxhinierike apo në fushën e teknologjisë nuk janë lindur në Amerikë, por kanë ardhur të kryejnë studimet në këtë vend dhe kanë qëndruar këtu.

Aftësia për të tërhequr dhe stimuluar intelektualisht dhe materialisht talentet shkencore nga të katër anët e botës është një ndër arsytet që shpjegon, të paktën qysh pas mbarimit të Luftës së Dytë Botërore, ritmet e larta të inovacionit shkencor dhe teknologjik në Shtetet e Bashkuara dhe që do t'i rezervojë shoqërisë amerikane rolin e leadershipit në këtë fushë për një periudhë të gjatë kohe. Nga ana e tyre, shoqëritë aziatike, të cilat kanë kohë që konkurojnë në tregun global të dijes dhe të ekonomisë, i çmojnë efektet transformuese pozitive shumë të mëdha që kanë luajtur universitetet amerikane në zhvillimin ekonomik, teknologjik, social dhe kulturor të tyre. Kjo ka ndodhur dhe vazhdon të ndodhë për shkak se mijëra studentë aziatikë,

të diplomuar dhe të doktoruar në Shtetet e Bashkuara, kthehen në vendet e tyre pas përfundimit të studimeve, duke sjellë me vete jo vetëm dije bashkëkohore dhe aftësi të çmuara në shkencat inxhinierike, në mjekësi, në arkitekturë etj, por edhe atë “American Dream” që i bën ata të besojnë se çdo individ mund të arrijë sukses në jetë, pavarësisht kastës apo klasës shoqërore nga e cila vjen. Kishore Mahbubani (2005: 60-61), një ndër analistët më të njohur të zhvillimeve aktuale në Azi dhe në shkallë globale, ka argumentuar se, ashtu sikundër “Katër Modernizimet” e Ten Sjaos Pinit nuk do të kishin pasur sukses nëse lideri kinez nuk do t’i kishte inkurajuar aspiratat e popullit kinez me shembullin e modelit amerikan dhe me ëndrrën ekonomike amerikane, po ashtu “është vështirë të mendohet se si do t’i kishte arritur sukseset e saj Azia moderne pa kontributin amerikan”.

Masivizimi dhe progresi cilësor i arsimit të lartë

Kërkesat në rritje ndaj arsimit të lartë në kohën e sotme ushtrojnë dy lloje presionesh. Njëri ka të bëjë me aksesin në shkollat e larta, ndërsa tjetri me mundësinë e pranimit në departamentet më prestigjioze të universiteteve dhe kolegjeve që ofrojnë diploma dhe PhD në fushat më të kërkuara, siç janë mjekësia, inxhinieria dhe administrimi i biznesit. Ambiciet për demokratizimin global të arsimit të lartë janë bërë sot një tipar jo vetëm i vendeve më të industrializuara, por edhe i vendeve të “botës së dytë” dhe të “tretë” (çfarëdo kuptimi që të kenë marrë sot këto terma), apo i vendeve periferike të globit, po të përdorim gjuhën e sociologut të njohur Immanuel Wallerstein. Në vendet që po njohin një zhvillim të madh dhe të shpejtë, si India, Kina apo Brazili, në shumë prej vendeve postkomuniste, si edhe në ato vende që akoma cilësohen “vende në zhvillim”, miliona të rinj kërkojnë të ngjisin shkallët e mobilitetit social në hierarkitë e shoqërive të tyre përmes arsimimit universitar dhe atij pasuniversitar. Ky është një fenomen i panjohur më parë në këtë shkallë. Rritja e mundësive për shkollim, numri i madh i të rinjve me arsim të mesëm dhe shtimi i numrit të studentëve universitarë, dukuri këto të cilat u bënë mjaft të përhapura në Amerikën e Veriut dhe në pjesën më të madhe të Europës Perëndimore gjatë gjysmës së dytë të shekullit të 20-të janë bërë, në ditët tona, një *dukuri e përbotshme*. Rreth 130 milionë studentë ndjekin sot universitetet dhe kolegjet në vendet në zhvillim. Edhe pse në këto vende vetëm një përqindje e ulët (3-15 përqind) e popullsisë arrin të kryejë studimet universitare (krahasuar me 45 deri 85 përqind në vendet e zhvilluara), numri i të rinjve që ndjekin shkollat e larta në vendet në zhvillim është rritur në mënyrë të konsiderueshme. Vetëm në Indi, fjala vjen, sot numërohen 15 mijë universitete dhe rreth 30 mijë kolegje të llojeve të ndryshme, në të cilat studiojnë mbi 4.7 milionë studentë. Shumica e studentëve në vendet në zhvillim vijnë nga shtresat e ulëta dhe të pasigurta të klasës së mesme dhe, aq sa janë të irrituar për shkak të gjendjes së tyre social-ekonomike, aq edhe janë të

motivuar—dhe të ndikuar nga Interneti—për ta ndryshuar status quo-në.

Në shumë prej vendeve postkomuniste (përfshirë edhe Shqipërinë) dhe në vendet në zhvillim, qeveritë e kanë pasur dhe e kanë relativisht të lehtë t'i bëjnë ballë presionit të parë, duke inkurajuar *masivizimin* e arsimit të lartë përmes zgjerimit të institucioneve arsimore ekzistuese, krijimit të universiteteve të reja publike dhe private dhe stratifikimit të sistemit të arsimit të lartë përmes krijimit të kolegjeve apo kampuseve të afliuar me universitete ekzistuese, vendase apo të huaja. Sfida më e madhe, sidoqoftë, ka qenë dhe mbetet përballja me presionin e dytë, konkurenca dhe prestigji akademik në një kohë kur universitetet janë bërë njëherësh *agentë* dhe *subjekte* të globalizimit.

Si institucione, universitetet janë, ose duhet të jenë “universale” apo ndërkombëtarë në orientimin e tyre, siç lë të kuptohet edhe vetë termi “universitas” (nga latinishtja), i përdorur për herë të parë në Mesjetë, me lindjen e jetës urbane në qytete, si referim ndaj shoqatave të studentëve dhe të profesorëve, të cilave princi apo qyteti ku ato ishin krijuar u garantonte të drejta ligjore kolektive. Stafet pedagogjike dhe kërkimore në universitetet e sotme janë pjesë e një komuniteti ndërkombëtar njerëzish të të njëjtit vokacion; si të tillë, ata krahasohen, vlerësohen dhe gjykohen nga vetë anëtarët e këtij komuniteti. Po kështu, një numër gjithnjë e më i madh studentësh, gjatë viteve të shkollimit të tyre universitar provojnë eksperiencë arsimore dhe edukative në vende të ndryshme, madje marrin diploma universitare, gradat Master dhe PhD në universitete të huaja. Kjo dukuri vërehet sot gjithnjë e më shumë edhe në Shqipëri. Në Universitetin Europian të Tiranës, fjala vjen, nga 97 pedagogë të brendshëm që japin mësim në këtë universitet, 24 kanë fituar gradën PhD (ose Doktor) dhe 33 të tjerë kanë fituar gradat “Master of Arts” apo “Master of Sciences” nga universitete perëndimore në vende të tilla si, Shtetet e Bashkuara, Britania e Madhe, Franca, Gjermania, Austria, Italia etj.

Globalizimi, konkurenca dhe prestigji universitar

Globalizimi i shoqërisë e ka bërë të paevitueshme rritjen e konkurrencës midis universiteteve në dy plane: së pari, për shkencëtarë dhe staf akademik dhe, së dyti, për prestigj. Në këtë konkurrencë, ashtu si në çdo fushë tjetër, Shtetet e Bashkuara dominojnë në mënyrë të padiskutueshme. Shkencëtarët amerikanë fitojnë shumicën absolute të çmimeve Nobel në shkencë dhe të çmimeve të tjera ndërkombëtare. Qysh pas mbarimit të Luftës së Dytë Botërore deri më 2005, për shembull, në katër fusha të kërkimit shkencor (mjekësi, kimi, fizikë dhe ekonomi), për të cilat çdo vit akordohet Çmimi Nobel, numri i shkencëtarëve amerikanë të laureuar me këtë çmim ishte 243, shumë më i madh se numri i shkencëtarëve të laureuar po me këtë çmim nga të gjitha vendet e tjera të botës të marra së bashku, i cili kapte shifrën 183 (Tarifa 2007). Po kështu, librat dhe artikujt shkencorë të studiuesve amerikanë janë ata që citohen më shumë në revistat akademike më të famshme të botës. Universitetet amerikane “prodhojnë” popullsinë më të madhe të studiuesve me PhD në botë. Ndërsa në vitin

1920 të gjitha universitetet amerikane, të marra së bashku, dhanë vetëm 615 PhD, sot ato japin më shumë se 43,000 PhD në vit (Calhoun 2006: 9).

Universitetet më të mira amerikane, të financuara nga donacione të shumta e të mëdha dhe nga pagesa të larta pranimi për shkollim, tërheqin një numër shumë të madh profesorësh dhe studiuesish nga e gjithë bota, veçanërisht në ato fusha të cilat konsiderohen shkenca e së ardhmes. Vende të tjera si, Britania e Madhe, Kanadaja, Franca, Gjermania, Izraeli apo India qahen se ky “brain drain” i ka lënë dhe vazhdon t’i lerë ato në pozita disavantazhi ndaj Shteteve të Bashkuara, sidomos në fusha të tilla si nanoteknologjia, teknologjia e informacionit, bio-mjekësia etj. Elitat kulturore në disa nga këto vende e shohin me shqetësim supremacinë e universiteteve amerikane dhe rënien e prestigjit të dikurshëm të universiteteve të tilla si Oksfordi, Sorbona apo Heidelbergu.

Çështja e prestigjit është bërë veçanërisht sensitive gjatë dekadës së fundit për shkak të publikimit çdo vit, në mënyrë të pavarur në Londër dhe në Shanghai, të klasifikimit të 500 universiteteve më të mira të botës. Revista *U.S. News & World Report*, nga ana e saj, prej kohësh ka publikuar çdo vit klasifikimin e universiteteve dhe të kolegjeve amerikane. Sidoqoftë, klasifikimi apo renkimi *ndërkombëtar* i universiteteve është një dukuri e re. Ky klasifikim ka rëndësi jo vetëm për universitetet, pasi i rendit ata në një hierarki vlerash dhe autoriteti, por është bërë edhe një çështje prestigji dhe dinjiteti kombëtar për shumë vende. Nga këto renkime vihet re se universitetet amerikane janë në krye të listës: 8 ndër 10 universitetet më të mira të botës janë universitete amerikane. Po kështu, 23 ndër 30, 37 ndër 50 dhe 60 ndër 100 universitetet më të mira janë përsëri universitete amerikane. Universitetet europiane renditen shumë më poshtë, por edhe ndër to, disa universitete në Angli, në Suedi, në Zvicër dhe në Hollandë renditen shumë më mirë sesa universitetet franceze, gjermane dhe italiane. Në Francë, vend ky në të cilin çështja e prestigjit kombëtar mbetet e një rëndësie të veçantë, vendimi i qeverisë së këtij vendi disa kohë më parë për të reformuar sistemin e arsimit të lartë duket se u motivua drejtpërdrejt pikërisht nga renkimi ndërkombëtar i universiteteve më të mira.

Modelet kryesore të sistemit universitar dhe debati bashkëkohor

Prej mëse një shekulli, Amerika është bërë fuqia më e madhe ekonomike, politike, ushtarake, teknologjike dhe kulturore e globit. Ajo i kontribuon planetit tonë 1/4 e GDP së tij; në të graviton pesha politike e mbarë globit; kapacitetet ushtarake të saj janë më të mëdha se ato të të gjitha vendeve të marra së bashku; teknologjia e saj është shumë më e avancuar se ajo e vendeve më të zhvilluara që vijnë pas saj; kultura amerikane është përhapur në të katër anët e globit dhe influencon këdo; universitetet më të mira të saj (dhe të tilla, siç thamë më sipër, janë shumë) nuk kanë të krahasuar me universitetet e vendeve të tjera të zhvilluara.

Josef Joffe, eksperti më i njohur gjerman në fushën e marrëdhënieve ndërkombëtare, duke krahasuar Shtetet e Bashkuara me fuqi të tjera të mëdha në të kaluarën, ka vënë në dukje se, në dallim nga ato, burimi i fuqisë së Amerikës është *truri* i saj. Ndryshe nga pushteti i mbretërve Habsburgë të Spanjës, fjala vjen, të cilin e mbante në këmbë argjendi i Amerikës Latine, ose ndryshe nga Gjermania e fillimit të shekullit të 20-të dhe e viteve 1930, forca e së cilës mbështetej në makinën ushtarake dhe në industrinë që punonte për të, Amerika ka mbledhur dhe vazhdon të mbledhë shkencëtarët më të mirë nga e gjithë bota (Joffe 2006b). Kjo e bën Amerikën të dominojë në çdo fushë të kreativitetit dhe të veprimtarisë njerëzore (në ekonomi, në politikë, në fushën ushtarake, në shkencë, në teknologji dhe në kulturë), dominim i cili nuk ka të bëjë me qenien në krye të administratës amerikane të këtij apo atij presidenti, por me potencialet e mëdha krijuese, me pasuritë e jashtëzakonshme të këtij vendi, si edhe me shkallën e lirisë që ekziston atje.

Universitetet amerikane kanë, më shumë se në çdo vend tjetër të botës, atë që sociologu i shquar amerikan Robert K. Merton në vitet 1940 e quante “ethos of science”. Amerika dominon pushtetin e truve të botës, çka do të thotë se ajo, jo vetëm mendon për të ardhmen, por ka edhe çelësin e saj. Dhe nëse klasa e mesme e “fshatit global” në të cilin jetojmë, me rritjen e vazhdueshme të konsumit masiv që është karakteristikë e shoqërisë moderne, po e dëmton edhe më shumë biosferën e planetit tonë, nuk ka dyshim se do të jenë pikërisht universitetet amerikane ato që do realizojnë studimet dhe do të shpikin metodat e duhura për ta riparuar këtë dëm.

Por le t’i kthehemi temës tonë kryesore, duke u mundur t’i japim përgjigje pyetjes: Çfarë i bën universitetet amerikane të kenë këtë autoritet dhe prestigj që ato gëzojnë? Ose, çfarë e dallon “modelin amerikan” të universitetit nga modelet e sistemeve të tjera të arsimit të lartë në Perëndim?

Në të vërtetë, sistemi i arsimit të lartë në SHBA nuk ka një model të vetëm. Ajo që është unike për këtë vend është *mjedisi social*, i cili e ka bërë të mundur suksesin e sistemit universitar amerikan. Madhësia dhe pasuria materiale e universiteteve më të mira amerikane krijojnë, pa dyshim, avantazhe të dukshme ndaj universiteteve të gjitha vendeve. Mjafton të përmendim se vetëm Universiteti i Harvardit kishte, në vitin 2008, një fond të krijuar prej donacioneve që llogaritej në rreth 37 miliardë dollarë, shumë kjo më e madhe se ajo e donacioneve të të gjitha universiteteve britanike të marra së bashku, përfshirë edhe Oksfordin (3,5 miliardë në vitin 2007) dhe Kembrixhin, bashkë me kolegjet e tij (3.95 miliardë në vitin 2009). Vetëm nga investimet e kësaj pasurie, Universiteti i Harvardit gjeneron të ardhura që i kalojnë çdo vit vlerat e donacioneve të Oksfordit, ose të Kembrixhit, dhe që janë më të mëdha se GDP-ja e përgjithshme e disa vendeve të vogla, si Armenia apo Maqedonia. Llogaritur për numrin e studentëve, buxheti vjetor i Universitetit të Princetonit, në Nju Xhërsi, ia kalon atij të Harvardit.

Sidoqoftë, superioriteti i sistemit universitar amerikan (sidomos i universiteteve

më të mira të këtij vendi) është i lidhur, në radhë të parë, me *sistemin e drejtimit* si të universiteteve private, ashtu edhe të universiteteve publike, sistem i cili kombinon *autonominë relative* prej qeverisë, nga njëra anë, me *administrimin e centralizuar*, nga ana tjetër. Mjedisi amerikan karakterizohet, gjithashtu, nga një etos konkurrues si edhe nga një shkallë filantropie dhe pagesa shkollimi shumë më të larta se në çdo vend tjetër.

Debati bashkëkohor mbi arsimin e lartë është përqendruar dhe vazhdon të fokusohet në atë se si mund të replikohen, ose të adaptohen, disa nga parakushtet e suksesit amerikan në vende të tjera. Diskutimet kryesore janë bërë dhe bëhen rreth dy çështjeve themelore, siç janë: (a) *struktura e sistemit* të arsimit të lartë dhe (b) *financimi dhe administrimi* i këtij sistemi. Këto çështje, në mënyrë të përmbledhur, i analizojmë më poshtë:

Struktura e sistemit të arsimit të lartë

Sa herë që institucionet politikëbërëse dhe vendimmarrëse diskutojnë të përmirësojnë apo të reformojnë sistemin e arsimit të lartë në një vend të caktuar, përfshirë edhe Shqipërinë vitet e fundit, ato përpiqen të konsultojnë dhe të përshtasin njërin (apo më shumë se një) prej katër modeleve strukturore kryesore. Këto modele janë:

Modeli amerikan

Modeli amerikan është, pa dyshim, “standardi i artë”, të cilin përpiqen ta imitojnë, ose ta përshtasin, sipas kushteve dhe nevojave të tyre, pjesa më e madhe e vendeve të botës. Në Shtetet e Bashkuara ka mbi 2,500 universitete dhe kolegje; shumë prej tyre janë private, shumë të tjera mbështeten nga shteti, një pjesë kanë mbështetje private dhe shtetërore. Më shumë se gjysma e universiteteve të këtij vendi janë krijuar pas Luftës së Dytë Botërore. Shumë universitete amerikane kanë programe akademike dhe profesionale pasuniversitare (*graduate programs*), të tjera ofrojnë vetëm kurse dhe diploma universitare. Disa universitete janë të orientuara në arsimimin liberal në shkenca dhe arte, duke e vënë theksin kryesisht në mësimdhënie dhe më pak në veprimtari kërkimore; të tjerë i kushtojnë prioritet kërkimit dhe “trajnimin” në krahasim me mësimdhënien dhe janë të orientuara nga shkencat natyrore dhe biznesi.

Pavarësisht këtyre dallimeve, struktura e pothuajse të gjitha universiteteve dhe kolegjeve amerikane është e ngjashme në kuptimin që të ardhurat e tyre vijnë nga pagesat e shkollimit, kontributet dhe donacionet dhe, për institucionet shtetërore, nga buxheti për arsimin. Struktura dhe mënyra e drejtimit të universiteteve është e centralizuar: në krye të saj janë Presidenti i Universitetit dhe një bord i vogël të besuarish (*board of trustees*). Përveç kërkimeve që kryhen nga institutet kërkimore kombëtare, nga

industria private, nga institucionet që kanë të bëjnë me sigurinë kombëtare dhe nga organizatat *think tank* të profilizuara në shkencat sociale të aplikuara, veprimtaria më e madhe kërkimore në SHBA realizohet në 50 universitetet më të mira kërkimore të këtij vendi (në ato që quhen *research universities*). Pjesa më e madhe e buxhetit për R&D (*Research & Development*—kërkim dhe zhvillim) në universitetet amerikane financohet nga korporatat dhe industritë e mëdha. Gjatë 30 vjetëve të fundit, financimi i kërkimeve shkencore në universitetet amerikane nga ana e kompanive industriale është rritur mbi 500 përqind. Vetëm në vitin 2003, shpenzimet e universiteteve kryesore amerikane për kërkime shkencore arritën vlerën 40 miliardë USD.

Një tipar dallues i sistemit amerikan është se fokusi dhe aktivitetet arsimore dhe ato kërkimore në universitetet e këtij vendi kanë qenë dhe janë të lidhura *institucionalisht* ndërmjet tyre që nga koha kur Presidenti Abraham Linkoln themeloi Akademinë Kombëtare të Shkencave më 1863, por, më shumë akoma, që nga koha e “Projektit Manhattan”, në vitet 1942-1946. Një lidhje e tillë institucionalisht organike midis mësimi dhe kërkimit ka mundur, më shumë se në çdo vend tjetër të botës, që idetë, stafet akademike dhe resurset njerëzore e financiare të qarkullojnë midis universiteteve dhe sektorëve të tjerë të shoqërisë. Si shembuj mund të përmendim bashkëpunimin Harvard/MIT (Massachusetts Institute of Technology); Bell Labs, DARPA (Defense Advanced Research Projects Agency) dhe RAND Corporation, etj. Në Shtetet e Bashkuara, kjo lidhje midis arsimit dhe kërkimit merret si e mirëqenë, gjë që nuk është e vërtetë për vende të tjera.

Modeli kontinental

I krijuar së pari në Europën kontinentale, ky model dallon shumë nga i pari. Pothuajse të gjitha universitetet e ndërtuara sipas këtij modeli janë publike dhe financohen nga buxheti i shtetit (kombëtar apo federal), ose provincial. Shumica e këtyre universiteteve drejtohen nga një Rektor. Senati i një universiteti të tillë, i përbërë nga anëtarë të stafit akademik, ka një peshë më të madhe në drejtimin e universitetit sesa senatet e universiteteve amerikane. Në vendet që aplikojnë këtë model, është qeveria ajo që përcakton buxhetin për çdo universitet dhe fare pak përpjekje bëhen për të gjeneruar fonde apo donacione bamirëse për sektorin e arsimit.

Për shkak të parimeve të shtetit të mirëqenies, në këto vende studentëve u kërkohet të paguajnë fare pak apo aspak për studimet e tyre të larta, çka do të thotë se mundësitë për të financuar sistemin e arsimit të lartë përmes të ardhurave nga regjistrimet e studentëve janë tepër minimale. Përveç kësaj, në shumë universitete europiane theksi vihet jo në konkurrencën, por në egalitarizmin dhe në trajtimin e barabartë, gjë që ka çuar në politika të pranimeve falas të një numri shumë të madh studentësh në një institucion të vetëm (më shumë se 100,000 studentë në Universitetin La Sapienza të Romës; 70,000 studentë në Universitetin e Vienës) si edhe në një rënie të ndjeshme të kushteve dhe të standardeve të mësimdhënies. Në

vendet e Europës kontinentale kërkimi i kualifikuar shkencor realizohet kryesisht jashtë universiteteve, në qendra dhe institute kërkimore kombëtare, si për shembull, Centre National de la Recherche Scientifique (CNRS) në Francë, apo Instituti Max Planck në Gjermani, të cilat edhe pse në më të shumtën e rasteve “ushqehen” nga sistemi universitar, nuk i japin këtij të fundit thuajse asgjë në shkëmbim. Edhe pse vitet e fundit kanë filluar të krijohen universitete private (siç është, për shembull, Universiteti Zeppelin, në Gjermani), ata janë, përgjithësisht, të vegjël dhe të marxhinalizuar në sistemin e arsimit të lartë.

Modeli francez

Ky model mund të thuhet se është i ngjashëm me modelin kontinental. Sidoqoftë, në Francë, krahas me sistemin e universiteteve publike, shteti ka krijuar, qysh nga shekulli i 18-të, një sistem paralel të “shkollave të mëdha” (*grandes écoles*), në të cilat tradicionalisht është përgaditur elita ekonomike dhe politike franceze. Kjo elitë duket se është, në parim, meritokratike dhe pranimi në këto shkolla bëhet në bazë të konkurimit. Megjithatë, aksesimi në këto shkolla nuk është i njëjtë për të gjithë (çka do të thotë se ky sistem nuk është i hapur për këdo) dhe elita franceze, në tërësi, vazhdon të riprodhojë vetveten. *Grandes écoles* financohen përgjithësisht nga shteti. Cilësia e tyre më e lartë, krahas lehtësive që krijon për to CNRS dhe disa institucione të tjera kërkimore të klasit të parë, kanë bërë që elita shkencore dhe intelektuale franceze të ruajë prestigjin e saj edhe në kushtet e një rënije të ndjeshme të sistemit të universiteteve publike në këtë vend.

Modeli britanik

Ky model dallon si nga modeli amerikan, ashtu edhe nga ai evropian, pasi universitetet angleze nuk janë ekzaktësisht as institucione shtetërore, as private. Ato janë institucione publike, të cilat mbështeten dhe subvencionohen nga qeveria, por nuk financohen krejtësisht prej saj. Financimi i tyre bëhet nga British Exchequer, një agjenci e veçantë qeveritare (e krijuar qysh në shekullin e 12-të nga Mbreti Henri I), përmes një procesi, i cili ruan një barrierë midis universiteteve dhe qeverisë, duke u dhënë universiteteve britanike më shumë autonomi nga ajo që gëzojnë universitetet publike në Europë. Pavarësisht nga kjo, sistemi universitar në Britani, siç pohonte pak ditë më parë Timothy Garton Hash (2010) në një ese botuar në gazetën MAPO, ka problemet e veta. Gjatë dekadave të fundit, sidomos duke filluar nga qeveria e Kryeministres Margaret Thatcher, të gjitha qeveritë britanike i kanë shkurtuar buxhetet për universitetet e vendit dhe kanë bërë ndryshime masive në sistemin tradicional britanik të arsimit të lartë, i cili për një kohë shumë të gjatë kishte funksionuar shumë mirë, veçanërisht për elitën e këtij vendi. Një politikë esencialisht populiste e ndjekur nga konservatorët anglezë në vitet 1980 çoi në konvertimin e një numri të madh shkollash politeknike nëuniversitete, gjë që përveçse rriti numrin e studentëve me diploma universitare, çoi pashmangësisht, nga njëra anë në rënien

e standardeve dhe të prestigjit të universiteteve britanike në përgjithësi dhe, nga ana tjetër, në thellimin e hendeikut midis universiteteve kërkimore angleze më të mira dhe një grupi universitetesh të klasit të dytë, pothuaj njëlloj siç ka ndodhur në Francë.

Financimi dhe administrimi i sistemit universitar

Nga parashtrimi i mësipërm mbi strukturën e sistemeve universitare, kuptohet se mënyra se si financohen universitetet luan një rol shumë të rëndësishëm në masën e pagesës që ato kërkojnë për pranimet e studentëve. Meqënëse në pjesën më të madhe të vendeve arsimit të lartë financohet nga shteti, masivizimi i universiteteve është shoqëruar, përgjithësisht, me rritjen e buxheteve për sistemin e arsimit të lartë. Sidoqoftë, në periudha ekonomike të vështira, veçanërisht në periudha krizash, ministrat e financave përgjithësisht hezitojnë t'i kalojnë sektorit të arsimit një pjesë të buxhetit të alokuar për sektorët e tjerë. Një ndër arsyt është edhe fakti se problemet dhe sfidat e krijuara nga përkeqësimi i sistemit të arsimit universitar nuk kanë për politikëbërësit dhe institucionet vendimmarrëse atë rëndësi që kanë, fjala vjen, rënia apo falimentimi i një industrie të dhënë.

Natyrisht, përjashtimet nuk mungojnë. Në vitin 2003, qeveria britanike vendosi të rrisë shpenzimet për kërkime shkencore për tre vitet pasardhëse në masën 30 përqind, në mënyrë që të rikuperonte një pjesë të shkurtimeve të bëra në dekadat e mëparshme. Po kështu, qeveritë e Singaporit dhe të Taivanit kanë dhënë prej vitesh shembullin më të mirë duke bërë investime masive në sistemin e arsimit të lartë dhe në studime të avancuara. Qeveritë e disa vendeve të tjera kanë investuar në mënyrë selektive në ata sektorë që ato i gjykojnë strategjikë. Të tilla janë fondet e konsiderueshme që qeveria zvicerane investon prej kohësh për Institutin Federal Zviceran të Teknologjisë në Zyrih (Swiss Federal Institute of Technology Zurich), një ndër institutet kërkimore më prestigjioze në botë, i cili mund të konsiderohet si ekuivalenti zviceran i Massachusetts Institute of Technology. Po kështu, investime serioze janë ato të qeverisë indiane në të pesëmbëdhjetë filialet e Institutit Indian të Teknologjisë (Indian Institute of Technology), të cilat janë vlerësuar nga parlamenti indian si Institute të Rëndësisë Kombëtare. Nga ana e saj, Europa ka vite që përpiqet të dekurajojë largimin e ekonomistëve të saj drejt Amerikës, ndërsa qeveria kineze po investon mjaft për të ngritur një sistem universitetesh të klasit të parë, me të cilët të konkurojë në tregun global të dijes dhe të ekonomisë.

Financimi i universiteteve është i lidhur ngushtë me çështjet e drejtimit administrativ të tyre dhe të lirisë akademike. Ajo që e karakterizon debatin e sotëm mbi këtë temë është ideja se profesorati dhe stafi pedagogjik dhe kërkimor, të cilët me të drejtë konsiderohen si baza (apo shpirti) i universitetit, duhet të kenë liri të plotë dhe fjalën e fundit në çështjet akademike. Liria akademike, siç formulohet ajo

në Deklaratën e Limës mbi Lirinë Akademike dhe Autonominë e Institucioneve të Arsimit të Lartë, të vitit 1988, është një parim i shenjtë, i cili synon të mbrojë lirinë e trupit pedagogjik për të menduar dhe për t'u shprehur brenda institucionit të tyre, si edhe për të qenë të imunizuar nga presionet brenda dhe jashtë sistemit që synojnë të shtypin pikëpamjet disidente. "Liria akademike", theksohet në këtë deklaratë, "është një parakusht thelbësor për ato funksione edukuese, kërkimore, administrative dhe të shërbimit, të cilat i janë besuar universiteteve dhe institucioneve të tjera të arsimit të lartë. Të gjithë anëtarët e komunitetit akademik kanë të drejtën të përmbushin funksionet e tyre pa asnjë lloj diskriminimi, pa frikë prej ndërhyrjeve apo represioneve nga shteti apo ndonjë burim tjetër".

Megjithatë, universitetet nuk ekzistojnë në një vakum dhe fondet që sigurohen nga individë apo organizata jashtë tij legjitimojnë ndikimin e tyre në mënyrën e organizimit dhe të drejtimit të universiteteve. Pavarësisht kualifikimeve dhe aftësive, prestigjit akademik e shoqëror dhe lirisë akademike që kanë anëtarët e komuniteti akademik të universiteteve, ata nuk mund të bëjnë pa administrim. Po kështu, universitetet nuk janë vetëm qendra të arsimit, të dijes dhe të shkencës, por edhe entitete ekonomike dhe, si të tilla, kanë nevojë të menaxhohen mirë që të kenë sukses dhe të zhvillohen.

Dy fjalë mbi debatin për arsimin e lartë në Shqipëri

Pavarësisht sa u tha më lart, gjithmonë ka pasur, ka dhe do të ketë tension dhe konflikte midis komunitetit akademik, nga njëra anë, dhe administratorëve të universiteteve apo autoriteteve qeveritare, nga ana tjetër, për sa i përket gjetjes së një raporti sa më optimal midis synimeve të përhershme të stafeve akademike për sovranitet akademik apo autonomi dhe kërkesave për efektivitet dhe ndryshim, të cilat një pjesë e komunitetit akademik i kontestojnë, ose nuk i mirëpresin.

Kjo duket se po ngjet aktualisht edhe në vendin tonë në kuadër të diskutimit të projektligjit mbi arsimin e lartë. Deklarime pa fund, të cilat shprehin interesa dhe qendrimet nga më të ndryshmet, si nga radhët e komunitetit akademik të universiteteve, ashtu edhe nga ana përfaqësuesve zyrtarë të sistemit të arsimit të lartë, mbushin gazetatat dhe debatet televizive, shpesh herë duke mos thënë ndonjë gjë të re, ose të informuar, përpos refrenit mbi autonominë financiare të universiteteve. Autonomia (dhe jo vetëm financiare) e universiteteve shqiptare është, pa dyshim, një kërkesë shumë e drejtë dhe që duhet mbrojtur dhe realizuar në praktikë. Por akoma më e rëndësishme se kjo autonomi është cilësia e programeve, e kurrikulave dhe e procesit të mësimdhënies në universitetet tona, pa përmendur domosdoshmërinë që universitetet shqiptare të shndërrohen në qendra të vërteta të kërkimit shkencor. Eksperienca e universiteteve amerikane dhe ajo e disa vendeve të tjera, për aq sa ato janë të dobishme për kushtet dhe mundësitë e vendit tonë, mund të studiohen dhe

të mbahen parasysh më mirë edhe nga qeveria shqiptare dhe universitetet tona, për të nisur një transformim (jo reformim) rrënjësor të sistemit të arsimit të lartë dhe të politikave që inkurajojnë studime universitare të standardeve bashkëkohore dhe kërkimin më të kualifikuar shkencor.

Bibliografia

- Baber, Z. (2006). "Globalization, Nostalgia, and the University", *Society*, Vol. 43, No. 4: 44-47.
- Calhoun, C. (2006). "Is the University in Crisis?", *Society*, Vol. 43, No. 4: 8-18.
- Carnoy, M. (2005). *Globalization, Educational Trends, and the Open Society*. Open Society Institute.
- Collins, R. (1985). *Three Sociological Traditions*. New York & Oxford: Oxford University Press.
- Hash, T. G. (2010). "Universiteteve britanike u duhet përvoja amerikane", *Gazeta MAPO*, 13 korrik, f. 10.
- Joffe, J. (2006). The John B. Hurford Memorial Lecture (A Conversation with Josef Joffe), Council on Foreign Relations, New York, 16 June; (Burimi online: http://www.cfr.org/publication/10982_john_b_hurford_memorial_lecture.htm).
- Mahbubani, K. (2005). "Asia's Destiny, America's Choice", *The American Interest*, Vol 1, No. 1: 58-68.
- Mills, C. W. (1963). *The Causes of World War III*. New York: Ballantine Books.
- Rabinovich, I. (2009). "The American Advantage", *The American Interest*, Vol. 4, No. 5: 75-81.
- Rothfork, J. (2006). "Remaking the American University: Open for Business", *Education Review*, Vol. 9, No. 3: 1-14.
- Tarifa, F. (2007). *Saga e dy kontinenteve: A po ndahen Amerika dhe Europa nga njëra tjetra?* Tiranë: Ombra GVG.

Një vështrim mbi renditjen e universiteteve nga Revista "Time" për periudhën 2011–2012

____ Prof. Dr. Përparim FUGA _____

____ Dr. Tomi TRESKA _____

Abstrakt. Para pak kohësh Revista "Time" prezantoi renditjen e universiteteve të vendeve të ndryshme të botës, sipas një klasifikimi të kryer nga ajo revistë (*Times Higher Education World Universiteti Rankings*)¹, të cilën e ka tashmë traditë të saj të përvitshme. Ky klasifikim prej kohësh është shndërruar në një industri të tërë dhe bëhet duke i renditur universitetet sipas një vlerësimi mbi cilësinë e tyre². Mjafton të mendojmë sa i madh është interesimi i prindërve dhe studentëve për të ditur se cilit universitet duhet t'i drejtohen për shkollim dhe do e kuptojmë qartë sa e madhe është kërkesa dhe vlera për një shërbim të tillë. Renditjet e kësaj natyre përgjithësisht synojnë klasifikimin e institucioneve ose të programeve, duke u fokusuar kryesisht në programet bachelor dhe ato master.

Përveç renditjes që ofron Revista Time, njihen edhe mjaft renditje të tjera, që kryen nga organizma të ndryshme ndërkombëtare (*The Leiden Ranking*³; *Shanghai Jiao Tong University Ranking*⁴; *The CHE Ranking*⁵; *Financial Times Rankings*⁶; etj.). Kuptohet se renditja e universiteteve nuk është një detyrë e lehtë po të marrim parasysh se ato janë institucione komplekse e të larmishëm për të cilët pa frikë mund të thuhet se i ndryshojnë madje jetën individit nëpërmjet ofrimit të njohurive me vlerë për përballimin e jetës në vazhdimësinë e saj, dhe që luajnë një rol të madh e të pazëvendësueshëm në zhvillimin njerëzor.

¹ <http://www.timeshighereducation.co.uk/world-university-rankings/2011-2012/top-400.html>

² Lepori B. (2007): [University rankings: Policy and value choices](#)

³ <http://www.universityrankings.ch/methodology/leiden>

⁴ http://www.universityrankings.ch/methodology/shanghai_jiao_tong

⁵ <http://www.universityrankings.ch/methodology/che>

⁶ http://www.universityrankings.ch/methodology/financial_times_rankings

Një vlerësim i universiteteve dhe renditje e tyre sipas cilësisë është e vështirë pasi cilësia dhe vlerat e asaj që realizojnë universitetet është e vështirë të njihen tërësisht e të vlerësohen saktësisht. Njihen një numër faktorësh që e kushtëzojnë këtë njohje. Së pari, të dhënat mbi arritjet dhe përpjekjet e këtyre institucioneve nuk është e lehtë të mblidhen në një bazë të vetme dhe të analizohen. Së dyti, dhe kur ato disponohen, është e vështirë të krahasohen mes tyre për shkak të dallimeve të mëdha si rrjedhojë e larmisë së dijeve që ata transmetojnë, të vendit ku e ushtrojnë aktivitetin e tyre, etj.⁷ Po ashtu, për të mundësuar një vlerësim të institucioneve universitare dhe krahasim mes tyre, shpesh është e detyrueshme të përdoren përafrime, të cilat në shumë raste rezultojnë të pabazuara dhe të pasakta.⁸

Klasifikimi i Revistës Time për periudhën 2011–2012 është bazuar në një metodologji të përpunuar pas 10 muajve konsultimi me ekspertë të shquar në fushën e arsimit të lartë. Më shumë se 50 prej tyre nga tërë kontinentet kanë dhënë ndihmesën e çmuar për këtë metodologji, të cilën e kanë përcaktuar dhe si një nga ushtrimet më të sofistikuar të ndërmarra ndonjëherë në këtë fushë. Synimi ka qenë i qartë, siguri i një transparence, krahasim i performancës mbi baza rigoroze e të pranueshme, që i ndihmon universitetet, fakultetet, politikë-bërësit, drejtuesit strategjikë të arsimit dhe prindërit e studentët që të orientohen drejt në punën dhe në interesat e tyre.

Metodologjia e përdorur për renditjen e universiteteve për vitin 2011–2012 bazohet në 13 indikatorë, të cilët janë zgjedhur në mënyrë të tillë që të përfshijnë një diapazon të gjerë aktivitetesh akademike, nga mësimdhënia dhe kërkimi shkencor te zbulimet fundamentale, transferimi i njohurive, zhvillimi i teknologjisë e bashkëpunimi me sektorin prodhues e atë të shërbimeve, etj.

Theksojmë se në vlerësimin për periudhën 2011–2012, janë përdorur 2 herë më shumë indikatorë vlerësimi në raport me 6 indikatorët e përdorur për të njëjtin qëllim në metodologjinë e zbatuar për renditjen e periudhës 2010–2011⁹. Të 13 indikatorët përfshijnë 5 fusha kryesore: mësimdhënien, kërkimin shkencor, mpakin e punimeve të botuara nga personeli akademik (shkalla e citimit), të ardhurat e përfutuara nga transferimi i arritjeve shkencore në sferën prodhuese e të shërbimit si dhe shkalla e ndërkombëtarizimit të universitetit lidhur me personelin akademik dhe kombësinë e studentëve. Në mënyrë më të hollësishme këta indikatorë janë paraqitur në Tabelën 1.¹⁰

⁷ Liu, N.C.; Cheng, Y.; Liu, L.: Academic ranking of world universities: using scientometrics - A comment to the "Fatal Attraction", in: Scientometrics, 2005, vol. 64, no. 1, p. 101-109.

⁸ Goldstein, H.; Spiegelhalter, D.J.: League tables and their limitations: Statistical issues in comparisons of institutional performance, in: Journal of the Royal Statistical Society. Series A (Statistics in Society), 1996, vol. 159, no. 3, p. 385-409.

⁹ <http://www.timeshighereducation.co.uk/world-university-rankings/2010-2011/analysis-methodology.html>

¹⁰ <http://www.usnews.com/education/best-colleges/articles/2011/09/12/methodology-undergraduate-ranking-criteria-and-weights-2012>

Nga kjo tabelë duket se disa indikatorë kanë një peshën më të madhe se të tjerët, ndër të cilët peshën më të madhe e ka indikator i që vlerëson shkallën e citimit të publikimeve shkencore të trupës akademike të universitetit (32.5%), i ndjekur nga indikator i që vlerëson nivelin e mësimdhënies dhe ai mbi kërkimin shkencor, secili me peshë statistikore prej 30%.

Tabela 1: Indikatorët e përdorur për vlerësim nga Revista "Time"

INDIKATORI		INDIKATORI INDIVIDUAL		PESHA NË PËRQINDJE (%)
1	Të ardhura nga industria/ inovacionet	1	Të ardhura nga puna kërkimore/për personel akademik	2.50
		Pesha për indikatorin		
2	Diversiteti ndërkombëtar	2	Raporti personel akademik ndërkombëtar ndaj atij vendas	3.00
		3	Raporti personel akademik ndërkombëtar ndaj numrit të studentëve	2.00
		Pesha për indikatorin		5.00
3	Mjedisi mësimdhënies dhe mësimnxënies	4	Sondazh mbi reputacionin në mësimdhënie	6.00
		5	PhD të fituara në raport me personelin akademik	4.50
		6	Studentë të pranuar për personel akademik	2.25
		7	Të ardhura për personel akademik	2.25
		8	PhD/diploma universitare të fituara	15.00
		Pesha për indikatorin		30.00
4	Vëllimi i kërkimit-të ardhurat dhe reputacioni	9	Sondazhi mbi reputacionin në kërkim	19.50
		10	Të ardhura nga kërkimi	5.25
		11	Artikuj kërkimor për personel akademik	4.50
		12	Të ardhura nga fondet publike për kërkim/të ardhura në total	0.75
		Pesha për indikatorin		30.00
5	Citimet-ndikimi në kërkimi	13	Impakti i citimeve (i normalizuar në citime për artikull)	32.50
		Pesha për indikatorin		32.50

Ndërsa në Tabelën 2 jepen të renditura emrat e dyqind universiteteve që kryesojnë listën e mijëra universiteteve nga mbarë bota. Në këtë renditje vërehet shumë qartë një dominim i kreut të saj nga ana e universiteteve të SHBA-së, të cilët zënë 75 vende ndër 200 universitetet më të mira të renditura në këtë klasifikimi, pasuar nga Anglia me 33 universitete, Holanda dhe Gjermania me 12 universitete secila, Kanadaja me 9 universitete, Australia dhe Zvicra me 7 universitete secila, Franca dhe Suedia me 5 universitete secila, Japonia me 4 universitete, Danimarka, Belgjika dhe Kina me 3 universitete secila, Norvegjia dhe Izraeli me nga 2 universitete etj.

Instituti i Teknologjisë i Kalifornisë është renditur në krye të kësaj liste, ndërsa në vend të dytë është renditur Universiteti i Harvardit, duke shënuar edhe të parën herë në historinë e tij që ky universitet e humbet kreun e listës së universiteteve më të mira në botë.

Pas universiteteve amerikane, një grup dinjitoz padyshim zënë universitetet angleze, nga të cilët 3 prej tyre janë mes 10 vendeve të para në listën në fjalë, duke i lënë të 7 vendet e tjera për universitetet amerikane. Grupi i universiteteve angleze kryesohet nga Universiteti i Oxfordit, i renditur i katërti mes 200 universiteteve më të mira, ndërsa rivali i tij i përhershëm, Universiteti i Kembrixhit është klasifikuar në vendin e gjashtë.

Kjo renditje për vitin 2010–2011 e realizuar nga Revista *Time* tregon se më shumë se 1/3 e universiteteve më të mira të botës ndodhen në Shtetet e Bashkuara dhe më shumë se gjysma e tyre (108 në 200 universitete) janë universitete amerikane dhe britanike. Me fjalë të tjera, janë universitetet anglo-saksone ato që udhëheqin renditjen e universiteteve dhe, në këto rezultate, padyshim, një rol pozitiv luan mënyra e financimit të tyre, politika e rekrutimit të personelit duke thithur vlerat më të mira intelektuale nga mbarë bota, përfshirja e kërkimit shkencor si një përparësi e veprimtarisë akademike si edhe përzgjedhja e kujdesshme e studentëve duke u fokusuar në studentë elitare. Duke e vlerësuar këtë aspekt, përpos nivelit të lartë të zhvillimit, duket se tradita anglo-saksone ka shfaqur ndikimin e saj edhe në renditjen relativisht të kënaqshme të universiteteve nga Kanadaja, Australia e Zelanda e Re, që qartazi janë renditur mjaft përpara në klasifikim në raport me mjaft shtete të tjera me thuajse të njëjtin nivel zhvillimi e potenciale njerëzore.

Një tjetër dukuri që vrojtohet është fakti se asnjë universitetet nga vendet postkomuniste nuk është klasifikuar mes 200 institucioneve arsimore elitare, me përjashtim të Universitetit të Pekinit, i renditur në vendin e 50-të. Madje në këtë listë, nuk renditet asnjë universitet nga Rusia, e njohur dikur për shkollat e larta cilësore dhe zhvillimin e gjithanshëm në shkencë, sidomos në drejtim të shkencave natyrore e teknike.

Arsyet mund të jenë disa, një prej tyre lidhet me atë që gjatë periudhës postkomuniste shumë nga këto vende humbën një pjesë të mirë të elitave të tyre

intelektuale, që u përthithën me shpejtësi në perëndim, veçanërisht në SHBA, por edhe gjetkë. Ndikim të madh ka pasur edhe kufizimi në financimin e institucioneve të arsimit të lartë dhe të kërkimit shkencor në këto vende, niveli i ulët i pagesë dhe shpërblimet e ulëta financiare për personelin akademik, infrastruktura e dobët në shumë drejtime dhe sigurisht jo pak ka ndikuar edhe politika dhe ngadalësia në reformat në këtë sferë.

Një tjetër fakt interesant është se asnjë prej universitete të Italisë, të Spanjës dhe të Greqisë, asnjë universitet nga shtetet Afrikane apo të Amerikës Latine nuk renditet mes 200 universiteteve që udhëheqin klasifikimin në fjalë. E pajustifikuar është edhe frekuenca relativisht e varfër e shfaqjes së universiteteve franceze e gjermane në krye të listës që i rendit universitetet sipas cilësisë së tyre.

Renditja e universiteteve tregon se vende të tilla si Holanda, Suedia, Zvicra, Belgjika e Norvegjia përfaqësohen me një numër më të madh universitetesh në kreun e listës në raport me vende me popullsi të përafërt me to si Italia, Spanja e Greqia, dukuri kjo që nuk mund të shpjegohet pa marrë parasysh dallimet mes niveleve që këto vende kanë në zhvillimin e tyre social dhe ekonomik.

Shumë domethënës është rasti i Izraelit¹¹, ku renditja e Universitetit të Tel Avivit brenda grupit të dyqind universiteteve elitarë mund të shpjegohet edhe me faktin e rikthimit të trurit; tërheqjes së trurit nga vendet e lindjes dhe orientimi anglo-sakson i shkollës së lartë izraelite. Një fenomen pak a shumë i njëjtë vrojtohet edhe me dy tre universitete kineze, që mund të shpjegohet njësoj me tërheqjen e trurit dhe programet speciale të shtetit kinez për shkollimin e elitës intelektuale kineze në vendet perëndimore, kryesisht në Amerikë, Angli e Japoni, me impakt të drejtpërdrejtë në universitetet kineze.¹²

Dhe së fundi, nuk mund të mos përmendim se në dominimin anglo-sakson të kreut të renditjes një rol të madh ka luajtur faktori “kërkim shkencor”, i cili përbën orientimin kryesor të universitete amerikane e angleze, me zbulime fundamentale në shkencë, me inovacione me interes për zhvillimin social, ekonomik e teknologjik dhe në shërbim të shoqërisë në nivel kombëtar e më gjerë.

Nuk ka dyshim që nëse renditja e universiteteve bazohet në një tjetër metodologji, me shumë gjasa do të kemi një renditje tjetër, ndoshta me ndonjë universitet tjetër në krye të renditjes me një ripozicionim tjetër të universiteteve në këtë listë, dikush më lartë e dikush më poshtë. Gjithsesi, ka pak gjasa që metodologji të tjera të shpien në ndryshime thelbësore dhe lista e universiteteve që i paraprijnë renditjes do ndryshojë shumë pak.

¹¹ http://www.jewishjournal.com/nation_world/article/la_donors_turn_israel_brain_drain_to_brain_gain_20100525/

¹² [http://en.wikipedia.org/wiki/Chinese_university_ranking_\(Chinese_Academy_of_Management_Science\)](http://en.wikipedia.org/wiki/Chinese_university_ranking_(Chinese_Academy_of_Management_Science))

Tabela 2: Renditja e 200 universiteteve kryesuese nga Revista "Time"

No.	University	State
1	California Institute of Technology	United States
2	Harvard University	United States
2	Stanford University	United States
4	University of Oxford	United Kingdom
5	Princeton University	United States
6	University of Cambridge	United Kingdom
7	Massachusetts Institute of Technology	United States
8	Imperial College London	United Kingdom
9	University of Chicago	United States
10	University of California, Berkeley	United States
11	Yale University	United States
12	Columbia University	United States
13	University of California, Los Angeles	United States
14	Johns Hopkins University	United States
15	ETH Zürich - Swiss Federal Institute of Technology Zürich	Switzerland
16	University of Pennsylvania	United States
17	University College London	United Kingdom
18	University of Michigan	United States
19	University of Toronto	Canada
20	Cornell University	United States
21	Carnegie Mellon University	United States
22	University of British Columbia	Canada
22	Duke University	United States
24	Georgia Institute of Technology	United States
25	University of Washington	United States
26	Northwestern University	United States
27	University of Wisconsin-Madison	United States
28	McGill University	Canada
29	University of Texas at Austin	United States
30	University of Tokyo	Japan
31	University of Illinois at Urbana Champaign	United States
32	Karolinska Institute	Sweden
33	University of California, San Diego	United States
34	University of Hong Kong	Hong Kong
35	University of California, Santa Barbara	United States

36	University of Edinburgh	United Kingdom
37	University of Melbourne	Australia
38	Australian National University	Australia
38	University of California, Davis	United States
40	National University of Singapore	Singapore
41	Washington University in St Louis	United States
42	University of Minnesota	United States
43	University of North Carolina at Chapel Hill	United States
44	New York University	United States
45	Ludwig-Maximilians-Universität München	Germany
46	École Polytechnique Fédérale de Lausanne	Switzerland
47	London School of Economics and Political Science	United Kingdom
48	University of Manchester	United Kingdom
49	Brown University	United States
49	Peking University	China
51	Pennsylvania State University	United States
52	Kyoto University	Japan
53	Pohang University of Science and Technology	Republic of Korea
54	Boston University	United States
55	University of Southern California	United States
56	King's College London	United Kingdom
57	Ohio State University	United States
58	University of Sydney	Australia
59	École Normale Supérieure	France
59	University of Pittsburgh	United States
61	University of Zürich	Switzerland
62	Hong Kong University of Science and Technology	Hong Kong
63	École Polytechnique	France
64	University of Massachusetts	United States
65	McMaster University	Canada
66	University of Bristol	United Kingdom
67	Katholieke Universiteit Leuven	Belgium
68	Utrecht University	Netherlands
69	Georg-August-Universität Göttingen	Germany
70	Vanderbilt University	United States
71	Tsinghua University	China
72	Rice University	United States

73	Universität Heidelberg	Germany
74	University of Queensland Australia	Australia
75	Emory University	United States
75	Wageningen University and Research Center	Netherlands
77	University of Colorado Boulder	United States
77	Tufts University	United States
79	Leiden University	Netherlands
80	Lund University	Sweden
81	University of Rochester	United States
81	Rutgers, The State University of New Jersey	United States
83	Durham University	United Kingdom
84	Université Pierre et Marie Curie	France
85	University of St Andrews	United Kingdom
86	University of California, Irvine	United States
87	Uppsala University	Sweden
88	Technische Universität München	Germany
89	University of Notre Dame	United States
90	Dartmouth College	United States
91	University of Helsinki	Finland
92	University of Amsterdam	Netherlands
93	Case Western Reserve University	United States
94	Korea Advanced Institute of Science and Technology	Republic of Korea
94	University of Maryland, College Park	United States
96	Michigan State University	United States
97	University of Arizona	United States
98	Purdue University	United States
99	University of Sussex	United Kingdom
100	University of Alberta	Canada
101	University of Sheffield	United Kingdom
102	University of Glasgow	United Kingdom
103	University of Cape Town	South Africa
104	Delft University of Technology	Netherlands
104	University of Montreal	Canada
106	Ghent University	Belgium
107	Royal Holloway, University of London	United Kingdom
108	Tokyo Institute of Technology	Japan
109	Humboldt-Universität zu Berlin	Germany

110	University of California, Santa Cruz	United States
111	Universität Basel	Switzerland
112	University of Bern	Switzerland
113	University of Utah	United States
114	Stony Brook University	United States
115	Eindhoven University of Technology	Netherlands
116	Université de Lausanne	Switzerland
117	Monash University	Australia
117	Trinity College Dublin	Republic of Ireland
119	Osaka University	Japan
120	Tohoku University	Japan
121	Hebrew University of Jerusalem	Israel
121	University of York	United Kingdom
123	Indiana University	United States
124	Seoul National University	Republic of Korea
125	Aarhus University	Denmark
125	University of Florida	United States
127	Arizona State University	United States
127	Queen Mary, University of London	United Kingdom
127	University of Southampton	United Kingdom
130	University of Geneva	Switzerland
131	Lancaster University	United Kingdom
131	Stockholm University	Sweden
133	University of Leeds	United Kingdom
134	University of Groningen	Netherlands
135	University of Copenhagen	Denmark
135	George Washington University	United States
135	University of Virginia	United States
138	Georgetown University	United States
139	University of Vienna	Austria
140	University of Nottingham	United Kingdom
141	École Normale Supérieure de Lyon	France
141	University of Iowa	United States
143	University of California, Riverside	United States
144	Rensselaer Polytechnic Institute	United States
145	University of East Anglia	United Kingdom
146	Newcastle University	United Kingdom

146	William & Mary	United States
148	University of Birmingham	United Kingdom
149	Birkbeck, University of London	United Kingdom
150	Brandeis University	United States
151	University of Aberdeen	United Kingdom
151	Chinese University of Hong Kong	Hong Kong
151	Freie Universität Berlin	Germany
154	National Taiwan University	Taiwan
154	Yeshiva University	United States
156	University of Exeter	United Kingdom
157	Erasmus University Rotterdam	Netherlands
157	University of Warwick	United Kingdom
159	University College Dublin	Republic of Ireland
159	Radboud University Nijmegen	Netherlands
159	VU University Amsterdam	Netherlands
162	Medical University of South Carolina	United States
162	Wake Forest University	United States
164	University of Reading	United Kingdom
164	Texas A&M University	United States
166	Tel Aviv University	Israel
167	University of Illinois at Chicago	United States
168	RWTH Aachen University	Germany
169	Université Catholique de Louvain	Belgium
169	Nanyang Technological University	Singapore
169	Université Paris Diderot - Paris 7	France
172	University of Miami	United States
173	University of Auckland	New Zealand
173	University of New South Wales	Australia
173	Queen's University	Canada
176	University of Dundee	United Kingdom
177	University of Victoria	Canada
178	University of São Paulo	Brazil
178	Technical University of Denmark	Denmark
180	University of Delaware	United States
181	Johann Wolfgang Goethe-Universität Frankfurt am Main	Germany
181	University of Liverpool	United Kingdom
181	University of Oslo	Norway

184	Iowa State University	United States
185	University of Ottawa	Canada
186	Pompeu Fabra University	Spain
187	KTH Royal Institute of Technology	Sweden
187	Eberhard Karls Universität Tübingen	Germany
189	Albert-Ludwigs-Universität Freiburg	Germany
189	University of Western Australia	Australia
191	University of Bergen	Norway
192	University of Science and Technology of China	China
193	City University of Hong Kong	Hong Kong
194	Universität Konstanz	Germany
195	Boston College	United States
196	Karlsruhe Institute of Technology	Germany
197	Georgia Health Sciences University	United States
197	University of Leicester	United Kingdom
197	Maastricht University	Netherlands
200	University of Twente	Netherlands

Vendet BRIK në arkitekturën globale të shekullit të 21-të

— Donald SHENA, MA —

Abstrakt. Ky artikull përfaqëson një analizë të sfidave dhe të zhvillimeve që pritet të ndodhin në botë në dy-tre dekadat e ardhëshme. Ai ofro një perspektivë mbi rendin e ri global, pa synuar të bëjë parashikime të vështira dhe jo realiste. Analiza fokusohet specifikisht në një fenomen të ri, siç është ngritja e fuqive të mëdha të Azisë (kryesisht e Kinës dhe Indisë), si edhe ngritja e Brazilit dhe rizgimi i Rusisë, vende të cilat kanë hyrë në zhargonin politik dhe ekonomik me akronimin BRIK. Konkluzioni në të cilin arrihet është se as Bashkimi Europian, as vendet BRIK nuk do mund ta sfidojnë dot seriozisht Amerikën në rolin e saj të lidershit ndërkombëtar për një kohë relativisht të gjatë.

Fjalë kyçe:

Lidershipi ndërkombëtar, vendet BRIK, BE, Amerika

Qysh nga mbarimi i Luftës së Ftohtë, arkitektura politike e planetit tonë dhe baza ekonomike e tij kanë pësuar ndryshime të mëdha. Ajo që mund të thuhet me siguri pas dekadës së parë të shekullit të 21-të është se vitet dhe dekadat që do të pasojnë do të shohin ndryshime edhe më të mëdha, shumë prej të cilave është e vështirë t'i parashikojmë sot. Ajo që mund të thuhet me siguri është se sot, ne jetojmë në fillimet e një epoke të re historike, tipari themelor i të cilës akoma nuk është definuar (Tarifa 2010a: 35). Ekspertë të çështjeve globale dhe të marrëdhënieve ndërkombëtare ndahen kur vjen fjala për të vlerësuar qëndrueshmërinë e sistemit të sotëm njëpolar. Disa prej tyre, të cilët i përmbahen pikëpamjes realiste se politika ndërkombëtare është një luftë e përhershme për pushtet, mendojnë se me daljen në skenë të fuqive të reja dhe me “mbylljen pak nga pak të ombrellës amerikane”, “njëpolariteti” po ia lë—ose

shumë shpejt do t'ia lërë—vendin një sistemi tjetër, në të cilin “pushteti dhe influenza do të jenë të shpërndara në mënyrë më të barabartë” (Kupchan 1999). Sipas tyre, sistemi aktual njëpolar mund të sfidohet dhe të zëvendësohet nga një sistem shumëpolar, ose nga një “koncert” i fuqive të mëdha, nëse Europa, Azia Lindore apo disa fuqi të mëdha, të marra së bashku, i shkëputen varësisë së theksuar nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe krijojnë kundërpesha ndaj supremacisë amerikane. Këtë pikëpamje e ka atikulluar mjaft qartë studiuesi i njohur gjerman Josef Joffe, i cili ka shkruar:

Librat e historisë tregojnë se Mr. Big gjithnjë inkurajon fundin e tij. Numrat 2, 3 dhe 4 do të bashkohen kundër tij, do të formojnë aleanca kundërvepruese dhe do të komplotojnë për shkatërrimin e tij. Kjo ndodhi me Napoleonin, siç ndodhi edhe me Luigjin e 14-të dhe me perandorinë e madhe të Habsburgëve, me Hitlerin dhe me Stalinin. Fuqia shkakton kundërfuqi më të madhe; ky është rregulli më i vjetër i politikës botërore” (cituar në Brooks & Wohlforth 2002: 24).

Luftrat në Afganistan dhe në Irak dhe rënia, gjatë dekadës së fundit, e popullaritetit të Amerikës thuhet në çdo rajon të botës, përfshirë edhe disa nga vendet aleate të saj në Europë, duket se e ka përtërirë zellin me të cilin shumë autorë përpiqen të argumentojnë se bota e sotme po bëhet shumëpolare. Kështu, për shembull, Peter Peterson shtronte pyetjen: “A do t'i zëvendësojnë vende të tjera Shtetet e Bashkuara në rolin e liderit botëror?”. Vetë ky autor i përgjigjej pyetjes së mësipërme në këtë mënyrë:

Ne po shkojmë gjithnjë e më shumë drejt një bote shumëpolare, në të cilën roli i Shteteve të Bashkuara do të bjerë, në terma relativë, përballë fuqive tradicionale (kryesisht Europës) dhe veçanërisht fuqive të reja që po ngrihen (kryesisht Kinës) (Peterson 2007: 21).

Një tjetër autor i njohur, Pierre Hassner, bën këtë arësyetim:

“A është vendosur se cili do të jetë fati i këtij shekulli?”. “Po”, përgjigjet ai, “nëse me këtë ne kuptojmë se nuk do të ketë më kthim mbrapa në një sistem njëpolar të hegjemonisë amerikane dhe, për rrjedhojë, [të hegjemonisë] perëndimore” (Hassner 2007: 37).

Në ditët tona është bërë thuhet e pamundur të mbrosh tezën mbi njëpolaritetin e botës së sotme, pasi gjithnjë e më shumë po shtjellohet ideja se bota është bërë ose po bëhet multipolare dhe se vendin e një fuqie hegjemone, atë të Shteteve të Bashkuara, e ka zënë, ose po e zë një “koncert i ri” fuqish të mëdha. Një “koncert” i fuqive të mëdha në kohën tonë, sipas shumicës së autorëve realistë, do të përfshinte fuqitë e mëdha të konsoliduara të globit si edhe fuqitë e

reja që po ngrihen—me fjalë të tjera, Shtetet e Bashkuara, Bashkimin European, Rusinë, Kinën, Indinë dhe Japoninë (Haass 2005; Lind 2006; Lieven & Hulsman 2006). Autorë të tjerë sugjerojnë se vende të tilla, si kuarteti Kinë, Indi, Rusi dhe Brazil—të njohura në zhargonin politik vitet e fundit, si një grup vendesh me akronimin BRIK (BRIC)—janë në prag të arritjes së statusit të fuqive të mëdha dhe se, shumë shpejt, ato do ta sfidojnë lidershipin ndërkombëtar të Shteteve të Bashkuara. Sipas tyre, këto fuqi të reja po krijojnë një “sistem alternativ” në politikën globale, ose një “arkitekturë institucionale alternative”, e cila as nuk do të konfrontohet me Perëndimin, por as do të asimilohet prej tij. Ky “rend” i ri botëror, të cilin e quajnë “një botë pa Perëndimin” (*a world without the West*), sipas tyre, synon ta shndërrojë Perëndimin, veçanërisht Amerikën, në një faktor gjithnjë e më pak të rëndësishëm në politikën globale, duke e zhvendosur qendrën e gravitetit nga Perëndimi në vendet kryesisht aziatike që po mëkëmben (Barma *et al.* 2007: 23).

Edhe pse bota e sotme vazhdon të jetë njëpolare, me Shtetet e Bashkuara të Amerikës si e vetmja superfuqi e saj, përgjithësisht pranohet se tendencat e zhvillimit të saj po çojnë drejt një strukture globale shumëpolare, në të cilët, një numur aktorësh të rëndësishëm do të luajnë role gjithnjë e më substanciale në shkallë globale, përfshirë vendet e grupit BRIK, të Bashkimit European, si edhe, ndoshta, një varg aktorësh jo-shtetërorë. Shumë vazhgues dhe analistë shprehin bindjen se ndërsa shekulli i 20-të ishte shekulli amerikan, shekulli i 21-të do të jetë një shekull *post-amerikan*—një shekull european, një shekull kinez, ose një shekull aziatik—por, sidoqoftë, një shekull, tipari esencial i të cilit do të jetë shumëpolariteti, edhe pse një *shumëpolaritet asimetrik*. Ky ndryshim i strukturës së fuqisë dhe i arkitekturës globale do të sjellë ndryshime në raportet e forcave midis fuqive kryesore të globit, si edhe në rregullat e bashkëpunimit dhe të konkurimit midis tyre, duke bërë ndoshta të dobësohen pesha dhe influenza e Washingtonit dhe të fuqizohen dhe rriten pesha dhe influenza e Pekinit, e Brukselit, e Delhit, e Moskës apo e Braziliat.

Edhe pse një rend i ri global mund të duket se po agon diku, tej në horizont, që shekulli i 21-të të jetë një shekull aziatik, kjo nuk është një perspektivë as e afërt, as e sigurt. Shtetet e Bashkuara nuk do të heqin dorë vullnetarisht nga statusi i tyre si superfuqi dhe nga influenza e tyre ende e pasfiduar seriozisht pothuajse në çdo rajon të globit. Historia nuk njeh deri më sot asnjë rast që fuqi dominuese të kenë hequr dorë vullnetarisht nga pozita e tyre për t’ia lënë vendin një fuqie të re që kërkon të dominojë. Nuk ka asnjë arsye të besojmë se Amerika, fuqia e vetme hegjemone në kohën tonë, do të veprojë ndryshe. Madje, përsa kohë që bota të mbetet kjo që është, e ndarë në *fuqi të mëdha demokratike* dhe në *fuqi të mëdha autoritariste*, është në interesin jo vetëm të Amerikës që ajo të vazhdojë të ruajë supremacinë e saj në shkallë globale, por edhe në dobi të ruajtjes së paqes dhe të stabilitetit në mbarë botën. Me fjalë të tjera, siç Stephen M. Walt, ruajtja

e supremacisë amerikane është “esenciale si për mirëqenien dhe sigurinë e vetë Amerikës, ashtu edhe për të ardhmen e lirisë” në botë; kjo supremaci “rrit sigurinë e kombit [amerikan], inkurajon një botë më të stabilizuar dhe zhvillimin e saj si edhe u jep Shteteve të Bashkuara një influencë më të madhe mbi zhvillimet globale, sesa influenca e çdo shteti tjetër” (Walt 2002: 10).

Europa, nga ana e saj, përballet me një sfidë tjetër, e cila ka të bëjë me statusin dhe rëndësinë që do të ketë ajo në rendin e ri global të shekullit të 21-të. Thomas Renard e shpreh këtë fare thjesht:

Zgjedhja që quhet të bëjë Europa është e thjeshtë: ta sundojë shekullin e 21-të, ose të lihet mënjanë prej tij. Ose Bashkimi Europian duhet të marrë pjesë në krijimin e rendit të ri dhe të bëhet një prej poleve të tij kryesore, ose ai do të mbetet në pozitën e një spektatori të thjeshtë të çështjet globale (Renard 2009b: 7).

Ky artikull përfaqëson një analizë të sfidave dhe të zhvillimeve që pritet të ndodhin në botë në dy-tre dekadat e ardhëshme. Ai përqipet të ofrojë një perspektivë mbi rendin e ri global, pa synuar të bëjë parashikime të vështira dhe jo realiste. Studimi fokusohet specifikisht në një fenomen të ri, siç është ngritja e fuqive të mëdha të Azisë (kryesisht e Kinës dhe Indisë), Brazilit, si edhe rizgjimi i Rusisë si një fuqi të madhe që nuk mund të neglizhohen, katër vende këto, të cilave këtej e tutje u referohemi me akronimin BRIK. Pjesa e parë e artikllit ofron një perspektivë historike të zhvillimeve dhe të trendeve kryesore që duket se po riformësojnë strukturën e sistemit global duke u fokusuar në tre aspekte kryesore: multipolariteti, ndërvarësia dhe multilateralizimi. Në pjesën e dytë përpqemi të identifikojmë polet kryesore që mund të formohen eventualisht, duke u mbështetur në një numër treguesish. Këtu nefokusohemi në të ashtuquajturat vende BRIK, term ky i përdorur për herë të parë nga James O’Neill (2001) dhe një grup ekonomistësh të bankës amerikane të investimeve dhe të sigurimeve globale Goldman Sachs, në një raport të publikuar prej tyre, në tetor të vitit 2003.

Aktorët kryesorë të sistemit në “Rendin e Ri Botëror”


Krijimi i një sistemi shumëpolar, nëse ky do të ishte eventualisht e ardhmja e tij, nënkupton krijimin e poleve të reja me të gjitha ato karakteristika që karakterisojnë një superfuqi. Por cilat fuqi të mëdha ka më shumë të ngjarë të bëhen pole të reja të sistemit global? Dhe, përpara se t’i jepet përgjigje pyetjes së mësipërme, një tjetër pyetje kërkon sqarim: Çfarë është një fuqi që ngrihet? Një përgjigje të pjesshme për këto pyetje na e jep Jim O’Neill, autori që pagëzoi akronimin BRIK, i cili u bë menjëherë sinonim i katër vendeve që po zhvillohen me ritme të shpejta: Brazili, Rusia, India dhe Kina. Pas këtij formulimi, akronime të tjera u vunë në

qarkullim si: BRICS (BRIC + South Africa); BRICSAM (BRIC + South Africa + ASEAN countries + Mexico) dhe BIC, ose RIC (në varësi të perceptimit se cili nga katër vendet e grupit BRIC është më i dobti në atë kuartet. Megjithatë, këto akronime nuk u japin përgjigje plotësisht pyetjeve tona.

Ekonomia e pushtetit


Parashikimet e Bankës Goldman Sachs ishin dhe janë tërësisht ekonomike. Në të vërtetë, në terma ekonomike, BRIK po ngrihet si një aktor dhe faktor i rëndësishëm global. Në vitin 1995, katër vendet e këtij grupimi gjeneruan, të marra së bashku, vetëm 7 përqind GDP-së globale; 10 vjet më vonë, më 2005, kontributi i tyre i përbashkët në GDP-në e globit arriti në 10-11 përqind, ndërsa në vitin 2009 ky kontribut u rrit në 15 përqind të GDP-së globale (e llogaritur si GDP për PPP kjo shifër arrin në 20% (shih grafikët 1 dhe 2).

Grafiku 1: GDP llogaritur si PPP 1990-2014 (në miliardë USD)



Burimi: IMF, *World Economic Outlook Database*. Washington, D.C.: International Monetary Found, 2009.


Grafiku 2: Kontributi i ekonomive më të mëdha në GDP-në globale llogaritur në përqindje si PPP në vitin 2009



Burimi: IMF, *World Economic Outlook Database*. Washington, D.C.: International Monetary Found, 2009


Sipas Jim O'Neill, ekonomitë e vendeve BRIK, të marra së bashku, do t'ua kalojnë ekonomive të vendeve më të industrializuara të grupit G-7 diku aty nga viti 2027 (si vlerë e GDP-së e matur në USD). Po sipas parashikimeve të këtij eksperti, në vitin 2050, GDP-ja nominale e Kinës mund të jetë dy herë më e madhe se ajo e Shteteve të Bashkuara, ndërsa GDP-ja e Indisë në atë kohë mund të jetë pothuajse e barabartë me atë të Amerikës. Nëse parashikimet bëhen për rritjen e GDP-së reale, sipas O'Neill, Kina do arrijë nivelin e 27 vendeve të Bashkimit European vetëm aty rreth vitit 2040, duke mbetur pas Shteteve të Bashkuara, ndësa ekonomitë e vendeve të tjera në rritje do të jenë akoma larg, si krahasuar me atë të Shteteve të Bashkuara, ashtu edhe me ekonominë e Bashkimit European (shih grafikët 3 dhe 3)

Grafiku 3: Kontributi (në përqindje) i ekonomive më të mëdha në GDP-në reale të globit në vitin 2040



Burimi: Llogaritje nga Thomas Renard, *A BRIC in the World: Emerging Powers, Europe, and the Coming Order*. Brussels, Egmont Royal Institute for International Relations: Academia Press, 2009.

Grafiku 3: Kontributi (në përqindje) i ekonomive më të mëdha në GDP-në reale të globit në vitin 2009



Burimi: Llogaritje nga Thomas Renard, *A BRIC in the World: Emerging Powers, Europe, and the Coming Order*. Brussels, Egmont Royal Institute for International Relations: Academia Press, 2009.

Përsa i përket GDP-së për frymë të popullsisë, vendet e grupit G-7 do të vazhdojnë të dominojnë mbi vendet BRIK për një periudhë shumë të gjatë kohe, kryesisht për shkak se ekonomitë e zhvilluara do të përfitojnë nga hapja e tregjeve të reja në vendet në zhvillim (O'Neill 2008/09; 2009).

Përveç vendeve BRIK, janë edhe disa vende të tjera, ekonomitë e të cilave kanë potencialin të zhvillohen shumë në dekadat që do të vijnë. Bazuar në GDP-në nominale të tyre, vende të tilla si Meksika, Indonezia, Korea e Jugut dhe ndoshta edhe Turqia mund të arrijnë nivelet e shumicës së vendeve të grupit G-7 aty rreth vitit 2050, edhe pse Meksika dhe Korea e Jugut mund të jenë në gjende deri në atë kohë që t'i rivalizojnë këto vende edhe për nga GDP-ja reale. Megjithatë, ndërsa këto vende do t'u afrohen vendeve të grupit G-7, ekonomitë e vendeve BRIK parashikohet të zhvillohen edhe më tej duke e thelluar edhe më tej distancën me vendet që vijnë pas tyre.

Një tjetër dallim i madh midis rritjes së vendeve BRIK dhe rritjes së ekonomive të vendeve të tilla si Meksika, Korea e Jugut, Indonezia, Turqia, Vietnami etj., është se BRIK ka një ndikim shumë më të madh mbi ekonominë globale se sa vendet e grupit të dytë. Në fakt, në periudhën midis viteve 2000-2007, vendet BRIK, të marra së bashku, i kontribuan rritjes së ekonomisë globale në masën 37 përqind, disi më shumë se Shtetet e Bashkuara, në sajë kryesisht të kontributit të ekonomisë kineze. Gjatë po kësaj periudhe, Korea e Jugut, Meksika dhe Indonezia i kontribuan rritjes së ekonomisë globale në masën vetëm 5.5 përqind dhe impakti i tyre (edhe nëse në këtë grup përfshijmë edhe Turqinë), do të jetë më i vogël se ai i vendeve BRIK për shkak se të parat janë tashmë më të urbanizuara dhe më të integruara në ekonominë botërore (Wilson & Stupnytska 2007).

Ekonomia dhe fuqia e një shteti


Historikisht, siç ka argumentuar në mënyrë brilante historiani i njohur Paul Kennedy (2007), fuqizimi ekonomik shumë herë u ka shërbyer shteteve të ndryshme që të rrisin influencën e tyre në shkallë globale, në radhë të parë për shkak të mundësisë që krijon zhvillimi ekonomik për rritjen e kapaciteteve ushtarake të një vendi, gjë që, nga ana e vet, e rrit edhe më shumë influencën e tyre në shallë globale. Kjo do të thotë se fuqizimi ekonomik është i lidhur ngushtë (madje mund të shihet si një kusht *i domosdoshëm*) për daljen e një vendi në skenën globale si një fuqi e madhe. Sidoqoftë, vetëm zhvillimi ekonomik nuk është një kusht *i mjaftueshëm* për t'u bërë fuqi globale dhe rasti i Japonisë është tipik. Traverton dhe Jones argumentojnë se “Fuqia e një shteti konsiston në tre nivele: (1) resurset ose kapacitetet, (2) si konvertohet fuqia që ato gjenerojnë përmes proceseve kombëtare dhe (3) rezultati i tyre, ose fakti cili shteti mbizotëron në rrethana të veçanta (Treverton & Jones 2005: 1). Niveli i tretë vlerësohet nga shumica e politikëbërësve si më i rëndësishmi, edhe pse ai është më eluzivi. Niveli i dytë është i vështirë të matet, ndërsa niveli i parë, pra resurset dhe kapacitetet e një shteti, përbën bazën dhe kriterin kryesor për matjen e fuqisë së një shteti, edhe pse treguesit në këtë nivel janë domethënës, por jo përcaktues (përsëri rasti i Japonisë) dhe duhen parë në dritën e dy niveleve të tjera.

Tradicionalisht, në nivelin e parë, i cili ka të bëjë me resurset dhe kapacitetet e një vendi për t'u bërë fuqi globale, dallohen shtatë dimensione kryesore të fuqisë, të cilat ndahen në faktorë *natyrorë* (gjeografia, popullsia, resurset natyrore) dhe në faktorë *sociale* (ekonomia, kapacitetet ushtarake, diplomacia, kultura).

Nuk është as vendi dhe as qëllimi ynë që në një artikull si ky t'i trajtojmë hollësisht të gjithë këta komponentë. Studiuesi Barry Hagues, sidoqoftë, ofron një model, sipas të cilit, fuqia e një vendi mund të llogaritet si një funksion i (a) popullsisë, (b) GDP-së, (c) teknologjisë dhe (ç) shpenzimeve për armatime konvencionale dhe bërthamore.¹ Ky model mundëson të krahasohen kapacitetet dhe fuqia e vendeve të veçanta dhe është interesant sepse përdoret si model nga Këshilli Kombëtar i Inteligjencies i Shteteve të Baskuara (U.S. National Intelligence Council) dhe, për këtë arsye, tregon se si vetë amerikanët e perceptojnë shpërndarjen e fuqisë në shkallë globale. Grafiku 5 tregon parashikimin, sipas buletinit *International Futures* të shpërndarjes së fuqisë në shkallë globale në vitet 2025 dhe 2050.

¹ “The International Futures Model” (burimi online source: <http://www.ifs.du.edu>).

Grafi 5: Parashikim mbi ndryshimet e mundshme në shpërndarjen e fuqisë ushtarake (Hard Power) në vendet kryesore të globit, deri në vitet 2025 dhe 2050 (në përqindje)



Burimi: *International Futures*

Pavarësisht modelit apo formulës së mësipërme, duhet theksuar se krijimi e një fuqie globale është rezultat i kombinimit të të gjithë faktorëve apo dimensioneve të përemendura më sipër. Përveç kësaj, duhet thënë se fuqia e një shteti mund të maten gjithnjë në terma relativë, në kuptimin që shifrat në të cilat matet fuqia e tyre në secilin nga këto dimensione bëjnë kuptim kur ato krahasohen me ato të shteteve apo të aktorëve të tjerë. Në vijim do të trajtojmë shkurtimisht disa nga këto dimensionet, të vlerësuara sipas disa treguesve specifikë.

Një ndër treguesit kryesorë që përdoret për të matur fuqinë e një vendi është *madhësia e territorit* të tij. Bazuar në këtë kriter, Shtetet e Bashkuara, vendet BRIK dhe Bashkimi Europian duhen konsideruar të gjitha fuqi të mëdha, pasi ato renditen ndër dhjetë vendet me territorin më të madh në botë, së bashku me Kanadanë dhe Australinë. Natyrisht që për dimensionin gjeografik mund të thuhet edhe më, duke përfshirë klimën e një vendi, kufijtë apo pozicionin e tij strategjik në hartë.

Nëse marrim në konsideratë *komponentin demografik*, Kina dhe India dominojnë qartë hartën e botës, duke pasur përkatësisht rreth 1.4 dhe mbi 1.1 miliardë barnorë. Nga këto dy vende, India dallohet për moshën shumë të re të popullsisë së saj. Qysh sot, gjysma e popullsisë së Indisë është nën moshën 25 vjeç, duke përbërë ndoshta popullsinë më të re në moshë në të gjithë botën (Sheridan 2006). Bashkimi Europian dhe Shtetet e Bashkuara vijnë në vend të tretë dhe të katërt përkatësisht, por plakja e popullsisë së Europës po krijon dhe do të krijojë shumë shpejt probleme dhe sfida të mëdha për këtë kontinent. Kina, gjithashtu, do të ndeshet shumë shpejt me vështirësi dhe sfida të mëdha që vijnë si rezultat e politikës më shumë se 30-vjeçare “one child policy”. Rusia, nga ana e saj, po përjeton prej vitesh një “vdekje demografike” graduale me pasoja eventualisht katastrofike (Eberstadt 2009, 2010; Tarifa 2010b).

Nga të gjithë vendet e industrializuara të Perëndimit, vetëm Shtetet e Bashkuara kanë një dinamizëm pozitiv të popullsisë, karakteristikë kjo, të cilën, Nicholas Eberstadt e cilëson si “eksepcionizëm demografik” të Amerikës (Eberstadt 2007: 52). Ky autor vë në dukje se Shtetet e Bashkuara janë tashmë jo vetëm “fuqia dominuese e botës”, por edhe “shoqëria më e populluar ndër vendet e zhvilluara”; ajo ka një popullsi mbi dy herë më të madhe se Japonia, mbi tri herë më të madhe se Gjermania dhe pesë herë më të madhe se Franca, Italia apo Britania. Sipas parashikimeve të bëra nga Zyra e Statistikave e Shteteve të Bashkuara (U.S. Census Bureau), në vitin 2050 popullsia e Shteteve të Bashkuara do të arrijë afërsisht në 420 milionë² (nga pak më shumë se 300 milionë që është sot). Duke mbajtur parasysh rënien drastike të popullsisë pothuajse në të gjitha vendet e BE-së, në mes të shekullit të 21-të Amerika parashikohet të ketë një popullsi më të madhe se ajo e 27 vendeve të Bashkimit të sotëm Europian, të marra së bashku. Parashikimet e mësipërme informojnë se hendeuku që ndan sot Amerikën nga Europa në pikëpamje të shkallës së lindshmërisë do të thellohet edhe më tej në të ardhmen.

Treguesit ushtarakë shihen zakonisht si kriteri absolut për të matur fuqinë e një shteti në një botë, në të cilën luftrat ndërmjet fuqive të mëdha shpesh herë shihen sot si “të pamundura”.³ Ky optimizëm nuk është pa precedent në histori nëse kujtojmë, për shembull, periudhën që pasoi Luftën e Parë Botërore, kur shumica e intelektualëve europianë ishin të bindur se ajo luftë ishte “lufta që u kishte dhënë fund të gjitha luftrave”. Dhe ne e dimë se ç’ndodhi vetëm dy dekada pasi ajo luftë kishte mbaruar. Çfarë garancie kemi sot se një luftë tjetër e përmasave botërore nuk do të mund të ndodhë 20 vjet më vonë? “Suprizat strategjike” janë një faktor konstant në histori (Gray 2008; Brustlein 2008). Për më tepër, sot dhe në të ardhmen, tensionet midis vendeve që po ngrihen nuk mungojnë, p.sh. tensionet midis Kinës dhe Rusisë, ose ato midis Kinës dhe Indisë, midis Kinës dhe Japonisë, midis Turqisë dhe Francës apo Bashkimit Europian. Për këtë arsye, treguesit ushtarakë janë dhe do të mbeten për shumë kohë ndër më kryesorët që përcaktojnë fuqinë e një shtetit.

Duhet vënë në dukje se numuri i forcave të armatosura është thjesht një prej treguesve, por jo ai më kryesor, që përcakton fuqinë ushtarake të një shteti. Historia dëshmon shumë raste kur ushtri të mëdha janë mundur nga forca më të pakta, të cilat kanë patur avantazh teknologjik, moral më të lartë dhe drejtues ushtarakë më të talentuar. Në këtë kuptim, jo vetëm kapacitetet dhe teknologjia ushtarake e Amerikës, por edhe komponentët e tjerë që përbëjnë fuqinë ushtarake të këtij vendi nuk kanë të krahasuar me ato të fuqive të tjera të mëdha. Amerika ka sot, ndaj shtetit më të fuqishëm që vjen pas saj, ose ndaj të gjitha fuqive të mëdha të kohës, të marra së bashku, një superioritet më të madh se ç’ka pasur ndonjëherë, gjatë tre shekujve të

² “USA Population Hits Milestone Number”, *USA Today*, October 17, 2006.

³ Shih *European Security Strategy: A Secure Europe in a Better World – European Security Strategy*. Brussels, 12 December 2003, f. 3.

fundit, ndonjë fuqi e madhe e vetme ndaj fuqive të tjera të mëdha (Wohlforth 1999: 7; Brooks & Wohlforth 2002: 21-23). Paul Kennedy, i cili në vitin 1987 predikonte rënien e fuqisë amerikane, 15 vjet më vonë, më 2002, detyrohej të pranonte se:

Deri më sot nuk ka ekzistuar asgjë e ngjashme me këtë akumulim disproporcional të fuqisë amerikane. Perandoria e Charlemagne u shtri vetëm në pjesën perëndimore të Europës. Perandoria Romake pati një shtrirje territoriale shumë më të gjerë por, në të njëjtën kohë me të, ekzistonte edhe një perandori tjetër e madhe, ajo e Persisë, dhe një tjetër perandori akoma më e madhe në Kinë. Për këtë arsye asnjë krahasim nuk mund të bëhet (Kennedy 2002).

Shpenzimet ushtarake të Amerikës janë sot, pothuajse të barabarta me ato të të gjitha vendeve të botës, të marra së bashku (Calleo 2009: 361). Në vitin 2008, fjala vjen, shpenzimet ushtarake të Shteteve të Bashkuara ishin 607 miliardë USD, ndërkohë që po atë vit, shpenzimet ushtarake të Kinës, të Indisë, të Japonisë dhe të Rusisë, të marra së bashku, ishin vetëm 219 miliardë USD, pra 2.7 herë më pak. Edhe nëse shpenzimeve të katër vendeve të mësipërme u shtojmë shpenzimet ushtarake të 27 vendeve të Bashkimit Europian, të cilat për vitin 2008, kapën shifrën 288 miliardë USD, shuma e tyre arrin 507 miliardë USD dhe është, pra, 100 miliardë USD më e vogël se ajo e shpenzimeve ushtarake të Shteteve të Bashkuara për vitin 2008 (shih Joffe 2009). Forcat ushtarake detare, ajrore dhe kapacitetet për kontrollin e hapësirës ajrore që posedon SHBA nuk rivalizohen nga asnjë shtet i veçantë apo grup shtetesh. Me fjalë të tjera, Amerika ka një supremaci të padiskutueshme në tokë, të ajër dhe në dete. Tonazhi i flotës ushtarake detare amerikane (2.85 milionë ton) është më i madh se tonazhi i flotave ushtarake detare të 17 vendeve kryesore që vijnë pas saj, të marra së bashku (2.66 milionë ton). Kjo është një supremaci, të cilën nuk e ka njohur as Britania në shekullin e 19-të, dhe asnjë fuqi tjetër e madhe detare në kohët moderne (Work 2005). Kjo supremaci, sot dhe për shumë kohë në të ardhmen, do të vazhdojë të ruhet pasi Amerika ka nën kontrollin e saj, siç shprehet Barry Posen (2003) “të përbashkëtat globale” (*global commons*)—oqeanet, hapësirën ajrore të globit dhe hapësirën përtej tij—çka i lejon Amerikës që të projektojë forcën e saj larg kufijve të vet, ndërkohë që këtë mundësi ajo nuk ua lejon shteteve kundërshtarë apo armiqësore ndaj saj.

Përveç kësaj, teknologjia amerikane është, sot për sot, e paarritshme. Asnjë fuqi tjetër në kohën tonë nuk mund të krahasohet me Shtetet e Bashkuara në aplikimin e teknologjive më të avancuara të informacionit dhe të komunikimit për nevoja ushtarake, çka ka bërë që Amerika të mos ketë asnjë rival përsa i përket aftësisë për të koordinuar dhe përpunuar informacionin mbi fushën e betejës dhe për të shkatërruar objektiva nga një distancë e largët dhe me një precizion të jashtëzakonshëm. Amerika po e bën gjithnjë e më të vështirë për fuqitë e tjera që të konkurojnë me të në këtë aspekt, për shkak se shpenzimet e saj për studim

dhe zhvillim (*research and development—R&D*) në fushën ushtarake janë tri herë më të mëdha se ato të gjashtë fuqive të tjera të mëdha që vijnë pas saj, të marra së bashku. Asnjë shtet në historinë moderne të marrëdhënieve ndërkombëtare nuk ka dominuar në këtë mënyrë mbi shtetet e tjera si Amerika.

Pas Shteteve të Bashkuara dhe Bashkimit Europian, nga vendet e kuartetit BRIK, Kina dhe Rusia janë vendet që shpenzojnë më shumë në fushën ushtarake, ndërsa Brazili dhe India, edhe pse ato i kanë dyfishuar buxhetet e tyre ushtarake qysh nga viti 1990, renditen përkatësisht në vend të pestë dhe të gjashtë. Tre aktorë të tjerë të rëndësishëm në këtë fushë janë Australia, Japonia dhe Meksika, shpenzimet ushtarake të cilave janë të konsiderueshme, por nuk është qëllimi i këtij punimi të thellohem në analizën e tyre.

Indikatorët e “butë”

Përveç treguesve të mësipërm, ka edhe shumë tregues të tjerë përmes të cilëve mund të matet fuqia e një shteti si, për shembull, sasia apo rezervat e resurseve natyrore, shkalla e urbanizimit dhe niveli i zhvillimit teknologjik etj. Sidoqoftë, këtu ne trajtojmë shkurtimisht një numur treguesish jotradicionale të fuqisë, të cilët i quajmë “tregues të butë” dhe që, në përgjithësi, mund të thuhet se përcaktojnë “fuqinë për të tërhequr” (*the power of attraction*). Në këtë kuptim, supremacia e Shteteve të Bashkuara ndaj fuqive të tjera të globit nuk duket vetëm në faktorët ekonomikë, politikë dhe ushtarakë, por shprehet, gjithashtu, edhe në një komponent tjetër të rëndësishëm, siç është *kultura* e saj. Ky komponent nuk ka të bëjë thjesht, ose vetëm me kulturën pop, me stilet artistike, preferencat dhe shijet konsumeriste, siç mendohet gabimisht shumë herë, por sidomos me kulturën artistike dhe shkencore më të lartë. Siç shkruan Fatos Tarifa në librin e tij *Saga e dy kontinenteve*, “Amerika ka jo vetëm McDonald’s, por edhe Microsoft; ajo ka edhe NBA edhe NASA, edhe Hollywood edhe Harvard” (Tarifa 2007). Amerika ka universitetet më të mira në botë, të cilat “prodhojnë” popullatën më të madhe të studiuesve me PhD, mbi 43,000 të tillë në vit (Calhoun 2006: 9). Përveç një numri të madh profesorësh nga Europa dhe nga vende të tjera, universitetet amerikane, dhe veçanërisht programet e tyre post-universitare, tërheqin një numër më të madh studentësh të huaj sesa të gjitha universitetet e botës, të marra së bashku. Tarifa shkruan se:

Ashtu si në gjysmën e dytë të shekullit të kaluar e deri më sot, qindra milionë europianoperëndimorë dhe njerëz në të katër anët e globit, do të vazhdojnë edhe më tej të jetojnë një të ardhme, dizenjoja e së cilës mban markën amerikane. Kinematografia amerikane dhe muzika pop e saj, artet vizuale dhe letërsia e saj, pikëpamja e saj gjërësisht e përhapur se diploma universitare duhet të jetë një normë për këdo, si edhe insistimi i saj në komfortin e jetesës familjare kanë marrë në ditët tona një përhapje shumë të gjërë përtej klasës së mesme, e cila, gjithashtu, ka qenë

një krijim amerikan, duke u bërë nevoja të domosdoshme për një klasë të mesme globale në çdo vend dhe rajon të globit, një klasë e mesme, e cila rritet numerikisht çdo ditë e më shumë. Dhe bashkë me të gjitha këto, Amerika ka përhapur në mbarë globin elementet themelore të besimit të saj: *lirinë e shtypit, lirinë e tregut dhe zgjedhjet e lira* (Tarifa 2010a: 204-205).

Për shkak të “pushtetit të butë” (*soft power*) të tyre (universitetet dhe qendrat kërkimore më të mira, kultura pop, moda dhe mënyra amerikane e jetesës), Shtetet e Bashkuara vazhdojnë të kenë një forcë atraktive të madhe në të katër anët e globit, përfshirë edhe Indinë dhe Kinën (Whitney & Shambaugh 2009). Shoqëritë aziatike, natyrisht, i çmojnë efektet transformuese pozitive shumë të mëdha që kanë luajtur universitetet amerikane në zhvillimin ekonomik, teknologjik, social dhe kulturor të këtyre shoqërive. Kjo ka ndodhur dhe vazhdon të ndodhë për shkak se studentët aziatikë, të diplomuar dhe të doktoruar në Shtetet e Bashkuara, si rregull, kthehen në vendet e tyre pas përfundimit të studimeve, duke sjellë me vete jo vetëm dijen bashkëkohore dhe aftësi të çmuara në shkencat inxhinierike, në mjekësi, në arkitekturë etj, por edhe atë “American Dream” që i bën ata të besojnë se çdo individ mund të arrijë sukses në jetë, pavarësisht kastës apo klasës shoqërore nga e cila vjen. Kishore Mahbubani shkruan se, ashtu sikurse “Katër Modernizimet” e Ten Sjaopinit nuk do të kishin patur sukses, nëse ky udhëheqës refomator i Kinës nuk do t’i kishte inkurajuar aspiratat e popullit kinez me shembullin e modelit amerikan dhe me ëndrrën ekonomike amerikane, “është vështirë të mendohet se si do t’i kishte arritur sukseset e saj Azia moderne pa kontributin amerikan” (Mahbubani 2005: 60-61).

Edhe pse Amerika mbetet vendi më atraktiv ndër të gjitha vendet e zhvilluara të botës, është Europa ajo që, zakonisht, konsiderohet se zotëron “pushtetin e butë” më të madh dhe modelin social më atraktiv, gjë që, për mendimin tonë, është vetëm pjesërisht e vërtetë. Sidoqoftë, vitet e fundit, ne shohim se vende të tilla si India po përpiqen të zgjerojnë “pushtetin e butë” të tyre përmes, fjala vjen, produkteve kinematografike të Bollywood-it apo progresit të dukshën në teknologjinë e informacionit.

Një tregues tjetër jotradicional i fuqisë është mënyra se si *perceptohet* fuqia. Në fakt, fuqia nuk ka të bëjë vetëm me faktorë objektivë, por përcaktohet edhe nga mënyra se si e perceptojnë fuqinë e tyre aktorë të ndryshëm dhe si perceptohen ata nga të tjerët. Nuk është e rastit dhe as e habitshme, për shembull, që një sondazh i i zhvilluar në shkallë globale në vitin 2006 tregoi se Shtetet e Bashkuara konsiderohen sot si fuqia kryesore e globit.⁴ Kina renditej në vend të dytë, kurse Bashkimi European renditej më poshtë, kryesisht për shkak të përgjigjeve të një numri të madh europianësh. Përsa u përket pritshmërive mbi fuqitë më të mëdha të globit në vitin 2020, pjesëmarrësit në këtë sondazh u shprehën në masë se parashohin një rënie të

⁴ “World Powers in the 21st Century”, Berlin: Bertelsmann Stiftung, 2 June 2006.

ndjeshme të fuqisë së Shteteve të Bashkuara dhe një rritje të fuqisë së Kinës dhe të Indisë dhe, në një masë më të vogël, fuqizimin e Brazilit, ndërsa me përjashtim të pjesëmarrësve europianë në këtë sondazh, Bashkimi European perceptohet si një fuqi që do vijë duke u dobësuar.

Së fundi, një indikator tjetër është *mirëqënia subjektive*, e cila ka të bëjë me kënaqësinë ose pakënaqësinë që njerëzit shprehin përsa i përket cilësisë së jetës së tyre. Sondazhi global i organizatës Gallup (Gallup World Survey) për vitin 2008⁵ tregon se qytetarët janë shumë të lumtur në Shtetet e Bashkuara dhe në vendet e Bashkimit European, më pak të lumtur në Brazil dhe në Rusi dhe shumë të palumtur në Indi dhe në Kinë. Sidoqoftë, pritshmëritë rezultojnë të tilla që në vendet që po ngrihen, njerëzit shprehin përgjithësisht besim se, në të ardhmen, ata do të jenë po aq të lumtur sa edhe njerëzit në vendet e zhvilluara.

Vendet BRIKS

Nga sa parashtruam mv sipër dhe duke u mbështetur në disa tregues kryesorë, sugjerojmë se pas akronimit BRIK mund të “fshihet” një histori edhe më e rëndësishme: KINA. Në fakt, “dragoi” aziatik, siç i referohen shpesh këtij vendi, është sot për sot e vetmja ekonomi që mund të sfidojë vërtet vendet e zhvilluara brenda një kohe relativisht të shkurtër. Shumë analistë parashikojnë se Kina do të bëhet një vend po aq i pasur sa edhe Bashkimi European brenda 30 vjetëve të ardhshme (Renard 2009b). Kriza ekonomike e viteve 2008-2009 i dha Kinës mundësi të demonstrojë qëndrueshmërinë e zhvillimit të saj, edhe pse gjatë vitit 2009 produkti i përgjithshëm kombëtar i këtij vendi ra në masën 50 përqind për shkak pikërisht të ndikimit të kësaj krize. Siqodoqoftë, ekonomia kineze mundi të ruajë një rritje prej 8-9 përqind në vitin 2010 dhe po kaq në vitin 2011. Kina konsiderohet sot si një ekonomi e maturuar dhe një aktor shumë i rëndësishëm në ekonominë globale dhe si një ndër liderët e grupit G-20 (Renard 2009a).

Për t’u ngritur në statusin e një globale, Kina mund të mbështet edhe në kapacitetet e saj ushtarake, të cilat, për hir të së vërtetës, dallohen më shumë për sasinë, sesa për cilësinë e tyre, në një kohë që buxheti ushtarak i saj është rritur nga viti në vit dhe, sipas Departmaneit të Mbrojtjes të Shteteve të Bashkuara, mund të jetë realisht mbi dy herë më i madh se të dhënat zyrtare që japin vetë autoritetet zyrtare kineze.⁶ Në fakt, nga pikëpamja e fuqisë ushtarake, Kina qysh sot shihet si një fuqi e madhe dhe është, sot për sot, i vetmi vend në kuartetin BRIK që po ngrihet si një fuqi e tillë.

⁵ Gallup World Survey, cituar në *OECD Factbook 2009*. Paris: OECD, 2009, ff. 254-255.

⁶ “Military Power of the People’s Republic of China 2009”, *Annual Report to Congress*, Washington: Office of the Secretary of Defense, March 2009.

Pas “dragoit” aziatik vjen “elefanti”, siç i referohen zakonisht Indisë. Ky vend ka, pa dyshim, një ekonomi që po fuqizohet me ritme të shpejta, rritje e cila parashikohet të jetë mbi 6 përqind edhe për disa dekada të tjera. Ndër vendet BRIK, India është e konomia e dytë më e madhe, pas Kinës, dhe me ritmet e sotme dhe ato të pritshme të zhvillimit të saj mund ta thellojë edhe më tej distancën që e ndan atë si nga Brazili, ashtu edhe nga Rusia. Për më tepër, për shkak të popullsisë së saj shumë të re në moshë, India nuk rrezikon të ndeshet me një sfidë demografike për një kohë relativisht të gjatë, siç po ndodh aktualisht me Rusinë dhe siç do të ndodhë edhe me Kinën brenda një kohe jo shumë të gjatë. Si një fuqi ushtarake, India ka një buxhet mbrojtje më të vogël se ai i Kinës, por India mund të mbështetet në ushtrinë e saj numerikisht shumë të madhe, edhe pse ajo ka nevojë për modernizimin e saj dhe, sidomos, për një flotë detare të fuqishme që të mund të përballojë sfidën kineze. Në analizë të fundit, India pritet të ndjekë rrugën e Kinës, duke bërë progres gjithnjë e më të madh si një fuqi në rritje, edhe pse jo me të njëjtat ritme si të fqinjët të saj.

Brazili dhe Rusia janë vendet në zhvillim që po ngrihen me ritme më pak të shpejta sesa Kina dhe India, por kjo s’do thotë se këto dy vende nuk po ngrihen. Pas një dekade stanjacioni dhe rënieje, duke filluar nga viti 2000 ekonomia e Rusisë ka njohur një rritje vjetore prej 6-7 përqind në vit dhe, pavarësisht sfidave politike, demografike dhe ekonomike që do i duhet të përballojë, ky vend duket se do të ketë ritme rritjeje ekonomike më të larta sesa ato të të gjitha vendeve të zhvilluara të Europës Perëndimore. Brazili, nga ana tjetër, edhe pse nuk ka hyrë akoma në klubin e fuqive të mëdha, po ngrihet ekonomikisht si një fuqi e madhe që nuk mund të neglizhohet, duke u bërë vendi lider në kontinentin amerikanojugor, njëlloj si Kina që ka marrë këtë rol në kontinentin aziatik. Njoftimi disa javë më parë se ekonomia braziliane, la pas për nga prodhimi i përgjithshëm ekonomik, ekonominë britanike⁷ dëshmon se Brazili do të fitojë një peshë ekonomike dhe politike edhe më të madhe në sistemin global në të ardhmen.

Pas vendeve BRIK qendrojnë një varg vendesh të tjera, të cilat, në të ardhmen, mund të zhvillohen si fuqi të rëndësishme në skenën globale. Ato janë Meksika dhe Indonezia, por edhe Japonia dhe Kora e Jugut, pa harruar, gjithashtu, Afrikën e Jugut, e cila duket se do të bëhet lideri i kontinentit afrikan. Sidoqoftë, asnjë nga këto vendet e fundit nuk do të mund të pretendojë të bëhet një pol kryesor në rendin e ardhshëm botëror në gjysmën e parë të shekullit të 20-të.

Pavarësisht nga sa parashtruam më sipër, unë nuk mendoj se vendet BRIK do të mund sfidojnë seriozisht Shtetet e Bashkuara dhe të krijojnë një pol të ri në skenën globale. Pikëpamja që i sheh vendet BRIK si një rival potencial të Shteteve të Bashkuara i ekzagjeron mundësitë që kanë vendet e përfshira në këtë grupim për një zhvillim ekonomik *të qëndrueshëm* dhe *afatgjatë*. Sipas disa prej

⁷ BBC News, 26 December 2011, “Brazilian economy overtakes UK’s, says CEBR”.

tyre, me përjashtim të Rusisë, tre vendet e tjera të këtij grupimi nuk kanë resurset e domosdoshme natyrore që do të mundësonin *diversifikimin* e ekonomive të tyre kombëtare.

Po kështu, ne shpesh harrojmë se suksemi ekonomik i Brazilit, i Indisë dhe i Kinës janë bërë të mundur dhe varen, në një masë të madhe, nga zgjerimi i marrëdhënieve të tyre tregtare me shtete më të zhvilluara se ato vetë, veçanërisht me Shtetet e Bashkuara të Amerikës, me Japoninë dhe me vendet e Bashkimit Europian. Ngritja ekonomike e vendeve BRIK dëshmon pikërisht një ndër arritjet më të mëdha të Amerikës në botën e sotme. Duke garantuar siguri, duke eksportuar kapitalin e saj, duke shitur mallra dhe shërbime dhe duke krijuar teknologji të reja, Amerika ka mundur realisht fuqizimin e tyre (Tarifa 2010a: 92). Siç shkruan një analist i njohur, suksemi i këtyre vendeve, dhe veçanërisht i Kinës, i detyrohet shumë “forcës së shembullit amerikan, depërtimit të kapitalit nga Shtetet e Bashkuara (dhe nga vende të tjera kapitaliste më të zhvilluara), si edhe arsimimit që legjione të tëra kinezësh kanë marrë në universitetet më të mira amerikane” (Menon 2009: 353). Njëllon si Kina, edhe bumi ekonomik i Indisë, qysh nga fillimi i viteve 1990, është shoqëruar nga një zgjerim i madh i marrëdhënieve ekonomike midis këtij vendi dhe Shteteve të Bashkuara. Amerika është bërë sot investuesi më i madh në ekonominë indiane dhe, gjatë dy dekadave të fundit, shkëmbimet tregtare midis këtyre dy vendeve, pothuajse janë katërfishuar (ibid).

Duke ndjekur këtë linjë arsyetimi, ka autorë, të cilët argumentojnë se ekonomitë në rritje të vendeve BRIK përfitojnë mjaft nga stabiliteti i ekonomisë në shkallë botërore dhe nga institucionet ndërkombëtare ekonomike dhe financiare ekzistuese (Banka Botërore dhe Fondi Monetar Ndërkombëtar) dhe, për këtë arsye, ato nuk janë të interesuara t’u kundërvihen atyre për të krijuar një “arkitekturë institucionale alternative”. Për më tepër, lëkundjet në stabilitetin ekonomik dhe krizat apo gjysmëkrizat që mund të pësojnë ekonomia e Shteteve të Bashkuara apo ekonomia europiane nuk mundet veçse të kenë efekte tronditëse për ekonominë në shkallë globale, pra edhe për ekonomitë e vendeve BRIK, siç u provua më së miri nga kriza e sistemit financiar në vitet 2008–2009.

Autorë të tjerë mendojnë se, pavarësisht suksesit të jashtëzakonshëm që kanë arritur këto vende, ato ndeshen me një varg sfidash ekonomike, sociale, demografike (në rastin e Kinës dhe të Rusisë, edhe politike), të cilat mund të mos arrijnë t’i përballojnë. Shumë herë, ata që profetizojnë triumfin e botës joperëndimore dhe të një sistemi shumëpolar që do t’i zërë vendin sistemit aktual njëpolar, flasin me ekzaltim mbi sukseset e këtyre vendeve dhe nuk harrojnë në asnjë rast të theksojnë problemet me të cilat ndeshen Shtetet e Bashkuara. Për më tepër, ndërsa problemet dhe sfidat me të cilat ndeshen vendet BRIK autorë të tillë i konsiderojnë jo shumë të rëndësishme, problemet me të cilat ndeshet Amerika i quajnë të jashtëzakonshme.

Përfundime

Është gjithmonë e vështirë të parashikosh se çfarë do kujtojë dhe çfarë do harrojë historia e njerëzimit nga ngjarjet dhe zhvillimet e saj. Shumë analistë, ekspertë dhe gazetarë janë gati të festojnë qysh sot ndryshimet dramatike që gjoja do të shënojnë krijimin e një rendi të ri global. Në fakt, ajo çfarë mund të duket shumë e rëndësishme sot mund të rezultojë krejt pa vlerë në një të ardhme dhe rendi i ri botëror t'i ngjajë përsëri rendit të sotëm. Siç është shprehur historiani i njohur anglez Philip Guedalla, "Historia përsërit vetveten, historianët përsërisin njëri-tjetrin" (citaruar në Renard 2009b: 9).

Parashikimet euforike në histori, sidomos i atyre që kanë të bëjnë me zhvillimin e marrëdhënieve midis kombeve, nuk janë një gjë e re. Shumë intelektualë dhe ekspertë perëndimorë të politikës dhe të marrëdhënieve ndërkombëtare kanë gabuar kur janë munduar të parashikojnë rendencat e zhvillimit historik. Për shembull, në fillim të shekullit të 20-të në radhët e intelektualëve europianë ishte mjaft e përhapur pikëpamja se lufta ishte shndërruar tashmë në një fenomen që po merrte fund dhe se forcat e kapitalizmit—teknologjia, tregtia e lirë dhe racionalizmi liberal—po krijojnë një botë paqësore, pa kufij dhe pa luftë. Vetëm pak vite më vonë, kur Europa u bë arenë e një luftë të përgjakshme, të paparë në histori deri atëherë, ky optimizëm u provua se nuk kishte asnjë mbështetje në realitetin shoqëror të kohës.

Po kështu, në mes të viteve 1930, në qarqet e intelektualëve europianë besohej gjerësisht se me Depresionin e Madh, kapitalizmi dhe liberalizmi po jetonin ditët e tyre të fundit, se ky sistem po "vetëshkatërrohej" për shkak të "kontradiktave të tij të brendshme" dhe se ai do të zëvendësohej nga një "luftë për pushtet" për jetë a vdekje midis fashizmit dhe komunizmit. Në të vërtetë, besimi se kapitalizmi i kishte ardhur fundi dominoi në radhët e intelektualëve europianë deri në fund të viteve 1940. Më 1945, për shembull, A.J.P. Taylor, një ndër historianët anglezë më në zë në atë kohë shkruante "Askush në Europë nuk beson më në modelin amerikan, që është ndërmarrja e lirë private. Nëse ka njerëz që akoma besojnë në të, ata i përkasin një partie të humbur" (citaruar në Harris 2005). Të gjitha këto thuheshin në një kohë kur Perëndimi ishte në vigjilje të prosperitetit më të madh ekonomik që kishte njohur deri atëherë historia e njerëzimit, prosperitet të cilin e solli po ai sistem kapitalist që intelektualët europianë e konsideronin si një sistem që po jepte shpirt.

Dy dekada më vonë, pikëpamja që sundoi në radhët e intelektualëve europianë u bë ajo, sipas të cilës, sistemi totalitar komunist ishte i pashkatërrueshëm dhe se Bashkimi Sovjetik po e fitonte Luftën e Ftohtë, të cilën Amerika—e mundur nga një ushtri fshatarësh në Vietnam, e lodhur nga konfliktet e brendshme dhe me një imazh të dëmtuar rëndë nga skandali i Uotergejtit—po e humbiste. Pikëpamje të tilla ngjajnë sot si dy pika uji me opinionin kaq shumë të përhapur dhe gati mbizotërues se, Amerika, e lodhur dhe e dobësuar në dy luftra të zhvilluara njëkohësisht—në Irak dhe në Afganistan—dhe me një imazh të dëmtuar nga politika e jashtme e

Presidentit George W. Bush, e ka humbur madhështinë dhe rolin e saj të dikurshëm si e vetmja fuqi hegjemone e botës (Tarifa 2010a: 22).

Analiza e të gjithë faktorëve të marrë në shqyrtim në këtë artikull na sjell në konkluzionin se do të duhen disa dekada që ndonjë fuqi tjetër e madhe të mund të arrijë Shtetet e Bashkuara në ndonjërin prej komponentëve që përcaktojnë statusin e saj si fuqia e vetme hegjemone e globit. Që të shkaktojë ndryshime strukturore në sistemin e marrëdhënieve ndërkombëtare, çdo zhvillim që mund të vihet re në njërën, ose në të gjitha elementet e fuqisë duhet të jetë i rëndësishëm dhe i qëndrueshëm. Rajan Menon vë në dukje se Amerika “i ngjan sot Britanisë së shekullit të 19-të. Ajo shkakton zili, zemërim dhe herë-herë alarm. Por ajo nuk krijon frikë si një rrezik i vazhdueshëm, real apo imediat. Në fakt, ajo që i shqetëson shumë vende nuk është dominimi amerikan, por tërheqja dhe mosangazhimi i Amerikës” (Menon 2009: 359).

Sipas mendimit tonë, sistemi aktual i marrëdhënieve ndërkombëtare vazhdon të jetë një sistem i qëndrueshëm dhe do të vazhdojë të jetë njëpolar edhe për një kohë relativisht të gjatë. Ai do pushojë së qeni i tillë kur një apo disa fuqi të mëdha, të marra së bashku, do të mund të krijojnë një pol të ri. Megjithatë, për sa kohë që sistemi i marrëdhënieve ndërkombëtare mbetet njëpolar, pasiguria në zgjedhjen e partnerëve dhe të aleancave është më e vogël, siç është më i thjeshtë edhe kalkulimi i avantazheve apo i rreziqeve potenciale në politikën e jashtme të çdo vendi. Një tipar interesant dhe i rëndësishëm i politikës së sotme ndërkombëtare (në një botë në të cilën supremacia amerikane është e qartë dhe, sot për sot, e padiskutueshme), është se shumica e vendeve janë të interesuara dhe duan që, në një mënyrë, ose në një tjetër, të jenë të lidhura me Shtetet e Bashkuara.

Përveç kësaj, edhe kur ndryshimi i balancës së fuqisë në shkallë globale bëhet i mundur, ky proces, në mungesë të një disfate totale në luftë (si ajo e Gjermanisë dhe e Japonisë në Luftën e Dytë Botërore, apo e Bashkimit Sovjetik në Luftën e Ftohtë), nuk ndodh menjëherë, por kërkon një kohë relativisht të gjatë. Sepse transformimi i strukturës së sistemit ndërkombëtar është një ndryshim i tillë cilësor, i cili kërkon ndryshime të mjaftueshme sasiore në të gjitha elementet që përbëjnë pushtetin: ekonomik, ushtarak, kulturor dhe teknologjik. Faktet tregojnë, sidoqoftë, se qysh nga fillimi i luftës në Irak, ngjarje kjo e cila identifikohet rëndom me fillimin e rënies së supremacisë amerikane, asnjë ndryshim esencial nuk ka ndodhur në këta faktorë “objektivë” që të justifikonte “teorinë” e kthimit në sistemin shumëpolar.

Dalja në skenën botërore e Kinës dhe e Indisë si fuqi të mëdha, “normalizimi” dhe fuqizimi ekonomik dhe ushtarak i Japonisë, zgjerimi dhe integrimi i mëtejshëm i Bashkimit European dhe ngritja ekonomike e Rusisë apo e Brazilit e kanë bërë jo më të lehtë, siç mund të duket në vështrim të parë, por më të vështirë perspektivën e çdonjërit nga këta vende për të zëvendësuar Shtetet e Bashkuara në rolin e fuqisë hegjemone për një kohë ende relativisht të gjatë, të paktën edhe për dy-tre dekada të tjera, çka dote thotë se as Bashkimi European, as vendet BRIK nuk do mund ta sfidojnë dot seriozisht Amerikën në rolin e saj të lidhshëm ndërkombëtar.

Bibliografia:

- Barma, Naazneen, Ely Ratner & Steven Weber (2007). "A World Without the West", *The National Interest* 90 (July/August): 23-30.
- Brooks, Stephen G. & William C. Wholphorth (2002). "American Primacy in Perspective", *Foreign Affairs* 81, 4 (July/August): 20-33.
- Brustlein, Corentin (2008). "La Surprise Stratégique: De la Notion aux Implications", *Focus Stratégique* 10, Paris: Institut Français des Relations Internationales, October.
- Calhoun, Craig (2006). "Is the University in Crisis?", *Society* 43, 4 (May/June): 8-18.
- Calleo, David P. (2009). "How to Govern a Multipolar World", *Current History* 108, 721 (November): 361-367.
- Eberstadt, Nicholas. (2007). "Born in the USA: America's Demographic Exceptionalism", *The American Interest* 2, 5: 52-58.
- Eberstadt, Nicholas. (2009). "Drunken Nation: Russia's Population Bomb", *World Affairs* (Spring): 51-62.
- Eberstadt, Nicholas. (2010). "The Enigma of Russian Mortality", *Current History* 109, 729 (October): 288-284.
- Gray, Colin S. (2008). "The 21st Century Security Environment and the Future of War", *Parameters* 38, 4: 14-26.
- Haass, Richard N. (2005). *The Opportunity: America's Moment to Alter History's Course*. New York: Public Affairs.
- Harris, Owen. (2005). "The Parochialism of the Present", *Australian Financial Review*, 16 September.
- Hassner, Pierre. (2007). "The Fate of a Century", *The American Interest* 2, 6 July/August): 36-47.
- Joffe, Josef. (2009). "The Default Power: The False Prophecy of America's Decline", *Foreign Affairs* 88, 5 (September/October): 21-35.
- Kennedy, Paul. (1987). *The Rise and Fall of Great Powers: Economic Change and Military Conflict from 1500 to 2000*. New York: Random House.
- Kennedy, Paul. (2002). "The Eagle has Landed". *The Financial Times*, 2 February.
- Kupchan, Charles A. (1999). "Life After Pax Americana", *World Policy Journal* 16, 3 (Fall): 20-27.
- Lieven, Anatol & John Hulsman. (2006). *Ethical Realism: A Vision for America's Role in the World*. New York: Pantheon Press.
- Lind, Michael. (2006). *The American Way of Strategy: U.S. Foreign Policy and the American Way of Life*. Oxford: Oxford University Press.
- Mahbubani, Kishore. (2005). "Asia's Destiny, America's Choice", *The American Interest* 1, 1 (Autumn): 58-68.
- Menon, Rajan. (2009). "Pax Americana and the Rising Powers", *Current History* 108, 721 (November): 353-360.

- O'Neill, Jim. (2001). "Building Better Global Economic BRICs", *Global Economics Paper* 66, New York: Goldman Sachs, 30 November.
- O'Neill, Jim. (2008/09). "Les BRIC, Nouvelles Grandes Puissances dans le Futur?", *La Revue Internationale et Stratégique* 72: 231-243; author's interview with an economist.
- O'Neill, Jim. (2009). "The New Shopping Superpower", *Newsweek*, 30 March.
- Peterson, Peter G. (2007). "No Free Lunch", *The National Interest* 90 (July/August): 19-22.
- Posen, Barry R. (2003). "Command of the Commons: The Military Foundation of U.S. Hegemony", *International Security* (Summer).
- Renard, Thomas. (2009a). "The Coming Order: Strategic and Geopolitical Impacts of the Economic Crisis", *World Politics Review* 1, 3: 47-50.
- Renard, Thomas. (2009b). *A BRIC in the World: Emerging Powers, Europe, and the Coming Order*. Brussels, Egmont Royal Institute for International Relations: Academia Press.
- Sheridan, Greg. (2006). "East Meets East: The Sino-Indian Rivalry", *The National Interest* 86 (November/December): 92-96.
- Tarifa, Fatos. (2007). *Saga e dy kontinenteve: A po ndahen Europa dhe Amerika nga njera-tjetra?* Tirane: Ombra GVG.
- Tarifa, Fatos. (2010a). *Fati i një shekulli: Hegjemonia amemrikane, dilemat e Europës dhe sfidat e Azisë Lindore*. Tiranë: Ombra GVG.
- Tarifa, Fatos. (2010b). "Vdekja demografike e Rusisë", *Gazeta MAPO*, 27 nëntor, f. 10
- Treverton, Gregory F. & Seth G. Jones. (2005). *Measuring National Power*. Santa Monica, CA: RAND Corporation.
- Walt, Stephen M. (2002). "American Primacy: Its Prospects and Pitfalls", *Naval War College Review* LV, 2 (Spring): 9-28.
- Whitney, Christopher B. & David Shambaugh. (2009). "Soft Power in Asia: Results of a 2008 Multinational Survey of Public Opinion", *Asia Soft Power Survey* 2008, Chicago: The Chicago Council on Global Affairs, April 2009.
- Wilson, Dominic & Anna Stupnytska. (2007). "The N-11: More Than an Acronym", Goldman Sachs Economic Research, Global Economics Paper No. 153, March 28.
- Wohlforth, William C. (1999). "The Stability of a Unipolar World", *International Security* 24, 1 (Summer): 5-41.
- Work, Robert O. (2005). Statement before the House Armed Services Committee (Projection Forces Subcommittee Hearing on DD(X), July 19, 2005 (http://www.globalsecurity.org/military/library/congress/2005_hr/050720-work.pdf).

Chinamania: Pse Kina nuk mund t'ia kalojë Amerikës si superfuqia shkencore e botës?

_____ Fatos TARIFA, PhD _____

_____ Prof. Dr. Përparim FUGA _____

Abstrakt. *Në një raport mbi bashkëpunimin në fushën e shkencës në shkallë globale, botuar në mars 2011, Shoqëria Mbretërore (Royal Academy) e Britanisë së Madhe vinte në konkluzionin se, Kina, e cila u ngjiti vjet në vendin e dytë në botë për sa i përket numrit të artikujve shkencorë të botuar në revista akademike, duke lënë pas Anglinë, shumë shpejt, në vitin 2013, do të lërë pas edhe Shtetet e Bashkuara, duke u bërë kështu “superfuqia shkencore e botës”. Në këtë artikull, duke kritikuar interpretim linear të të dhënave, si metodologjinë mbi të cilën është mbështetur raporti në fjalë, ne vëmë në dyshim konkluzionin e mësipërm dhe argumentojmë se Kina është dhe do të mbetet për një kohë të gjatë shumë larg Amerikës edhe përsa i përket “output”-it shkencor.*

Fjalë kyçe:

chinamania, dija shkencore

Në mars 2011, Shoqëria Mbretërore (Royal Academy) e Britanisë së Madhe, botoi një raport mbi bashkëpunimin në fushën e shkencës në shkallë globale, me titull “Dija, rrjetet dhe kombet” (*Knowledge, Networks and Nations*). BBC e raportoi këtë botim nën titullin sensacional “Për dy vjet Kina ua kalon Shteteve të Bashkuara në shkencë”. Një titull i tillë mund të ketë tërhequr lehtë vëmendjen e shumëkujt në Europë, në Kinë dhe në shumë


prej vendeve në zhvillim, por ai duket se nuk ka bërë ndonjë përshtypje të veçantë në publikun amerikan dhe as në qarqet akademike në Shtetet e Bashkuara. Një prej konkluzioneve në të cilin mbërrin ky raport është se, Kina, e cila këtë vit ka zënë vendin e dytë në botë për sa i përket numrit të artikujve shkencorë të botuar në revista akademike, duke lënë pas Anglinë, shumë shpejt, në vitin 2013, do të lërë pas edhe Shtetet e Bashkuara, duke u bërë kështu “superfuqia shkencore e botës”.

Arsyeja që e shtyn raportin në fjalë të vijë në këtë konkluzion është rritja lineare e numrit të artikujve të botuar nga autorë kinezë në revistat akademike, sipas të dhënave të regjistruara në database-in e shtëpisë së madhe botuese Elsevier, me qendër në Amsterdam, por me filiale në Angli, në Shtetet e Bashkuara e gjetkë. Raporti prej më shumë se 100 faqesh trajton shumë probleme, duke nisur që nga drejtimet kryesore të zhvillimit shkencor në kohën e sotme, e deri tek bashkëpunimi shkencor në shkallë globale. Ai që tërheq vëmendjen tonë dhe për të cilin dëshirojmë të shprehim konsideratat tona, është iluzioni se, në dy vjet, Kina do të mund të bëhet “superfuqia” e globit në fushën e shkencës dhe të teknologjisë. Më poshtë parashtrijmë argumentet tona pse një konkluzion i tillë nuk mund të merret shumë seriozisht.

Metodologjia

Konkluzioni i mësipërm është i pasaktë që në premisën e tij, për shkak të indikatorit matës që është përdorur. Ky indikator është numri i artikujve studimorë që botohen çdo vit në revistat akademike. Ndërsa në vitin 1996, viti i parë me të cilin nis analiza në fjalë, studiuesit amerikanë botuan 292,513 artikuj shkencorë, 10 herë më shumë se studiuesit kinezë (25,474), në vitin 2008 numri i artikujve shkencorë që kanë për autorë studiues amerikanë u rrit në 316,317, ndërkohë që numri i artikujve studimorë të botuar nga autorë kinezë u rrit në 184,080, pra më shumë se shtatë herë. Një e dhënë e tillë, sipas hartuesve të raportit, flet për një ndryshim radikal të peizazhit shkencor dhe teknologjik të globit, si edhe të konkurrencës midis aktorëve kryesorë në këtë fushë. Nisur nga një trend i tillë, deri disa kohë më parë parashikohej se Kina do t’ia kalonte Amerikës në këtë drejtim diku aty nga viti 2020, por projektimi që bën Akademia Mbretërore, bazuar mbi të dhënat e shtëpisë botuese Elsevier dhe mbështetur në një *interpretim linear* të të dhënave, sugjeron se Kina do ta lërë pas Amerikën përse i përket “output”-it shkencor, brenda dy viteve të ardhshme, pra më 2013 (shih grafikun e mëposhtëm).

Projected growth in citations in scientific literature



Kriteri i përdorur për të ardhur në këtë konkluzion është thjesht dhe vetëm sasior dhe, prandaj, *i pasaktë*. Nga njëra anë, është e gabuar të pretendosh se ekziston një korrelacion pozitiv midis numrit të artikujve studimorë të botuar dhe lidërshiptit global në shkencë dhe në teknologji. Fjala vjen, në 40-50 vitet e fundit, Britania e Madhe ka zënë vendin e dytë në botë, pas Shteteve të Bashkuara, përse i përket numrit të studimeve të botuara në revista shkencore, por ajo ka qenë dhe mbetet pas Japonisë dhe Gjermanisë nga pikëpamja e zhvillimit teknologjik. Kina nuk mund të krijojë një rregull të ri dhe as mund të jetë një përjashtim. Nga ana tjetër, ekstrapolimi linear është një metodë e gabuar për të parashikuar tendencën e zhvillimit të një dukurie. Historia e njerëzimit provon se shumë zbulime, në fusha të tilla si fizika, kimia, biologjia, elektronika, e kanë prishur linearitetin e zhvillimit pasi kanë krijuar premisa dhe një impakt të madh për hope të ndjeshme cilësore. Edhe nëse, për një çast, vlerësojmë se vëllimi i artikujve të botuar është një indikator i rëndësishëm i progresit në shkencë dhe në teknologji, ky vëllim nuk duhet parë si një vlerë absolute, por në raport me numrin e popullsisë, pra si shifër *për frymë*. Nga kjo pikëpamje, Kina, me një popullsi rreth 4.4 herë më të madhe dhe shumë më të varfër se popullsia e Shteteve të Bashkuara, është dhe do të mbetet për një kohë të gjatë shumë prapa kësaj të fundit.

Sasia, cilësia dhe vlera reale

Cilësia është një tregues më i rëndësishëm sesa sasia. Po kështu, rritja sasiore jo gjithmonë dhe jo domosdoshmërisht çon në zhvillime cilësore. Kjo është e vërtetë sidomos në shkencë. Shtimi i numrit të botimeve akademike nuk tregon domosdoshmërisht rritjen e cilësisë në fushën e kërkimit shkencor, as rritjen e prestigjit apo të aftësisë konkurruese në tregun global të ideve, të teknologjisë

dhe të prodhimit. Ne nuk mendojmë se në Harvard apo në Columbia, në MTI (Massachusetts Institute of Technology), apo Catech (California Institute of Technology), në Stanford apo në Berkely, në Yale, në Duke apo në Johns Hopkins, shkencëtarët amerikanë i shqetëson progresi shkencor dhe teknologjik i Kinës. Mund të themi se vetëm “output”-i teknologjik që prodhohet në një rajon të vetëm të Shteteve të Bashkuara, siç është Silicon Valley, është më i madh se ai që prodhon e tërë Kina.

Kontributi shkencor matet jo me numrin e artikujve apo të faqeve të botuara, por me atë se çfarë është e re në to dhe, sidomos, me dobinë praktike të gjetjeve të tyre. Qysh nga koha e Arkimedit, dobia e shkencës është parë në vlerat praktike të saj, sidomos në aplikimin e saj në fushën e teknologjisë së prodhimit dhe të mbrojtjes, si edhe në marketueshmërinë e produkteve të tyre. Më shumë se çdo vend tjetër i globit, siç ka mundur të konstatojë Michael Holman (2006) në një studim të kompanisë Lux pak kohë më parë, Amerika ka aftësinë të “gjenerojë rritje ekonomike nga inovacionet shkencore”. Ky studim evidenton se vende të tilla si, Kina, Franca, madje edhe Britania e Madhe, të cilat investojnë në mënyrë të konsiderueshme për zhvillimin e kërkimeve shkencore, nuk arrijnë t’i aplikojnë arritjet e tyre shkencore në fushën e biznesit dhe se 85 përqind e investimeve kapitale në teknologjitë nano në shkallë globale kanë shkuar deri më sot në kompanitë amerikane (Holman 2006). Fareed Zakaria, nga ana e tij, dëshmon se investimet amerikane për zhvillimin e nanoteknologjisë janë dy herë më të mëdha sesa ato të konkuresit më të madh që vjen pas saj në këtë fushë—Japonisë—ndërkohë që Amerika ka krijuar më shumë patenta për nanoteknologjitë sesa të gjitha vendet e botës, të marra së bashku (Zakaria 2008: 184).

Nëse shohim se ç’vendi i përkasin autorët e artikujve shkencorë më të cituar, Shtetet e Bashkuara dhe, pas saj, Anglia, mbeten, në mënyrë të padiskutueshme, në vend të parë. Kjo vjen, së pari, për shkak të metodologjive shumë më të avancuara që ata përdorin (Calhoun 2006); së dyti, për shkak të cilësisë më të lartë dhe të karakterit inovativ që kanë dhe; së treti, për shkak se, ashtu si latinishtja shekuj më parë, sot anglishtja jo vetëm ka zënë vendin e frëngjishtes si *lingua franca* e diplomacisë dhe e kulturës, por është bërë, në një kuptim real të fjalës, gjuha universale e shkencës, e tregtisë, e teknologjisë dhe e Internetit. “Njerëzimi” sot flet, dëgjon, mendon, lexon, sheh, krijon, komunikon në gjuhën e fuqisë më të madhe të botës—të Amerikës. *C’est la vie!*

Përveç të tjerash, në grafikun e mësipërm të Akademisë Mbretërore, i cili thuhet se mat shkallën e rritjes së output-it shkencor, tregohet vetëm viti (2013), kur ky output do të jetë i barabartë midis Shteteve të Bashkuara dhe Kinës (gjithmonë përsa i përket numrit të artikujve të botuar në revista akademike), por nuk tregohen aspak dallimet e theksuara të *cilësisë* së këtij output-i në të dyja vendet. Niveli i cilësisë së “produktit shkencor” pasqyrohet qartë edhe në cilësinë

e produktit teknologjik material. Gjithçka që është “Made in America” është krejt tjetër nga shumica e produkteve “Made in China”, të cilat, përgjithësisht, konsiderohen të jenë “cheaply made junk”. Në qershor të vitit 2011, gazeta *The Seattle Times* informonte se “shkenca dhe teknologjia kineze janë të mbushura me mashtrime dhe ndonjëherë edhe me praktika që janë shqetësuese. Më shumë se 200 institucione në Kinë praktikojnë terapi të tilla në fushën e biologjisë molekulare tek pacientë që vuajnë nga plagë, sëmundje ose defekte të lindura, të cilat janë dyshimta” (Pomfret 2011).

Një fakt i rëndësishëm që duhet mbajtur parasysh kur bëhet fjalë për numrin e madh të artikujve që botohen në revista akademike nga autorë kinezë është se studentëve që kryejnë studime doktorale në universitetet kineze u kërkohet në mënyrë të detyrueshme të botojnë artikuj të tillë përpara se të mbrojnë dizertacionet. Por, mendoni për një çast: rreth 1.5 milionë kinezë nisin çdo vit studimet doktorale. Numri i artikujve që atyre u kërkohet të botojnë është jashtëzakonisht i madh, por niveli cilësor dhe kontributi i këtij “output-i” janë përgjithësisht shumë të ulët. Me fjalë të tjera, numri i artikujve të botuar nuk është tregues i cilësisë, madje mund të mos jetë as edhe tregues i gjendjes aktuale të shkencës në një fushë apo në një disiplinë të caktuar. Kjo aq më tepër, nëse shumë nga këta artikuj nuk botohen në revistat akademike më prestigjioze.

Dihet se një kriter objektiv për të vlerësuar cilësinë e një punimi shkencor të botuar në një revistë akademike sipas procedurës “blind peer review” është të shohësh se sa herë i janë referuar, ose e kanë cituar atë punim studiues të tjerë në punimet e tyre. Grafiku i mësipërm nuk tregon dallimin e madh që ekziston në fakt midis numrit të artikujve të cituar që kanë për autorë studiuesit amerikanë apo anglezë, nga artikujt e autorëve kinezë. Është veçse e kuptueshme që 100 artikuj të botuar nga studiuesit dhe nga shkencëtarët e universiteteve dhe të instituteve kërkimore më të mira të Amerikës, të cilët eksplorojnë në limitet e njohjes njerëzore dhe shtyjnë përpara kufijtë e botës tonë, të kenë vlerë, impakt dhe të citohen shumë më tepër në të gjithë botën, sesa 1 milion artikuj të shkruar nga studentë doktorantë të universiteteve kineze, qoftë edhe në bashkëpunim me pedagogët e tyre. Përveç faktit që një pjesë e madhe e artikujve akademikë të botuar nga autorë kinezë s’bëjnë tjetër veçse konfirmojnë atë çfarë kanë zbuluar apo kanë thënë studiues dhe shkencëtarë të tjerë në revista perëndimore, për të mos thënë se në shumë raste artikujt e tyre janë “copycats” të studimeve amerikane, një arsye tjetër është edhe se një pjesë shumë e madhe e artikujve që shkruhen nga autorë kineze botohen në gjuhën e tyre, e cila është shumë pak e njohur për shumicën e studiuesve jokinezë. Por edhe sikur të gjitha ata të botoheshin në aglisht, ka një dallim esencial midis artikujve që botohen në revista, nga njëra anë, dhe dijes reale që bëhet pjesë fundamentale e shkencës duke u materializuar në botimet e librave më të mirë, nga ana tjetër. Edhe këtu, Amerika është dhe do të ruajë lidërshtipin në shkallë globale.

Plagjiarizmi

Asgjë nuk flet më shumë për cilësinë e dobët të produktit shkencor dhe teknologjik sesa prania e *plagjiarizmit*, i cili duket se është bërë një fenomen endemik në Kinë. Jo shumë kohë më parë, gazeta *New York Times* botonte një artikull, në të cilin vihej në dukje numri i madh i artikujve akademikë të plagjiarizuar të botuar nga studiues kinezë (Jacobs 2010). Plagjiarizmi në Kinë nuk është vetëm një dukuri *akademike*, por edhe një dukuri *teknologjike* dhe *industriale*. Për shkak se një pjesë e mirë e studimeve në fushën e shkencave inxhinierike që bëhen në Kinë nuk arrijnë të gjejnë aplikim në prodhim, “ethosi” i industrive kineze është bërë “kopjimi” i gjithçkaje që është prodhuar më parë në Amerikë ose në Japoni. Është botërisht e njohur dhe e vlerësuar që Kina, historikisht i ka dhënë botës talente dhe kontribute të shquara në shumë fusha të dijes dhe të shkencës; sidoqoftë, sot ky vend ka probleme të mëdha me korrupsionin akademik dhe, më shumë akoma, me mosrespektimin e të drejtës së pronësisë intelektuale në çdo fushë të krijimtarisë, përfshirë edhe patentat e inovacioneve teknologjike, dhe se ajo “huazon” idetë dhe teknologjitë e prodhuara në vendet e tjera.

Shkenca dhe demokracia

Kina vuan nga një dualizëm politik dhe ekonomik, duke mos qenë as një shtet tipik komunist, as edhe një vend tipik kapitalist, por një farë “leninizmi i tregut”. Ky dualizëm nuk ka sesi të mos ndikojë në shkallën e lirisë në çdo fushë të krijimtarisë njerëzore, pra, edhe në cilësinë e produktit shkencor dhe të progresit teknologjik. Nëse mbajmë parasysh restriksionet e shumta që zbaton qeveria kineze ndaj kërkimit dhe mendimit të lirë të qytetarëve dhe të shkencëtarëve kinezë, është e vështirë të përfytyrosh se si, në kushtet e sundimit të një oligarkie partieke, shkenca do të gjejë hapësirën e nevojshme për t’u zhvilluar lirisht. Shkenca mbështetet në eksplorim dhe ky mund të bëhet më mirë në kushtet e lirisë. Njerëzit e lirë kanë mundësi të zbulojnë më shumë. Në Kinë, me ose pa dashjen e shumë prej profesorëve të tyre të shquar, studentëve nuk u mësohet sesi të arsyetojnë në mënyrë të pavarur, racionale dhe kritike. Ajo që ndodh rëndom në universitetet e këtij vendi është plagjiarizmi dhe vjedhja e ideve të të tjerëve. Astrofizikanti i shquar amerikan, Carl Sagan (1996: 38), ka shkruar se: “Shkenca presupozon dhe lulëzon përmes shkëmbimit të lirë të ideve”. Në shkencë, ashtu si edhe në demokraci, diversiteti dhe debati çmohen. Kujtoni maksimën e Ajnshtajnit se nuk mund të ketë shkencë pa liri të fjalës. Rrjedhimisht, në atë shoqëri ku demokracia është e shëndetëshme, shkenca gëzon një vend të respektuar. Duke respektuar dhe zhvilluar vlerat demokratike, ne përtërijmë gjithashtu parakushtet për zbulime të reja shkencore dhe për inovacione teknologjike. Me fjalë të tjera,

atje ku nuk praktikohet demokracia, as shkenca nuk bëhet mirë dhe *vice versa* (Tarifa 2011: 206).

Një tjetër garë me Amerikën?

Pas Luftës së Dytë Botërore, Bashkimi Sovjetik, në laboratorët e të cilit ishin bërë një varg zbulimesh të rëndësishme në fizikë, në kimi dhe në teknologjinë dixhitale, nisi një garë të vërtetë me Amerikën për pushtimin e hapësirës kozmike. Amerika triumfoi. Në vitet 1980, shumëkush besonte se Japonia do t'ia kalonte Amerikës, duke u bërë fuqia më e madhe ekonomike e globit. Amerika përsëri triumfoi (Tarifa 2010). Sot, besohet se është Kina ajo që, brenda një kohe të shkurtër, do të bëhet jo vetëm ekonomia më e madhe e planetit, por edhe superfuqia shkencore dhe teknologjike e tij. A duhet ta besojmë? Ne mendojmë se jo. Distanca që ndan Amerikën nga Kina është realisht shumë e madhe dhe nuk mund të shkurtohet me shtimin e titujve të artikujve që botojnë studiuesit kinezë në revista akademike. Amerika vazhdon të zërrë vendin e parë në botë përse i përket shpenzimeve për kërkim dhe zhvillim (*Research & Development*); ajo zë vendin e parë në botë (dhe është shumë larg çdo vendi tjetër) përse u përket universiteteve më të mira; po ashtu, Amerika zë vendin e parë në botë përse u përket çmimeve Nobel që jepen në shkenca.

Nuk janë të pakta ata njerëz, të cilët besojnë se për shkak se Kina tradicionalisht i ka dhënë qytetërimit botëror shumë shpikje të rëndësishme—letrën, shtypshkrimin, barutin, kartmonedhën—ajo, herët ose vonë, do të bëhet përsëri një vend që do t'i paraprijë zhvillimit të qytetërimit tonë. Problemi me këtë mënyrë arsyetimi është se historia nuk zhvillohet në mënyrë ciklike. As Greqia dhe as Roma e lashtë, me shkëlqimin e qytetërimeve të tyre të dikurshme, dhe as qytetërimi arab nuk u përsëritën më. Kina nuk mund të krijojë një rregull të ri dhe as të bëjë përjashtim nga ky rregull.

Ç'do të thotë të edukosh sot konkurrentët e tu të nesërm?

Shumë nga programet më të mira doktorale në shkencat ekzakte dhe inxhinierike në universitetet amerikane pranojnë studentë të huaj, veçanërisht nga India dhe nga Kina (Geiger 2006). Mjafton të shëtisësh për disa minuta në kampuset e universiteteve të tilla si Harvard, Yale, Columbia, MIT, Stanford, Berkeley, Duke etj., për ta konstatuar këtë. Studentët nga këto vende marrin në universitetet dhe në kolegjet amerikane jo vetëm arsimin më të mirë të mundshëm në këto fusha, por edhe atë që Robert K. Merton ([1942] 1973: 268) e quante “ethos of science” dhe, bashkë me to, edhe një kulturë politike dhe kërkimore që

stimulon mendimin e pavarur, kritik dhe shprehjen e lirë të argumenteve disidente në shkencë dhe në politikë. Shumë prej studentëve kinezë, pasi marrin gradën PhD në këto universitete, mbeten në Shtetet e Bashkuara (ku edhe, nëse janë të martuar ose martohen, linden më shumë se një fëmijë, e drejtë kjo, të cilën në vendin e tyre ua ndalon politika nataliste “one child” që vazhdon të mbetet në fuqi qysh nga viti 1978). Një pjesë e tyre kthehen në Kinë dhe punësohen në universitete, në qendra kërkimore apo në sektorin privat të industrisë. Kthimi i qindra dhe i mijëra specialistëve të doktoruar në universitetet amerikane përbën një faktor të rëndësishëm për zhvillimin shkencor, teknologjik, ekonomik dhe kulturor të Kinës, duke e bërë këtë vend gjithnjë e më konkurrues në tregjet ndërkombëtare, madje edhe për vetë Shtetet e Bashkuara. Me fjalë të tjera, mund të themi se Amerika sot po arsimon dhe po edukon gjithnjë e më shumë konkurrentët e saj të nesërm. Ky është një tjetër tipar i lidërshiptit në shkencë dhe në teknologji. Por, a është kjo diçka vërtet për t’u shqetësuar, ose në dëm të interesave të saj?

Good for all

Ne përsëri mendojmë se jo. Shqetësuese për Amerikën, ose për Anglinë, do të ishte jo nëse dhjetramijëra studentë kinezë shkojnë për të studiuar në universitetet e këtyre vendeve, por nëse studentët amerikanë, anglezë, gjermanë, japonezë apo francezë do të dyndeshin për të studiuar në universitetet e Kinës. Ne mendojmë, gjithashtu, se zhvillimi shkencor dhe teknologjik i Kinës nuk duhet parë me shqetësim, as si një triumfalizëm apo si epërsi e Lindjes ndaj Perëndimit dhe as si një dështim i Amerikës apo i qytetërimit Perëndimor. Zhvillimi i Kinës është pozitiv për dy arsye: së pari, ai i ndihmon thellimit të mëtejshëm të njohjes njerëzore dhe përmirësimit të kushteve humane të jetesës në përgjithësi, dhe, së dyti, progresi shkencor dhe teknologjik i Kinës nuk e pengon, por e stimulon edhe më tej progresin shkencor dhe teknologjik të Amerikës, të Japonisë, të Gjermanisë, të Francës, të Anglisë, të Hollandës dhe të vendeve të tjera më të zhvilluara. Në fund të fundit, në një botë gjithnjë e më të globalizuar, në të cilën kufijtë dhe barrierat e tjera nacionale humbasin gjithnjë e më shumë rëndësinë e tyre, fakti se cili vend “prodhon” më shumë literaturë shkencore bëhet gjithnjë e më pak i rëndësishëm.

Bibliografia:

- Calhoun, C. (2006). “Is the University in Crisis?”, *Society* 43, 4: 8-18.
 Geiger, R. L. (2006). “Real Crisis or Unpleasant Realities?” *Society* 43, 4: 35-40.
 Holman, M. W. (2006). *Profiting from International Nanotechnology*. Lux Research (December).

- Jacobs, A. (2010). "Rampant Fraud Threat to China's Brisk Ascent", *The New York Times*, October 6.
- Merton, R. K. [1942] (1973). "The Normative Structure of Science", ff. 267-278 në Robert K. Merton, *The Sociology of Science: Theoretical and Empirical Investigations*. Chicago, IL: University of Chicago Press.
- Pomfret, J. (2011). "China Becoming Scientific Superpower", *The Seattle Times*, June 29.
- Royal Academy (The). (2011). *Knowledge, Networks and Nations: Global Scientific Collaboration in the 21st Century*. London: Royal Society.
- Sagan, C. (1996). *The Demon-Haunted World: Science as a Candle in the Dark*. New York: Ballantine Books.
- Tarifa, F. (2010). *Fati i një shekulli: Hegjemonia amerikane, dilemat e Europës dhe sfidat e Azisë Lindore*. Tiranë: Ombra GVG.
- Tarifa, F. (2011). "The Values of Science and Democratic Culture", *The International Journal of Science in Society* 2, 1: 201-207.
- Zakaria, F. (2008). *The Post-American World*. New York: W.W. Norton & Company.

Një përmbledhje ekonometrike mbi analizën e modelimit shumëpërmator. Transmetimi i çmimeve në produktet bujqësore

— Avis ANDONI, MSc —

Abstrakt. Shqipëria, shteti që paraqitet si më pak i zhvilluari prej ish pjesarëve të sistemit socialist të ekonomisë së centralizuar, është e fundit që u angazhua në tranzicion. Kalimi drejt një tregu të lirë është shoqëruar me transformime dhe disekuilibra të shumtë, si në planin ekonomik por edhe në atë social. Mbi të gjithë, është sektori bujqësor, i cili ka pësuar më shumë transformime thelbësore. Ky sektor mishëron, në fakt, vektorin kryesor të ekonomisë shqiptare. Megjithatë sektori në fjalë manifeston pamjaftueshmëri të rëndësishme.

Objekti i këtij studimi qëndron në analizën e situatës së tregut bujqësor për të ofruar zgjidhje në rivendosjen e rritjes së tij. Në fakt, përmes këtij studimi do të mund të analizojmë më në thellësi pamjaftueshmëritë e tregut bujqësor në mënyrë që të detektojmë mekanizmin dhe dinamikën e tij. Kjo analizë do të na mundësojë ta kuptojmë më mirë, me qëllim propozimin e veprimeve ekonomike që duhen ndërmarrë.

Për t'i dhënë përgjigje pyetjeve tona, do të përdorim disa metoda të ekonometrisë shumëpërmatore. Egzaktësisht, modelet VAR dhe VECM, të cilët do të na shërbejnë për të analizuar dinamikën dhe ndërlidhjet e variablave ekonomike të marra në konsideratë. Modelet në fjalë do të na mundësojnë, atëherë, analizën e fenomenit të transmetimit të çmimeve për shportën e produkteve që zotërojmë.

Fjalë kyçe:

Shqipëri, pamjaftueshmëria e tregut, politika ekonomike, ekonometri shumëpërmatore, analiza e shokut, VAR, VECM.

HYRJE

Shqipëria përfaqëson një portë hyrëse shumë të rëndësishme në Ballkan, dhe si pjesë e tij, ajo përfiton nga karakteristikat Ballkanase. Vendi zotëron atëhere asete të favovorshme për zhvillimin bujqësor. Duke filluar nga pozita gjeografike, kushtet klimatike, abondanca e ujit, diversiteti i tokës, mosha e re dhe specializimi i popullsisë rurale në sektorin bujqësor, e plot të tjera që mund të “nxjerrin në dritë” sektorin në fjalë.

Shqipërinë e kanë karakterizuar evolucione të rëndësishme gjatë shekullit të kaluar, duke renditur diz-ekuilibrat ekonomik dhe social. Pavarësisht nga vështirësi ngulmuese, Shqipëria ka mundur të rradhisë veten në vitet 2000 përmes vëndeve të Ballkanit me rritje ekonomike më të lartë. Sektori bujqësor përbën një komponent kryesor në ekonominë shqiptare. Sektori në fjalë mobilizon gati gjysmën e popullsisë rurale dhe kontribuon me një përqindje të rëndësishme të PBB-së.

Të gjithë faktorët në lojë bëjnë që sektori bujqësor të ketë një potencial dhe një prespektive zhvillimi jo neglizhent, pavarësisht realitetit ekonomik që duket të indikojë të kundërtën. Në fakt, balanca tregëtare e sektorit ndodhet në degradim permanent, dhe prodhimi bujqësor “vuan” për kënaqjen e kërkesës vëndase. Për më tepër, edhe pse ky sektor përballet me këtë mori pamjaftueshmëriash aparente, mbetet i zbrazur nga rregullime specifike që mund të kishin siguruar qëndrueshmërinë e tij. Ka qënë objekt strategjish ekonomike e politikash rilancimi të rritjes dhe zhvillimit të tij, por, këto të fundit kanë rezultuar të pamjaftueshme.

Në kuadrin e studimit aktual, ka qënë e mundur të plotësohen disa seri çmimesh mbi një shportë produktesh bujqësorë për një periudhë të konsiderueshme. Bëhet fjalë për seri kohore mbi çmimet mujore të disa produkteve të matura për një periudhë kohore prej dymbëdhjetë vitesh. Kjo bazë të dhënash e përpiluar nga seritë në fjalë përbën një bazë për analizën mbi dinamikën e tregut që përfaqëson secila nga kronikat gjithashtu edhe për analizën e ndërveprimeve të mundshme midis tregjeve të ndryshëm.

Për studimin e një problematike të tillë, kam vendosur të përdor modelet dinamike shumëpërmasore si modelet “Vector Auto Regression” dhe plotësuesit e tyre për analizën e dinamikave afatgjata, modelet “Vector Error Correction Models”

Përdorimi i të tilla metodologjish do të më mundësojë t’i përgjigjem pyetjeve të mia mbi transmetimin e çmimeve nga një treg në tjetrin, për më tepër :

- i. *A është e mundur të detektohen ndërveprimet apo ndërlidhjet në terma afatshkurtra apo/dhe afatgjata midis tregjeve të ndryshme të panelit të ndërtuar?*
- ii. *A është e mundur të detektohen relacionet shkak-pasojë të tregjeve mbi njëri-tjetrin?*
- iii. *Cili është impakti i zhvillimit të tregjeve mbi njëri-tjetrin?*

Për këtë, studimi i realizuar në këtë dokument organizohet sipas tre akseve, pikë së pari do të vëzhgojmë situatën dhe interesin ekonomik të sektorit bujqësor.

Më pas në një aks të dytë , do të bëhet fjalë për prezantimin e metodologjisë së punës. Dhe së fundmi nën kuadrin e aksit të tretë, do të procedohet me aplikimin e metodave mbi të dhënat ekonomike dhe do të mbyllet me një prezantim të rezultateve përfundimtare.

1. Shqipëria dhe zhvillimi i saj bujqësor

Shqipëria, duke u lokalizuar në pjesën perëndimore të gadishullit të Ballkanit, pozita e saj gjeografike dhe relievi e kategorizojnë në zonën agro-ekologjike dhe klimatike mesdhetare. Karakteristikat e sipërpërmendura dhe të tjera si karakteristikat e sistemit të ujërave, të tokave dhe popullsisë bëjnë që Shqipëria të jetë një vend me vokacion bujqësor. Në fakt, sektori në fjalë përfaqëson një element të dosmosdoshëm për ekonominë vendase, duke përbërë kështu arsyen e thellimit tim të mëtijshëm në analizën e këtij sekori dhe impaktit të tij në ekonomi.

Le të zgjerojmë pak fokusin, pas një gjysëm shekulli komunizëm dhe një tranzicion shumë të gjatë, sot, ekonomia vendase karakterizohet nga tregu i lirë dhe mbizotërohet nga sektori privat. Por, aplikimi i “ ekonomisë së lirë ” nuk ka ndodhur në mungesë diz-ekuilibrash. Karakteristikat e ekonomisë kanë ndryshuar rrënjësisht në një dekadë duke shkaktuar diz-ekuilibra të mëdhenj ekonomikë e socialë.

Tashmë vendi është i varur, veçanërisht në nivel të produkteve bujqësore, kemi pra një ekonomi të tërhequr nga importet. Mund të vëzhgohet, atëherë, një pamjaftueshmëri e madhe e tregut bujqësor, dhe masa e eksporteve të tij është shumë e reduktuar.

Aktualisht, aktiviteti ekonomik i sektorit në fjalë realizohet gati ekskluzivisht në fermat private, të cilat burojnë nga baza ligjore mbi tokën e ligjit 7501. Kjo shpërndarje ka shkaktuar formimin e afërsisht 466000 fermash bujqësore me sipërfaqe shumë pak të ndryshyeshme nga njëra tjetra. Këto ferma variojnë nga përmasat shumë të vogla në përmasa të vogla, atëherë, zhvillimi i strukturave të prodhimit është i limituar. Mungesa e këtyre strukturave gjeneron shumë probleme në nivel të tregjeve bujqësore.

Në fakt, bujqit gjenden pa blerës dhe janë të detyruar të shesin vetë produktet e tyre. Kjo pasiguri i detyron ata të mos jenë të prirur të prodhojnë në sasi të konsiderueshme, duke ndikuar kështu, negativisht në zhvillimin bujqësor.

Përmasat e fermave implikojnë gjithashtu që pjesa më e madhe e bujqëve nuk zotërojnë mjete të mëdha financiare duke vënë gjithashtu re mungesën e automatizimit të proceseve bujqësore . Rrjedhimisht shumica e bujqëve e ushtrojnë aktivitetin e tyre në kushte shumë të vështira. Krahës mangësive në procesin e prodhimit, mund të vëzhgojmë mangësitë edhe në optikën e komercializimit të produkteve.

Në tregjet bujqësore mungojnë strukturat e grupimit dhe mbledhjes së prodhimtarisë për blerësit e medhenj, si për shembull hipermarketet apo industrialët e agro-ushqimores, apo më tej mungesa e kontratave me blerësit. Si pasojë, bujqit nuk arrijnë dot të sigurojnë një treg për të shitur produktet e tyre dhe paralelisht me ta, edhe blerësit harxhojnë më shumë para dhe kohë për të gjetur produkte. Situata e sektorit paraqet atëherë një skenar shumë pesimist. Gjëndemi mes ekzodit rural, mungesës së oragnizimit në treg, mbrojtës ndaj konkurrencës së produkteve të importit, pamjaftueshmërisë së investimeve në sektor, apo akoma keqpërdorimit dhe mungesës së informacionit në treg.

Por, duke vënë në balancë potencialet e shumta të bujqësisë për tu zhvilluar më tej dhe këto pengesa të shumëfishta, detektimi i strategjive e politikave të zhvillimit është një domosdoshmëri ekonomike nga ku buron interesi im në thelimin e analizës së mekanizmave e dinamikave të tregjeve bujqësore. Arsyhet e pamjaftueshmërisë së tregjeve në fjalë mund të jenë të shumta, ndaj duhen grumbulluar sa më shumë të dhëna kohore mbi një numër të madh variablash ekonomike, me qëllim propozimin e zgjidhjeve mbi problemet aktuale të sektorit bujqësor.

2. Modelimi VAR dhe VECM: një sintezë ekonometrike mbi modelimin shumëpërmasor.

30 vitet e fundit kanë sjellë arritje të konsiderueshme mbi modelimin makroekonomik si në planin empirik edhe në planin teorik. Rinovimi gradual i modelimit makroekonomik ka kaluar përmes katër akseve:

1. përmirësimin të modeleve maro-ekonometrik
2. zhvillimit të modeleve vektorial autoregresiv (VAR)
3. zhvillimit të modeleve të ekuilibrit të përgjithshëm dinamik stokastik (DSGE)
4. zhvillimit të modeleve vektorial të korigjimit të gabimeve (VECM)

Që prej punimeve të Sims (1980) modelet VAR janë paraqitur si një alternativë interesante për analizën e influencave dinamike midis një numri të caktuar variablash. Metodologjia VAR ofron mundësinë e analizës së relacioneve dinamike në terma afat shkurtër midis variablave në sajë të studimit të përgjigjeve dinamike të vektorit autoregresiv pas një shoku unitar të pësuar nga seritë në fjalë. Modeli VECM rezulton si një kryqëzim midis qasjes ekonometrike dinamike sipas Hendry(1983) dhe Hendry (1995) dhe metodave statistike të analizës së serive kohore të Box dhe Jenkins (1976). Kuptimi i vetive statistike të serive të përdorura përmes koncepteve të integritimit dhe të bashkëintegritimit të Engle dhe Granger (1987) furnizojnë një suport statistik për përdorimin e VECM.

Kontributi i këtyre modeleve në nivel bashkëintegrimi, relacioni shkak-pasojë

dhe analizë të shokut mundëson detektimin e evolucionit dhe inter-varësive midis variablave të ndryshme, pra midis serive kronologjike. Zotërimi i këtyre modeleve dhe funksionimit të tyre bën të mundur realizimin e një modeli robust të mekanizmit të transmetimit të çmimeve, thellimit në mekanizëm dhe parashikimin e tij.

Modelet VAR

Këto modele prezantohen si një alternative e modeleve Keyneziane, të cilët kanë rezultuar si ineffikasë. Modelet VAR janë një përgjithësim i procesit AR (autoregresiv), por, në modelet VAR nuk është e detyrueshme që të gjithë komponentët të zbatojnë një proces AR. Modelimi VAR përfaqëson një mjet shumë interesant të ekonometrisë shumëpërmasore për detektimin e relacioneve dinamike midis variablave ekonomike. Ky model realizon modelimin e një vektori prej N variablash stacionare duke u bazuar mbi historikun e tyre.

Kemi, atëherë, një vektor variablash X_t , ku x_{1t} , është e shpjeguar nga vlerat e saj të kaluara por gjithashtu prej vlerave të kaluara dhe të tashme të variablave të tjera që janë pjesë e vektorit fillestar. Ky është sistemi i relacioneve që ndërton lidhjet dinamike të modeleve VAR. Variablat varen, atëherë, linerisht nga e shkuara. Qëllimi i një modeli të tillë është që të nxjerrë në pah lidhjet shkak-pasojë midis variablave të ndryshme, pra një variabël X shkakton një variabël Y nëse parashikimi i variablës Y që bazohet nga njohuritë e kaluara të nderthurjes së dy variablave është më i mirë se sa parashikimi i bazuar vetëm mbi njohuritë e kaluara të variablës Y (kauzaliteti në sensin e Granger (1969)). Gjithashtu modeli synon të detektojë sjelljen ndaj shokut apo impulset, të masë amplitudën e përgjigjeve nga një shok i mundshëm dhe mbi të gjitha të arrihet realizimi i parashikimeve të besueshme.

Për përdorimin e modeleve VAR duhet verifikuar stacionariteti i modelit dhe dekompozimi i tij, duhet siguruar endogjeniteti i variablave si dhe numri vonesave optimal në model. Për të shkruar një model VAR le të marrim një vektor X_t variablash stacionare me përmasa $(n \times 1)$, $X_t = (x_{1t}, x_{2t}, \dots, x_{nt})$. Modeli VAR (p) do të paraqitet atëherë nën formën:

$$X_t = C + \varphi_1 X_{t-1} + \varphi_2 X_{t-2} + \dots + \varphi_p X_{t-p} + \varepsilon_t \quad \text{ku } t = 1, \dots, T$$

Me $\varepsilon_t = (\varepsilon_{1t}, \varepsilon_{2t}, \dots, \varepsilon_{nt})$, ku ε_t është një proces iid që ndjek një shpërndarje normale $N(0, \Sigma)$, i quajtur vektori i inovacionit (ku Σ është një matricë diagonale primordiale për modelimin e modelit VAR dhe për përdorimin e tij), C është një matricë me përmasa $(n \times 1)$ që përfaqëson një vektor me konstante dhe φ_i është një matricë me përmasa $(n \times n)$ për $i = 1, 2, \dots, p$.

Bashkëintegrimi dhe modelimi VECM

Modelimi VAR mbështetet mbi kushin e stacionaritetit. Në rastin kur serite kohore nuk janë stacionare, ky modelim nuk është më i realizueshëm direkt mbi seritë. Kur serite kohore nuk janë stacionare gjenerojnë dy probleme, pikë së pari përballemi me problemin e regresioneve të fallcifikuara, ngaqë mbetja nuk është më “White Noise”, dhe pikë së dyti, në nivel të asimptotave, që nuk janë më të vlefshme.

Alternativa e transformimit të serive në stacionare përbën gjithashtu probleme, si për shembull nuk do të merrnim parasysh ndryshimin nga një periudhe në tjetrën, do të maskonim, atëherë vetitë në termat afatgjatë. Në këtë rast seritë transformohen në stacionare duke u vendosur në diferenca dhe përftojmë kështu një model VAR në diferencë. Por kjo zgjidhje e ka një risk që buron nga transformimi i serisë dhe gjeneron humbje informacioni sepse procedura në fjalë kalon përmes vendosjes së një kushti parametrik.

Duke vëzhguar gjithë skenarët e mundshëm, duhet të dimë që duhet të mundohemi të ruajmë sa më shumë informacion të jetë e mundur, pra të mos transformojmë seritë vetëm për të mundur të përdorim modelin që dëshirojmë. Ekziston atëherë alternativa që të konservojmë sa më shumë informacion mbi seritë.

Koncepti i bashkëintegritimit është një ndër këto alternativa. Ky koncept është mjaft i ri, autorët e të cilit janë Hendry (1986) Granger dhe Engle (1987) dhe Stock & Watson (1988). Bashkëintegrimi është shumë i rëndësishëm për kuptimin e relacioneve të ekuilibrit afatgjatë midis variablave kohore. Nëse relacionet afatgjata janë stabël, mund të flasim për relacione bashkëintegrimi, dhe të përdorim më pas modelet VECM.

Modelet e korrigjimit të gabimeve mundësojnë paralelisht modelimin e dinamikave afatshkurtra dhe dinamikave afatgjata. Teorikisht, zbardhja e relacioneve shkak-pasojë midis variablave ekonomike na ofron elemente refleksioni avantazhoze për të kuptuar më mirë fenomenet e ndryshëm ekonomikë. Më saktësisht, “the causal knowledge” është i rëndësishëm për të formuluar në mënyrë korrekte politikat ekonomike.

Ekzistenca e një relacioni bashkëintegrimi midis variablave kohore gjeneron prezencën e relacioneve shkak-pasojë midis këtyre të fundit. Relacionet shkak-pasojë mund të analizohen përmes testeve të Granger. Matja e relacionit shkak-pasojë mund të paraqitet përmes:

$$C_{X \rightarrow Y} = \log \frac{\det V_{\varepsilon} [Y_t | \underline{Y_{t-1}}]}{\det V_{\varepsilon} [Y_t | \underline{Y_{t-1}}, \underline{X_{t-1}}]}$$

Sipas Granger, të gjithë seritë kohore të bashkëintegruara mund të prezantohen përmes një mekanizmi të korrigjimit të gabimeve. Ky i fundit ndalon variablat që

të largohen shumë nga ekuilibri afatgjatë. Sipas literaturës së Hendry (1978-1984, 1982-1983) VECM-të mundësojnë , kështu, modelimin e rregullimeve që çojnë në një situatë ekuilibri afatgjatë. Modelet VECM janë atëherë modele dinamike që integrojnë në të njëjtën kohë evolucionin afatshkurtër dhe afatgjatë të variablave.

Le të ilustrojmë modelin VECM duke marrë X_t dhe Y_t dy seri kohore të bashkëintegruara me rend (1,1) :

$$\begin{cases} \Delta X_t = \gamma_1 Z_{t-1} + \sum_i \beta_i \Delta X_{t-i} + \sum_j \delta_j \Delta Y_{t-j} + d_1 + (L)\varepsilon_{Xt} \\ \Delta Y_t = \gamma_2 Z_{t-1} + \sum_i \beta'_i \Delta X_{t-i} + \sum_j \delta'_j \Delta Y_{t-j} + d_2 + (L)\varepsilon_{Yt} \end{cases}$$

Ku ε_{Xt} dhe ε_{Yt} janë “White Noise” dhe $Z_t = X_t - aY_t$ përfaqëson mbetjen e relacionit të bashkëintegrimit midis variablave X_t dhe Y_t . Diferenca e vëzhguar pikërisht me një model VAR është prania e variablës Z_{t-1} . Koeficientët γ_i (për $i= 1, 2$) përfaqësojnë forcën e kthimit drejt targetit të termit afatgjatë, ekuilibrit afatgjatë, të dhënë nga relacioni i bashkëintegrimit.

Modeli VECM përbëhet nga dy lloje variablash. Ai integron fluktuacionet afatshkurtra, (të përfaqësuara nga variablat në diferenca të para) , rreth ekuilibrit afatgjatë (të dhëna nga relacioni i bashkëintegrimit) . Duke u bazuar te rezultatet që do të përftojme nga modeli VECM do të mund të vëzhgojmë dhe të shpjegojmë shpejtësinë e rregullimit të relacionit afatgjatë ose të ekuilibrit afatshkurtër.

Prurjet e këtyre modeleve në nivel të bashkëintegrimit, relacioneve shkak-pasojë apo analizës së shokut, mundëson pra, detektimin e evolucionit dhe të inter-varësive midis variablave të shumta të një modeli. Mirëpërdorimi i tyre bën të mundur realizimin e nje modelimi robust për të kuptuar më mirë mekanizmat e tregut dhe realizimin e parashikimeve.

3. Rasti i tregjeve të fruta-perimeve

Vazhdimësia e dokumentit prezent bazohet në aplikimin e metodave të paraqitura *supra* , mbi një shportë produktesh bujqësore. Zgjedhja e variablave në fjalë ka qënë lehtësisht e kushtëzuar nga disponibiliteti i informacionit mbi tregjet në fjalë. Më është dhënë mundësia, atëherë, të ndërtoj për realizimin e këtij studimi eksperimental nën optikën e studimit të transmetimit të çmimeve, një bazë të dhënash të përbërë nga seri çmimesh mujore për periudhën kohore 1998-2009. Dinamikat e gjithësecilit prej tregjeve të përfaqësuar nga seritë kohore të sipërpërmendura do të studjohen dhe do të bashkëvendosen, në mënyrë që të detektojmë ndërveprimet e tyre, relacionet e mundshme dhe mbi të gjitha të mund të detektojmë dinamikat e transmetimit të çmimve nga një treg në tjetrin. Do të jetë gjithashtu një analizë premtuese për propozime mbi politikat ekonomike të racionalizimit dhe kontrollit të tregjeve bujqësore.

Prezantimi dhe përgatitja e të dhënave

Seritë kohore janë në çmime mujore në Lek, për një periudhë dymbëdhjetë vjeçare, nga viti 1998 deri më 2009, duke përfshirë kështu 144 vërtetime, numër i mjaftueshëm për realizimin e procedurave ekonometrike të zgjedhura. E thënë ndryshe, baza e të dhënave është mjaftueshëm e rëndësishme për të realizuar një modelim korrekt. Bëhet fjalë për 8 seri çmimesh mujore për produktet e mëposhtme:

$-X_1$ = Patate $-X_2$ = Domate $-X_3$ = Spinaq $-X_4$ = Karrote
 $-X_5$ = Mollë $-X_6$ = Portokalle $-X_7$ = Rrush $-X_8$ = Grurë

Për çdo modelim duhet kaluar nëpër etapa të shumta për të arritur në modelin korrekt. Fillohet me një studim më në thellësi të gjithë variablave.

Tabela 3.1 Karakteristikat stokastike të variablave

	(X1) Patate	(X2) Domate	(X3) Spinaq	(X4) Karrota	(X5) Mollë	(X6) Portokalle	(X7) Rrush	(X8) Grurë
Mesatarja	45,17	93,65	83,15	79,11	95,63	108,48	181,88	35,68
Minimumi	25	21	36	50	62	72	72	28
Maksimumi	69	185	150	115	157	184	600	53
Devijimi Standart	7,60	45,04	24,16	11,66	20,16	25,70	107,57	6,40
Varianca	57,706	2028,202	583,711	136,002	406,404	660,335	11571,629	40,974

Për të patur një ide më të qartë për seritë tona do të analizojmë sjelljen e tyre. Në tabelën e mësipërme 3.1 mund të vëzhgohen karakteristikat e tyre stokastike, që na ofrojnë një përshkrim të përbledhur mbi seritë. Më pas do të procedojmë me analizën e normalitetit të serive. Nëpërmjet testeve të Jarque-Bera, Skewness dhe Kurtosis do të detektojmë një shpërndarje rreth mesatares normale për variablat X_1, X_2, X_4, X_6 dhe X_7 . Për sa i përket variablave X_2, X_5 dhe X_7 shpërndarja e tyre nuk është normale.

Të dhënat do të procesohen në mënyrë të tillë që të “zhvishen” nga komponentët e ndryshëm për të detektuar realisht dinamikat e tyre. Për të thjeshtuar llogaritjet do të kalohen seritë në logaritmike, në mënyrë që ti linearizojmë duke mos ndryshuar strukturën e tyre dhe duke eliminuar nga seritë komponentët parazitare. Do të punohet atëherë me log-seritë. Së dyti, seritë në fjalë kanë një probabilitet shumë të lartë për të qënë stinore, ndaj është realizuar studimi i stinës. Komponenti stinor pra, do të eliminohet nëpërmjet metodës CENSUS.

Më pas duhet testuar stacionariteti i variablave nëpërmjet testeve Dickey-Fuller, pikë kjo shumë e rëndësishme për vazhdimësinë e studimit, duke bërë ndarjen në përdorimin e dy metodave ekonometrike të zgjedhura. Në fakt, nëse seritë janë

stacionare do të procedohet me modelimin sipas modeleve VAR. Në të kundërt duhet proceduar me detektimin e shkallës së integritimit.

Në rastin kur seritë nuk janë të integruara në të njëjtën shkallë jemi në pamundësi vazhdimi të analizës, ndërsa në rastin kur seritë janë të integruara në të njëjtën shkallë do të mund të realizohet modelimi nëpërmjet modeleve VECM. Mund të vëzhgojmë në tabelën e mëposhtme 3.2 përmbledhjen e analizës së stacionaritetit.

Tabela 3.2 Rezultatet e analizës së stacionaritetit

	(X1) Patate	(X2) Domate	(X3) Spinaq	(X4) Karrota	(X5) Mollë	(X6) Portokalle	(X7) Rrush	(X8) Grurë
Stacionariteti	Stacionare	Jo Stacionare	Stacio.	Stacio.	Stacio.	Stacio.	Stacio.	Jo Stacio.
Shkalla e integritimit	I(0)	I(1)	I(0)	I(0)	I(0)	I(0)	I(0)	I(1)

Në bazë të analizave të realizuare ndajmë variablat tona në dy grupe, duke integruar ne modelin VECM variablat X2 dhe X8 dhe variablat e tjera në modelin VAR.

Modeli VECM

Përmes modelit VECM do të mund të detektohet dinamika e variablave, në rastet kur variablat nuk manifestojnë relacione afatshkurtra, ato mund të kenë gjithsesi relacione në periudha afatgjata duke patur një tendencë të rikthimit drejt ekuilibrit. Ndodh që variablat të kenë tendencë të largohen nga ekuilibri, por mekanizmi i tyre dinamik do të korrigjojë këtë divergjencë duke siguruar konvergjencën drejt ekuilibrit afatgjatë, nga ku përftohet edhe emri i modelit VECM, pra bëhet fjalë për një “korrigjim të gabimeve”.


Do të fillojmë analizën me detektimin e relacioneve të bashkëintegritimit midis variablave. Në mënyrë që të ruhet dinamika e modelit dhe të kemi vlerësues sa më efikas vendosim një numër vonesash në model të barabartë me tre. Studimi i bashkëintegritimit kryhet nëpërmjet testit të Johansen, i cili do të na ilustrojë sa relacione bashkëintegrimi ekzistojnë në modelin VECM. Në bazë të këtij testi ne evidentojmë një relacion bashkë integrimi në model, i dukshëm në tabelën 3.3, i cili është i përfaqësuar nga variabla X2, si variabël endogjene, dhe nga variabla X8. Konstantja në model nuk është statistikisht e rëndësishme ndaj përftojme ekuacionin:

$$\text{Ekuacioni i bashkëintegritimit} = -0.414706(X_{8_sa})_{t-1}$$

Tabela 3.3 Vlerësimi i ekuacionit të bashkëintegrimit

Cointegrating Eq: CointEq1	
X2_SA(t-1)	1.000000
X8_SA(t-1)	-0.414706 (0.20806) [-1.99324]
C	-1.273621

Grafiku 3.1 Paraqitja e relacionit të bashkëintegrimit



Tendencën e rikthimit drejt ekuilibrit mundt ta vëzhgojmë gjithashtu edhe në paraqitjen grafike 3.1 të relacionit të bashkëintegrimit të mësipërm. Ekzistojnë pra dy lloje variablash, variablat që çrregullojnë ekuilibrin dhe ato që e rikapin ekuilibrin, të cilat janë në origjinën e koriggjimit të gabimit, duke ulur diferencën që gjeneron kështu rikthimin drejt ekuilibrit. Është pikërisht shenja e koeficientit të variablës që përcakton kategorinë në të cilën ajo ndodhet. Në këtë rast, është variabla X8, pra gruri, i cili rikap diferencën nga ekuilibri në sajë të shenjës negative që e karakterizon koeficientin e tij.

Në sajë të vlerësimit të modelit do të vëzhgojmë ndërveprimet dhe relacionet e influencës mes variablave të modelit. Variabla X2, pra domatja, influencohet pikë së pari negativisht nga relacioni i bashkëintegrimit, dhe se dyti influencohet pozitivisht nga e shkuara e variablet X8 në periudhën t-1. Në të kundërt gruri nuk është as e shpjeguar as e influencuar nga variablat dhe relacionet e detektuara. Le të ilustrojmë modelin VECM me ekuacionin e tij:

$$\left\{ \begin{array}{l} D(X2) = -0.37612514 * (X2(-1) - 0.41470 * X8(-1) - 1.27362) + 0.149499 * D(X2(-1)) - 0.032228 * D(X2(-2)) - 0.01790 * D(X2(-3)) + 0.8821 * D(X8(-1)) - 0.58201 * D(X8(-2)) - 0.75928 * D(X8(-3)) + 0.0001596 \\ D(X8) = 0.0296858 * (X2(-1) - 0.4147 * X8(-1) - 1.2736) + 0.006155 * D(X2(-1)) - 0.013716 * D(X2(-2)) - 0.0004 * D(X2(-3)) + 0.00756 * D(X8(-1)) + 0.1325 * D(X8(-2)) + 0.1429758 * D(X8(-3)) + 0.00028 \end{array} \right.$$

Nuk mbetet gjë tjetër për këtë model përveç bërjes së vlefshëm, pra do të testojmë “bardhësinë” e mbetjes së tij. E thënë ndryshe do të testojmë nëse mbetjet sillen si një “White Noise” duke qënë homosedastikë, më një shpërndarje normale dhe në mungesë të autokorrelacionit. Në bazë të testeve të sipërpërmendur mund të shpreh që mbetja e modelit VECM nuk gëzon asnjë nga vetitë e sipërpërmendura, duke dalë kështu, në përfundimin se modeli i realizuar nuk mund të përdoret për parashikime

shifrore. Por pavarësisht nga ky fakt, modeli VECM mund shumë mirë të përdoret për të shpjeguar ndërlidhjet dhe relacionet midis variablave, pra, variacionet në variablën grurë do të influencojnë mbi relacionin e bashkëintegrit, mbi variablën domate dhe të klasifikohet si variabla që rifiton divergjencat nga ekuilibri afatgjatë.

Modeli VAR

Modeli VAR si përgjithësimi i modeleve AR (Auto Regressive), kanë për qëllim modelimin e një vektori prej N variablash stacionare duke u bazuar mbi historikun e tyre. Atëherë, dy variablat që nuk ishin stacionare janë transformuar në të tilla për të mundur të integrohen në model. Pra i kemi kaluar seritë në fjalë në diferenca për të arritur stacionaritetin e tyre. Duke plotësuar kushtin bazë të modelit VAR, mund të vijohet me ndërtimin e tij.

Pikë së pari, duke u bazuar në kriterin e Akaike , numri i vonesave optimale në model është $p=1$. Nga analiza shkak-pasojë, e realizuar nëpërmjet testit të Granger, mund të vëzhgohen lidhjet kauzale midis variablave tona. Relacionet shkak-pasojë të detektuara nëpërmjet këtij testi mund paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Tabela 3.4 Relacionet shkak-pasojë të detektuara nga testi Granger

Variabla	X1	X3	X5	X6	X7
Shkakton variablën:	X5	X4	X3	X7	X3
	X7		X7		

Me këto relacione të detektuara ndërtojmë një apriori mbi rezultatet e modelit VAR. Kështu, mund të vëzhgojmë që dy variablat në diferencë (X2 dhe X8) nuk bashkëveprojnë me asnjë variablë, dhe është marrë vendimi që këto të fundit të mos integrohen në model.

Do të vazhdohet analiza e modelit VAR me variablat X1, X3 , X4, X5, X6 dhe X7. Vlerësimin e plotë të modelit e gjejmë në tabelën 3.6, përmbledhjen e vlerësimit të realizuar mund ta vëzhgojmë në tabelën 3.5.

Tabela 3.5 Përmbledhja e vlerësimit të modelit VECM

Variabla	X1	X3	X4	X5	X6	X7
----------	----	----	----	----	----	----

Vector Autoregression Estimates
Sample (adjusted): 1998M02 2009M12
Included observations: 143 after adjustments
Standard errors in () & t-statistics in []

	X1_SA	X3_SA	X4_SA	X5_SA	X6_SA	X7_SA
X1_SA(-1)	0.805949 (0.05358) [15.0412]	0.004707 (0.11335) [0.04153]	-0.016196 (0.05357) [-0.30236]	0.127545 (0.04629) [2.75511]	0.038799 (0.04250) [0.91294]	0.146398 (0.13573) [1.07858]
X3_SA(-1)	0.016715 (0.03204) [0.52168]	0.658302 (0.06778) [9.71280]	0.095227 (0.03203) [2.97297]	-0.018833 (0.02768) [-0.68031]	-0.036249 (0.02541) [-1.42641]	0.153475 (0.08116) [1.89095]
X4_SA(-1)	0.061599 (0.05026) [1.22550]	-0.013969 (0.10633) [-0.13138]	0.772477 (0.05025) [15.3730]	0.074903 (0.04343) [1.72482]	0.015557 (0.03987) [0.39022]	-0.030037 (0.12733) [-0.23591]
X5_SA(-1)	-0.039994 (0.05413) [-0.73879]	0.016716 (0.11451) [0.14597]	0.041830 (0.05412) [0.77295]	0.787885 (0.04677) [16.8457]	0.039643 (0.04294) [0.92328]	0.603006 (0.13713) [4.39736]
X6_SA(-1)	0.104201 (0.07030) [1.48226]	0.142623 (0.14871) [0.95910]	-0.037242 (0.07028) [-0.52992]	0.049884 (0.06074) [0.82133]	0.758073 (0.05576) [13.5960]	0.055477 (0.17808) [0.31154]
X7_SA(-1)	0.050502 (0.03297) [1.53161]	0.105133 (0.06975) [1.50729]	-0.054364 (0.03296) [-1.64921]	0.070282 (0.02849) [2.46707]	0.018995 (0.02615) [0.72630]	0.336560 (0.08353) [4.02942]
C	-0.070930 (0.15808) [-0.44869]	0.117413 (0.33440) [0.35112]	0.389776 (0.15804) [2.46637]	-0.153854 (0.13658) [-1.12648]	0.345664 (0.12538) [2.75685]	-0.313921 (0.40045) [-0.78393]
R-squared	0.767435	0.548956	0.683370	0.892307	0.685037	0.619812
Adj. R-squared	0.757175	0.529057	0.669401	0.887556	0.671142	0.603039
Sum sq. resids	0.152245	0.681243	0.152154	0.113643	0.095775	0.976916
S.E. equation	0.033458	0.070775	0.033448	0.028907	0.026537	0.084754
F-statistic	74.79710	27.58708	48.92064	187.8090	49.29956	36.95303
Log likelihood	286.5171	179.3795	286.5600	307.4256	319.6564	153.6050
Akaike AIC	-3.909330	-2.410901	-3.909930	-4.201757	-4.372817	-2.050420
Schwarz SC	-3.764296	-2.265867	-3.764896	-4.056723	-4.227783	-1.905386
Mean dependent	1.648992	1.901972	1.893975	1.970575	2.024715	2.203131
S.D. dependent	0.067898	0.103133	0.058173	0.086205	0.046276	0.134520

Tabela 3.6 Vlerësimi i modelit VAR

Pra, variablat X1, X3 dhe X6 (përkatësisht patatet, spinaqi dhe portokallet) shpjegohen vetëm nga e kalaura e tyre. Në të kundërt, variabla X4 (karrota) shpjegohet nga e kaluara e saj dhe nga e kaluara e variablës X3, variabla X5 (molla) shpjegohet nga e kaluara e saj, dhe e kaluara e X1 dhe X, dhe variabla X7 (Rrushi) shpjegohet nga e kalaura e saj dhe e kaluara e variablës X5.

Atëherë, ekuacionet e gjeneruara nga modeli VAR i gjejmë më poshtë:

$$\begin{aligned}
X1 &= 0.80595 \cdot X1(t-1) + 0.016715 \cdot X3(t-1) + 0.061599 \cdot X4(t-1) - 0.039994 \cdot X5(t-1) + \\
&0.104201 \cdot X6(t-1) + 0.05050 \cdot X7(t-1) - 0.07092978 \\
X3 &= 0.00471 \cdot X1(t-1) + 0.6583 \cdot X3(t-1) - 0.01397 \cdot X4(t-1) + 0.0167155 \cdot X5(t-1) + 0.14262 \cdot X6(t-1) \\
&+ 0.1051333 \cdot X7(t-1) + 0.11741 \\
X4 &= -0.016196 \cdot X1(t-1) + 0.095227 \cdot X3(t-1) + 0.772478 \cdot X4(t-1) + 0.04183 \cdot X5(t-1) - \\
&0.03724 \cdot X6(t-1) - 0.054364 \cdot X7(t-1) + 0.389776 \\
X5 &= 0.127545 \cdot X1(t-1) - 0.0188326 \cdot X3(t-1) + 0.074903 \cdot X4(t-1) + 0.78788 \cdot X5(t-1) + \\
&0.0498841298626 \cdot X6(t-1) + 0.07028 \cdot X7(t-1) - 0.15385 \\
X6_SA &= 0.038799 \cdot X1(t-1) - 0.036249 \cdot X3(t-1) + 0.015557 \cdot X4(t-1) + 0.03964 \cdot X5(t-1) + \\
&0.75807 \cdot X6(t-1) + 0.018994 \cdot X7(t-1) + 0.345664 \\
X7 &= 0.146398 \cdot X1(t-1) + 0.153475 \cdot X3(t-1) - 0.0300369 \cdot X4(t-1) + 0.603 \cdot X5(t-1) + \\
&0.055477 \cdot X6(t-1) + 0.33656 \cdot X7(t-1) - 0.313921
\end{aligned}$$

Për sa i përket pranimin të modelit, do të kalojmë baterinë e testeve mbi “bardhësinë” e mbetjeve, dhe në bazë të tyre dalim, fatkeqësisht, në përfundimin se edhe modeli VAR nuk do mund të përdoret për parashikimet shifrore. Në të njëjtin rast si modeli VECM, rezultatet e analizës do të përdoren për të detektuar dhe kuptuar ndërveprimet midis variablave. Një analizë e tillë e modeleve VAR është pikërisht analiza e përgjigjeve të impulseve.


Nëpërmjet funksionit të përgjigjeve ndaj impulseve studjohet elovucioni i një komponenti të serisë që ndërhyr falë një impulsi që i përcillet në T. Në fakt, kjo përgjigje ndaj impulsit përkthen trasmissionin e një shoku nga një periudhë në tjetrën. Është pikërisht kjo, analiza që mundëson studimin e trasmetimit të çmimeve. Prezantimet grafike të paraqitura më poshtë, ilustrjnë për secilën variabël, përgjigjen e saj kundrejt shokut të dhënë variablave të tjera.

Gjysma e variablave (X1, X3 dhe X6) nuk u përgjigjen impulseve të trasmetuara kundrejt variablave të tjera te sistemit, por përgjigjen në mënyrë imediate nga shoku pësuar mbi vetveten. Shoku pozitiv i dërguar mbi këto variabla ndjell një përgjigje negative, duke gjeneruar një rikthim drejt sjelljes së vet normale. Pra variablat në fjalë, që i përgjigjen vetëm impulseve mbi vetveten, kanë tendencë të rivendosin ekuilibrin e tyre me kalimin e kohës. Në anën tjetër gjejmë variablat të cilat manifestojnë përgjigje të rëndësishme nga shoku i induktuar kundrejt variablave të tjera të modelit. Paraqitjet grafike të përgjigjeve ndaj impulseve për variablat X1, X4, X5 dhe X7 illustrohet në figurën 3.1.

Përkatesisht, variabla X4 manifeston një përgjigje pozitive kundrejt shokut pozitiv të variablës X3, përgjigja është imediate, dhe zbehet mbas 9 periudhash. Variabla X5 i përgjigjet shokut mbi variablën X1, me një përgjigje imediate, me sens pozitiv që nuk shuhet shpejtë. Më mënyrë marxhinale X5 i përgjigjet pozitivisht edhe shokut mbi variablën X7, por me një periudhë vonesë. Variabla X7 i përgjigjet me një periudhë vonesë shokut të induktuar mbi variablën X5. Kjo përgjigje është negative dhe shuhet me kalimin e kohës.

Variablat e sipërpërmendura i përgjigjen gjithashtu në mënyrë imediate dhe negativisht shokut pozitiv të pësuar nga vetvetja, duke ju rikthyer sjelles së tyre të zakonshme, pra rikthehen drejt ekuilibrit të tyre personal në periudhë afatgjatë. Kjo analizë na ofron, atëherë, rezultate të nevojshëm për vendosjen e disa rregullave mbi sjelljen e ndërthurur të këtyre variablave.

Figura 3.1



Rezultatet

Rezultatet e përftuar nga modelet prezentë mund të përdoren për kryerjen e inferencave mbi analizën statike të ndërlidhjeve të mundshme midis variablave, me qëllim detektimin e një veprimi që mund të ndikojnë në rrokadë shumë tregje njëkohësisht.

Atëherë, është e mundur të bartin si informacione vendimtare prej modelit VECM, impaktin e çmimit të grurit mbi çmimin e domates, që manifestohet në dy plane: fillimisht në periudhë afatshkurtër –përmes rëndësisë së koeficientëve të historikut- por gjithashtu edhe në periudhë afatgjatë- nga kontributi mbi trajektoren e ekuilibrit që prek qartë çmimin e domates-.

De facto, një politikë subvencionuese mbi dy tregjet në fjalë (me kostot më të ulëta) mund të konsiderohet, përmes një ndërhyrjeje të fuqishme publike mbi tregun e grurit, i cili, me kalimin e kohës do të ketë impakt dhe do të shtyjë uljen e çmimit të domates.

Nga modeli VAR përftojme dy profile tregjesh të ndryshëm:

- Profili i parë grupon tregun e patates, spinaqit dhe të portokallit, ku seritë kanë rezultuar procese auto regresivë të pastër. Në terma të tjerë, niveli kontemporan i çmimit ndikohet vetëm nga historiku i tij vetjak. Në fakt, na lë të mendojmë që apiori, do ta kemi të pamundur të ndërmarrim ndonjë veprim për të ndikuar tregjet në fjalë përmes ndikimit të bërë mbi tregje të tjerë.

- Profili i dytë përfshin çmimin e karrotës, mollës dhe të rrushit, dhe secila karakterizohet nga ekzistenca e influencave të rëndësishme prej historikut të variablave të tjera mbi nivelin kontemporan të çmimit. Në të tillë raste janë detektuar ndërlidhjet e mëposhtme

- Tregu i karrotës paraqitet si një proces autoregresiv me efekte pozitive mbi nivelin e tij të çmimit, të cilit i shtohet një influencë negative nga historiku i tregut të spinaqit. Çmimi i karrotës përgjigjet në mënyrë imediate dhe pozitive shokut të induktuar mbi çmimin e spinaqit të një periudhe më parë.

- Çmimi i rrushit paraqitet gjithashtu si një proces autoregresiv me efekte pozitive mbi nivelin e tij të çmimit, të cilit i shtohet paralelisht një influencë pozitive nga historiku i tregut të mollës. Çmimi i rrushit reagon në imediat dhe negativisht nga shoku mbi çmimin e mollës.

- Së treti, tregu i mollës paraqitet si rasti i ndërveprimeve më të plota, sepse në të njëjtën kohë i parashtrohet edhe influencës së vlerave të tij por gjithashtu edhe influencës së dy tregjeve të tjera, të karrotës dhe rrushit. Çmimi i mollës përgjigjet në imediat dhe pozitivisht shokut të pësuar nga çmimi i patates.

Në mënyrë analoge me modelin e parë, nëse përdorim me korrektësi ndërlidhjet e përftuara mund të orientohe mi drejt politikave efikase mbi tregjet në fjalë.

Përfundime

Përmes këtij studimi u mundësua detektimi i ndërlidhjeve midis çmimeve të shportës së produkteve bujqësore. Në fakt, janë nxjerrë lidhjet kauzale midis çmimeve të produkteve të ndryshëm, amplituda dhe sensi i relacioneve mes tyre për të analizuar fenomenin e trasmetimit të çmimeve që mund të ekzistojë midis këtyre tregjeve. Është ndërtuar atëherë një portofol rezultatesh që do të mundësojë vendosjen e disa rregullash vendimi në optikën e politikave ekonomike. Në të vërtetë, mund të kategorizojmë tre lloje tregjesh.

Lloji i parë përfaqësohet nga tregjet e integruar. Në fakt në prezencë të bashkëintegritimit konsiderohet mundësia e të paturit të tregjeve të integruara. Këta të fundit shprehin mekanizmin e rikthimit drejt ekuilibrit afatgjatë. Pavarësisht nga tendencat divergjuese të variablave në periudhë afatshkurtër, në periudha afatgjata ato do të konvergjojnë drejt ekuilibrit.

Lloji i dytë evokon tregjet kontingjent. Pra, në rastin kur bashkëintegrimi nuk verifikohet, kalojmë në modelimin VAR dhe në analizën e shokut që do të vërë në evidencë ndërveprimet midis variablave nën optikën e trasmetimit të çmimeve.

Së fundmi, pas një varg analizash, evidentojmë një grup tregjesh të cilët nuk manifestojnë as influenca as kauzalitet ndërmjet tyre. Këta të fundit formojnë atëherë tregjet hermetikë të cilët ndjekin trajektoret vetjake në mënyrë të pavarur nga tregjet e tjera.

Fakti që në rastin e studimit konkret modelet nuk mund të kalojnë në përdorim të parashikimeve shifrore, do të doja të vija në dukje gjithashtu strukturat e rënda të modeleve VAR dhe VECM, me nevojën e tyre për kampionë të mëdhenj, gjithashtu fusha e aplikimit të tyre merr në konsideratë një optikë lineare, ndërkohë që idealja do të ishte të përshtasim metodat statistike me një parametrizim që rrjedh nga realiteti ekonomik. Ndaj për arsye të limiteve që na caktoi studimi në fjalë optimalja do të ishte të kalonim në një optikë jo lineare vektoriale dhe/ose bashkëintegruese në mënyrë që të shtyjmë akoma më tej analizën në nxjerrjen e rezultateve më bindëse.

Bibliografia:

- Banerjee, A., Dolado, J., Galbraith, J. W. and Hendry, D. F. (1993): Co-Integration, Error-Correction, and the Econometric Analysis of Non-Stationary Data, Oxford University Press, Oxford.
- Clements, M. , Hendry D. , (1995): Macro-economic Forecasting and Modelling, Economic Journal, Royal Economic Society, vol. 105(431), pp 1001-13.
- Dickey, D. A. and Fuller, W. A. (1979): Distribution of the estimators for autoregressive time series with a unit root, Journal of the American Statistical Association 74, pp 427—431.
- Granger, C.W.J.(1969): Investigating Causal Relations by Econometric Models and Cross Spectral Methods, Econometrica, 37,pp 424-438.
- Lutkepohl, H. (1991): Introduction to Multiple Time Series Analysis. Springer-Verlag, Berlin.
- Stock, J.H. and M.W. Watson (2001): Vector Autoregressions, Journal of Economic Perspectives.
- Tavéra Ch. (1991-93) : Test de racine unité et stationnarisation des séries non stationnaires= présentation générale et application au cas des séries agricoles. Economie et prévision .
- Watson, M. (1994): Vector Autoregressions and Cointegration, in Handbook of Econometrics, volume IV. R.F. Engle and D. McFadden Elsevier Science Ltd., Amsterdam.
- Wold, H. (1954): A study in the analysis of stationary time series. Stockholm: Almqvist & Wiksell
- Zha, T. (1998): Dynamic Multivariate Model for Use in Formulating Policy, Economic Review, Federal Reserve Bank of Atlanta, First Quarter.

Sistemi Bankar Shqiptar përballë krizës ekonomike: Prirja e këtij tregu

— Arbi AGALLIU*, MSc —

Abstrakt. *Sistemi bankar në Shqipëri paraqitet si një sistem i konsoliduar dhe i qëndrueshëm. Pjesëmarrja e grupeve të fuqishme bankare në tregun shqiptar mund të shihet si një shenjë pozitive që jep siguri për vazhdimsin e rritjes dhe zhvillimit të këtij tregu. Mirëpo nga ana tjetër sot ekonomia globale është prekur rëndë nga kriza ekonomike. Efektet e kësaj krize nuk lanë pa prekur edhe Shqipërinë. Ndikimi i saj u ndje në çdo fushë të ekonomisë shqiptare, aq më tepër në atë të ndërmjetësve financiar.*

Sistemi bankar si një nga përfaqësuesit kryesor të ndërmjetësve financiar po has vështirësi të shumta si pasojë e krizës ekonomike. Për këtë arsye janë marrë masa të cilat kanë ndikuar pozitivisht ose jo në situatën aktuale ekonomike të sistemit bankar shqiptar. Por a ka mundësi të tjera ndërhyrje për të parandaluar efektet negative të krizës si dhe për të përmirësuar situatën? Cilat janë ato dhe si duhen implementuar? A ka kapacitete të mjaftueshme sistemi bankar shqiptar për ta kaluar me sa më pak efekte negative këtë situatë? A është bërë mjaftueshëm deri më tani apo ka mundësi përmirësimi të mëtejshëm? Këto janë disa nga pyetjejet të cilat ju jepen përgjigje gjatë zhvillimit të këtij punimi.

Punimi është përgatitur mbi bazën e të dhënave statistikore si dhe përdor një metodë narrative e krahasuese për sa i përket problemeve dhe efekteve të krizës në sistemin bankar shqiptar.

Fjalë kyçe:

sistemi bankar, kriza ekonomike

* Doktorant. Pedagog pranë Departamentit të Financës, Universiteti Europian i Tiranës.

HYRJE

Ekonomia është një nga fushat ku të papriturat dhe zhvillimet ndodhin me ritme të larta. Sot ekonomia botërore po përballet me probleme dhe sfida të cilat nuk i ndesh shpesh. Kriza financiare ka vënë në lëvizje pothuaj të gjithë ekonomistët. Shumë pyetjeve dhe problemeve u jepet zgjidhje në mënyrë unanime, për disa të tjera ka debate dhe përplasje, ndërsa për disa të tjera zgjidhjet nuk gjenden. Shpesh lind pyetja se a duhet të ndodhnin këto kriza? A janë këto kriza normale për ekonominë globale apo mos vallë janë të sajura artificialisht për arsye gjeopolitike?

Një shprehje e njohur thotë: *“Ekonomia pa kriza nuk mund të konceptohet, ashtu si nuk mund të konceptohet kristianizmi pa ferrin.”*

Kështu që argumentat për prezencën e krizës janë të shumta por ajo që na intereson ne është dalja sa më shpejt nga kjo situatë. Shumë vende kanë marrë masa për parandalimin e efekteve negative në ekonominë e tyre ose për minimizimin e këtyre efekteve. Vihet re se disa shtete kanë ndërhyrë në kohën e duhur dhe me masat e duhura ndërsa disa shtete të tjera janë vonuar në vendimarrje. Kjo ka sjell që në këto shtete efektet e krizës të ndihen më tepër. Shqipëria është një vend i cili nuk u prek drejtpërsëdrejti nga kriza financiare globale pasi Shqipëria nuk është një vend i mirë integruar në tregjet financiare globale. Kjo anë negative e financave shqiptare beri që efektet e krizës në Shqipëri të vinin në mënyrë indirekte dhe në një mënyrë më të butë krahasuar me vendet e zhvilluara. Ulja e remitançave, ulja e shpenzimeve të konsumatorëve shqiptar (më tepër si rezultat i panikut), problemet e tregut të ndërtimit, shtrenjtimi i karburantit si dhe zhvlersimi i Lekut kundrejt valutave të huaja, por edhe probleme të tjera, ishin disa nga ndikimet e para të krizës në ekonominë shqiptare. Me fillimin e krizës në fund vitin 2007 dhe fillim vitin 2008 edhe në Shqipëri ekonomistët filluan të jepnin mendimet e tyre rreth çështjes së krizës. Shumë e shumë zgjidhje u morrën të gatshme nga vendet e zhvilluara dhe duhej vetëm implementimi i tyre. Disa zgjidhje të tjera duheshin të përshtateshin me realitetin shqiptar. Kështu që prej vitit 2008 e deri më sot ekonomia shqiptare i është nënështruar masave antikrizë. Një nga fushat në të cilën ekonomistët treguan një kujdes të veçant ishte sistemi bankar. Ballafaqimi i sistemit bankar shqiptar me efektet e krizës si dhe prirja e këtij tregu është objekt trajtimi në këtë punim.

Gjatë zhvillimit të këtij punimi do të mundohem ti jap përgjigje pyetjeve të tilla si: A janë implementuar sakt masa anti krizë në Shqipëri apo jo? A mund të aplikohen praktika të tjera për ti bërë efektet e krizës më pak të ndjeshme? Cilat janë mundësit e zhvillimit të ekonomisë shqiptare dhe konkretisht të sitemit bankar shqiptar?

Situata aktuale e sistemit bankar shqiptar

Tashmë, disa vite pas fillimit të krizës financiare edhe sistemi financiar në Shqipëri ka filluar të ndjei pasojat duke bërë që aktiviteti bankar shqiptar të ngadalësoj ritmin e zhvillimit të tij. Kriza e ndjerë tashmë edhe nga bizneset dhe individët ka bërë që sistemi bankar në Shqipëri të shfaq probleme të ndryshme. Rritja e kredive të këqija, ulja e ritmeve të kredidhënies apo edhe mungesa e likuiditetit janë disa nga problemet kryesore me të cilat po ndeshet sistemi bankar shqiptar. Për të patur një pamje sa më të plotë dhe për ta patur një mundësi krahasimi po bëj një paraqitje të shkurtër të situatës ekonomike botërore. Dihet që ekonomika globale po kalon një periudhë tepër të vështirë. Këtë tregojnë edhe shifrat e statistikave. Në një situatë të përgjithshme jo të favorshme për zhvillim ekonomik edhe realiteti ekonomik shqiptar nuk mund të bëjë diferencë. Mëposhtë po paraqes disa të dhëna të cilat tregojnë se ka shenja pozitive për një ecuri të mirë në të ardhmen.

Të dhëna të marra nga Banka Botërore por edhe nga Banka e Shqipërisë tregojnë se ekonomia botërore përgjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2011 ka patur një rritje ekonomike me ritme më të vogla krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë. Rritja ekonomike e vendeve të zhvilluara përgjatë gjashtëmujorit të parë të 2011 ka qënë afërsisht 1.5% ndërsa rritja ekonomike e vendeve në zhvillim ka qënë afro 6.8%. (*Banka e Shqipërisë, Raporti i stabilitetit financiar për gjashtëmujorin e parë të 2011*). Në vendet në zhvillim bënë pjesë edhe Shqipëria, por megjithëse rritja ekonomike ka qënë e krahasueshme me ato të vendeve në zhvillim mund të themi se ka akoma mundësi dhe potenciale ekonomike për zhvillim dhe rritje të mëtejshme. Një fenomen tjetër i gjashtëmujorit të parë të 2011 është edhe inflacioni. Ritmet rritëse të inflacionit vijnë si rezultat i rritjes së çmimit të lëndëve të para, ndoshta edhe si pasojë e gjeopolitikës. Në vendet në zhvillim, ashtu si është edhe Shqipëria, norma e inflacionit ka qënë më e lartë se e vendeve të zhvilluara. Kjo ndodhë pasi vendet në zhvillim kanë patur edhe rritje ekonomike më të lartë se vendet e zhvilluara. Nga ana tjetër mund të themi se edhe tregjet financiare globale nuk kanë treguar stabilitet. Ato kanë qënë tepër të luhatshme si pasojë e problemeve të shfaqura nga ekonomitë e vendeve të eurozonës në lidhje me borxhin publik. Gjithashtu negativisht në tregjet financiare ka ndikuar edhe ngadalësimi i zhvillimit të ekonomisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës.

Në Shqipëri sistemi bankar është ndërmjetësuesi kryesor financiar. Në totalin e vet vëllimi i aktiviteteve të ndërmjetësve financiar shqiptar në gjashtëmujorin e parë të 2011 pësoi një rritje prej rreth 5% krahasuar me fundvitin 2010. (*Banka e Shqipërisë, Raporti i stabilitetit financiar për gjashtëmujorin e parë të 2011*). Sistemi bankar shqiptar përfaqëson rreth 94.5% të totalit të aktivitetit të ndërmjetësve financiar që operojnë në Shqipëri duke përfaqësuar kështu afro 82.2% të GDP. (*Banka e Shqipërisë, Raporti i stabilitetit financiar për gjashtëmujorin e parë të 2011*). Totali i aktiveve në sistemin bankar shqiptar në 6-mujorin e parë të 2011 kapi një

shifër prej 1,043.9 miliardë Lekë. E thënë ndryshe kjo përfaqëson një rritje prej 5.4% më tepër se fundi i 2010. Sipas të dhënave të Bankës së Shqipërisë totali i kredive kapi vlerën 518.7 miliardë Lekë që nënkupton një rritje prej 6.6% krahasuar me fundvitin 2010. Ndërsa nga ana tjetër depozitat në totalin e tyre arritën një vlerë prej 842.5 miliardë Lekë duke përfaqësuar një rritje prej 4.6% në krahasim me fundin e vitit 2010. Por ajo që duhet theksuar është se pjesa më e madhe e fitimit të sistemin bankar por edhe të aktivitetit kreditues i përket bankave më të mëdha në vend si Banka Kombëtare Tregtare, Raiffeisen Bank, Tirana Bank apo dhe Kredins Bank. Ndërsa në lidhje me rrezikun e likuiditetit mund të themi se nuk ka ndonjë përmirësim. Të dhënat statistikore tregojnë se jemi pothuajse në të njëjtën situatë si në fund të vitit 2010.

Në tabelën 1. paraqitet pesha e sistemit bankar kundrejt Prodhimit të Breshëm Bruto që prej vitit 2006 e deri në gjashtëmujorin e parë të vitit 2011.

Tabela 1: Pesha e sistemit bankar ndaj PBB ndër vite.

	Vitet					
	2006	2007	2008	2009	2010	2011 / Q2
Sistemi Bankar	69.6	75.9	76.7	77.5	80.9	82.2

Burimi: *Banka e Shqipërisë, Raporti i stabilitetit financiar për gjashtëmujorin e parë të 2011.*

Pra vihet re qartë se pavarësisht faktit se kriza ekonomike globale ka prekur edhe sistemin financiar shqiptar, sistemi bankar shqiptar ka patur rritje të aktivitetit të tij, megjithëse këto kanë qënë ritme rënëse gjatë viteve të fundit.

Kriza financiare dhe ndikimet e saj në sistemin bankar shqiptar

Sot në jetën e përditshme të njerëzve, qofshin këta ekonomist ose jo, fjala “krizë” ka marrë një kuptim të caktuar prej së cilës derivon çdo fenomen negativ në ekonominë botërore por edhe në atë shqiptare. Ndikimet negative të krizës në ekonominë shqiptare kanë qënë dhe vazhdojnë të jenë të dimensioneve të ndryshme. Kjo krizë, e cila nisi si një krizë financiare e sot shfaqet si ekonomike, nuk kurseu asnjë vend qofshin këto vende të zhvilluara apo vende në zhvillim. Në këtë seksion të këtij punimi po paraqes se ç’farë impakti pati kriza në sistemin bankar shqiptar. Fillimisht po tregoj se si lindi ajo dhe afektoi pothuajse gjithë financat botërore. Gjithashtu sesi ishte sjellja e sistemit bankar shqiptar gjatë ballafaqimit me efektet e krizës.

Si edhe përmendëm më sipër kjo ishte një krizë që shenjat e para të saj i dha në fund vitin 2007 dhe fillim vitin 2008. Përgjatë kësaj periudhe bursat botërore si dhe tregjet financiare filluan të pësonin ulje të vlerave të tyre duke aritur në nivele minimale. Kjo bëri që humbjet e pësuar nga shumë kompani dhe institucione

financiare të arrinin nivele stratosferike brenda një periudhe tepër të shkurtër kohore. Ato vlersohen të kenë qënë rreth 50.000 miliard \$¹. Bazuar në studimet e deri më tanishme por edhe nga të dhënat statistikore mund të themi se arsyeja kryesore e fillimit të kësaj krize ishin problemet me kreditë hipotekore në SHBA. Pra rritja e nivelit të kredive të këqija bëri që më pas të kishte mungesë likuiditeti në sistemin bankar duke u përhapur si një efekt domino në tregjet fianciare kudo në botë, gjithashtu duke ulur dukshëm besimin në këto institucione financiare. Kjo krizë e cila nisi si finaciare e lokalizuar në SHBA e më pas u shndërrua në globale pati efektet e saj në ekonomi, duke dëmtuar edhe sistemin bankar të shumë shteteve. Ndër pasojat më kryesore të kësaj krize në ekonominë botërore (por edhe të shteteve në veçanti) mund të përmendim zhvlerësimin e monedhave valutore të shteteve respektive (sidomos Dollari e me pas Euro)². Kjo bëri që të rritet defiçiti buxhetor si edhe të rritet papunësia.

Problematike ishte rritja e nivelit të çmimeve për lëndët e para të shumë produkteve që solli më pas një efekt zinxhir në rritjen e përgjithshme të nivelit të çmimeve. Pra mund të themi se flukset dalëse të parasë ishin shumë herë më të mëdha se flukset hyrëse të parasë dhe kjo do të thotë se konsumatori nuk ka mundësi të kryej shpenzime për konsum e jo më për të investuar. Për më tepër mund të theksojmë se sipas të dhënave të Fondit Monetar Ndërkombëtar vendet e Europës Juglindore kanë pësuar një rënie të theksuar të GDP-së. Këtu përfshihet edhe Shqipëria.

Ndër të tjera efekte të krizës ne mund të përmendim edhe zvogëlimin e volumit të tregtisë ndërkombëtare, uljen me ritme të larta të investimeve të huaja direkte (IHD), uljen e nivelit të kreditimit nga bankat e nivelit të dytë³ si edhe uljen e remitançave nga emigrantët shqiptar të cilët ndodhen në vende që janë prekur më rëndë nga kriza ekonomike. Këto efekte ndikuan në mënyrë të dukshme në aktivitetin bankar shqiptar duke ulur likuiditetin e tyre, më pas rrjedhimisht edhe kreditimin. Kjo solli mungesë investimesh në Shqipëri duke krijuar në këtë mënyrë një ngërç ekonomik.

Një element tjetër i krizës bankare të cilit duket se nuk i shpëtoj dot sistemi bankar por edhe financat në tërësi ishte “PANIKU”. Frika e njerëzve se ç’farë do të ndodhte në të ardhmen ishte e madhe. Konsumatorët ishin të pa sigurt se ç’farë pritet të ndodhte në kohët që do të pasonin. Kështu që shtynë shpenzimet e tyre duke bërë kështu që prodhuesit të mos furnizoheshin me likuiditet (para cash) duke e futur ekonominë në recesion. Kur bëhet fjalë për kursimet e tyre konsumatorët janë shumë të ndjeshëm. Kjo situatë paniku bëri që dhe në tregun shqiptar të kishte tërheqje depozitash nga bankat respektive por relativisht të kontrolluara nga sistemi bankar. Kështu që mund të themi se të gjitha problemet

¹ Civici A (2010). “Kriza fianciare apo globale” fq 20.

² Në Shqipëri pati zhvlerësim të Lekut.

³ Ky fenomen ndodhi edhe në Shqipëri. Raportet vjetore 2009 – 2010 të Bankës Qëndrore si edhe të bankave të nivelit të dytë e tregojnë këtë fenomen.

e lartë përmendura ndikuan negativisht në sistemin bankar shqiptar duke rritur dyshimin në këtë sistemi. Aq me tepër kur dihet se shumica e bankave në Shqipëri janë me kapital të huaj, pikërisht kapital që vjen nga vendet e prekura më rënd nga kriza si Greqia apo dhe Italia.

Mëposhtë po paraqes në mënyrë tabelare disa nga efektet negative të krizës në sistemin bankar shqiptar.

Tabela 2. Mbulimi me shërbime bankare

	2004	2005	2006	2007	2008	2009	2010
Nr. i bankave	16	17	17	16	16	16	16
Nr. i punonjësve						6,404	6384

Burimi: Banka e Shqipërisë, Raporti vjetori i mbikqyrjes 2010.

Shihet qartë se prej vitit 2008 numuri i punonjësve në sistemin bankar ka filluar të reduktohet dhe kjo si rezultat i shkurtimit të shpenzimeve nga ana e bankave.

Tabela 3. Pesha e totalit të aktiveve dhe portofolit të kredive të sistemit bankar ndaj Produktit të Brendshëm Bruto.

	2002	2003	2004	2005	2006	2007	2008	2009	2010
Totali i aktiveve (në mld Lekë)	339.3	373.6	426.4	496.6	624.3	742.9	834.1	886.3	990.6
Totali i aktiveve/PBB (në %)	54.5	53.8	56.8	60.9	70.8	76.8	76.7	77.5	81.0
Totali i kredive/PBB (në %)	6.3	7.3	9.3	15.7	22.4	30.2	36.5	39.3	40.1

Burimi: Banka e Shqipërisë, Raporti vjetori i mbikqyrjes 2010.

Edhe nëpërmjet kësaj tablele vëmë re se pas vitit 2008 ritmet e kredidhënies janë ulur ndjeshëm, gjithashtu edhe vlera e totalit aktiveve ka pësuar një ulje të ritmit të saj rritës.

Tabela 4. Klasifikimi i kredisë në përqindje ndaj tepricës së kredisë.

Klasifikimi i kredisë	2008				2009				2010			
	T I	T II	T III	T IV	T I	T II	T III	T IV	T I	T II	T III	T IV
Standarde	89.8	91.0	90.0	87.3	86.0	85.7	82.5	83.2	80.8	81.2	78.7	79.0
Në ndjekje	6.3	4.7	5.8	6.0	6.5	5.6	7.8	6.4	7.6	6.6	7.5	7.0
Nënstandarde	2.1	2.4	1.9	4.0	4.0	4.1	4.7	4.7	5.4	5.4	5.9	6.2
Të dyshimta	0.8	1.0	1.3	1.4	1.8	2.4	2.3	2.7	3.0	3.2	3.9	3.7
Të humbura	1.0	0.9	1.0	1.3	1.7	2.2	2.8	3.0	3.3	3.7	4.0	4.1

Burimi: Banka e Shqipërisë, Raporti vjetori i mbikëqyrjes 2010.

Pra është evidente se problemet ekonomike të derivuara nga efektet e krizës kanë sjell që numuri i kredive me probleme si dhe ato të humbura të rritet që pas fillimit të krizës financiare.

Mungesa e likuiditetit është një nga efektet më negative të krizës. Sistemi bankar shqiptar u përball me këtë fenomen në fund të vitit 2008 ku si rezultat i panikut publiku filloi të mos vendos më depozita bankare por edhe të tërhiqte një pjesë të tyre. Në tabelën e më poshtëme bëhet një paraqitje sesi ka qënë ecuria e depozitave prej vitit 2004 e deri në 6-mujorin e parë të 2011.

Tabela 5. Rritja vjetore e totalit të depozitave për sektorin bankar.

Përiudha	2004	2005	2006	2007	2008	2009	6m I '10	2010	6m I '11
Rritja e totalit të depozitave (në %)	13.4	16.4	20.1	19.9	2.4	7.6	7.04	17.7	4.9

Burimi: Banka e Shqipërisë, Raporti i stabilitetit financiar për 6 mujorin e parë.

Duket se në vitin 2008 pati një rënie drastike të depozitave. Në vitet që vijuan u vu re një rritje e lehtë e depozitave por përsëri në nivele më të ulta se ato të para krizës. Mungesa e likuiditetit paraqet mjaft rrezik për sistemin bankar por edhe për ekonominë në tërësi. Kjo bënë që të ulët niveli i përgjithshëm i kreditimit. Kjo sjell mungesë investimesh dhe si pasojë do të kemi një ulje të nivelit të përgjithshëm të zhvillimit ekonomik të vendit, pra mund të çoj ekonominë në recesion. Këto efekte që përmendëm më sipër janë ato më kryesoret që prekën sistemin bankar shqiptar sepse pothuaj çdo tregues financiar (tregues i performancës pozitive) se sitemit bankar pësoi ulje të ndjeshme.⁴

Në përgjithësi kemi tre tipe bazë të krizave financiare ku mund të përmendim: *Krizën e monedhës ose kursit të këmbimit*, *Krizën bankare* si edhe *Krizën e borxhit të jashtëm*.⁵ Në këtë punim ne jemi fokusuar te kriza financiare për të cilën ka disa përkufizime ku mund të përmendim: “*Kriza financiare është situata në të cilën kërkesa për para rritet në mënyrë të shpejtë*”⁶apo edhe shprehjen “*Kriza financiare i referohet situatës në të cilën institucionet financiare ose asetet financiare humbasin vlerën e tyre duke çuar në rënie të institucioneve financiare dhe jo financiare*”⁷

Nga trajtimi i deri tanishëm mund të dalim në përfundimin se me krizë bankare do të kuptojmë kur një sistem bankash ndodhen në mungesë likuiditeti si dhe kanë një shkallë të lartë të kredive të këqija. Kjo mund të çoj bankën drejt falimentimit.

⁴ Të vetmit tregues që paraqesnin vlera në ritje ishin treguesit negativë tëperformacës bankare. Këtu mund tëpërmendim kreditë me probleme.

⁵ Dervishi D (2011). “Monografi - Krizat financiare dhe modeli stress indeks”, fq 8.

⁶ “Modern Banking Financial Crises”, fq 18.

⁷ Mishkin. “Money, banking and financial institutions”, chapter 8 – “Financial crises and aggregate economic activity”, fq 203 – 205.

Një bankë në situatë krize kërkon me doemos asistencën e shtetit. Në përgjithësi krizat bankare kalojnë në dy etapa. Në etapën e parë në të cilën bankat krijojnë një numër të madh kredish të këqija por mundohet që këto kredi të mos i raportojnë për arsye besimi ndaj tyre si edhe në etapën e dytë e cila ka të bëjë me publikimin e këtyre problemeve dhe kërkojnë zgjidhje imediate për to. Kriza të tilla sikurse kjo e fundit kanë ekzistuar edhe më parë por problemet e derivuara në ekonomi ndoshta kanë qënë të ndryshme. Gjatë viteve 1980 – 1995 vendet e zhvilluara janë përballur me rreth 65 kriza me një kosto të vlersuar 250 bilion \$.⁸ Gjithashtu mund të përmendim krizën e monedhës në Europë gjatë vitit 1990, në vitin 1994 – 1995 kriza në Amerikën Latine apo dhe në Azinë Lindore përgjatë viteve 1997 – 1998. Por gjithashtu njihen edhe kriza në periudha më të hershme si ajo e Frangës fraceze dhe Sterlinës në vitin 1960, kriza e famshme e Bretton Woods-it në 1970, etj. Si përfundim do të thoshim se krizat financiare (bankare) deri më sot kanë qënë të pashmangshme dhe ekonomitë e vendeve të ndryshme janë përballuar me këto fenomene negative. Duhet me domosdoshmëri të mësojmë nga këto kriza për ti përballuar me sa më pak pasojë negative por edhe për ti eliminuar ato.

Për përballimin e krizave është tepër e rëndësishme mënyra e sjelljes së secili prej nesh dhe aq me tepër sistemi bankar. “Pjesa më e madhe e dështimeve të bizneseve nuk vijnë si rrjedhojë e kohëve të vështira. Ato vijnë si pasojë e manaxhimit të gabuar dhe kohët e vështira vetëm sa e përkeqësojnë situatën.” (Th. Murphy 1956).

Për më tepër në rastin shqiptar ndikimi i krizës në sistemin bankar ka qënë dhe është evident por mësimet e nxjerra prej saj na ndihmojnë për të përballuar kriza të tjera në të ardhmen.

Kapitali human dhe roli i tij gjatë krizës ekonomike në sistemin bankar

Historia ka treguar se krizat mund të çojnë në falimentimin jo vetëm të një sistemi bankar (financiar) por edhe të shteteve. Këtu mund të përmendim faktin se prej vitit 1750 e më pas kanë falimentuar rreth 60 shtete⁹ ku mund të përmendim rastin e Austrisë (1811), Danimarkës (1813), Rusisë (1918¹⁰ dhe 1998) si edhe shtete të tjera. Kjo do të thotë se manaxhimi i krizave është më se i rëndësishëm. Nëse krizat do të manaxhohen mirë kjo do të thotë se efektet negative në sistemin bankar do të jenë minimale por nëse kemi një keq manaxhim atëherë ndikimi i saj në sistemin bankar por edhe në ekonomi do të jetë tepër negativ. Kjo i jep një rëndësi të veçantë manaxhimit të krizës por edhe manaxhimit të sistemit bankar për të parandaluar krizat financiare që derivojnë prej tij. Për të patur një manaxhim të mirë duhet

⁸ Honohan 1997.

⁹ Dervishi D (2011). “Monografi - Krizat financiare dhe modeli stress indeks”, fq 6.

¹⁰ Falimentimi erdhi si pasojë e mos pranimit për të paguar borxhin e Rusisë sëperiudhës së Carit.

edhe një kapital human në nivele të larta. Pra duhet një staf i përgatitur, i shkolluar dhe i mirëtrajnuar, me etikë profesionale dhe me parimin bazë për mbrojtjen e klientit bankar. Duhet që stafi të këtë princip pune plotësimin në mënyrë rigorozë të politikave dhe procedurave të brendshme të bankës si dhe të mbikqyrësve të këtij sistemi. Duhet të plotësoj në mënyrën më të mirë të mundshme rekomanimet që japin sistemet e kontrollit si auditi i brendshëm apo dhe ai i jashtëm. Koha ka treguar se nëse një institucion finaciar ka një staf profesional ka edhe një performacë më të mirë.

Kapitali human ishte ai që solli krizën e fundit, pasojat e së cilës akoma janë prezente në ekonomi. Njerëz të caktuar, përgjithësisht drejtuesit e bankave apo dhe të institucioneve të tjera financiare ishin të prirur për të rritur fitimet e tyre personale duke shkelur rregulloret dhe duke abuzuar me funksionet e tyre financiare. Fitimet e këtyre drejtuesve në SHBA por edhe në shtete të tjera të zhvilluara kapnin shifra mbi 500.000\$ në vit. ("Kapitalizmi, një histori dashurie" – 2010). Papërgjegjshmëria e tyre krijoi një kolaps të vërtetë në sistemin bankar botëror. Por ndryshe nga bankat e vendeve të zhvilluara, kapitali human i sistemit bankar shqiptar ka një tjetër problematikë. Në stafet bankare në Shqipëri ka një numër të konsideruar personash pa shkollimin e duhur, jo adekuat për atë pozicion pune. Shumë banka në Shqipëri për të ulur kostot fikse (FC) si pagat¹¹, mundohen që të punësojnë në pozicione jo strategjike¹² persona jo të kualifikuar në mënyrë që ti paguajnë më pak. Pra udhëhiqen nga parimi i maksimizimit të fitimit duke abuzuar në këtë drejtim.

Duhet që domosdoshmerisht rekrutimi i stafit në sistemin bankar të kryhet në mënyrën më të mirë të mundshme bazuar në një sistem meritash dhe vlerash. Pra kush bëhet pjesë e sistemit bankar (financiar) duhet të këtë kualifikimin e duhur për funksionin që duhet të kryej. Për më tepër bankat duhet të rrisin aktivitetin e tyre trajnues mbi stafin, sidomos për stafin e ri por edhe për atë ekzistues, duke i përditësuar informacionin dhe teknika të reja bankare. Nga ana tjetër duhet që sistemet e kontrolleve të ushtrojnë veprimtarinë e tyre edhe mbi aftësitë e stafeve bankare si dhe mënyrën e rekrutimit të tyre. Kjo do të minimizoj (parandaloj) që një individ i pa aftë të mos bëhet pjesë e sistemit bankar. Gjithashtu është e domosdoshme që të kryhen kontrole më të shpeshta përsa i përket kapitalit human në mënyrë që të rritet presioni te drejtuesit e bankave për të mos abuzuar me pushtetin. Pra, një kapital human i përgatitur, profesional, me etikë si dhe kontrollet e vazhdueshme mbi kapitalin human do të reduktojë ndjeshëm mundësin e ndodhjes së krizave financiare. Për më tepër një kapital human në nivele të larta është potencial për zhvillim dhe zgjidhje të situatave negative në rast krizash financiare. Kriza ekonomike pati efektin e vet në kapitalin human në sistemin bankar botëror

¹¹ Nga teoria mikroekonomike dihet se pagat përbëjnë rreth 70% të kostove fikse.

¹² Pozicione ku puna që kryhet është monotone. Në këtë mënyrë individ i punësuar mund ta kryej atë edhe pa kualifikimin e duhur, thjesht duke u bazuar në ndonjë trajnim sipërfaqësor.

por edhe atë shqiptar. Shumë punonjës humbën vendet e tyre të punës si pasojë e kësaj krize. Në vendet e zhvilluar, ashtu si e përmendëm edhe me lart, falimentimi i bankave por edhe bashkimi i tyre me njëra tjetrën nxori në rrugë qindra punonjës. Ky fenomen u vu re edhe në Shqipëri ku disa banka reduktuan numurin e punonjësve¹³.

Si përfundim mund të theksojmë se kapitali human ka një rëndësi të veçantë në sistemin bankar. Nga sjellja e tij profesionale ose jo (abuzime) mund të shkaktohen kriza financiare. Një staf bankar i përgatitur dhe profesional jep garanci jo vetëm për një zhvillim të qëndrueshëm të bankës por edhe për përballimin me sukses të krizave financiare.

Masat për të parandaluar efektet e krizës në sistemin bankar shqiptar

Tashmë që ekonomia jonë është prekur nga efektet e krizës nuk na ngelet gjë tjetër veçse të mundohemi që nëpërmjet masave të marra të minimizojmë efektet e saj. Shtetet kudo nëpër botë po mundohen që nëpërmjet masave anti krizë të kalojnë këtë moment të vështirë në ekonomitë tyre. Masat anti krizë të cilat po përdoren kanë efekte të ndryshme në vende të ndryshme. Kjo varet edhe nga fakti se me çfarë lloji vendi kemi të bëjmë. Nëse flasim për një ekonomi të një vendi të zhvilluar si SHBA, Itali, Francë ose Gjermani apo flasim për ekonominë e një vendi në zhvillim si është rasti i Shqipërisë. Megjithatë në themel të tyre këto masa janë pothuaj të njëjta. Por kjo nuk do të thotë se ato nuk duhen përshtatur me ekonomitë respektive. Në këtë mënyrë një rëndësi të veçantë merr implementimi i tyre që do të thotë se si ato zbatohen dhe përshtaten me realitetet e secilit shtet. Shqipëria për nga vetë karakteristikat¹⁴ që ka e bënë më të vështirë implementimin e këtyre masave. Një nga masat e para që u ndërmorrën nga bankat qendrore të vendeve të zhvilluara ishte hedhja në qarkullim e sasive të mëdha likuiditeti të cilat do të ndihmonin tregjet financiare (bankare) shoqëruar kjo edhe me politika monetare në favor të institucioneve financiare.¹⁵ Në rastin shqiptar Banka Qendrore morri një sërë masash për të minimizuar ose parandaluar efektet e krizës ku rriti kontrollin mbi bankat e nivelit të dytë si dhe ushtroi presion për të rritur transparencën bankare. Nga ana tjetër u mundua të injektonte në publik një frymë besimi për sistemin bankar shqiptar. Për më tepër Banka Qendrore e Shqipërisë ka inkurajuar disa herë bankat e nivelit të dytë për të rritur nivelin e kreditimit. Nga ana tjetër sygjerohet se duhet të tregohet kujdes për mënyrën e kredidhënies.

Nëse ekonomia në tëresinë e saj ka prire pozitive atëherë kjo sjell edhe një rritje

¹³ Shiko "Tablen 2" në këtë punim.

¹⁴ Jo rrallë herë ekonomia shqiptare nuk i është përgjigjur rregullave të tregut. Këtu rol të rëndësishëm luan edhe fakti se në shumë tregje ka abuzime. Autoriteti i konkurrencës duhet që të jetë më aktiv sidomos në situata të tilla.

¹⁵ Civici A (2010). "Krizat financiare apo globale" fq 22.

të qëndrueshme në sistemin bankar. Kështu që masat të cilat merren për ekonominë në përgjithësi ndikojnë drejtpërsëdrejti në sistemin bankar.

Ndër masat kryesore për parandalim të krizës në ekonomi mund të përmendim:

Nxitjen e politikave publike nga ana e shtetit me qëllim për të hapur vende të reja punësimi duke bërë kështu që të rritet sasia e parasë në qarkullim; Përmirësimi i infrastrukturës sidomos në zonat turistike me qëllim tërheqjen e sa më shumë turistëve; Hartimin e politikave social – ekonomike për të rikthyer në Shqipëri emigrantët me qëllim që ata të mund të investojnë kursimet e tyre, sidomos në sektorin buqësor dhe atë përpunues; Është e udhës që të hartohen politika sa më efektive. Duhet që të rishikohet modeli ekonomik por duke u bazuar në atë që ekonomistët e quajnë “avantazhet konkurruese”. Pra duhet që tregu shqiptar të di cilat janë avantazhet konkurruese të tij që të pozicionohet në mënyrën më të mirë të mundshme. Kjo bënë që të kemi një rritje të eksporteve të cilat lënë për të dëshiruar.

Ndërsa përsa i përket sistemit bankar mund të themi se duhet ti kushtohet më tepër vëmendje kontrollit të tij. Kjo duhet të kryhet me anë të auditit të brendshëm, të jashtëm si edhe mbikëqyrjes nga Banka Qëndrore. Në këtë mënyrë do të rritet më tepër transparenca dhe besimi i publikut në këto institucione. Sistemi bankar duhet që të rrisë nivelin e kreditimit por duke analizuar më parë në mënyrë rigoroze të gjitha aplikimet. Sot në treg ekzistojnë shumë abuzues të cilët kërkojnë të marrin kredi duke lënë kolateral mjedise që duan ti shesin. Pas marrjes së kredisë këta persona nuk kryejnë asnjë pagesë të kësteve. Kjo është një kosto për bankën e cila humbet likuiditet. Për këtë arsye bankat duhet të tranojnë gjithmon e më tepër analistët e kredive.

Tërësia e këtyre masave bëjnë që sistemi bankar të jetë me i mbrojtur si dhe të rifilloj një aktivitet normal duke siguruar në këtë mënyrë një rritje dhe zhvillim të tij.

Në Shqipëri përgjithësisht masat anti krizë janë implementuar në mënyrën e duhur por duhet të tregohet kujdes për raste të veçanta. Shqipëria ka kapacitete të mjaftueshme për të përballuar sa më mirë efektet e “post krizës”. Nëse kjo shoqërohet me politika të duhura dhe me masat e nevojshme, sistemi bankar shqiptar ashtu si edhe ekonomia shqiptare ka potenciale zhvillimi.

Konkluzione dhe rekomandime

Si përfundim mund të themi se në Shqipëri efektet e krizës u ndjen por nuk patën atë ndikim si në vendet e zhvilluara. Kjo për faktin se Shqipëria nuk ishte dhe vazhdon të mos jetë e integruar në tregjet financiare globale. Ndër pasojat e krizës në Shqipëri mund të përmendim uljen e ritmeve rritëse të ekonomisë, rritjen e papunësisë, zhvlerësimin e monedhës tonë (ALL) kundrejt valutave të huaja¹⁶, uljen e prodhimit dhe rrejdhisht atë të eksporteve, rënien e aktivitetit tregtar në

¹⁶ Njëzhvlerësim të ndjeshëm pati në raport me EURO dhe USD.

përgjithësi, ulja e remitancave, etj. Këto ndikuan direkt në performacën e sistemit bankar shqiptar duke bërë që të rritet numuri i kredive me probleme, të zvogëlohen ritmet e rritjes së depozitave duke bërë që të këtë munges likuiditeti në treg e si pasoj të ulët ndjeshëm niveli i kreditimit. Ulja e nivelit të kreditimit do të sjell në ekonomi mungesë investimesh, rritje papunësie dhe shumë efekte të tjera negative në ekonominë tonë. Fatmirësisht u ndërmorën disa masa të cilat mbajtën nën kontroll sistemin bankar shqiptar por nga ana tjetër duhet që vazhdimisht të tregohet kujdes për tregjet ndërbankare si dhe për ekonominë në tërësi në këtë periudhë “post krize”. Kujdes i veçant duhet ti kushtohet kapitalit human. Rekrutimet për pozicionet vakante në sistemin bankar duhen bërë bazuar në aftësinë e punëmarrësit dhe jo mbi faktor subjektiv. Kjo do të thotë se ata persona të cilët bëhen pjesë e sistemit bankar duhet të kenë kualifikimin dhe eksperiencën e duhur. Nga ana tjetër bankat duhet të rrisin nivelin e trajnimeve për stafet e tyre. Sistemet e kontrolleve të sistemit bankar duhet që në vazhdimësi të kryejnë jo vetëm kontrolle periodike por edhe ato që quhen “surprise controls”¹⁷. Pra në këtë moment auditi i brendshëm, i jashtëm si edhe mbikëqyrja e Bankës Qëndrore duhet të jenë tepër të vëmendshëm.

Së fundmi duhet të theksoj se pavarësisht efekteve të krizës në sistemin bankar shqiptar dhe masave që janë marrë ose jo, Shqipëria ka mundësi dhe potencial zhvillimi në këtë sektor. Mjafton një mirë manaxhim i të gjithë aseteve si dhe një mirë funksionim ndër institucional në mënyrë që performanca e sistemit bankar të jetë gjithmonë në rritje.

Bibliografia

- Banka e Shqipërisë (2011). Raporti i stabilitetit financiar për gjashtëmujorin e parë.
 Banka e Shqipërisë (2011). Raporti i politikës monetare për tremujorin e tretë.
 Dervishi D (2011). “Monografi - Krizat financiare dhe modeli stress indeks”.
 Banka e Shqipërisë, Raporti vjetori i mbikëqyrjes 2008,2009,2010.
 Civici A (2010). “Kriza financiare apo globale”.
 World economic situation and prospects 2011, global outlook, United Nations, New York 2010.
 Banka e Shqipërisë, “Politika të stabilitetit monetar dhe financiar – Leksione nga kriza”, Konferenca e 8-të ndërkombëtare e Bankës së Shqipërisë 17 nëntor 2009.
 Mishkin. “Money, banking and financial institutions” - “Financial crises and aggregate economic activity”.
 Bae, K.H., Karyoli, G.A., Stulz, R.M. (2003), “A New Approach to Measuring Financial Contagion”, Review of Financial Studies, 16(3), 717- 764.
 Luce Dragi Spajic: “Financial Intermediation in Europe”, 2002.

¹⁷ Kontroll jashtë planifikimit.

Përdorimi optimal i të dhënave të vrojtuar: Mbi shpërndarjen e statistikës

$D^+(n_1, n_2)$

____ Prof.Asoc.Dr. Hysen BINJAKU _____

____ Teuta XHINDI, MA _____

Abstrakt. Në mjaft probleme praktike, në studime të fenomeneve të fushave dhe disiplinave shkencore dhe teorike, në veçanti ato Ekonomike, lind nevoja e përdorimit optimal të të dhënave të vrojtuar. Që këto të dhëna të mund të japin informacion të saktë për gjithë popullimin është i domosdoshme ndërtimi dhe studimi i statistikave të tilla, me anën e të cilave kontrollohet vërtetësia e informacionit të mbledhur dhe të përpunuar. Jo rrallë përpjekje të tilla konvergjojnë në studimin e Homogjenitetit të të Dhënave.

Studimi i homogjenitetit të zgjedhjeve realizohet me anë të kontrollit të hipotezave joparametrike duke ndërtuar teste të caktuara për rastin e një ose disa zgjedhjeve. Shumë autorë janë përpjekur të ndërtojnë teste të përshtatshme për kontrollin e hipotezës jo parametrike. Studimet teorike të tyre përfshijnë edhe probleme asimptotike që lidhen me këto statistika dhe që lejojnë përdorimin e formulave të përafërta për vëllime jo të vogla zgjedhjesh. Në këtë material analizohen përfundime të arritura nga dy autorë të ndryshëm për të njëjtën statistikë dhe ka një përpjekje nga ana jonë për të krahasuar këto rezultate.

Fjalë kyçe:

të dhënat e vrojtuar, përdorimi optimal i të dhënave, homogjeniteti i të dhënave

HYRJE

Në përdorimin e të dhënave të vrojtuar ka rëndësi të dihet:

-Çfarë vlere përfaqësuese kanë të dhënat për një popullim, në qoftë se është e pamundur t'i nënshtrohet sondazhit çdo pjesë e popullimit?

-Ç'siguri probabilitare ka që homogjeniteti i grupeve të marrë është i kënaqshëm?

-Informacioni i përftuar nga këto grupe është vërtetë sintetik, në kuptimin që specialistët të gjykojnë më me vërtetësi për problemin që studjojnë?

Të gjitha këto bëjnë të domozdoshëm kontrollin e Hipotezës për Homogjenitetin e Zgjedhjes. Studimi i homogjenitetit të një popullimi lind nevojën e përdorimit të dy zgjedhjeve, të trajtuara ato si zgjedhje nga i njëjti popullim ose si zgjedhje të marra nga popullime që karakterizohen nga shkalla e homogjenitetit. Vlerësimi asimptotik apo i përafërt i shkallës së devijimit të dy funksioneve empirike, që u korespondojnë këtyre dy zgjedhjeve, mat shkallën e homogjenitetit të popullimit.

Ky studim u realizua për herë të parë nga Smirnov [3], i cili, ndër të tjera, ndërtoi edhe statistikën:

$$D^+(n_1, n_2) = \sup_{-\infty < x < +\infty} \left[F_{n_1}^*(x) - F_{n_2}^*(x) \right]$$

ku: $F_n^*(x) = \frac{K_n(x)}{n}$ është funksioni empirik i shpërndarjes të madhësisë së rastit X i lidhur me zgjedhjen $(x_1, x_2, \dots, x_n)$ të nxjerrë nga bashkësia e vlerave të mundshme të kësaj madhësie të rastit.

Studim i shpërndarjes ekzakte të statistikës $D^+(n_1, n_2)$

Në rastin kur zgjedhjet nuk kanë vëllim të njëjtë është me interes të veçohet ai kur raporti i vëllimeve të zgjedhjeve është numër i plotë.

Koroliouk [6] ka studjuarë shpërndarjen ekzakte të statistikës $D^+(n_1, n_2)$ në rastin kur $n_2 = pn_1$ (p – numër i plotë). Rezultati që ka gjetur është:

$$\varphi_{n_1, n_2}^+(z) = P \left\{ \sqrt{\frac{n_1 n_2}{N}} D^+(n_1, n_2) < z \right\} =$$

$$\begin{cases} 0 & \text{për } z \leq 0 \\ 1 - \frac{1}{C_N^{n_1}} \sum_{k=0}^{\left[n_1 \frac{c}{p} \right]} \frac{c}{k(p+1)+c} {}^*C_{k(p+1)+c}^k {}^*C_{N-k(p+1)-c}^{n_1-k} & \text{për } 0 < z \leq \sqrt{\frac{n_1 n_2}{N}} \\ 1 & \text{për } z > \sqrt{\frac{n_1 n_2}{N}} \end{cases} \quad (K)$$

$$\text{ku: } c = - \left[-z \sqrt{\frac{N n_2}{n_1}} \right], \quad N = n_1 + n_2, \quad n_2 = p n_1 \text{ (} p \text{- numër i plotë)}$$

Me supozimin se hipoteza bazë $H_0 : F_1(x) = F_2(x)$ është e vërtetë, llogaritim

$$P \left\{ \sqrt{\frac{n_1 n_2}{n_1 + n_2}} D^+(n_1, n_2) < z \right\} =$$

$$P \left\{ \sqrt{\frac{n_1 n_2}{N}} \sup_{-\infty < x < +\infty} [F_{n_1}^*(x) - F_{n_2}^*(x)] < z \right\} =$$

$$P \left\{ \sqrt{\frac{n_1 n_2}{N}} \sup_{-\infty < x < +\infty} \left[\frac{K_{n_1}(x)}{n_1} - \frac{K_{n_2}(x)}{n_2} \right] < z \right\} =$$

$$P \left\{ \sqrt{\frac{n_1 n_2}{N}} \cdot \frac{1}{n_2} \sup_{-\infty < x < +\infty} [p \cdot K_{n_1}(x) - K_{n_2}(x)] < z \right\} =$$

$$P \left\{ \sqrt{\frac{n_1}{n_2 N}} \sup_{-\infty < x < +\infty} [p \cdot K_{n_1}(x) - K_{n_2}(x)] < z \right\} =$$

$$P \left\{ \sup_{-\infty < x < +\infty} [p \cdot K_{n_1}(x) - K_{n_2}(x)] < z \sqrt{\frac{n_2 N}{n_1}} \right\}$$

Dallojmë dy raste:

$$1) z \sqrt{\frac{n_2 N}{n_1}} \text{ është numër i plotë, pra } z \sqrt{\frac{n_2 N}{n_1}} = \left[z \sqrt{\frac{n_2 N}{n_1}} \right] = c$$

Në këtë rast do të kemi:

$$P \left\{ \sup_{-\infty < x < +\infty} [p \cdot K_{n_1}(x) - K_{n_2}(x)] < z \sqrt{\frac{n_2 N}{n_1}} \right\} =$$

$$1 - P \left\{ \sup_{-\infty < x < +\infty} [p \cdot K_{n_1}(x) - K_{n_2}(x)] \geq c \right\} =$$

$$P \left\{ \sup_{-\infty < x < +\infty} [p \cdot K_{n_1}(x) - K_{n_2}(x)] < c \right\} =$$

Barazimi i fundit është në bazë të rezultatit të Korolioukut.

$$2) z \sqrt{\frac{n_2 N}{n_1}} \text{ është numër jo i plotë, pra } z \sqrt{\frac{n_2 N}{n_1}} = \left[z \sqrt{\frac{n_2 N}{n_1}} \right] + \alpha, \alpha \text{ numër në } (0;1).$$

Në këtë rast do të kemi:

$$P \left\{ \sup_{-\infty < x < +\infty} [p.K_{n_1}(x) - K_{n_2}(x)] < z \sqrt{\frac{n_2 N}{n_1}} \right\} =$$

$$P \left\{ \sup_{-\infty < x < +\infty} [p.K_{n_1}(x) - K_{n_2}(x)] < \left[z \sqrt{\frac{n_2 N}{n_1}} \right] + \alpha \right\} =$$

$$P \left\{ \sup_{-\infty < x < +\infty} [p.K_{n_1}(x) - K_{n_2}(x)] \leq \left[z \sqrt{\frac{n_2 N}{n_1}} \right] \right\} =$$

$$1 - P \left\{ \sup_{-\infty < x < +\infty} [p.K_{n_1}(x) - K_{n_2}(x)] > \left[z \sqrt{\frac{n_2 N}{n_1}} \right] \right\} =$$

$$1 - P \left\{ \sup_{-\infty < x < +\infty} [p.K_{n_1}(x) - K_{n_2}(x)] \geq \left[z \sqrt{\frac{n_2 N}{n_1}} \right] + 1 \right\} =$$

$$1 - P \left\{ \sup_{-\infty < x < +\infty} [p.K_{n_1}(x) - K_{n_2}(x)] \geq c + 1 \right\} =$$

$$1 - \frac{1}{C_N^{n_1}} \sum_{k=0}^{\left[n_1 \frac{c+1}{p} \right]} \frac{(c+1)}{k(p+1) + (c+1)} * C_{k(p+1)+(c+1)}^k * C_{N-k(p+1)-(c+1)}^{n_1-k}$$

Barazimi i fundit është në bazë të rezultatit të Korolioukut.

Të dy rastet mund t'i shkruajmë me një formulë të vetme:

$$P \left\{ \sqrt{\frac{n_1 n_2}{n_1 + n_2}} D^+(n_1, n_2) < z \right\} =$$

$$1 - \frac{1}{C_N^{n_1}} \sum_{k=0}^{\left[n_1 \frac{c^*}{p} \right]} \frac{(c^* + 1)}{k(p+1) + (c^* + 1)} * C_{k(p+1)+(c^*+1)}^k * C_{N-k(p+1)-(c^*+1)}^{n_1-k}$$

$$\text{ku: } c^* = \begin{cases} \left\lceil z \sqrt{\frac{n_2 N}{n_1}} \right\rceil & \text{në qoftë se } z \sqrt{\frac{n_2 N}{n_1}} \text{ është numër i plotë} \\ \left\lceil z \sqrt{\frac{n_2 N}{n_1}} \right\rceil + 1 & \text{në qoftë se } z \sqrt{\frac{n_2 N}{n_1}} \text{ është numër jo i plotë} \end{cases}$$

Tregohet [10] se mund të bëjmë paraqitje më të thjeshtë për c^* në trajtën:

$$c^* = - \left\lceil -z \sqrt{\frac{n_2 N}{n_1}} \right\rceil$$

Vërejtje: Shpesh, në artikuj apo punime, rezultatet e dhënë nga Koroliouk

përmenden duke shënuar $c = \left\lceil z \sqrt{\frac{N n_2}{n_1}} \right\rceil$. Përdorimi i këtij shënimi, kur

$z \sqrt{\frac{n_2 N}{n_1}}$ nuk është numër i plotë, çon në rezultate që ndryshojnë nga ato

të dhëna nga autorë të tjerë, p.sh. nga ato të dhëna nga Steck [7]. Më posht do të tregojmë një shembull që e konfirmon këtë, por më parë të tregojmë rezultatin e Steck (S) dhe të transformojmë rezultatin e Korolioukut (K) në një trajtë më të përshtatshme për llogaritje.

Rezultati i Steck në rastin kur m_1 dhe m_2 janë çfarëdo, që natyrisht zbatohet edhe në rastin $n_2 = p n_1$ (p - numër i plotë), është:

$$d_{ij} = \begin{cases} 0 & \text{në qoftë se } i - j > 1 \\ C_{n_2 - b_j + j}^{j-i+1} & \text{në rastet e tjera} \end{cases} \quad (\text{S})$$

$$\text{ku: } d_{ij} = \begin{cases} 0 & \text{në qoftë se } i - j > 1 \\ C_{n_2 - b_j + j}^{j-i+1} & \text{në rastet e tjera} \end{cases} \quad \text{dhe}$$

$$b_j = \max \left(j - 1; \left\lceil \frac{jN - z}{n_1} \right\rceil \right)$$

Përfundimi (S) mund të shkruhet edhe në formën:

$$P\left\{n_2 D^+(n_1, n_2) < \frac{z}{n_1}\right\} = \frac{|d_{ij}|}{C_N^{n_1}} \quad (S)$$

Bëjmë disa transformime në përfundimin e Korolioukut (K), kemi:

$$P\left\{n_1 n_2 \sqrt{\frac{n_1 n_2}{N}} D^+(n_1, n_2) < z n_1 n_2\right\} = P\left\{n_1 n_2 \sqrt{\frac{n_1 n_2}{N}} D^+(n_1, n_2) < z n_1 n_2\right\} =$$

(shumzuam me $n_1 n_2$ të dy anët e shprehjes brenda shenjës së probabilitetit)

$$P\left\{n_1 n_2 D^+(n_1, n_2) < z n_1 n_2 \sqrt{\frac{N}{n_1 n_2}}\right\} =$$

(shumzuam me $\sqrt{\frac{N}{n_1 n_2}}$ të dy anët e shprehjes brenda shenjës së probabilitetit)

$$P\left\{n_1 n_2 D^+(n_1, n_2) < z \sqrt{N n_1 n_2}\right\} = P\left\{n_2 D^+(n_1, n_2) < z \sqrt{\frac{N n_2}{n_1}}\right\} =$$

(shumzuam me $\frac{1}{n_1}$ të dy anët e shprehjes brenda shenjës së probabilitetit)

$$P\left\{n_2 D^+(n_1, n_2) < \beta\right\} = 1 - \frac{1}{C_N^{n_1}} \sum_{k=0}^{\left[\frac{n_1 - c}{p}\right]} \frac{c}{k(p+1) + c} * C_{k(p+1)+c}^k * C_{N-k(p+1)-c}^{n_1-k} \quad (K)$$

$$(\text{shënuam } z \sqrt{\frac{N n_2}{n_1}} = \beta \text{ dhe } c = \left\lceil z \sqrt{\frac{N n_2}{n_1}} \right\rceil = [\beta])$$

Shembull: Marim $n_1 = 3$, $n_2 = 6$, $z = 7$ ($\Rightarrow N = 3 + 6 = 9$, $p = 2$)

a) Sipas përfundimit (S), bëjmë llogaritjet:

$$b_j = \max\left(j-1; \left\lceil \frac{jN-z}{n_1} \right\rceil\right)$$

$$b_1 = \max \left(1 - 1; \left\lfloor \frac{1 \cdot 9 - 7}{3} \right\rfloor \right) = \max(0; 0) = 0$$

$$b_2 = \max \left(2 - 1; \left\lfloor \frac{1 \cdot 18 - 7}{3} \right\rfloor \right) = \max(1; 3) = 3$$

$$b_3 = \max \left(3 - 1; \left\lfloor \frac{1 \cdot 27 - 7}{3} \right\rfloor \right) = \max(2; 6) = 6$$

$$C_N^{n_1} = C_9^3 = \frac{9!}{6! \cdot 3!} = \frac{9 \cdot 8 \cdot 7}{3 \cdot 2} = 84 \quad (\text{zbatuam formulën } C_n^r = \frac{n!}{r!(n-r)!})$$

$$d_{ij} = \begin{cases} 0 & \text{në qoftë se } i - j > 1 \\ C^{j-i+1}_{n_2 - b_i + j} & \text{në rastet e tjera} \end{cases}$$

$$d_{11} = C_7^1 = 7, d_{12} = C_5^2 = 10, d_{13} = C_3^3 = 1$$

$$d_{21} = C_7^0 = 1, d_{22} = C_5^1 = 5, d_{23} = C_3^2 = 3$$

$$d_{31} = 0, d_{32} = C_2^0 = 1, d_{33} = C_3^1 = 3$$

$$|d_{ij}| = \begin{vmatrix} 7 & 10 & 1 \\ 1 & 5 & 3 \\ 0 & 1 & 3 \end{vmatrix} = 7 \cdot 5 \cdot 3 + 1 \cdot 1 \cdot 1 + 10 \cdot 3 \cdot 0 - 1 \cdot 5 \cdot 0 - 1 \cdot 3 \cdot 7 - 1 \cdot 10 \cdot 3 = 55$$

$$P \left\{ n_2 D^+(n_1, n_2) < \frac{z}{n_1} \right\} = \frac{|d_{ij}|}{C_N^{n_1}} = \frac{55}{84} \approx 0.6547619$$

b) Sipas përfundimit (K), në qoftë se marim $\beta = \frac{z}{n_1}$ duhet të gjejmë të njëjtin rezultat që gjetëm më rastin kur përdorëm përfundimin (S). Bëjmë llogaritjet:

$$\beta = \frac{z}{n_1} = \frac{7}{3} \Rightarrow c = [\beta] = \left[\frac{7}{3} \right] = 2, \left[n_1 - \frac{c}{p} \right] = \left[3 - \frac{2}{2} \right] = [2] = 2$$

$$P \left\{ n_2 D^+(n_1, n_2) < \frac{z}{n_1} \right\} = 1 - \frac{1}{C_N^{n_1}} \sum_{k=0}^{\left[n_1 - \frac{c}{p} \right]} \frac{c}{k(p+1) + c} * C_{k(p+1)+c}^k * C_{N-k(p+1)-c}^{n_1-k} =$$

$$1 - \frac{1}{C_9^3} \sum_{k=0}^2 \frac{2}{k(2+1)+2} * C_{k(2+1)+2}^k * C_{9-k(2+1)-2}^{3-k} =$$

$$1 - \frac{1}{C_9^3} \left(C_2^0 * C_7^3 + \frac{2}{5} C_5^1 * C_4^2 + \frac{2}{8} C_8^2 * C_1^1 \right) =$$

$$1 - \frac{1}{84} \left(1 * 35 + \frac{2}{5} * 5 * 6 + \frac{2}{8} * 28 * 1 \right) = 1 - \frac{54}{84} \approx 0.3571428$$

Në fakt nuk gjejmë të njëjtin rezultat, ndryshimi është shumë i ndjeshëm.

c) Bëjmë llogaritjet sipas përfundimit (K) por duke marrë jo

$$c = \left[z \sqrt{\frac{Nn_2}{n_1}} \right] = [\beta] \text{ por } c = - \left[-z \sqrt{\frac{n_2 N}{n_1}} \right] \quad (\text{domethënë të zëvendësojmë } c \text{ me } c^*).$$

$$\text{Kemi: } c = - \left[-\frac{z}{n_1} \right] = - \left[-\frac{7}{3} \right] = -(-3) = 3 \Rightarrow \left[n_1 - \frac{c}{p} \right] = \left[3 - \frac{3}{2} \right] = \left[\frac{3}{2} \right] = 1$$

$$\text{dhe } P \left\{ n_2 D^+(n_1, n_2) < \frac{z}{n_1} \right\} =$$

$$1 - \frac{1}{C_N^{n_1}} \sum_{k=0}^{\left[n_1 - \frac{c}{p} \right]} \frac{c}{k(p+1)+c} * C_{k(p+1)+c}^k * C_{N-k(p+1)-c}^{n_1-k} =$$

$$1 - \frac{1}{C_N^{n_1}} \sum_{k=0}^1 \frac{c}{k(p+1)+c} * C_{k(p+1)+c}^k * C_{N-k(p+1)-c}^{n_1-k} =$$

$$1 - \frac{1}{C_9^3} \left(C_3^0 * C_6^3 + \frac{3}{6} C_6^1 * C_3^2 \right) = 1 - \frac{1}{84} \left(1 * 20 + \frac{1}{2} * 6 * 3 \right) = 1 - \frac{29}{84} \approx 0.6547619$$

Rezultati i gjetur përputhet me atë që gjetëm kur përdorëm formulën (S).

Pra, përdorimi i shënimit $c = - \left[-z \sqrt{\frac{Nn_2}{n_1}} \right]$, pavarësisht nëse $z \sqrt{\frac{n_2 N}{n_1}}$ është numër i plotë ose jo i plotë, është i domosdoshëm.

Bibliografia:

- Naqo, M dhe Puka, LL (1982) Kurs i Statistikës Matematike, Tiranë
- Kolmogorov, A.N. (1933) Sulle determinazione empirike di una lege di distribuzione. Giorn.Ist. Itali. Attuori, 4
- Smirnov, N.V. (1939) Sur les ecarts de la courb de distribucion empirik. Vol.6, Approximate laws of distribucion of rëndom variables from empirical data. Uspehi Matem. Nauk, Vol.10 (1944)
- Gnedenko, B,V. dhe Koroliouk, V.S (1951) On the maximal deviacion betweet two empirical distribucion. Doklady akad Nauk SSSR, Vol.80
- Gnedenko, B. V. dhe Rvaceva, E. L. (1952) A problem of comparison of two empirical distribucions functon. Doklady Akad Nauk SSSR, Vol.82
- V.S.Koroliouk, V. S. (1955 a) On the deviacion of empirical distribucions for the casa of to independant somples. Isvestiga Akad. Nauk SSSR, Vol.19
- G.P.Steck, G. P. (1969) The Smirnov to sample tests as rank tests
- Steck, G. P. (1974) Evoluation of some stech determinants with applications, communicayions in statistics
- Riordan, I. (1968) Combinatorial Indentities. Wiley, New York
- Binjaku, H dhe Xhindi, T (2011) Studimi i homogjenitetit të zgjedhjes me anën e testeve joparametrike ECONOMICUS nr.6, UET/PRESS

Një vështrim i përgjithshëm mbi përdorimin e teknologjive të GPS dhe të sensorëve në menaxhimin e një biznesi transporti

_____ Prof. Asoc. Dr. Tamara LUARASI _____

_____ Muhamet AVDYLI, MSc _____

Abstrakt. Artikulli do të ketë një karakter përshkrues të qëllimit, metodologjisë, si dhe të teknologjive që do të përdoren në një studim në nivel doktorature. Studimi do të marrë përsipër përdorimin e teknologjive moderne në krijimin e një sistemi menaxhues të aktivitetit të një biznesi transporti në lidhje me përdorimin e automjeteve të tij. Esenca e studimit është krijimi i një sistemi informacioni rreth një grupi automjesh, dhe përdorimi i tij për kontrollin, planifikimin, dhe rritjen e efikasitetit të përdorimit të tyre. Ky sistem informacioni mundësohet nga sistemet satelitore ekzistues GPS, bashkëpunimi i tyre me sensorë të vendosur në automjet dhe shfrytëzimi i këtij informacioni me metoda bashkëkohore programimi.

Fjalë kyçe:

teknologjitë e GPS-ve, sensorët, biznes transporti

HYRJE

Sistemi i Pozicionimit Global (GPS) (<http://en.wikipedia.org/wiki/Gps>) është një sistem i bazuar në përshkrimin satelitor të hapësirës që siguron informacione

të ndryshme që mund të përdoren sipas interesave specifike të bizneseve ose institucioneve të ndryshme. Informacionet e marra nga GPS me ndihmën e marrësve specialë bëhet e mundur me teknologjitë moderne hardware dhe software dhe rezervohen në Servera të caktuar (Qëndër Kontrolli) ku këto informacione do të përpunohen dhe do të përdoren për qëllimet konkrete të studimit. Teknologjia nga pikëpamja e hardware-it përfshin marrësin GPS, sensorë të ndryshëm që vendosen në automjete me konfigurime specifike të tyre për të mbledhur atë lloj informacioni për të cilin jemi të interesuar si dhe paisje të tjera që do të bënin të mundur transmetimin e këtij informacioni në një Server. Nga ana tjetër ky transmetim kërkon ndërhyrjen e një software-i që do të realizonte komunikimin e Serverit me paisje të tilla si marrësi GPS dhe sensorët, si dhe interpretimin e informacionit që do të kalonte nga sensori në një bazë të dhënash në Server. Në rastin konkret të këtij studimi, gjithë kjo teknologji do të përdorej për një menaxhim më të mirë të aktivitetit të transportit nga pikëpamja e përdorimit më me efikasitet të automjeteve, duke e lidhur këtë efikasitet me përdorimin e rrugës më të përshtatëshme (nga pikëpamja e kostos), shfrytëzimit racional të kohës së punës dhe elementëve të tjerë që të gjithë bashkë do të ngrinin rendimentin dhe dhe efikasitetin të një biznesi transporti.

Sbtrimi i Problem

Studimi merr shtysë nga një situatë e zakonshme dhe që është menaxhimi jo i mirë e me metoda tashmë të vjetëruara të bizneseve të transportit. Mangësitë mund të përmbliken në mungesë menaxhimi të:

- Orëve të punës që automjetit
- Shpenzimet e lëvizjeve të automjetit
- Shpenzimet e derivative
- Shpenzimet e sigurimeve të automjetit
- Shpenzimet e komunikimit me drejtuesin e automjetit

Në ditët e sotme dihet se çelësi i suksesit të një biznesi është informacioni rreth gjithshkaje që ka të bëjë me të dhe përdorimi i këtij informacioni në mënyrë eficiente. Për vetë natyrën e tij ky lloj biznesi transporti automjetesh e ka të vështirë sigurimin e informacionit rreth aktivitetit të automjetit dhe respektimit nga ana e tij e rregullave të automjetit vetë dhe kërkesave të diktuar nga biznesi. Kjo sjell si domozdoshmëri përdorimin e teknologjive moderne të cilat e bëjnë të mundur një gjë të tillë.

Pra sigurimi i një Sistemi Informacioni të saktë dhe të gjithanshëm do të ishte objekti kryesor i këtij studimi. Përdorimi i tij është po aq i rëndësishëm por është një fazë e dytë dhe do të jepte rezultate konkrete në menaxhimin e punës në këtë sektor.

Përmes formës menaxhuese që do të ofronte ky studim do të lehtësohej mbikqyrja, udhëheqja personave përgjegjës të aktivitetit të tyre, dhe kushte më komode pune të gjithë automjeteve që janë pasuria e një biznesi privat apo shtetëror.

Është e kuptueshme që pasja në dorë e një informacioni që azhurnohet në çdo moment rreth automjetit do të rriste kontrollin, efikasitetin e punës, si dhe sigurinë e automjetit dhe vënjen e tij në kushte komunikimi të vazhdueshëm me drejtuesit e aktivitetit. Përdorimi i teknologjive moderne si në aspektin e hardware-it dhe atë të software-it do ta bënin të mundur një gjë tilla. Nuk është se këto teknologji nuk njihen sot, por përdorimi dhe implementimi i tyre në kushte konkrete do të sjell diçka të re dhe situata të paparashikueshme për tu zgjidhur gjë që do të përbëjë një kontribut në eksperiencën ekzistuese të aplikimit të teknologjive të tilla.

Do të konsideronim burim referimi për këtë studim eksperiencën të ngjajshme në fusha të ndryshme që përdorin sistemin e pozicionimit global (GPS). Ky sistem është bërë pjesë e pandashme e shoqërisë sot së bashku me sistemet e telekomunikimit dhe navigacionit. Zbatimi i GPS po përhapet edhe në pajisje si telefonia mobile dhe rrjedhimisht njohja e vet sistemit dhe pajisjeve që përdor ky sistem është parësor për të ardhmen. Eksperiencën të tilla ka në ushtri, në monitorimin e automjeteve, në menaxhimin e logistikës së të anijeve, monitorimin e temperaturave të traqeve që luajnë gjithashtu rolin e frigoriferëve, monitorim të taksive, të autobuzëve etj. Ka shumë lloje paisjesh që luajnë rolin e sensorëve, software-sh që realizojnë komunikimin në rrjeta të tipeve të ndryshme duke përfshirë wireless-et.

Në një situatë të tillë mbetet të bëhet një analizë e gjithanëshme për të përcaktuar kërkesat konkrete dhe elementët hardware (ku nënkuptojmë sensorë të ndryshëm që janë produkte të tregut tashmë) dhe software më të përshtatshëm për ti u përgjigjur situatës konkrete dhe për të marrë rezultate konkrete.

Si punon sistemi satelitor GPS në bashkëpunim me marrësin GPS (GPS for MARINERS Robert J.Sweet 2003, <http://www.gps.com>)

Sistemi i Pozicionimit Global (GPS) është një konstelacion i përbërë nga 27 satelitë, 24 në përdorim dhe 3 në gatishmëri, i vendosur në orbitë në distancë afro 20020 km mbi sipërfaqen e tokës, nga 4 satelite në secilën prej 6 orbitave, ku këndi i inklinationit (pjerrtësia orbitale) në mes të këtyre rrafshëve është 55 shkallë (fig1.a.b).


Satelitët gjenden në lartësinë e përmendur më sipër dhe lëvizin në trajektoren e tyre me shpejtësi 11,000 km/h. Furnizimi kryesor apo primar elektrik është me energji diellore por në rast të eklipseve (zënies së diellit) ata mund të përdorin bateritë e brendshme.

Të 24 satelitët aktivë në orbitë rrotullohen rreth Tokës dy here brenda 24 orëve, duke përmbyshur kështu një cikël të plotë.



a)

Fig.1.a,b Konstelacioni GPS



b)

Koordinatat e GPS bazohen në Sistemin Gjeodezik Boteror të vitit a)1984 që përbëhet nga vijat në gjerësi dhe gjatësi gjeometrike.(GPS Basic Jean-Mariu Zoog 2002)

Për të caktuar pozicionin në tokë (dy dimensional) nevojiten që së paku tre satelitetë të shikojnë në objektin e caktuar statik apo mobil dhe për pozicionin tre dimensional nevojiten së paku 4 satelitetë të diktojnë objektin.

Se pari duhet thënë që nëpërmjet sistemit GPS dhe marrësit GPS mund të përcaktohet distanca nga sateliti në një marrës GPS.

Largësia në mes të satelitetit dhe marrësit llogaritet në bazë të kohës së kaluar prej momentit të dërgimit të sinjalit nga satelitetë deri në momentin e pranimit të sinjalit nga marrësi (ndryshimit fazor). Pra, këto llogaritje bëhen duke aplikuar apo përdorur dy orë, njera në satelitet dhe tjetra në marrës (antenë) të GPS-it.

Në kohë të caktuar sateliteti fillon të transmetojë një sinjal të gjatë digjital të quajtur pseudo kodi. Aparati marrës (pranuesi) në anën tjetër në të njëjtën kohë fillon me transmetimin e kodit të njëjtë. Për të arritur në satelitet, ai do të vonohet për një kohë të caktuar. Zgjatja e kësaj vonese është kohëzgjatja e udhëtimit të sinjalit nga i cili mund të matet distanca. Mbase dihet shpejtësia e dritës (~300.000 km/s), mund të matim distancën me saktësi të madhe. Kushti që kjo të bëhet si duhet është që orët në marrësin GPS dhe satelitetë të jenë të sinkronizuara. Satelitetë janë të pajisur me orë atomike ndërsa marrësit me orë kuartz të cilët rregullohen (kolaudohen) periodikisht, mbasi dihet që ora kuartz nuk punon me të njëjtën saktësi si ora atomike.

Për të evituar gabimet në matjen e distancës vazhdimisht kontrollohet ora e marrësit duke e sinkronizuar me orën e satelitetëve.

Intervali kohor (apo e ashtuquajtura vonesa e sinjalit) i nevojshëm që sinjali të arrijë nga sateliti në marrës përcaktohet duke lexuar orën nga sateliti i GPS në momentin e dërgimit të sinjalit dhe orën tjetër në momentin e arritjes së sinjalit te marrësi GPS Fig 2.




Fig .2 Koha e transmetimit dhe marrjes së sinjalit

Duke shumëzuar këtë interval kohor me shpejtësinë e dritës që është (300.000. km/s) e fitojmë largësinë apo distancën e kërkuar

$$L=c \cdot t$$

ku:

L...largësia e satelitit nga marrësi apo antena

c...shpejtësia dritës

t... kohe për të cilën sinjali ka rrugëtuar deri te pika caktuar në marrës.

Duke qënë në gjendje të llogarisim distancën e një marrësi GPS nga një satelit dhe duke e patur këtë mundësi për të paktën 4 satelitë bëhet e mundur të gjendet pozicioni i një objekti (tre dimensional). Në fakt janë 4 të panjohura, të cilat janë 3 koordinatat e objektit në sistemin kartezi Fig 3, dhe pasaktësia e llogaritjes së distancave që vjen si rezultat i diferencës në kohë në mes të orës satelitore dhe orës së shfrytëzuesit. Kjo është arsyeja që na duhen 4 satelitë diktues të një objekti për të realizuar një system ekuacionesh me 4 të panjohura dhe 4 ekuacione. Secili nga ekuacionet do të shprehë distancën midis satelitit dhe marrësit GPS.




Fig 3. Një objekt në Sistemi Kartezian 3 dimensional

Roli i marrësit GPS (Punimi i magjistraturës shkencore “Funksionimi i Sistemit Global të Pozicionimit (GPS) dhe mundësitë e aplikimit të tij në lëmin e navigacionit dhe më gjerë në avancimin e proceseve teknologjike në komunikacionin rrugorë” Muhamet Avdyli 2008 Prishtinë)

Përveç përcaktimit të saktë të pozicionit GPS marrësi përcakton apo llogarit edhe të dhëna të tjera të rëndësishme siç janë: shpejtësia e lëvizjes, drejtimi i lëvizjes, koha reale e lëvizjes, gjatësia e distancës apo shtegut që duhet të kalohet. Kjo varet nga sensorët që ndodhen në të si dhe konfigurimi i tyre që do të jetë një pjesë e rëndësishme e studimit.

Programimi dhe krijimi i një ambienti pune për programimin

Një element i rëndësishëm i punës është dërgimi i informacionit nga marrësi GPS në një bazë të dhënash në një server. Nëse marrësi GPS është i diktuar nga satelitët e sistemit satelitor GPS atëherë pozicioni i saktë i një objekti dhe informacionet tjera merren në kohën reale.

Përndryshe nëse marrësi GPS nuk i “shikon” satelitët, ndërsa është realizuar lidhja nëpërmes shërbimeve komunikuese atëherë të dhënat në lidhje me pozicionin dhe të dhënat e tjera mund të merren nëpërmes ‘logut’ (kujtesës së brendshme të pajisjes GPS e cila në vartësi nga lloji i pajisjes mund të mbajë mendë deri 12000 km e fundit të rrugës së përshkruar të objektit).

Ky lloj përcjelljeje të informacionit quhet ndryshe edhe përcjellje GPS pasive e objektit i cili është në lëvizje ose ka qënë në lëvizje. Në këtë rast nuk mundemi të kemi transmetim të të dhënave në kohë reale, por antena e cila është vendosur në GPS marrës e ushqen me të dhëna siç janë pozicioni, shpejtësia, etj kujtesën e

brendshme (logun) e marrësit GPS që më vonë do të mund të lexohet.

Përcjellja dhe marrja e të dhënave nga GPS marrësi në aspektin lëvizës bëhet në tri mënyra:

- GPS Përcjellja automatike bëhet atëherë kur e kemi të programuar GPS marrësin ashtu që në intervale të caktuara kohore (psh. çdo orë, 4 herë në 24 orë etj) të shpërndaj informacione.

- GPS Përcjellja sipas thirrjes nga një qendër kontrolli apo nga interneti e cila bëhet sipas nevojës dhe kërkesave, nëse kemi situatë të atillë që shërbimi komunikues është i gatshëm d.m.th. marrësi GPS i “shikon” satelitët e sistemit satelitore apo është i fiksuar nga të njëjtit. Software-i që do të instalohet në paisjen që vihet në automjet, bën të mundur të përcaktohet pozicioni i saktë i objektit në kohën reale dhe software-i i instaluar në server këto pozicione do ti paraqesë në monitorin e qendrës së kontrollit apo në dritaren e internetit të site-it përkatës. Nëse nuk ka “fiksime” (shikim nga satelitët) atëherë në monitor tregohet pozita e fundit kur satelitët kanë parë objektin në lëvizje.

- GPS Përcjellje pasive cila i mundëson qendrës kontrolluese apo shfrytëzuesit që ndërkohë të marrë të dhëna të ruajtura dhe të kuptojë në bazë të tyre pozicionin, drejtimin, shpejtësinë etj.

Transmetimi i Informacionit nga paisjet e vogla në Server do të kërkonte instalimin e programeve specifike në paisjet e vogla që vendosen në automjete

(<http://code.google.com/android/add-ons/google-apis/maps-overview.html>) ekzekutimi i të cilave shkakton dërgimin e informacionit të mbledhur në destinacion.

Këto programe fillimisht do të duhej të realizoheshin jashtë paisjeve të vogla e më pas të instaloheshin atje. Për këtë duhet realizuar një ambient specifik pune. Mund të punohet fillimisht me një emulator të një paisje të vogël dhe për këtë ndihmohemi nga platforma që u përgjigjen teknologjive të reja të programimit. Një e tillë është platforma ose sistemi Android. Android është një sistem operativ për paisjet e lëvizshme të tilla si smartphone-et dhe kompjuterat tablet. Kjo platformë është zhvilluar nga “Open Handset Alliance” e udhëhequr nga Google

([http://en.wikipedia.org/wiki/Android_\(mobile_phone_platform\)](http://en.wikipedia.org/wiki/Android_(mobile_phone_platform)))

dhe konsiderohet sot një platformë sistemi operativ më gjerësisht e përdorur në teknologjinë e biznesit. Aplikimet në këtë sistem janë kryesisht në Java e cila ofron klasa të posaçme për programimin në paisjet e vogla. Android është një sistem operativ “open source” bazuar në Linux dhe me mundësi integrimi të fuqishme me baza të dhënash. (<http://goarticles.com/article/Advantages-of-Android-Development-platform-on-Mobile-Phones/4927014/>)

Me interes në rastin tonë do të ishte përdorimi i GPS dhe hartat e Google (Google Maps) në Android.

Për komoditetin e punës tonë përdorim Eclipsin si IDE dhe sistemi Android do të integrohet në Eclipse. Më poshtë po paraqesim hapat që ndërmarrim për të realizuar këtë ambient pune:

- Ngarkojmë Eclipsin (nëse kemi ngarkuar eclipse-jee-helios-SR2-win32-x86_64.zip)

- Ngarkojmë Java JDK ne kemi ngarkuar JDK6 Update 6: (<http://java.sun.com/javase/downloads/widget/jdk6.jsp>) Zgjidhni Windows x64
- Ngarkojmë Android SDK (<http://developer.android.com/sdk/index.htm>)
- Ngarkojmë ADT (Android Development Tools: 1) Zgjedhim Windows
- Instalojmë Java SDK: për këtë së pari duhet të kemi instaluar JDK
- Instalojmë Eclipsin.
- Instalojmë Android SDK. Më poshtë paraqiten disa hapa për këtë proces
- Shqyrtojmë në se kompjuteri plotëson kërkesat që ky system kërkon.
- Instalohet paketa startuese se mund të jetë njëra prej:

[android-sdk_r16-windows.zip](#)

[installer_r16-windows.exe](#) (rekomandohet)

- Instalohen ADT Plugin për Eclipsin.
- Hapet Eclipsi dhe zgjidhet **Help>Install New Software....**
- Klikjmë **Add**, në skajin lart-djathtas.
- Në dialogun Add Repository që shfaqet shtypni «ADT Plugin» për *Name* dhe URL <https://dl-ssl.google.com/android/eclipse/> *Location*, klikoni OK.

Shenim: në se ka probleme provojmë “http” në Location URL, në vend “https” (https preferohet për arsye sigurie).

- Në dialogun Available Software zgjedhim checkbox-in pas Developer Tools dhe klikojmë **Next**.

- Në dritaren që vijon, shohim listen e tool-seve që ngarkohen. Klikojmë **Next**.
- Lexojmë dhe pranojmë kërkesën e licensës, kliko **Finish**.
- Ristartojmë Eclipsin.
- Bëjmë modifikimet e përshtatëshme në PATH-in e sistemit:
... \Program Files (x86)\Android\android-sdk\platform-tools;
... \Program Files (x86)\Android\android-sdk\tools
- Konfigurojmë ADT Plugin.

Pasi ADT është ngarkuar në mënyrë të suksesshme si më sipër, hapi tjetër është modifikimi i preferencave në Eclipse për tu lidhur me direktorinë e Android SDK

- zgjedhim Window>Preferences).
- Zgjedhim Android nga paneli i majtë.

Një aplikim i thjeshtë për të testuar se çdo gjë funksionon:

(http://www.linuxtopia.org/online_books/android/devguide/guide/developing/eclipse-adt.html)

1. Hapim Eclipsin
2. Zgjedhim **File>New>Project**.
3. Zgjedhim **Android>Android Project**, dhe klikojmë **Next**.
4. Zgjedhim përmbajtjen e projektit:
 - Shtypim një *Emër Projekti*. Ky do të jetë emri i folderit ku projekti krijohet.
 - Nën Contents, zgjedhim **Create new project in workspace**. Zgjedhim një

vendndodhje (workspace) për projektin.

- Nën Target, zgjedhim Android target për tu përdorur si një Build Target i projektit. Build Target specifikon se cilën platformë Android duam për të ndërtuar aplikimin.

- Nën Properties, plotësojmë gjithë fushat e nevojshme.

- Shtypim një *Emer Aplikimi*. Ky duhet të diçka e lexueshme dhe do të afishohet në emulatorin e paisjes Android.

- Shtypim një *Emer Pakete*. Ku është emri i paketës (që plotëson disa rregulla të kërkuara nga gjuha e programimit Java) ku vendoset gjithë kodi i aplikimit.

- Zgjedhim *Create Activity* (opsionale, por i përdorur zakonisht) që na lejon të fusni një emër për klasën kryesore Activity.

- Shtypim *Min SDK Version*. Ky është një i plotë që paraqet nivelin minimal API të kërkuar për të ekzekutuar në mënyrë të përshtatëshme aplikimin. Duke futur këtë numur automatikisht shtohet atributi [<uses-sdk>](#) në file-in AndroidManifest.

5. Krijojmë një emulator që do tju duhet për ta ekzekutuar aplikimin:

- Në nivel komande japim komandën:

android list targets

që na nevojitet për të zgjedhur paisjen ku do të bëjet ekzekutimi (Deployment Target). Ju do të shihni një liste target-esh të Android për shembull:

id:1

Name: Android 1.1

Type: platform

API level: 2

Skins: HVGA (default), HVGA-L, HVGA-P, QVGA-L, QVGA-P

id:2

Name: Android 1.5

Type: platform

API level: 3

Skins: HVGA (default), HVGA-L, HVGA-P, QVGA-L, QVGA-P

Gjejmë atë target që përputhet me platformën Android nën të cilën ekzekutojmë aplikimin.

- Krijojmë një emulator paisje duke përdorur targetin e zgjedhur. Ekzekutojmë komandën.

android create avd --name *<emri i paisjes suaj>* --target *<targetID>*

- Më pas pyetemi për të krijuar një profile hardware-i të personalizuar, si fillim shtypim return (përgjigja apriori është jo).

Paisja AVD është gati.

6. Klikojmë **Finish**.

7. Ekzekutojmë aplikimin : zgjedhim **Run>Run** (ose **Run>Debug**) nga menuja kryesore e Eclipsit. ADT plugin automatikisht krijon një konfigurim të ekzekutimit për projektin

Konkluzione:

Ky studim pretendon të sjellë rezultate konkrete në këto aspekte të menaxhimit të një kompanie ose biznesi transporti.

- Shpejtësinë e shërbimeve
- Shkallë më të lartë të organizimit të punës
- Sigurinë e bartjes mallrave dhe saktësinë e shpërndarjes
- Disiplinën e punës

Përveç kësaj rezultati i studimit do të ndryshonte metodën e punës së biznesit. Ajo do të udhëhiqej tani nga një dektop kompjuteri, do krijohet një menaxhim modern dhe bashkëkohor. Sigurisht i gjithë procesi do të kërkonte organizimin e një sistemi të tërë kompjuterash, të lidhur në një rrjet dhe ky rrjet do të kishte një ose disa servera ku do të vendosej një bazë të dhënash. Edhe ky aspekt do të përbënte një pjesë të studimit, d.m.th analiza e problemit, e kushteve teknike dhe ambientit të punës që ky modernizim do të kërkonte.

Pra qëllimi i studimit sjell me vete dhe aspekte të tjera të cilat janë pjesë e kësaj ndërmarjeje dhe në fund të fundit sjellin një progres në mënyrën e menaxhimit dhe punës në një biznes.

Bibliografia:

Robert J. Sweet (2003G) PS for MARINERS

Jean-Mariu Zoog (2002) GPS Basic

Avdyli, M (2008) "Funksionimi i Sistemit Global të Pozicionimit (GPS) dhe mundësitë e aplikimit të tij në lëmin e navigacionit dhe më gjerë në avancimin e proceseve teknologjike në komunikacionin rrugorë" Prishtine

Burime nga internet:

<http://code.google.com/android/add-ons/google-apis/maps-overview.html>

[http://en.wikipedia.org/wiki/Android_\(mobile_phone_platform\)](http://en.wikipedia.org/wiki/Android_(mobile_phone_platform))

<http://goarticles.com/article/Advantages-of-Android-Development-platform-on-Mobile-Phones/4927014>

<http://developer.android.com/sdk/adding-components.html>

<http://developer.android.com/sdk/index.html>

<http://developer.android.com/guide/developing/tools/adt.html>

http://www.linuxtopia.org/online_books/android/devguide/guide/developing/eclipse-adt.html

<http://en.wikipedia.org/wiki/Gps>

[http:// www.gps.com](http://www.gps.com)

Një teoremë mbi pikat fikse të përbashkëta në hapësirat kuazi-metrike të dislokuara

____ Prof. As. Dr. Elida HOXHA ____

____ Arben ISUFATI, Mrc ____

Abstrakt. Teoria e pikave fikse në këto 50 vitet e fundit është kthyer në një mjet të rëndësishëm në studimin e fenomeneve jolinearë. Në veçanti teknikat e pikave fikse kanë gjetur zbatime në fusha të ndryshme sidomos në ekonomi, inxhinieri, teorinë e lojrave apo në teorinë e marrjes së vendimeve. Në këtë artikull ne do të vërtetojmë teorema për pikat fikse të përbashkëta të funksioneve kontraktive të vazhdueshëm që plotësojnë kushte kontraktiviteti racionale në hapësirat kuazi-metrike të dislokuara. Rezultate të mparshme janë raste të veçanta të teoremave tona.

Fjalë kyçe:

hapësirat kuazi-metrike, teoremë mbi pikat fikse të përbashkëta

HYRJE

Banach [1922] vërtetoi teoremën e pikave fikse për funksionet kontraktive në hapësirat e plota metrike. Ajo njihet si teorema e pikës fikse e Banach-ut. Gjatë shekullit të 20 një numër i madh teoremesh për pikat fikse zhvilluan atë fushë të matematikës që u quajt teoria e pikave fikse. Kjo teori në këto 50 vitet e fundit është kthyer në një mjet të rëndësishëm në studimin e fenomeneve jolineare. Në veçanti teknikat e pikave fikse kanë gjetur zbatime në fusha të ndryshme sidomos në ekonomi, inxhinieri, teorinë e lojrave apo në teorinë e marrjes së vendimeve. Që nga Arrow Debreu, teoria e pikave fikse ka qënë një mjet standart në teorinë e përgjithshme të ekuilibrit, duke dhënë zgjidhje në problemet e ekzistencës së ekuilibrit apo pseudoekuilibrit në ekonominë financiare.

Pas Banach-ut mjaft autorë kanë studiuar kontraksione në hapësira të ndryshme dhe kanë vërtetuar terema mbi pikat fikse në kushte të tjera. Hitzler dhe Seda [3] futën konceptin e topologjisë së dislokuar dhe shtrinë principin e kontraksionit të Banach-ut në hapësirat metrike të dislokuara dhe në hapësirat kuazi metrike të dislokuara. Dass and Gupta [2] përgjithsuan principin e kontraksionit të Banach-ut në hapësirat metrike. Rhoades [1977] bëri një renditje të pjesshme për përcaktimet e ndryshme të funksioneve kontraktive. Aage and Salunke [1] përgjithsoi rezultatet e Zeyada [6] duke përdorur kontraksione të Rhoades [5]. Objekti i këtij artikulli është që të vërtetojë një teorem mbi pikat fikse të përbashkëta për funksione kontraktive të vazhdueshëm të përcaktuar nga Dass and Gupta [2] and Rhoades [4], në hapësirat kuazi metrike të dislokuara.

Njohuri paraprake

Përkufizim 2.1 [6] Le të jetë X një bashkësi jo boshe dhe $d: X \times X \rightarrow [0, \infty)$ një funksion që plotëson kushtet:

- (i) $[d(x, y) = d(y, x) = 0] \Rightarrow [x = y]$,
- (ii) $d(x, y) \leq d(x, z) + d(z, y)$, për çdo $x, y, z \in X$.

Atëhere d është kuazi-metrikë e dislokuar në X dhe shënohet dq-metrikë.

N.q.s. d plotëson edhe kushtin $d(x, y) = d(y, x)$, atëhere ajo quhet metrikë e dislokuar.

dhe shënohet d-metrikë

Është e qartë që çdo d-metrikë është dq-metrikë ndërsa e anasjellta nuk është e vërtetë.

N.q.s. d është dq-metrikë atëhere çifti (X, d) është hapësirë kuazi-metrike e dislokuar që shënohet hapësirë dq-metrike.

Hapësirat dq-metrike janë hapësira topologjike të dislokuara. Konceptet e topologjisë së dislokuar janë të përdorshme në logjikën e programimeve.

Përkufizim 2.2 [6] Një varg $\{x_n\}$ në një hapësirë dq-metrike (hapësirë kuazi-metrike e dislokuar) (X, d) quhet varg Koshi n.q.s. për çdo $\varepsilon > 0, \exists n_0 \in \mathbb{N}$, i tillë që $\forall m, n \geq n_0$, kemi $d(x_m, x_n) < \varepsilon$ ose $d(x_n, x_m) < \varepsilon$ d.m.th. $\min\{d(x_m, x_n), d(x_n, x_m)\} < \varepsilon$.

Përkufizim 2.3 [6] Një varg $\{x_n\}$ është dq-konvergjent në x n.q.s.

$$\lim_{n \rightarrow \infty} d(x_n, x) = \lim_{n \rightarrow \infty} d(x, x_n) = 0$$

Në këtë rast x quhet dq-limit i $\{x_n\}$ dhe shkruajmë $x_n \rightarrow x$.

Lemë 2.4 [6]. dq-limiti i një vargu $\{x_n\}$ në një hapësirë dq-metrike është i vetëm.

Lemë 2.5. [6]. Çdo nënvarg i një vargu dq-konvergjent në x është dq-konvergjent në x .

Përkufizim 2.6. [6] Një hapësirë dq-metrike (X, d) është e plotë n.q.s. çdo varg Koshi në të është dq konvergjent.

Përkufizim 2.7. [6] Le të jenë (X, d_1) dhe (Y, d_2) hapësira dq-metrike dhe $f: X \rightarrow Y$ një funksion. Funksioni f është i vazhdueshëm në $x_0 \in X$, n.q.s. për çdo varg $\{x_n\}$ i cili është d_1 -q konvergjent në x_0 në X , vargu $\{f(x_n)\}$ është d_2 -q konvergjent në $f(x_0)$ në Y .

Përkufizim 2.8. [6] Le të jetë (X, d) një hapësirë dq-metrike. Një funksion $T: X \rightarrow X$ është kontraksion n.q.s. ekziston $0 \leq \lambda < 1$ e tillë që për çdo $x, y \in X$

$$d(Tx, Ty) \leq \lambda d(x, y)$$

Teoremë 2.9. [6] Le të jetë (X, d) një hapësirë dq-metrike dhe $T: X \rightarrow X$ një funksion kontraktiv i vazhdueshëm, atëherë T ka një pikë fikse.

Rezultate kryesore

Teoremë 3.1. Le të (X, d) një hapësirë e plotë dq-metrike dhe $T_1, T_2: X \rightarrow X$ dy funksione kontraktive të vazhdueshëm që kënaqin kushtin:

$$d(T_1x, T_2y) \leq \alpha d(x, y) + \beta d(x, T_1x) + \gamma d(y, T_2y) + \delta [d(x, T_2y) + d(y, T_1x)] \quad (3.1)$$

për çdo $x, y \in X$, ku $\alpha, \beta, \gamma, \delta$ janë numra jonegativë, të tillë që $\sup\{\alpha + \beta + \gamma + 2\delta : x, y \in X\} < 1$. Atëherë T_1, T_2 kanë një pikë fikse të vetme të përbashkët.

Vërtetim

Le të jetë $x_0 \in X$, $T_1(x_0) = x_1$, $T_2(x_1) = x_2$, $\dots$, $T_1(x_{2n}) = x_{2n+1}$, $T_2(x_{2n+1}) = x_{2n+2}$, $\dots$.

Për vargun $\{x_n\}$ kemi:

$$\begin{aligned} d(x_{2n+1}, x_{2n+2}) &= d(T_1(x_{2n}), T_2(x_{2n+1})) \\ &\leq \alpha d(x_{2n}, x_{2n+1}) + \beta d(x_{2n}, T_1 x_{2n}) + \gamma d(x_{2n+1}, T_2 x_{2n+1}) + \\ &\quad \delta [d(x_{2n}, T_2 x_{2n+1}) + d(x_{2n+1}, T_1 x_{2n})] \\ &= \alpha d(x_{2n}, x_{2n+1}) + \beta d(x_{2n}, x_{2n+1}) + \gamma d(x_{2n+1}, x_{2n+2}) + \\ &\quad \delta [d(x_{2n}, x_{2n+2}) + d(x_{2n+1}, x_{2n+1})] \\ &= \alpha d(x_{2n}, x_{2n+1}) + \beta d(x_{2n}, x_{2n+1}) + \gamma d(x_{2n+1}, x_{2n+2}) + \\ &\quad \delta [d(x_{2n}, x_{2n+1}) + d(x_{2n+1}, x_{2n+2})] \end{aligned}$$

Kështu

$$d(x_{2n+1}, x_{2n+2}) \leq \frac{\alpha + \beta + \delta}{1 - (\gamma + \delta)} d(x_{2n}, x_{2n+1}) = \lambda d(x_{2n}, x_{2n+1}),$$

$$\text{ku } \lambda = \frac{\alpha + \beta + \delta}{1 - (\gamma + \delta)} \text{ dhe } 0 \leq \lambda < 1.$$

E aplikojmë këtë mosbarazim për $n=0, n=1, \dots$, dhe marrim

$$d(x_{2n+1}, x_{2n+2}) \leq \lambda^{2n} d(x_0, x_1)$$

Me që $0 \leq \lambda < 1$, atëherë $\lambda^{2n} \rightarrow 0$ kur $n \rightarrow \infty$, kështu që vargu $\{x_n\}$ është varg Koshi në hapësirën e plotë kuazi-metrike të dislokuar (X, d) . Atëherë ekziston një pikë $u \in X$ e tillë që $x_n \rightarrow u$ dhe rrjedhimisht edhe nënvargjet $\{T_1(x_{2n})\} \rightarrow u$ dhe $\{T_2(x_{2n+1})\} \rightarrow u$. Me që T_1 dhe T_2 janë të vazhdueshëm atëherë $T_1(u) = u$,

$$T_2(u) = u$$

Pra, T_1 dhe T_2 kanë pikën u pikë fikse të përbashkët

Uniciteti: Le të jetë u një pikë fikse e përbashkët e T_1, T_2 . Prej kushtit (3.1) në teoremë kemi

$$d(u, u) = d(T_1 u, T_2 u) \leq (\alpha + \beta + \gamma + 2\delta) d(u, u)$$

Me që $0 \leq (\alpha + \beta + \gamma + 2\delta) < 1$ dhe $d(u, u) \geq 0$ rrjedh $d(u, u) = 0$. Kështu n.q.s. u është pikë fikse e T_1 dhe T_2 atëherë $d(u, u) = 0$.

Le të jenë $u, v \in X$ pika fikse të përbashkëta të T_1 dhe T_2 . Atëherë $T_1 u = u, T_2 u = u$ dhe $T_1 v = v, T_2 v = v$.

Nga kushti (3.1) në teorem kemi,

$$d(u, v) = d(T_1 u, T_2 v) \leq \alpha d(u, v) + \beta d(u, T_1 u) + \gamma d(v, T_2 v) + \delta [d(u, T_2 v) + d(v, T_1 u)] \\ \leq \alpha d(u, v) + \beta d(u, u) + \gamma d(v, v) + \delta [d(u, v) + d(v, u)]$$

Kështu

$$d(u, v) \leq \frac{\delta}{1 - (\alpha + \delta)} d(v, u) \quad (3.2)$$

Në mënyrë të ngjashme kemi

$$d(v, u) \leq \frac{\delta}{1 - (\alpha + \delta)} d(u, v) \quad (3.3)$$

Me që $0 < \frac{\delta}{1 - (\alpha + \delta)} < 1$ atëherë marrim që $d(u, v) = d(v, u)$. Përsëri prej (3.2)

dhe (3.3) marrim që $d(u, v) = d(v, u) = 0$, pra $u = v$.

Kështu pika fikse e përbashkët e T_1 dhe T_2 është e vetme.
Rrjedhimi i mëposhtëm përgjithson Teoremën 3.3 in [1].

Rrjedhim 3.2 Le të jetë (X, d) një hapësirë e plotë dq-metrike dhe $T_1, T_2 : X \rightarrow X$ dy funksione kontraktive të vazhdueshëm që plotësojnë kushtin

$$d(T_1 x, T_2 y) \leq \alpha [d(x, T_1 x) + d(y, T_2 y)]$$

për çdo $x, y \in X$, ku $0 \leq \alpha < \frac{1}{2}$. Atëherë T_1, T_2 kanë një pikë fikse të vetme të përbashkët.

Vërtetim. Vërtetimi i këtij rrjedhimi është i ngjashëm me atë të Teoremës 3.1 duke marrë $\alpha = \delta = 0$ dhe $\beta = \gamma$.

Teorema e mëposhtme përgjithson Teoremën 3.1 in [4].

Teorem 3.3 Le të jetë (X, d) një hapësirë e plotë dq-metrike dhe $T_1, T_2 : X \rightarrow X$ dy funksione të vazhdueshëm që plotësojnë kushtin

$$d(T_1 x, T_2 y) \leq \alpha \frac{d(y, T_2 y)[1 + d(x, T_1 x)]}{1 + d(x, y)} + \beta d(x, y) \quad (3.5)$$

Për çdo $x, y \in X$, ku α, β janë numra jonegativë, të tillë që $\sup \{\alpha + \beta : x, y \in X\} < 1$. Atëherë T_1, T_2 kanë një pikë fikse të vetme të përbashkët.

Vërtetim. Let $x_0 \in X$, $T_1(x_0) = x_1$, $T_2(x_1) = x_2$, $\dots$, $T_1(x_{2n}) = x_{2n+1}$, $T_2(x_{2n+1}) = x_{2n+2}$, $\dots$

Për vargun $\{x_n\}$ kemi:

$$\begin{aligned} d(x_{2n+1}, x_{2n+2}) &= d(T_1(x_{2n}), T_2(x_{2n+1})) \\ &\leq \alpha \frac{d(x_{2n+1}, T_2 x_{2n+1})[1 + d(x_{2n}, T_1 x_{2n})]}{1 + d(x_{2n}, x_{2n+1})} + \beta d(x_{2n}, x_{2n+1}) \\ &\leq \alpha \frac{d(x_{2n+1}, x_{2n+2})[1 + d(x_{2n}, x_{2n+1})]}{1 + d(x_{2n}, x_{2n+1})} + \beta d(x_{2n}, x_{2n+1}) \\ &= \alpha d(x_{2n+1}, x_{2n+2}) + \beta d(x_{2n}, x_{2n+1}) \end{aligned}$$

Rrjedhimisht

$$d(x_{2n+1}, x_{2n+2}) \leq \frac{\beta}{1-\alpha} d(x_{2n}, x_{2n+1}) = \lambda d(x_{2n}, x_{2n+1})$$

ku $\lambda = \frac{\beta}{1-\alpha}$ dhe $0 \leq \lambda < 1$.

E aplikojmë këtë mosbarazim për $n=0, n=1, \dots$, dhe marrim

$$d(x_{2n+1}, x_{2n+2}) \leq \lambda^{2n} d(x_0, x_1)$$

Me që $0 \leq \lambda < 1$, kemi që $\lambda^{2n} \rightarrow 0$ kur $n \rightarrow \infty$. Kështu vargu $\{x_n\}$ ështëvarg Koshi në hapësirën e plotë kuazi-metrike të dislokuar (X, d) , **prej ku ekziston $u \in X$ e tillë që $x_n \rightarrow u$.** Rrjedhimisht edhe nënvargjet $\{T_1(x_{2n})\} \rightarrow u$, $\{T_2(x_{2n+1})\} \rightarrow u$. Me që T_1 dhe T_2 janë të vazhdueshëm kemi $T_1(u) = u$, $T_2(u) = u$

Uniciteti: N.q.s. u është pikë fikse e përbashkët e T_1, T_2 , atëhere nga kushti në teorem kemi

$d(u, u) = d(T_1 u, T_2 u) \leq (\alpha + \beta) d(u, u)$,
prej ku $d(u, u) = 0$, me që $0 \leq (\alpha + \beta) < 1$ dhe $d(u, u) \geq 0$. Kështu, n.q.s. u është pikë fikse e përbashkët e T_1 dhe T_2 atëhere $d(u, u) = 0$.

Le të jenë $u, v \in X$ pika fikse të përbashkëta të T_1 dhe T_2 . Atëherë, $T_1 u = u, T_2 u = u$ and $T_1 v = v, T_2 v = v$

Nga kushti (3.5) në teoremë kemi,

$$\begin{aligned} d(u, v) &= d(T_1 u, T_2 v) \leq \alpha \frac{d(v, T_2 v)[1 + d(u, T_1 u)]}{1 + d(u, v)} + \beta d(u, v) \\ &\leq \alpha \frac{d(v, v)[1 + d(u, u)]}{1 + d(u, v)} + \beta d(u, v) \end{aligned}$$

Kështu,

$$d(u, v) \leq \beta d(v, u) \quad (3.6)$$

Në mënyrë të ngjashme kemi

$$d(v, u) \leq \beta d(u, v) \quad (3.7)$$

prej ku $d(u, v) = d(v, u)$, me që $0 < \beta < 1$. Përsëri prej (3.6) dhe (3.7) kemi $d(u, v) = d(v, u) = 0$ dhe rrjedhimisht $u = v$

Kështu pika fikse e përbashkët e T_1 dhe T_2 është e vetme.

Teoremë 3.4 Le të jetë (X, d) një hapësirë e plotë dq-metrike dhe $T_1, T_2 : X \rightarrow X$ dy funksione kontraktive të vazhdueshëm që plotësojnë kushtin

$$d(T_1 x, T_2 y) \leq k [d(x, T_1 x) d(y, T_2 y)]^{\frac{1}{2}} \quad (3.8)$$

për çdo $x, y \in X$, dhe $0 < k < 1$. Atëherë T_1, T_2 kanë një pikë fikse të vetme të përbashkët.

Vërtetim.

Le të jetë $x_0 \in X$, $T_1(x_0) = x_1$, $T_2(x_1) = x_2$, $\dots$, $T_1(x_{2n}) = x_{2n+1}$, $T_2(x_{2n+1}) = x_{2n+2}$, $\dots$.

Për vargun $\{x_n\}$ kemi:

$$\begin{aligned} d(x_{2n+1}, x_{2n+2}) &= d(T_1(x_{2n}), T_2(x_{2n+1})) \leq k^{\frac{1}{2}} d(T_1(x_{2n}), T_2(x_{2n+1})) \\ &\leq k^{\frac{1}{2}} [d(x_{2n}, T_1 x_{2n}) d(x_{2n+1}, T_2 x_{2n+1})]^{\frac{1}{2}} \\ &\leq k^{\frac{1}{2}} [d(x_{2n}, x_{2n+1}) d(x_{2n+1}, x_{2n+2})]^{\frac{1}{2}} \end{aligned}$$

Rrjedhimisht

$$d(x_{2n+1}, x_{2n+2}) \leq k d(x_{2n}, x_{2n+1})$$

Në këtë mënyrë tregojmë që

$$d(x_{2n+1}, x_{2n+2}) \leq k^{2n} d(x_0, x_1)$$

Me që $0 < k < 1$, atëherë $k^{2n} \rightarrow 0$ kur $n \rightarrow \infty$, kështu që vargu $\{x_n\}$ është varg Koshi në hapësirën e plotë kuazi-metrike të dislokuar. Atëherë ekziston një pikë $u \in X$ e tillë që $x_n \rightarrow u$. Po ashtu dhe nënvargjet $\{T_1(x_{2n})\} \rightarrow u$

, $\{T_2(x_{2n+1})\} \rightarrow u$. Me që T_1 dhe T_2 janë të vazhdueshëm, atëherë $T_1(u) = u$, $T_2(u) = u$.

Uniciteti: N.q.s. u është pikë fikse e përbashkët e T_1, T_2 , atëherë nga kushti i dhënë në teoremë kemi

$$d(u, u) = d(T_1 u, T_2 u) \leq k d(u, u)$$

Me që $0 < k < 1$ dhe $d(u, u) \geq 0$, atëherë $d(u, u) = 0$.

Le të jenë $u, v \in X$ pika fikse të përbashkëta të T_1 dhe T_2 . Pra, $T_1 u = u, T_2 u = u$ dhe $T_1 v = v, T_2 v = v$.

Nga kushti (3.8) në teorem kemi,

$$d(u, v) = d(T_1 u, T_2 v) \leq k [d(u, T_1 u) d(v, T_2 v)]^{\frac{1}{2}} \leq k [d(u, u) d(v, v)]^{\frac{1}{2}}$$

Prej ku marrim

$$d(u, v) = d(v, u) = 0 \quad \text{dhe} \quad u = v$$

Pra T_1 dhe T_2 kanë një pikë fikse të vetme të përbashkët.

Rrjedhim 3.5 Le të jetë (X, d) një hapësirë e plotë dq-metrike dhe $T : X \rightarrow X$ një funksion kontraktiv i vazhdueshëm që plotëson kushtin

$$d(Tx, Ty) \leq k [d(x, Tx) d(y, Ty)]^{\frac{1}{2}} \quad (3.9)$$

Për çdo $x, y \in X$ dhe $0 < k < 1$. Atëherë T ka një pikë fikse të vetme.

Konkluzione

1. Me që çdo hapësirë dq-metrike e dislokuar është hapirë d-metrike atëhere teoremat e vërtetuara më sipër qëndrojnë edhe në hapësirat d-metrike.
2. Teorema 3.1. është përgjithsim i teoremës 3.4 në [1] për pikat fikse të përbashkëta. Teorema 3.4 në [1] merret si rast i veçantë i teoremës sonë 3.1 duke marrë $T_1 = T_2$. Po kështu edhe teorema 3.3 në [1] merret si rast i veçantë i rrjedhimit tonë 3.2.
3. Teoremat 3.3. dhe 3.4 janë përgjithsime të rezultateve në [4] për pikat fikse të përbashkëta.
4. Më tej mund të shihet përgjithsimi i këtyre rezultateve duke zbutur kushtet e vazhdueshmërisë së funksioneve apo duke parë ekzistencën e pikave të përbashkëta të një vargu funksionesh në hapësirat dq-metrike.

Bibliografia:

- Aage, C. T. dhe Salunke, J. N. (2008) *The Results on Fixed Points in Dislocated and Dislocated Quasi-Metric Space*, Applied Mathematical Sciences, Vol. 2, no. 59, 2941-2948.
- Dass, B. K. dhe Gupta, S. (1975) *An extension of Banach contraction principle through rational expression*, Indian J. pure appl. Math., 6, 1455-1458.
- Hitzler, P dhe Seda, A. K. (2000) *Dislocated Topologies*, Journal of Electrical Engineering, Vol. 51, no. 12/s, 3-7.
- Isufati, A (2010) *Fixed point theorems in dislocated quasi-metric spaces*, Applied Mathematic Sciences, Vol. 4, no. 5, 217 - 223 .
- Rhoades, B. E (1977) *A comparison of various definitions of contractive mappings*, Trans. Amer. Soc. 226, 257-290.
- Zeyada, F. M. dhe Hassan, G. H. dhe Ahmed M. A. (2005) *A generalization of a fixed point theorem due to Hitzler and Seda in dislocated quasi-metric spaces*, The Arabian Journal for Science and Engineering, Vol. 31, Number 1A, 111-114.

Zbulimi i autokorrelacionit në modelet ekonometrike dhe metodat e vlerësimit të tyre

_____ Raimonda DERVISHI, MSc _____

_____ Prof. Asoc. Dr. Shkëlqim KUKA _____

Abstrakt. *Në ekonomi, pavarësia e një variabli të pavarur nga variablat e tjerë shpjegues është rrallëherë e menjëhershme. Për arsye psikologjike, teknologjike dhe institucionale, një regresant reagon në një regresor me një interval kohe, i cili quhet “lag”. Pjesa e parë e këtij artikulli fokusohet në dy tipe modelesh ekonometrike: në modelin “distributed-lag” dhe në atë “autoregresiv” si edhe vlerësohen modelet e llojit të parë përmes metodës “Koyck”. Punimi është një përpyetje për të racionalizuar modelin “Koyck” në mënyrë që të mund të parashikojmë rezultatet e përdorimit të tij, si edhe të mund të modifikohet ai përmes Modelit Stock. Pjesa e dytë e artikullit përmban një vlerësim të modeleve autoregresive, duke i ilustruar ato përmes shqyrtimit të variablave instrumentale dhe të autokorrelacionit me anë të testit “h Durbin”.*

Fjalë kyçe:

modelet ekonometrike, autokorrelacionet, vlerësimi

Ekonometria dhe dobia e saj

Qysh nga koha kur Quetelet kontribuoi në zhvillimin e metodologjisë ekonomike, veçanërisht të ekonomisë empirike dhe të ekonometrisë, kjo e fundit, e kuptuar literalisht si aplikimi i metodave statistikore dhe matematikore në studimin e të dhënave ekonomike, është bërë një fushë shumë e

rëndësishme studimesh (Dervishi & Tarifa 2011: 33). Edhe pse aspekti matës është një pjesë e rëndësishme e ekonometrisë, fokusi i studimit dhe objekti i ekonometrisë janë më të gjerë, siç mund të shihet edhe nga përkufizimet që i janë dhënë asaj në disa prej teksteve më të rëndësishme të botuara deri më sot. Gerhard Tintner, fjala vjen, në librin e tij *Metodologjia e ekonomisë matematike dhe ekonometria*, e përkufizon ekonometrinë si “aplikimin e statistikës matematike në studimin e të dhënave ekonomike për të mbështetur empirikisht modelet e ndërtuara nga ekonomia matematike dhe për të marrë rezultate numerike” (Tintner 1968: 74; shih gjithashtu Malinvaud 1966: 514). Autorë të tjerë, si laureatët e Çmimit Nobel në ekonomi, P. A. Samuelson, T. C. Koopmans dhe J. R. N. Stone, e përkufizojnë ekonometrinë si “analizën kuantitative të fenomeneve ekonomike, të bazuar në zhvillimin e njëhershëm të teorisë dhe të vëzhgimeve, dhe që ka të bëjë me përdorimin e metodave deduktive të përshtatshme (1954: 141-146). Ka, gjithashtu, autorë që e konsiderojnë ekonometrinë si një “shkencë sociale, në të cilën, teoria ekonomike, matematika dhe deduksionet statistikore aplikohen në analizat e fenomeneve ekonomike” (Goldberger 1964: 1), ose si atë fushë kërkimesh, e cila interesohet për—dhe synon—përcaktimin empirik të shkaqeve dhe të ligjësisve ekonomike” (Theil 1971: 1; Darnell & Evans 1990). Me pak fjalë, ekonometria mund të konsiderohet si një metodë, ose si një fushë studimi, e cila konsiston në aplikimin e metodave statistikore në studimin e fenomeneve ekonomike, pra si një “urë” që lidh teorinë ekonomike me teknikat statistikore (Haavelmo 1944: iii; Gujarati 1995).

Në ekonomi, pavarësia e një variabli — (variabli i pavarur) nga variablat e tjerë X (variablat shpjegues), është rrallëherë e menjëhershme. Zakonisht Y koresponдон me X me një interval kohe, i cili quhet “lag”. Ky punim fokusohet në dy tipe modelesh ekonometrike: në modelin “distributed-lag” dhe në atë “autoregresiv”, duke u synuar kryesisht vlerësimin e modeleve të llojit të parë përmes metodës “Koyck”, të përpunuar nga ekonomisti hollandez Leendert Marinus Koyck (1954a; 1954b). Në të bëhen përpjekje për të racionalizuar modelin “Koyck” në mënyrë që të mund të parashikojmë rezultatet e përdorimit të tij, si edhe të mund të modifikohet ai përmes Modelit Stock. Në pjesën e dytë të artikullit vlerësohen modelet autoregresive, duke i ilustruar ato përmes shqyrtimit të variablave instrumentale dhe të autokorrelacionit me anë të testit “h Durbin”.

Modelet e “Distributed-Lag” dhe modelet Autoregresive

Për arsye psikologjike, teknologjike dhe institucionale, një regresant reagon në një regresor me një interval kohor “lag”. Modelet e regresit që vlerësojnë këtë interval kohor njihen si modele “lagget regression”, ose modele “dinamike ekonometrike”. Ka dy tipe modelesh të tilla: modeli “distributed-lag” dhe ai “autoregresiv”. Modeli i parë përfshin jo vetëm vlerat e tanishme, por dhe vlerat e kaluara (lag) të variablave

shpjegues; ndërsa modeli i dytë përfshin një ose disa vlera “lag” të ndryshorëve të varur midis variablave të tij shpjegues. Këto dy modele mund të paraqiten në formë ekuacioni, përkatësisht, si më poshtë:

$$Y_t = \alpha + \beta_0 X_t + \beta_1 X_{t-1} + \beta_2 X_{t-2} + u_t$$

dhe

$$Y_t = \alpha + \beta X_t + \gamma Y_{t-1} + u_t$$

Në përgjithësi, ekuacioni

$$Y_t = \alpha + \beta_0 X_t + \beta_1 X_{t-1} + \beta_2 X_{t-2} + \dots + \beta_k X_{t-k} + u_t$$

shpreh një model “distributed-lag” me lag të fundëm k periudhash kohore.

Koeficienti β_0 quhet shumëzues “afatshkurtër” (*short-run*) pasi ai jep ndryshim në vlerën kryesore të Y duke dhënë, në të njëjtën periudhë kohore, një ndryshim në X. Nëqoftëse ndryshimi në X është i vazhdueshëm në të njëjtin nivel, atëherë $(\beta_0 + \beta_1)$ jep ndryshim në vlerën kryesore Y në periudhën tjetër, ndërsa $(\beta_0 + \beta_1 + \beta_2)$ në periudhën pasardhëse, e kështu me radhë.

Pas k periudhash, fitojmë ekuacionin e mëposhtëm, i cili quhet shumëzuesi “afatgjatë” (*long-run*):

$$\sum_{i=0}^k \beta_i = \beta_0 + \beta_1 + \beta_2 + \dots + \beta_k = \beta$$

Nëqoftëse:

$$\beta_i^* = \frac{\beta_i}{\sum \beta_i} = \frac{\beta_i}{\beta}$$

atëherë përftojme standartizimin e β_i . Shumat e pjesshme të shumëzuesit “afatgjatë”, ose totali tyre, ndikojnë për një periudhë kohore të caktuar.


Për të ilustruar natyrën dhe rëndësinë e intervalit kohor “lag” mund të trajtojmë si shembull funksionin e konsumit. Supozojmë që një individ merr një shtesë vjetore page prej 2000 USD dhe se paga e tij rritet në mënyrë të vazhdueshme. Pas kësaj shqyrtojmë efektet që do ketë kjo rritje e të ardhurave të këtij individ në shpenzimet e tij vjetore përgjatë një periudhe tre-vjeçare. Nëse supozojmë se, për shkak të rritjes së pages, ai vendos t’i rrisë shpenzimet në masën 800 USD gjatë vitit të parë, 600 USD mbi këtë shumë gjatë vitit të dytë dhe 400 USD më shumë akoma në vitin e tretë, shpenzimet vjetore të këtij individ në fund të vitit të tretë do të jenë 1800 USD më shumë se ato të tre vjetëve më parë. Për këto të ardhura funksioni i konsumit mund të shprehet si më poshtë:

$$Y_t = \text{const} + 0.4X_t + 0.3X_{t-1} + 0.2X_{t-2} + u_t$$

ku Y përfaqëson shumën e konsumuar, ndërsa X të ardhurat.

Modeli i mësipërm është një model “distributed-lag” pasi të ardhurat janë

shpërndarë përgjatë një numri intervalesh kohore. Gjeometrikisht, ky model mund të paraqitet në figurën e mëposhme:



Në këtë shembull, shohim se shumëzuesi “afatshkurtër” është zero, por ndërsa shumëzuesi “afatshkurtër” minimal është 0.4, shumëzuesi “afatgjatë”, i cili është edhe shumëzuesi “afatgjatë” minimal është $0.4 + 0.3 + 0.2 = 0.9$.

Prej këtij rrjedh se, për 1 USD rritje të të ardhurave, konsumatori do të rrisë nivelin e konsumit me 40 cent gjatë vitit të parë, me 30 cent gjatë vitit të dytë dhe me 20 cent të tjera në vitin e tretë. Shumëzuesi “afatgjatë” ndikon në rritjen për 1 USD të të ardhurave me 90 cent. Nëqoftëse pjestojmë çdo β_i me 0.9, marim, përkatësisht, 0.44, 0.33 dhe 0.23, çka tregon se 44 për qind e totalit që ndikon në ndryshimin e X në Y ndjehet menjëherë, 77 përqind mbas një viti dhe 100 përqind në fund të vitit të dytë.

Vlerësimi i modeleve “Distributed-Lag”

Për nga rëndësia që kanë modelët “distributed-lag” në ekonomi, përbën interes të vlerësohen koeficientët e tyre.

Vlerësimi ad hoc i modeleve “distributed-lag”

Meqë ndryshorja shpjeguese X_t është pranuar të jetë jo stokastike (ose të paktën e palidhur me mbetjen u_t), edhe X_{t-1} , X_{t-2} , e kështu me radhë, janë, gjithashtu, jo stokastikë. Rrjedhimisht, në këto lloj modelesh nuk mund të përdoret Metoda e Katrorëve më të Vegjël (*Least Squares Method*, ketej e tutje MKV). Në vend të saj, Alt (1942) dhe Tinbergen (1949) kanë propozuar metodën “Ad Hoc”, duke sugjeruar se për të vlerësuar modelët “distributed-lag”, mund të procedohet në mënyrë të vazhdueshme, domethënë fillimisht në regresin e Y_t me X_t , pastaj Y_t me X_t dhe X_{t-1} , më tej Y_t me X_t , X_{t-1} dhe X_{t-2} , e kështu me radhë (shih, gjithashtu, Klein 1958; Liviatan 1963; Bauer, Mundy & Sappington 1978). Kjo procedurë e njëpasnjëshme mbaron kur koeficientët e regresit të variablave “lag” fillojnë të bëhen statistikisht të rëndësishëm dhe/ose kur koeficienti fundit i variablit ndryshon shenjë nga pozitiv në negativ, ose ndryshe.


Metoda Koyck për modelet distributed-lag

Nëse për modelin “distributed-lag” të pafundëm pranojmë se të gjitha β janë me shenjë të njëjtë, Koyck (1954b) provoi se ato pësojnë një zvoglim (rënie) gjeometrike si më poshtë:

$$\beta_k = \beta_0 \lambda^k \quad k = 0, 1, \dots$$

ku λ është e tillë që $0 < \lambda < 1$, dhe quhet koeficient i zvoglimit (ose i rënies).

Çdo koeficient β pauses është më i vogël se çdo β i mëparshëm (sepse $\lambda < 1$). Kjo do të thotë se nëse kthehemi pas në një interval kohor të mëparshëm, përfundimi i këtij “lag”-u në Y_t zvogëlohet progresivisht. Gjeometrikisht, skema “Koyck” paraqitet si më poshtë:



Metoda “Koyck” ka këto veçori: (1) Për vlera jo negative të λ , β -të nuk ndryshojnë shenjë; (2) Për $\lambda < 1$ largesa e β merr pak peshë; (3) Shuma e β që jep shumëzuesin “afatgjatë” është e fundme (shih Morrison 1970; Franses & van Oest 2007).

$$\sum_{k=0}^{\infty} \beta_k = \beta_0 (1 + \lambda + \lambda^2 + \lambda^3 + \dots) = \beta_0 \left(\frac{1}{1 - \lambda} \right)$$

Kështu, me zëvendësimin e β -ve në modelin “distributed-lag” me “lag” të pafundëm, ai merr trajtën:

$$Y_t = \alpha + \beta_0 X_t + \beta_0 \lambda X_{t-1} + \beta_0 \lambda^2 X_{t-2} + \dots + u_t$$

Ky model nuk është i thjeshtë për t’u vlerësuar sepse ai vazhdon të ketë një numër të madh parametrash, si edhe për shkak se parametri λ që futet në model nuk është linear. Metoda lineare e analizës së regresit nuk aplikohet në modele të tilla, por Koyck (1954a; 1954b) vuri në dukje dallimin e këtij modeli nga modeli i një intervali kohor të mëpasëm, të shumëzuar me λ , duke përfutur në këtë mënyrë modelin që vijon:

$$Y_t - \lambda Y_{t-1} = \alpha(1 - \lambda) + \beta_0 X_t + (u_t - \lambda u_{t-1})$$

Ose :

$$Y_t = \alpha(1 - \lambda) + \beta_0 X_t + \lambda Y_{t-1} + v_t$$

$$\text{ku } v_t = (u_t - \lambda u_{t-1})$$

Këto dy modele njihen si “transformimet Koyck” (shih Franses & van Oest 2007).

Nga sa u parashtrua më sipër, mbeten për tu vlerësuar vetëm tre të panjohura: α , β_0 , λ . Sidoqoftë, për shkak se multikolineariteti u zgjidh, në një farë mënyre, duke zëvendësuar X_{t-1} , X_{t-2} , ... me një variabël të vetëm, Y_{t-1} , nuk ka arsye të parashikojmë multikolinearitetin.

“Transformimet Koyck” kanë këto veti:

(1)Ndërsa në shembullin e dhënë më sipër filluam me një model “distributed-lag”, përfunduam me një model “autoregresiv” sepse Y_{t-1} shfaqet si një variabël shpjegues. Ky transformim tregon njëkohësisht se si mund një model “distributed-lag” mund të kthehet në një model “autoregresiv” (shih Fuller & Martin 1961; Malinvaud 1961; Hannan 1965).

(2)Shfaqja Y_{t-1} krijon disa probleme statistikore. Y_{t-1} si Y_t është stokastik, pra kemi një variabël shpjegues stokastik në model. Kujtojmë se MKV mbështetet në supozimin se variablat shpjegues janë jo stokastik, ose, nëqoftëse ata janë stokastik, kanë gabime të pavarura. Prej kësaj rrjedh se nevojitet të zbulojmë nëse Y_{t-1} kënaq këtë supozim (Dhrymes, Klein & Steiglitz 1970).

(3)Në modelin fillestar, termi i gabimit është u_t , ndërsa në modelin e transformuar është $v_t = u_t - \lambda u_{t-1}$. Siç do e shohim më vonë, vetitë statistikore të v_t varen nga supozimet që do bëjmë rreth vetive statistikore të u_t ; nëqoftëse u_t janë të pakorreluara, v_t janë të korreluara. Për më tepër, do nxjerrim problemin e korrelacionit në variablin shpjegues Y_{t-1} (Jorgenson 1966; Amemiya & Fuller 1967).

(4)Prezenca e lagut Y çënon një nga supozimet themelore të statistikës “d Durbin-Watson”.

Siç vumë re më lart, shumat e pjesshme të standartizuara të β_1 tregojnë një pjesë të shumëzuesit “afatgjatë”, ose totalin. Gjithashtu, për të karakterizuar natyrën e “lag”-ut në një model “distributed-lag” përdoret koncepti “mean lag”, i cili shërben si një masë për shpejtesinë me të cilën Y reagon ndaj X dhe përkufizohet si më poshtë:

$$\text{Mean Lag} = \frac{\sum_{k=0}^{\infty} k\beta_k}{\sum_{k=0}^{\infty} \beta_k}$$

Për modelin “Koyck” ai është:

$$\text{MeanLag} = \frac{\lambda}{1 - \lambda}$$

Një racionalizim i modelit “Koyck”: Modeli “Stock Adjustment”

Modeli “Koyck” është një model *ad hoc*, sepse u përftua nga një proces algjebrik, të cilit i mungon një arsyetim teorik. Kjo mangësi mund të plotësohet nëqoftëse veprojmë ndryshe. Le të marrim modelin e mëposhtëm:

$$Y_t^* = \beta_0 + \beta_1 X_t + u_t$$

Supozojmë se kapitali Y_t^* është funksion linear i prodhimit X . Meqë kapitali nuk është direkt i dallueshëm, Nerlove (1958a; 1958b) postuloi hipotezat e mëposhtme të quajtura hipotezat “stock adjustment”:

$$Y_t - Y_{t-1} = \delta(Y_t^* - Y_{t-1})$$

ku δ është e tillë që $0 < \delta \leq 1$, dhe quhet koeficient parashikues; $Y_t - Y_{t-1}$ është ndryshimi aktual, ndërsa $Y_t^* - Y_{t-1}$ është ndryshimi dëshiruar.

Hipotezat “stock adjustment” tregojnë se ndryshimi aktual i investimeve në një periudhë kohore t është prodhim i δ me ndryshimin e dëshiruar për atë periudhë. Në qoftë se $\delta=1$, gjendja e tanishme e kapitalit është e barabartë me gjendjen e dëshiruar. Me fjalë të tjera, gjendja aktuale përshtatet menjëherë, në të njëjtën periudhë kohe, me gjendjen e dëshiruar; në qoftë se $\delta=0$, kjo do të thotë se nuk kemi asnjë ndryshim, përderisa gjendja aktuale në kohën t është e njëjtë me kursimin gjatë kohës së mëparshme.

Meqë $Y_t - Y_{t-1}$ tregon ndryshimin në kapitalin rezervë ndërmjet dy intervaleve kohorë, atëherë barazimi i mësipërm shprehet në trajtën e mëposhtme:

$$I_t = \delta(Y_t^* - Y_{t-1})$$


ku I_t është investimi në intervalin kohor t , ose në trajtën:

$$Y_t = \delta Y_t^* + (1 - \delta) \cdot Y_{t-1}$$

Duke zëvendësuar modelin e parë me të fundit, përftohet:

$$Y_t = \delta\beta_0 + \delta\beta_1 X_t + (1 - \delta)Y_{t-1} + \delta u_t$$

Ky model quhet modeli “Stock adjustment”. Meqënëse modeli i parë riprezanton një perspektivë afatgjatë për kapitalin “stock”, ky i fundit mund të quhet funksioni “afatshkurtër” për këtë kapital, për shkak se në një perspektivë afatshkurtër, gjendja ekzistuese e kapitalit mund të mos jetë e barabartë në perspektivën afatgjatë të tij, arsye kjo, për shkak të së cilës, morëm vlerësimin e koeficientit parashikues δ (nga koeficientët e Y_{t-1}). Prej kësaj shumë thjesht mund të përftojme funksionin “afatgjatë”, duke veçuar $\delta\beta_0$ dhe $\delta\beta_1$ nga δ , si edhe duke lënë mënjëanë termat “lag” të Y , që pastaj vlerësojnë modelin fillestar. Gjeometrikisht, modeli “stock adjustment” paraqitet si më poshtë:



Në figurën e mësipërme, Y^* është gjendja e dëshiruar e kapitalit, ndërsa Y_1 përfaqëson gjendjen aktuale të tij. Për ilustrim, supozojmë se $\delta=0.5$, çka do të thotë se firma planifikon të mbyllë, në çdo periudhë, gjysmën e boshllëkut midis gjendjes së kapitalit aktual dhe gjendjes së kapitalit të dëshiruar. Kështu, në periudhën e parë, ajo lëviz tek Y_2 , duke investuar $(Y_2 - Y_1)$, që në kthim është e barabartë me gjysmën e vlerës $(Y^* - Y_1)$. Në çdo periudhë që pason periudhën e parë, firma mbyll gjysmën e boshllëkut ndërmjet gjendjes së kapitalit në fillim të periudhës dhe gjendjes së dëshiruar të kapitalit Y^* .

Vlerësimi i modeleve autoregresive dhe zbulimi i autokorrelacionit

Modeli “Stock adjustment” është i ngjashëm me modelin “Koyck”. Të dy këta modele kanë të njëjtën trajtë, pasi janë modele autoregresive dhe, si të tilla, paraqiten si më poshtë:

$$Y_t = \alpha_0 + \alpha_1 X_t + \alpha_2 Y_{t-1} + v_t$$

Siç vumë në dukje më sipër, MKV nuk aplikohet mbi modele të tilla për shkak të variablove stokastik shpjegues dhe të mundësisë së korrelacionit. Pos si mund t’i vlerësojmë këto modele? Për të aplikuar MKV duhet treguar se variabli stokastik shpjegues Y_{t-1} ka shpërndarje të pavarur me termin e gabimit v_t . Për të përcaktuar nëse ai është i tillë ose jo, duhet të njohim vetitë e v_t . Nëqoftëse supozojmë se termat fillestare të gabimit u_t gëzojnë të gjitha supozimet klasike, mund të konkludojmë se $E(u_t)=0$, $\text{var}(u_t)=\delta^2$ (supozimi i homoskedasticitetit) dhe $\text{cov}(u_t, u_{t+s})=0$ për $s \neq 0$ (supozimi për autokorrelacionin), por v_t mund të mos i gëzojë të gjitha këto veti. Për shembull, termi gabimit në modelin “Koyck” është $v_t = u_t - \lambda u_{t-1}$. Duke bërë supozimet e mësipërme për u_t , tregohet se v_t është e korreluar sepse:

$$\begin{aligned} E(v_t v_{t-1}) &= E[(u_t - \lambda u_{t-1}) \cdot (u_{t-1} - \lambda u_{t-2})] \\ &= -\lambda E(u_{t-1})^2 \\ &= -\lambda \delta^2 \end{aligned}$$

është e ndryshme nga zero (sepse λ tenton në zero). Meqë Y_{t-1} shfaqet në modelin “Koyck” si një ndryshore shpjeguese, duhet të korrelohet me v_t (për shkak të prezencës së u_{t-1} në të). Kjo do të thotë, njëkohësisht se:

$$\text{cov}[Y_{t-1}, (u_t - \lambda u_{t-1})] = -\lambda \sigma^2$$

që është e njëjtë me barazimin e mësipërm.

Në modelin “Stock adjustment” $v_t = \delta u_t$, ku $0 < \delta \leq 1$. Nëqoftëse u_t kënaq supozimin e modelit të regresit linear klasik të dhënë më parë, e njëjta gjë mund të thuhet edhe për δu_t . Kështu, MKV në modelin “Stock adjustment” do japë vlerësues konsekuent. Arsyeja e Konsekuencës është se, megjithëse Y_{t-1} varet nga u_{t-1} dhe nga të gjithë termat e mëparshëm të gabimit, Y_{t-1} nuk ka lidhje me termin e tanishëm u_t të gabimit. Si rrjedhim, u_t është e pavarur, Y_{t-1} bëhet gjithashtu e pavarur, ose të paktën e korreluar me u_t , duke kënaqur në këtë mënyrë një supozim të rëndësishëm të metodës MKV, që quhet jokorrelacion midis ndryshores shpjeguese dhe termit stokastik të gabimit.

Në përfundim, mund të themi se edhe pse modeli “Stock adjustment” është i ngjashëm me modelin “Koyck”, ai ka më shumë terma gabimi se ky i fundit.

Metoda variablove instrumentale

Arsyeja që MKV nuk mund të aplikohet në modelin Koyck është se variabli shpjegues Y_{t-1} tenton të korrelohet me termin e gabimit v_t . Nëqoftëse një nga këto korrelime mund të lëvizë, atëherë aplikojmë MKV për të siguruar vlerësues konsekuentë, siç është shënuar më parë. Në rast të kundërt, aplikojmë zgjidhjen e propozuar nga Liviatan (1963). Supozojmë se gjendet një variabël *proksi* për Y_{t-1} , i cili është i korreluar me Y_{t-1} , por që nuk është i korreluar me v_t , ku v_t është termi gabimit që shfaqet në modelin “Koyck”. Kështu një variabël *proksi* është quajtur variabël instrumentale dhe X_{t-1} sugjerohet si një variabël instrumentale për Y_{t-1} , ndersa parametrat e modelit autoregresiv fitohen duke zgjidhur ekuacionet normale:

Nëqoftëse aplikojmë MKV në barazimet e mësipërme, ekuacionet normale do të ishin:

$$\begin{aligned}\sum Y_t &= n\hat{\alpha}_0 + \hat{\alpha}_1 \sum X_t + \hat{\alpha}_2 \sum Y_{t-1} \\ \sum Y_t X_t &= \hat{\alpha}_0 \sum X_t + \hat{\alpha}_1 \sum X_t^2 + \hat{\alpha}_2 \sum Y_{t-1} X_t \\ \sum Y_t X_{t-1} &= \hat{\alpha}_0 \sum X_{t-1} + \hat{\alpha}_1 \sum X_t X_{t-1} + \hat{\alpha}_2 \sum Y_{t-1} X_{t-1}\end{aligned}$$

Vlerësuesit α të llogaritur nga barazimi i parë janë të qëndrueshëm, kurse vlerësuesit e tyre nga barazimi i dytë mund të mos jenë të tillë, sepse Y_{t-1} dhe v_t mund të jenë të korreluara, kurse X_t dhe X_{t-1} janë të pakorreluara me v_t . Kjo teknike është e ngjashme me procesin e multikolinearitetit, sepse X_t dhe X_{t-1} që futen në ekuacionet

$$\begin{aligned}\sum Y_t &= n\hat{\alpha}_0 + \hat{\alpha}_1 \sum X_t + \hat{\alpha}_2 \sum Y_{t-1} \\ \sum Y_t X_t &= \hat{\alpha}_0 \sum X_t + \hat{\alpha}_1 \sum X_t^2 + \hat{\alpha}_2 \sum Y_{t-1} X_t \\ \sum Y_t Y_{t-1} &= \hat{\alpha}_0 \sum Y_{t-1} + \hat{\alpha}_1 \sum X_t Y_{t-1} + \hat{\alpha}_2 \sum Y_{t-1}^2\end{aligned}$$

normale mund të ndodhë që të jenë të korreluara.

Zbulimi i autokorrelacionit në modelet autoregressive: Testi “h Durbin”

Siç vumë në dukje më sipër, korrelacioni në gabimet v_t e bëjnë më kompleks problemin e vlerësimit në modelin autoregresiv. Në modelet “Stock adjustment” termi i gabimit v_t nuk është i korreluar në qoftë se termi i gabimit u_t në modelin fillestar është i pakorrelueshëm, kurse në modelet Koyck v_t është i korreluar vetëm në qoftë se u_t është i pavarur. Zbulimi i korrelacionit në modelet autoregressive bëhet më i rëndësishëm.

Statistika “d Durbin-Watson” nuk përdoret për të parë korrelacionin në modelet autoregressive, sepse vlera d , e njehsuar në disa modele, zakonisht tenton drejt 2, çka është një vlerë që parashikohet në një ndryshore të vazhdueshme. Gjithsesi, vetë Durbin (1970) propozoi një test për zbulimin e korrelacionit në modelet autoregressive të quajtur “statistika h” “h statistic”, i cili shprehet si më poshtë:

$$h = \hat{\rho} \sqrt{\frac{n}{1 - n[\text{var}(\hat{\alpha}_2)]}}$$

ku n është përmasa modelit, $\text{var}(\hat{\alpha}_2)$ është varianca e koeficientit lag Y_{t-1} , ndërsa është vlerësuesi i korelacionit ρ . Nëqoftëse $\rho=0$, Durbin (1970) ka treguar se “statistika h” ka shpërndarje normale standarde, me pritje matematike zero dhe variancë një. Dimë që p përafrohet nga llogaritja e mëposhtme:

$$\hat{\rho} = 1 - \frac{1}{2}d$$

ku d është statistika e zakonshme Durbin-Watson. Kështu:

$$h = (1 - \frac{1}{2}d) \sqrt{\frac{n}{1 - n[\text{var}(\hat{\alpha}_2)]}}$$

Hapat që ndërmerren për të aplikuar “statistikën h” janë si më poshtë:

- (1) Vlerësojmë modelin autoregresiv me MKV
- (2) Gjejmë $\text{var}(\hat{\alpha}_2)$
- (3) Llogarisim $\hat{\rho}$
- (4) Llogarisim h

(5) Për n mjaft të mëdha $h \sim AN(0,1)$.

Nga shpërndarja normale, dimë se: $P(-1.96 \leq h \leq 1.96) = 0.95$. Rrjedhimisht, rregulli I vendim-marrjes është se:

- a) n.q.s $h > 1.96$, refuzohet hipoteza bazë se nuk ekziston autokorrelacion pozitiv;
- b) n.q.s $h < -1.96$, refuzohet hipoteza bazë se nuk ekziston autokorrelacion negativ;
- c) n.q.s h ndodhet ndërmjet -1.96 dhe 1.96 , pranohet hipoteza bazë se nuk ekziston as autokorrelacion pozitiv dhe as autokorrelacion negativ.

Supozojme se duke bërë 100 vëzhgime, u gjet $d=1.9$ dhe $\widehat{\text{var}(\alpha_2)}$. Rrjedhimisht del që $h=0.7071$. Me nivel sigurie 5%, pranojmë hipotezën se në këtë rast nuk ekziston autokorrelacion pozitiv.

Në përfundim, vëmë në dukje këto veti të statistikës h :

- (1) Nuk ka rëndësi sa shumë variabla X ose sa shumë vlera “lag” të Y janë të përfshira në model. Për të llogaritur h , nevojitet vetëm varianca e koeficientit lag Y_{t-1} .
- (2) Testi nuk është i aplikueshëm nëqoftëse $[n \widehat{\text{var}(\alpha_2)}]$ kalon 1.
- (3) Aplikimi i testit me përmasa të vogla është pak i përdorshëm.

Bibliografia

- Alt, F.F. 1942. “Distributed Lags”, *Econometrica*, Vol. 10, ff. 113-128.
- Amemiya, Takeshi & Wayne A. Fuller. 1967. “A Comparative Study of Alternative Estimators in a Distributed Lag Model”, *Econometrica*, Vol. 35, No. 3/4, ff. 509-529.
- Bauer, Larry L., S. Darrell Mundy & Charles B. Sappington. 1978. “Relative Sensitivity of Selected Distributed Lag Estimators to Measurement and Specification Error”, *Southern Journal of Agricultural Economic* (December), ff. 125-131.
- Darnell, Adrian C. & J. Lynne Evans. 1990. *The Limits of Econometrics*. Hants, UK: Edward Elgar Publishing.
- Dervishi, Raimonda & Fatos Tarifa. 2011. “Statistika në shkencat sociale dhe sociologjia matematike”, *Economicus*, No. 6, ff. 29-44.
- Dhrymes, Phoebus J., Lawrence R. Klein & Kenneth Steiglitz. 1970. “Estimation of Distributed Lags”, *International Economic Review*, Vol. 11, No. 2, ff. 235-250.
- Durbin, J. 1970, “Testing for Serial Correlation in Least-Squares Regression When Some of the Regressors are Lagged Dependent Variables”, *Econometrica*, Vol. 38, ff. 410-421.
- Franses, Philip Hans & Rutger van Oest. 2007. “On the Econometrics of the Koyck Model”, *Econometric Institute Report 2004-07*. Rotterdam: Econometric Institute, Erasmus University.

- Fuller, Wayne A. & James E. Martin. 1961. "The Effects of Autocorrelated Errors on the Statistical Estimation of Distributed Lag Models", *Journal of Farm Economics*, Vol. 43, No. 1, ff. 71-82.
- Goldberger, Arthur S. 1964. *Econometric Theory*. New York: John Wiley & Sons.
- Gujarati, Damodar N. 1995. *Basic Econometrics*. Third Edition. New York: McGraw-Hill.
- Haavelmo, Trygve. 1944. "The Probability Approach in Econometrics", Supplement to *Econometrica*, Vol. 12, ff. iii-vi + 1-115.
- Hannan, E. J. 1965. "The Estimation of Relationships Involving Distributed Lags", *Econometrica*, Vol. 33, No. 1, ff. 206-224.
- Jorgenson, Dale W. 1966. "Rational Distributed Lag Functions", *Econometrica*, Vol. 34, No. 1, ff. 135-149.
- Klein, L. R. 1958. "The Estimation of Distributed Lags", *Econometrica*, Vol. 26, No. 4, ff. 553-565.
- Koyck, Leendert Marinus. 1954a. *An Econometric Study on the Timeshape of Economic Reactions with an Application to Investment Behaviour*. Amsterdam: North Holland Publishing Company.
- Koyck, Leendert Marinus. 1954b. *Distributed Lags and Investment Analysis*. Amsterdam: North Holland Publishing Company.
- Liviatan, Nissan. 1963. "Consistent Estimation of Distributed Lags", *International Economic Review*, Vol. 4, No. 1, ff. 44-52.
- Malinvaud, E. 1961. "The Estimation of Distributed Lags: A Comment", *Econometrica*, Vol. 29, No. 3, ff. 430-433.
- Malinvaud, E. 1966. *Statistical Methods of Econometrics*. Chicago, IL: Rand McNally.
- Morrison, J. Lawton, Jr. 1970. "Small Sample Properties of Selected Distributed Lag Estimators", *International Economic Review*, Vol. 11, No. 1, ff. 13-23.
- Nerlove, Marc. 1958a. *Distributed Lags and Demand Analysis for Agricultural and Other Commodities*. Agricultural Handbook No. 141. Washington, D.C.: U.S. Dept. of Agriculture.
- Nerlove, Marc. 1958b. "Distributed Lags and Estimation of Long-Run Supply and Demand Elasticities: Theoretical Considerations", *Journal of Farm Economics*, Vol. 40, No. 2, ff. 301-311.
- Samuelson, Paul A., Tjalling C. Koopmans & John R.N. Stone. 1954. "Report of the Evaluative Committee for *Econometrica*", *Econometrica*, Vol. 22, No. 2, ff. 141-146.
- Theil, Henry. 1971. *Principles of Econometrics*. New York: John Wiley & Sons.
- Tinberger, J. 1949. "Long-Term Foreign Trade Elasticities", *Metroeconomica*, vol.1, ff. 174-185.
- Tintner, Gerhard. 1968. *Methodology of Mathematical Economics and Econometrics*. Chicago, IL: The University of Chicago Press.

Hipoteza e Porterit dhe Politika Mjedisore: Rishikimi i literaturës mbi ekonomiksin e mjedisit dhe paradigmën

Matilda TOLA

Abstrakt. “...Dreka jonë nuk vjen si pasojë e dashamirësisë së kasapit, të bukëpjekësit apo të prodhuesit të birrës. Është vëmendja ndaj interesit të tyre personal, forca që realizon çdo gjë. Ne i drejtohem jo humanizmit të tyre por dashurisë që ata kanë për veten, dhe kurrë s’u flasim për nevojat që kemi ne por për përfitimet që do të kenë ata”.

(Adam Smith, Pasuria e Kombeve)

Kur Adam Smith fliste për interesin personal që rregullonte tregjet, I referohej egos si forca që e con ekonominë në Pareto eficientë dhe pikërisht realizimin e interesit personal si faktorin që sjell ndryshimin dhe inovacionin. Megjithatë realiteti ekonomik nuk paraqitet kaq rozë. Është pikërisht ndjekja kaq e ngushtë e interesit personal të vendeve, të firmave dhe deri të individëve, të sjelljes abusive ndaj burimeve natyrore dhe ndaj njëri tjetrit që sot na vendos përpara një prej sfidave më të mëdha të njerëzimit si ngrohja globale.

Të ndryshojmë stilin e jetesës për t’iu përshtatur mjedisit do të thotë kufizime në konsum dhe reduktim i mirëqënies në afatgjatë për individin, dhe për korporatat shumë kombëshe (sidomos për ato në sektorët ndotës të mjedisit) fitime të reduktuara. Kuadri rregullator ekziston, por mesa duket nuk është mjaftueshëm efektiv dhe preferencat e korporatave janë më të përfaqësuara se ato të komunitetit, për shkak të lobingut të fuqishëm që ato ushtrojnë (Rasti i projektligjit për Clean Air). Në rastet e tilla duket sikur jemi shumë të vegjël përpara fuqisë financiare që mund të blejë çdo qeveri duke dëmtuar mjedisin ku jetojmë të gjithë. Megjithatë, ndonjëherë ligjet mjedisore më të ashpër mundet t’i motivojnë korporatat të kërkojnë avantazhe të reja konkurruese në treg duke krijuara situata ëm-ëm; është pikërisht kjo hipotezë që ngriti M. Porter, në vitin 1995 e cila shkaktoi ndoshta debatin më të madh në ekonomiksin politik të mjedisit.

Në këtë artikull do të diskutojmë argumentat që e shtynë Porterin të ngrinte një hipotezë të tillë, argumentat pro dhe kundër, provat empirike nga studimet e deritanishme dhe ndikimet e mundshme në hartimin e politikave për mbrojtjen e mjedisit.

Fjalë kyçe:

politika mjedisore, hipoteza e Porterit, ekonomiksi i mjedisit,

Hipoteza e Porterit

Në vitin 1995 Michael E. Porter dhe Claas van der Linde publikuan një artikull i cili shkaktoi reagime të fuqishme mes akademikëve; ku arsyetoni se ligjet më të ashpra mjedisore mundet të rrisin konkurrueshmërinë mes firmave në nivel ndërkombëtar. Kjo hipotezë, e bazuar në raste empirike studimi, nuk ishte metodologjia klasike e përdorur në punimet ekonomike, si analiza kosto marxhinale vs përfitime sociale, por fokusohej në kostot e përshtatjes që rëndonin mbi këto firma.

Ajo që i shtyu autorët të bënin një pohim të tillë ishte se debati mbi mjedisin dhe konkurrueshmërinë ishte parë në një këndvështrim statik të ekonomisë, mjedisit dhe kuadrit rregullator. Porter sugjeronte që në vend që ta shikoni gjithshka si statike, le të fokusohemi në paradigmen e konkurrencës dinamike ku vendimet bazohen mbi inovacionin dhe jo mbi produktivitetin. Nëse kuadri rregullator hartohet sic duhet, mund ti motivojë firmat të kërkojnë mundesi të përmirësimit teknologjik të cilat mbase mund të ishin anashkaluar në prani të një kuadri rregullator më të butë. Ai argumenton që kostot e përshtatjes mund të rikuperohen pjesërisht ose plotësisht nga përfitimet që sjell inovacioni duke i dhënë atyre një avantazh ekonomik absolut në tregjet ndërkombëtare, duke u bërë kështu më konkurruese.

Kritika më e zakonshme që i bëhet kësaj hipoteze është se ai ofron një *vakt falas*, dhe ekonomistët nuk besojnë në ngjarje të tilla. Është shembulli i klasik që pse nuk mund të gjejmë një kartëmonedhë \$10 në rrugë? Sepse dikush tjetër para nesh e ka marrë. Megjithatë sipas Porterit, ky është një argument shume statik dhe jo realist pasi presupozon që firmat marrin vendime optimale¹. Por duke qenë se realiteti është shumë larg të qenit perfekt, atëherë kemi një mori kartëmonedha \$10 të cilat po presin që të mblidhen nga kompanitë.

Kjo hipotezë na con në një sugjerim shumë delikat në ekonomiksin e mjedisit, që nëse arrijmë të ndërtojmë mjete të tipit urdhërues/kontrollues efektive, ato mund të jenë superiore ndaj metodave të tregut për të internalizuar eksternalitetet negative të veprimtarisë ekonomike. Megjithatë, cfarë nënkuptonte Porter me kuadër rregullator të hartuar sic duhet. *Së pari*, këto ligje duhet të ofrojnë hapësirë maksimale për inovacion, pasi mënyra se si do t'i përshtaten ligjit u takon firmave dhe jo agjensive shtetërore. *Së dyti*, këto ligje duhet të promovojnë inovacionin dhe jo të kapen pas një teknologjie të caktuar. *Së treti*, procesi rregullator duhet të lërë sa më pak pasiguri në cdo hap të zbatimit të tij.

¹ Ideja është të firmat nuk marrin vendime racionale sidomos në afatgjatë, dhe ligjet më të ashpra do t'i shtyjnë ato të zgjedhin projektet që kanë IRR më të lartë se kostot totale oportune të kapitalit, duke internalizuar në këtë mënyrë eksternalitetet negative.

Kritikat mbi Hipotezën e Porterit

Është e kuptueshme që një perspektivë kaq e guximshme që quante metodologjinë ekonomike të përdorur deri tani si “te vjetëruar” do të përballej me reagime edhe më të ashpra nga ekonomistët e tjerë të cilët i kanë quajtuar metodat rregullatore si jo efektive dhe që nuk reflektojnë preferencat për mirëqënien sociale.

Mbase kritikët më të ashpër kanë qenë Palmer, Oates dhe Portney. Në artikullin e tyre të botuar po atë vit, ata argumentojnë që hipoteza nuk merr në konsideratë përfitimet sociale që vijnë nga ligje të tilla.

Porter dhe van der Linde i nxorren këto konkluzione nga raste studimi të kompanive subjekt i ligjeve mbi mjedisin. Por ata nuk përmendin që qindra mijëra kompani kanë shkuar pothuajse në prag të falimentimit prej tyre. Rastet e firmave të suksesshme, konsideruar masën e provës, nuk mund të përdoren absolutisht për të përgjithësuar përfundime të tilla.

Ligjet më të ashpra mjedisore do të rrisin inovacionin dhe produktiviteti më i lartë do të rikuperojë kostot e rritura. Megjithatë Porter pret që firmat do t’u rezistojnë këtyre vështirësive në afatshkurtër në këmbin të avantazheve ekonomike që do të përfitojnë në afatgjatë. Fakti që kompanitë amerikane po humbasin treg përkundëjt atyre europiane, të cilat janë subjekt i ligjeve mjedisore më të lehta, bie ndesh me përfundimin e Porterit.

Ekonomiksi politik i mjedisit

Duke qënë se një supozim i rëndësishëm në Hipotezën e Porterit ishin ligjet mjedisore të hartuara në mënyrë të përshtatshme, le t’i hedhin një sy procesit politik rezultat i të cilit ato janë dhe faktoreve që ndikojnë mbi të. Le të fillojme me faktorët kryesore:

Renditja në prioritetet publike – në vendet ku ndërgjegjësimi i publikut është i lartë presioni për ligje më të forta mjedisore është më i fuqishëm, duke i bërë ato më përfaqësuese në preferencat e komunitetit. Sipas disa anketimeve të realizuara nga kompani si GALLUP and PAW, ndërgjegjësimi i individëve për problemet mjedisore është akoma i ulët. Mbase kjo për faktin që mbrojtja e mjedisit konsiderohet mall luksi. Në vendet e zhvillura firmat priren të operojnë sipas parimit të legjitimitetit ndërsa vendet në zhvillim janë të prirura drejt rritjes së produktivitetit sesa drejt frenimit të ekonomisë nëpërmjet ligjeve të tilla.

Stabiliteti politik dhe korrupsioni – Përcakton përpjekjet e lobingut që zhvillohen nga grupe të caktuara interesi. Grupet e interesit mund të influencojnë ligjvënësit nëpërmjet skeduleve të rryshfetut për të miratuar ligje të cilat i shërbejnë interesave të tyre personale, duke rritur kostot mbi mirëqënien sociale. Në modelin e prezantuar nga Fredrikkson dhe Svensson (2004) ka një lidhje negative ndërmjet korrupsionit dhe stabilitetit politik. Nëse një vend ka korrupsion të lartë, por paqëndrueshmëri

politike të lartë atëherë grupet e interesit do të marrin një normë kthimi negative nga rryshfetet e tyre, dhe në këtë mënyrë ligjet mjedisore janë subjekt më i një ndikimi më të ulët prej tyre.

Pyetja që lind natyrshëm është: Cilat janë shanset që procesi politik do të arrijë të miratojë ligje të tilla?

Për t'iu përgjigjur kësaj pyetjeje së pari duhet të hedhim një sy ne sjelljen strategjike që manifestojnë grupet e interesit që përfshihen. Kemi firmat, të cilat nuk janë të interesuara të promovohen ligje të tilla, pasi kjo do të thote kosto me të larta dhe detyrimisht më pak fitime. Së dyti, vetë përfaqësuesit e lëvizjeve ambientaliste që interesohen për më shumë pushtet dhe më shumë fonde në dispozicion gjithashtu kemi dhe ligjvënësit të cilët zgjidhen nëpërmjet procesit demokratik.

Teoria e lojës sugjeron që në fakt politika mjedisore është një lojë me konflikt zero. Kjo rrjedh vecanërisht nga natyra e vecantë e burimeve në fjalë si dhe vështirësia për të përcaktuar të drejta pronësie mbi to. Firmat përdorin, ujin, ajrin, token publike, burime të cilat na përkasin të gjithëve por mbledhin përfitimet duke shpërndarë kostën mbi të gjithë komunitetin, duke krijuar kështu eksternalitete negative. Vecanërisht firmat e mëdha të cilat kanë akses në burime të shumta kanë një fuqi të madhe lobimi mbi ligjvënësit, të cilët nga ana tjetër veprojnë në emër të maksimizimit të fitimeve të tyre. Në anën tjetër, ambientalisët gjithashtu ndjekin interesin e tyre personal duke kërkuar më shumë ndikim dhe më shumë pushtet. Fakti që këto burime s'i përkasin askujt i jep mundësi ligjvënësve të përdorin ata në varësi të faktit se cili krah ofron më shumë përfitime, duke krijuar kështu renta të vazhdueshme.

Teoria e lojës ofron një nga argumentët më të fuqishëm në kundërshtim të Hipotezës së Porterit. Duke qënë se ligjet mjedisore janë produkt i një procesi politik që gjeneron eksternalitete negative, duket më efciente t'i drejtohem tregut, dhe lejeve të ndotjes për t'i rregulluar ato. Shumica e studimeve argumentojnë që mjeti më efcient për të adresuar eksternalitetet e ndotjes është një taksë Pigouiane. Rritja e kostove mbi firmat do t'i stimulonte ato të investonin në teknologji "të gjelbra", duke e reduktuar outputin e tyre deri në pikër kur kostot barazojnë mirëqënien marxhinale sociale.

Politika për mbrojtjen e mjedisit dhe ekonomiksi i sjelljes: Pse nuk sillemi gjithmonë në mënyrë racionale?

Nga ana tjetër duket sikur studimet në ekonomaksin e sjelljes i ofrojnë suport hipotezës së Porterit. Edhe pse interesi që i është kushtuar ekonomiksit të mjedisit është i vonshëm, kjo disiplinë po sjell pikëpamje shumë interesante për të shpjeguar pse edhe tregjet dështojnë në rregullimin e eksternaliteteve mjedisore, ose pse nuk kemi tregje për disa nga ato. Për më tepër ajo hedh një hap drejt paradigmës ekonomike evolucionare të *Homoeconomicus*, në të cilën anomalitë në preferencat dhe në sjelljen strategjike të firmave shpjegohen nëpërmjet sjelljes altruiste.

Edhe pse sjellja altruiste është një koncept i ri, ajo arrin të shpjegojë pse aktorët

ekonomikë jo gjithmonë veprojnë në funksion të maksimizimit të dobisë së tyre, duke shkaktuar kështu sjellje të cilat teoritë ekonomike standarte nuk arrijnë t'i shpjegojnë. Megjithatë sjellja altruiste ka qënë shumë e vështirë për t'u izoluar në eksperimentet e Teorisë së Lojës, ajo ka ofruar zgjidhje të reja për PM. Aktorët ekonomikë do të manifestojnë sjellje altruiste edhe në situatat më të paimagjinueshme (Schogren and Taylor 2008). Asaj që nuk i është gjetur përgjigje deri tani është se c'pjesë e sjelljes altruiste është gjenetike dhe c'pjesë kushtëzohet nga mjedisi i jashtëm

Le të rikthehemi tek Hipoteza e Porterit. Disa nga argumentat që sjell ekonomiksi i sjelljes janë:

1. Manaxherët janë të kushtëzuar nga e tashmja, kështu që ata i japin një peshë më të madhe të sotmes dhe kanë tendencë që t'i shtojnë në kohë kostot. Manaxheri kundërshtar i rriskut do të pranojë vetëm ato projekte, norma e brendshme e kthimit të cilave tejkalon kostot e tij. Megjithatë, për shkat të kësaj tendence, ata mund të eliminojnë projekte të cilat mund të sjellin përfitueshmëri në afatgjatë dhe të përmirësojnë performancën e tyre ambjentaliste. Ligjet më të forta mund të shërbejnë si nxitës për manaxherët që të veprojnë në mënyrë të sofistikuar.
2. Si rezultat i asimetrisë së informacionit firmat kanë tendencë të mbivlerësojnë rriskun e dështimit të projekteve të kërkim zhvillimit duke reduktuar kështu investimet në teknologjitë e gjelbra. Ligjet ambjentaliste më të ashpra do t'i nxisin firmat të investojnë në projekte të cilat në rrethana të tjera do t'i kishin refuzuar.
3. Konkurrenca ndërmjet firmave në një industri të caktuar nuk është perfekte. Duke ushtruar ligje më të ashpra kjo mund t'i sigurojë industrisë vendase një avantazh konkurrues. Firmat do të kenë mundësinë të transformojnë disa nga kostot e tyre variabile në kosto të zhytura duke rritur në këtë mënyrë ekonomitë e shkallës.

Deri tani janë zhvilluar shumë studime për të përcaktuar vlefshmërinë praktike të Hipotezës së Porterit, megjithatë provat empirike të deritanishme akoma nuk tregojnë një lidhje pozitive të fuqishme ndërmjet ashpërsisë së ligjeve mjedisore dhe zhvillimit të patentave.

Ndikimi në inovacion-Brunnermeier dhe Cohen (2003) sugjerojnë që ekziston një lidhje pozitive e dobët ndërmjet ligjeve më të ashpra dhe inovacionit.

Produktiviteti- shumica e studimeve sugjerojnë që ligjet mjedisore kanë një impakt negativ në produktivitet. Vetëm një pjesë shumë e vogël e firmave i përmbahen parashikimeve të Porterit.

Transferimi i produkteve- Konsumatorët kanë një tendencë në rritje për të konsumuar produkte të gjelbra. Gjithsesi akoma nuk mund të themi se si ligjet më të ashpra ndikojnë me saktësi zgjedhjen konsumatore.

Ndikimi në kapital- në këtë rast, teoritë tradicionale marrin epërsi. Studimet përcaktojnë që kuadri rregullator mbi mjedisin nuk promovon investimet në

industritë ndotëse dhe rrit moshën mesatare të kapitalit. Kjo ndodh pasi legjislacioni aplikohet vetëm mbi teknologjitë në momentin e miratimit të tyre duke reduktuar incentivat për investime në teknologji të reja. Fundja cili do të ishte përfitimi nëse në të ardhmen do të aplikoheshin ligje akoma më të ashpra të cilat do të ulnin efikasitetin e teknologjisë së kohës?!

Ndikimi në performancën financiare– akoma nuk mund të thuhet dicka e qartë në këtë aspekt por studime empirike janë në vazhdim për të përcaktuar efektin e kuadrit rregullator mjedisor mbi performancën financiare.

Një vështrim i shkurtër mbi politikën për mbrojtjen e mjedisit në Shqipëri

Një mjedis i ndotur ndikon në mirëqenien e një komuniteti. Efektet negative të saj nuk shtrihen vetëm në ndryshimet klimaterike por dhe në ndotjen e ujërave, ndotjen akustike e kështu me rradhe. Gjithsesi, efekti i ngrohjes globale është pasoja më e dukshme e gjithë veprimtarisë njerëzore. Sektorët me ndotjen më të lartë në Shqipëri janë transporti, industria dhe sektori energjitik².

Për sa i përket zhvillimit të një politike mjedisore, Shqipëria ngelet e kufizuara në masat urdhër dhe kontroll të kuadrit rregullator. Në vitet e fundit janë adoptuar disa ligje për sa i përket mbrojtjes së ajrit dhe mjedisit, në kuadrin e harmonizimit të legjislacionit me atë të BE³. Gjithashtu në 2006 u nënshkrua Protokollin për Regjistrimin dhe Transferimin e Ndotësve.

Objekti është të arrihen standartet e përcaktuara duke përmirësuar cilësinë e shëndetit, dhe gjithashtu të arrihet dhe plotësimi i direktivave të BE. Megjithatë është shumë e rëndësishme përcaktimi i një strategjie të saktë për të përballuar këtë problem; duke filluar që nga rritja e shpeshtësisë së matjeve, zgjerimi i bazës së të dhënave sidomos në lidhje me performancën e investimeve të reja; dhe identifikimi i projekteve që mund të reduktojnë emisionet e lëndëve ndotëse.

Duke qenë se deri tani politikat mjedisore janë kufizuar në hartimin dhe zbatimin e ligjeve, duhen marrë në konsideratë dhe prezantimi i mjeteve me bazë tregun si dhe çështje më e rëndësishme matja e efikasitetit për secilin nga këto instrumenta. Deri tani përpjekjet në këtë drejtim janë në fazën fillestare, por mbase rritja e interesit të përgjithshëm mbi problematikën e ngrohjes globale do të ushtrojë ndikimin e saj për përmirësimin e këtij procesi.

2 Shfaqet më të mëdha të ndotjes janë nxjerrja dhe përpunimi i naftës, ngrohja e shtëpive dhe industria e cimentos

3 Ligji No 8934 5/09/2002 për mbrojtjen e mjedisit (i ndryshuar me ligjin No 9890 20 Mars 2008), përcakton faktorët kryesorë të gjendjes, influencës dhe rëndësisë në ndotjen e ajrit.: Ligji Nr 8897 i 16 Maj 2002 për mbrojtjen e ajrit nga ndotja përcakton burimet e ndotjes dhe bën klasifikimin e tyre në burime me impakt të rëndësishme dhe burime me impakt të vogël: VKM No 435 dt 12 Shtator 2002 aprovohej kuotat e emisionit të CO₂: VKM No 803 dt 4 Dhjetor 2003 përcaktohen normat e cilësisë së ajrit: VKM No 248 dt 24 Prill 2003 përcaktohen kuotat e përkohëshme të CO₂: VKM No 147 dt 21 Mars 2007 mbi cilësinë e hidrokarbureve

Konkluzione

1. Hipoteza e Porterit është një argument i guximshëm që sugjeron se kur ligjet për mbrojtjen e mjedisit janë të ashpra dhe fleksibile ato do të nxisin inovacionin dhe përmirësojnë avantazhet konkurruese të firmave
2. Mendimi ekonomik tradicional e quan këtë hipoteze naive, e cila nuk bazohet në matjen e kostove dhe përfitimeve, dhe nuk është përfaqësuese e realitetit ekonomik në shkallë të gjërë.
3. Ekonomiksi politik I mjedisit dhe Teoria e Lojës, sugjerojnë që sjellja strategjike e aktorëve që marrin pjesë në hartimin dhe miratimin e politikave mund të vërë në dyshim serioz hipotezën e Porterit.
4. Ekonomiksi i sjelljes sugjeron që anomalitë që shfaqen në preference janë përjashtimi jashtë sjelljes optimale që sugjeron ekonomiksi tradicional, dhe hipoteza e Porterit mund të jetë një alternative e dobishme për krijimin e një politike efektive për mbrojtjen e mjedisit.

Bibliografia:

- Ambec, B. (2006, January 10). Can environmental regulation be good for bussiness? An assesment of PH. *Energy studies Review Second Volume* , p. First Article.
- Costanza, R. (1987). Social Traps and Environment Policy. *Bioscience vol 37 no 6* , 404-412.
- J. Shogren, L. T. (2008). On behavioral economics. *Oxford University Press: Environmental Economics and Policy* , 26-44.
- K. Palmer, W. O. (1995). Tightening environmental standarts:The benefit-cost or the no cost paradigm. *The Journal of economic perspectives* , 119-132.
- M. Porter, C. v. (1995). Toward a new conception of environment-competitiveness relationship. *The journal of economic perspectives* , 97-118.
- P. Lanoie, J. L. (2008). Environmental Policy,Innovation and Performace: New Insights on Porter Hypothesis.

Abstracts

The study of trade flows based _____ on the gravity trade model – the case _____ of Albania _____

Engjell Pere - Godiva Rëmbeci - Arianit Shkurti

ABSTRACT. The principle idea of this paper is to analyze bilateral trade flows between Albania and other countries based on gravity model of trade. As in the classic model of gravity, the base of analysis are exports - imports flows between Albania and other countries, as well as factors influencing these flows, as for example size of respective economies, distance between countries, differences in economic development, existence of economic agreement, etc..

The aim of the model is to highlight in the case of Albania, the impact of those factors on the economic international trade. Actually, there are already known the main partners of Albania regarding export and import countries. In this point of view, intend of the paper is to go further in the analysis, studying in detail the influence of the factors mentioned above.

In this contest, analyzing the export and import flows, in the paper are taken in consideration determining factors: (i) the size of the Albanian economy and that of different countries, which is specified in the respective countries' GDP, (ii) relative advantages between countries, expressed in labor intensity and concretized in the difference between GDP per capita in Albania and other countries, (iii) geographical distances between countries, (iv) real exchange rate as an important factor affecting trading relations between countries, (v) changes in price competitiveness, reflected

in purchasing power parity between countries, and (vi) the existence of special trade agreements between Albania and other countries.

As the database in the paper is used *CHELEM-French CEPII database*, which provides a better complexity of all data needed to the model and presents in the mean time an objective rating system in international view. The number of countries included in the study is 15, including the main countries trading with Albania. The period of analyse is that of the years 1991-2009, as the whole period, and split also in two periods: 1991-2000 and 2001-2009.

The Reform of drinking and waste water sector development: Progress, results, analysis and evaluation

Arben Bakllamaja

ABSTRACT. Water and sewerage services over the past 20 years have improved constantly. During this period, like in other former communist countries, a number of reforms have taken place in the fields of macroeconomic stabilization, price liberalization, reduction of direct subsidy, transformation of state enterprises into commercial entities, establishment of regulatory systems, private sector participation in the public service, including water and sanitation.

In the meantime, public companies of water and sanitation are still suffering from serious problems of operational and financial efficiencies. The gap between the costs and tariffs is narrowing slower than anticipated. A perennial problem is the old fashion management of the companies, and the dilapidation of the network. The experience of former communist countries has shown that reforms that aim establishment of the regulatory system of the public services, strengthening of the institution capacities and establishment of law enforcement are the most difficult and take more time to achieve the desired objectives. This is the case in Albania, as well.

Countries, which have put their emphasis development and functioning of the legal and regulatory framework, and corporate governance of the public companies, have made faster progress in the reform implementation comparing with other countries. This article makes the evaluation of the preparation and implementation of the water and sanitation sector reform in Albania, results achieved in the

performance of the sector over two decades of the transition period. Additionally, we want to prove that the utilization of the methods of programme evaluation, by OECD and EC countries is a must for developing better policies, and for efficient implementation of capital investments in the water and sanitation sector, in order that achieved objectives are sustainable.

National Culture and women _____ in Leadership _____

Edlira Gjuraj (Tukaj)

ABSTRACT. New global and economic developments are reshaping the profile of leadership. It is not only the recognition and assessment, but also the proper management of diversity in organizations, that create today competing advantage. Scholars and consultants of social and managerial areas, since the '80s of the 20th century, have addressed gender issues of leadership, aiming to explore, based on various research methods, the presence and/or the nonpresence of gender distinctions in leadership styles (Eagly & Johnson, 1990). Managing diversity is an issue belonging to all, and to achieve this requires change in leadership behaviour, through training programs, establishing new visions of diverse organizations, working out strategies and selection of techniques in order to make diversity the engine of change and success. When cultural dimension is added to the gender dimension of diversity, certain alternatives and solution models in a certain cultural setting, can not be easily implemented in another cultural setting. This diversity, at least bidimensional, requires specific analyses to come to concrete solutions.

This article is mainly focused on the impact of one of the cultural dimensions, the masculinist one, on the nonsuccess of women in leadership in Albania. Studies prove that women demonstrate more often today some of their leadership behaviours, considered as more critical in order to face the global challenges of the future. (Desvaux & Devillard, 2008). It is also treated here whether there are the deviances from this world trend, and if these trends are of cultural origin.

Does the flat tax work? _____

Enea Zafiri

ABSTRACT. One of the main promises of the flat tax is the positive effect on the efficiency of the fiscal system. To control for this effect, 14 e-communist countries which undertook the flat tax reform after the year 2001 are analyzed. This sample is selected because those countries were very determined on the flat tax reform, lowering their tax level far more than the previous levels. To compare the efficiency of their fiscal system, a database of the World Bank “Paying Taxes”, which ranks every year the fiscal systems of about 180 countries, is used. Looking the relative ranking of the selected countries on this database for a 5 years period (2007-2011), we conclude that, in most of the cases, the flat tax does not significantly improve the fiscal system. Excluding Macedonia and Georgia, the efficiency of the fiscal systems of all other countries of the sample remain more or less the same despite the reform of the flat tax. Meanwhile, in Rumania are appearing the negative effects of flat tax on the distribution of incomes. It is recommend to the ex-communist countries to abandon the flat tax, replace it with a progressive tax and adapt their legislation to the one on the developed countries.

The collapse of a state: Rise and fall of Albanian's financial pyramids in 1997 _____

Adrian Civici

ABSTRACT. In 1997, the economy, finances and the entire state and Albanian society recognized one of the worst crises of their history. Several hundred or thousands of people who completely lost their money, billions of dollars swallowed by a rentiere firms system of Ponzi- Type, a whole country paralyzed, and the majority of people in revolt, the army and police were totally destroyed, and millions of guns were in the arms of population, thousands of dead and wounded, without ever being clear who was really “enemy”, thousands of Albanians fled as refugees to Italy, Greece, etc..What seemed to happen to Albania was a real economic, political and social apocalypse. It took the intervention of foreign military forces, mainly Italian, in order to calm the country, and to resume a normal life and activity.

The negotiations between Albania and Italy for the implementation of the Treaty of Peace with Italy – 1947

(The implementation of the economic and financial matters arising from the Treaty of Peace with Italy)

Ksenofon Krisafi

ABSTRACT. The Peace Treaty with Italy, signed in Paris on February 10th, 1947, ended the state of war between Italy and the other States, former member of Anti-Fascist Coalition during the WWII, among which Albania was included. In the preamble of the Treaty and in a number of his articles has been said and proved the Italy's responsibility for the war and during the war. The Peace Treaty defined explicitly the status of Albania and its juridical position in relation to Italy and in general with the system created by the Peace Treaty. It was précised that every member of the United Nations, at war with Italy and who has not signed this treaty, as well as Albania, may accede to the Treaty, being considered immediately after accession, as Associate State in the implementation of the Treaty. This article gives Albania the opportunity, even though he had not signed the Treaty, to be a part of its general provisions. Treaty of Peace with Italy provided the final arrangement between the two countries in all matters, of economic and financial natures, arising from the provisions of the Treaty of Peace, and settled that the exact reparations and delivery of goods, items, equipment, etc., will be realized after a special agreement that will signed between concerned countries and Italy. On this basis, the Albanian government started the demarches with the Italian government to precise the next necessary measures needed to perform its implementation. After nearly 10 years of the persistent efforts was achieved in the end of negotiations between two countries and was signed in Rome on June 22, 1957, an Agreement which regulate all the matters arising from the Treaty of Peace signed in Paris on February 10, 1947, between the Allied and Associated Powers and Italy.

The new scheme of higher education financing _____

Henri Çili

ABSTRACT. What is today, the fundamental feature of the role of the Albanian state, the Albanian government and politics in general in higher education, which has an uninterrupted tradition, as the ruling party were left, and when they were right? There is only one conclusion: all measures are quantitative or populist nature, or a statist nature. However, the problem of financing higher education and his concept, there should be no distinction between public and private, and there should be considered as a whole for the entire system.

Role of Higher Education in Economics and its forms of financing _____

Engjell Pere - Luljeta Minxhozi

ABSTRACT. In the new theories of economic growth increasing educational and professional level is at the core being a fundamental element which characterizes the human capital. On the other hand, social development in many countries has changed the social structure of society, increasing significantly the demand for education. In this regard, reforms in higher education for several years represent a phenomenon which perhaps characterizes the most social and economic development in many countries.

Problems that have faced and face this development include a wide range of highly controversial aspects and also they affect very important issues quantitatively and qualitatively. This paper is not intended to address the totality of these aspects. Its perspective is mainly related to economic and financial issues that characterizes today the development of higher education. This aspect, though not often treated in public discussions, in fact associates all the changes observed in this area, if not in some cases, it is at the core of these changes. More widely the problem can be viewed as a trend of transforming the public sector itself, going so in the debate of

the controversial partnership between this sector and the private sector.

In this perspective the paper aims is to treat the whole content of the reform of higher education funding, putting the spotlight on the relationship between the development of public and private education. The main idea of the paper is to treat and argue, both theoretically and practically, that the development of higher education today makes it necessary to harmonize the development of public education with that of private funding in this area.

American model of the university _____ and its advantages in global market _____ of knowledge and economy _____

Fatos Tarifa

ABSTRACT. The urgency of the higher education debate over the past decade stems in part from the now pervasive recognition that higher education is a wise and cost-effective investment for national economies. First-class higher education and research systems are understood to be crucial national assets in today's knowledge-based economy. On the individual level this is matched by the widely shared sense that higher education and a university or college degree are essential for one's career and upward social mobility. In this article we argue that of all four traditional and most respected university models—American, Continental, French and British—the research-oriented American model, defined by diversity, autonomy and philanthropy, enjoys global superiority. It is argued that in addition of its obvious advantages conferred by sheer size and wealth, as well as by a broadly competitive ethos, the superiority of the American university system has to do with the system of governance of both private and state universities.

BRICs countries in the global _____ architecture of the 21th century _____

Donald Shena

ABSTRACT. This article represents an analysis of the challenges and developments expected to occur on the global stage in the next two to three decades. It offers a perspective on the new global order, making no difficult or unrealistic predictions. The analysis focuses specifically on a new phenomenon, such as the rise of Asia's great powers (mainly China and India), as well as the rise of Brazil and the awakening of Russia, countries that have become known in the economic and political jargon acronymously as BRIK. The conclusion in which it is arrived is that neither the European Union nor the BRIK countries will be able to seriously challenge the United States in its role of global leadership for a relatively long time.

Chinamania: Why China can not _____ pass America as the world's scientific _____ superpower? _____

Fatos Tarifa – Përparim Fuga

ABSTRACT. A report on the global scientific collaboration in the 21st century, published by the Royal Society in the U.K., in March 2011, concluded that China, which ranked second in the world regarding the number of scientific papers published in academic journals last year, leaving the United Kingdom behind, will very soon, by 2013, surpass the United States, therefore becoming "the world scientific superpower". By taking a critical stance toward the linear interpretation of data, the methodology on which this report is based, we question the aforesaid conclusion, arguing that, even with regard to its scientific output, China is and will remain for a long time to come much behind the United States.

An econometric summary on _____ the multidimensional modelling _____ analysis. The transfer of prices in _____ agricultural products _____

Avis Andoni

ABSTRACT.Albania, the country which is described as the less developed among the former states of the centralized economy socialist system, was the last one to join the transition towards democracy. The transition to a free market has been characterized by many transformations and imbalances, both in economic and social terms. Above all, it is the agricultural sector which has undergone radical transformation. In fact this sector represents the main vector of the Albanian economy. It does however manifest important insufficiencies.

The objective of this study is the analysis of the agricultural market condition in order to offer solutions to re-establish its growth. As a matter of fact, this study will attempt a closer analysis of the insufficiencies of the agricultural market in order to detect its mechanism and dynamic. This analysis will enable us to understand it better and as a result, propose the economic actions which need to be taken. In order to answer our questions, we will be using some methods of multidimensional econometry. More specifically, the VAR and VECM models will be used to analyse the dynamics and interconnections of the economic variables taken in consideration. These models will enable an analysis of the price transfer phenomenon on the products basket which we possess.

Optimal use of observed data on the _____ distribution of statistics $D^+(n_1, n_2)$ _____

Hysen Binjaku – Teuta Xhindi

In many practical problems, same as in studies of the phenomena of different scientific and theoretical fields and disciplines, particularly economic ones, comes up the need for optimal use of observed data. In order to these data can provide

accurate information for all the population, is necessary construction and study of such statistics, through which checked the authenticity of information collected and processed. Too often, such efforts converge in the study of the Homogeneity of Data.

The study of the homogeneity of the samples is conducted by non parametric control of the hypotheses set by building tests for the case of one or several samples. Many authors have attempted to construct appropriate tests for the control of non parametric hypothesis. Their theoretical studies include asymptotic problems associated with these statistics allowing the use of similar formulas for non small volumes of samples. In this paper we analyse results achieved by two different authors for the same statistic and there is an attempt on our part to compare these results.

An overview of the use of _____ GPS technology and sensors in a _____ transport business managing _____

Tamara Luarasi – Muhamet Avdyli

ABSTRACT. This abstract describes the goal, methodology, and the technologies that will be used in a doctoral thesis. The study uses modern technologies in the design of a management system in a transportation business as it relates to the vehicles' transportation activity. The objective of the study is the design of an Information System about the use of vehicles, their control, planning, and the increase of transportation efficiency. This system becomes a reality due to the existing GPS System, its relation with sensors placed inside the vehicle, and the use of this information with modern programming technologies.

Detection of autocorrelation in _____ econometric models and their _____ evaluation methods _____

Raimonda Dervishi – Shkëlqim Kuka

ABSTRACT. In economy, the independence of an independent variable from other explanatory variables is rarely instantaneous. For a number of psychological, technological as well as institutional reasons, an independent variable impacts the dependent one within a time interval that is called *lag*. The first part of this article focuses on two types of econometric models: the *distributed lag model* and the *autoregressive model*, providing an evaluation of the first model using Koyck approach. An attempt is made to rationalize the Koyck approach in order to predict the results that may derive from its use, as well as the possibility of its adjustment through the Stock model. The second part of the article provides an evaluation of autoregressive models through the examination of the instrumental variables and autocorrelation using the “h Durbin” test.

Porter hypothesis and environmental _____ policy: Literature review on environment _____ economics and economic paradigms _____

Matilda Tola

ABSTRACT. “It is not from the benevolence of the butcher, the brewer, or the baker that we expect our dinner, but from their regard to their own self-interest. We address ourselves not to their humanity but to their self-love, and never talk to them of our own necessities, but of their advantages” (Smith, A).

When Adam Smith referred to personal interest as the drive that moved markets to equilibrium, he implied that was human ego that moved economy into Pareto efficiency and brought change and innovation. Anyway, nothing is so perfect in

reality. It the blind pursue of self interest by firms, individuals and governments, the abuse to natural resources, that puts us ahead one of the greatest challenges we have ever faced; global warming.

Changing our life style, means to reduce consumption and welfare in the long run for individuals, and reduced profits for the firms. Regulations are stringent but not tough enough due to the lobby power this corporations have, (the Clean Air Bill case) so compromise seems far away in the horizon, making environmentalist movements even more tense. But there is a medial way, first introduced by the economist M. Porter that stringent environment law can improve competition.

This paper will discuss the rationales behind such hypothesis, making a literature review; discuss empirical studies conducted by other countries and discuss possible policy outcomes which may be implemented in policymaking.